


Raporti Vjetor 2007

Raport i hollësishëm
mbi punën e policisë

IPK-ja është projekt i misionit
të OSBE-së në Kosovë për
krijimin e kuadrove

Inspektorati Policor i Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme



Ministria e Punëve të Brendshme Qeveria e Kosovës

© 2008 Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)

Ministria e Punëve të Brendshme, Rr. Armend Daci nr 1, Bregu i Diellit, Prishtinë.

E drejta e autorit

Dizajni dhe formati nga Burim Brahim, Departmenti për Siguri dhe Rend Publik, Misioni i OSBE-së në Kosovë

osce



Inspektorati Policor i Kosovës

Raporti vjetor

2007

Raport i hollësishëm mbi punën policore

I prezentuar Ministrit të Punëve të Brendshme

Në bazë të nenit 9.1(b) të Rregullores së UNMIK–ut 2005/54

Shkurtesat

KE	Kryeshefi ekzekutiv, Inspektorati Policor I Kosovës
KIE	Këshilli i Evropës
DSPS	Departamenti për Siguri dhe Rend Publik (Misioni i OSBE-së në Kosovë)
KEEP	Kodi Evropian I Etikës Policore
BE	Bashkimi Evropian
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SHSHPK	Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme (Kosovë)
MD	Ministria e Drejtësisë
OMnK	Misioni i OSBE-së në Kosovë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
NJSP	Njësitë i Standardeve Profesionale, Shërbimi Policor i Kosovës
KB	Kombet e Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Fjala hyrëse e Ministrit	7
Njoftim nga Kryeshefi ekzekutiv	9
PJESA I – INSPEKTIMET E JASHTËZAKONSHME	
Shqyrtimi i sjelljes së pjesëtarëve të SHPK–së gjatë trazirave qytetare të datës 10 shkurt, 2007	14
Deklarata e Kryeshefit Ekzekutiv mbi mbikëqyrjen e pavarur të hetimeve të UNMIK–ut lidhur me vdekjen e dy personave gjatë demonstratave të qytetarëve më 10 shkurt, 2007	36
Inspektimi i SHPK–së lidhur me pajtueshmërinë me nenin 7 të Rregullores 2005/54	49
Inspektimi i SHPK–së lidhur me menaxhimin e laboratorit të krim–teknikës në SHPK	60
Lista e rekomandimeve kryesore – Inspektimet e jashtëzakonshme	68
PJESA II – INSPEKTIMET E ZAKONSHME	72
Kryerja e detyrave në SHPK– Menaxhimi në fushën e armës së zjarrit	73
Kryerja e detyrave në SHPK – Menaxhimi i ankesave dhe disiplinës	86
Kryerja e detyrave në SHPK – Menaxhimi i buxhetit dhe financave	98
Kryerja e detyrave në SHPK – Menaxhimi i zhvillimit të karrierës	109

Kryerja e detyrave në SHPK – Menaxhimi i Policisë Kufitare	129
Kryerja e detyrave në SHPK – Menaxhimi në fushën e trafikut rrugor	146
Kryerja e detyrave në SHPK – Menaxhimi i Parkut të Automjeteve	165
Kryerja e detyrave në SHPK – Menaxhimi I ndërtesave	182
Lista e Rekomandimeve kryesore – Inspektimet e zakonshme	215
PJESA III – HETIMI I SJELLJEVE TË KËQIJA	
Hetimi i ankesave – Trajnimi i hetuesve të IPK-së	224
Lista e inspektorëve të IPK-së	228
Ekipi për implementim i OSBE-së	230
Shtojcat	232

Fjala hyrëse e Ministrit



Është kënaqësi e imja ta paraqes *Raportin e Dytë Vjetor të Inspektoratit Policor të Kosovës (2007)*. Ky dokument ofron dëshmi të mjaftueshme që Inspektorati Policor është zhvilluar edhe më, në rolin e tij të sigurimit të përgjegjshmërisë policore në Kosovë dhe që Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) është duke iu përgjigjur në mënyrë pozitive qasjes së re të mbikëqyrjes policore. Ky vit ka qenë një vit i sfidave të konsiderueshme, po njëlloj edhe i sukseseve të mëdha për Ministrinë, Inspektoratin dhe SHPK-në.

Shprehja *përgjegjshmëri policore* është e një rëndësie të veçantë për shkak të rolit unik të policisë në një shoqëri demokratike. Policia posedon autorizime të konsiderueshme detyruese dhe një masë të madhe të lirisë së veprimit në përdorimin e këtyre autorizimeve. Ata mund të arrestojnë, të kontrollojnë persona dhe pronat e tyre, të konfiskojnë gjësende, të marrin shenjat e gishtërinjve dhe mostrave trupore dhe të përdorin të gjitha nivelet e forcës fizike ndaj qytetarëve. Zyrtarët policor kanë autorizim të ligjshëm për të privuar qytetarët nga liria e tyre, dinjiteti dhe –në raste të jashtëzakonshme –edhe nga jetërat e tyre. Shoqëria i lejon këto autorizime shtypëse në mënyrë që policia të veprojë në mbrojtjen e të drejtave individuale dhe të shoqërisë si tërësi. Në të njëjtën kohë shoqëria kërkon që mënyra sipas së cilës këto autorizime të rëndësishme ushtrohen, të jetë rreptësisht e rregulluar me ligj dhe procedura përkatëse. Si një Agjencion Ekzekutiv i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Inspektorati Policor ofron funksionin e nevojshëm për të siguruar mbikëqyrjen e SHPK-së në emër të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Ky raport vjetor është përgatitur në përkrahje të drejtpërdrejtë të aspiratave të Ministrisë, të prezentuara në Planin Strategjik për tri vitet e ardhshme. Theks i veçantë është vënë në polici dhe çështjet që kanë të bëjnë me policinë si dhe në raportin zhvillimor në mes të SHPK-së dhe Ministrisë. Veçanërisht, aktivitetet kryesore të Inspektoratit Policor në vitin 2007 kanë mbështetur dëshirën e madhe të Ministrisë për të zhvilluar marrëdhëniet e veta me SHPK-në dhe për të ofruar “shërbime policore cilësore për qytetarët – shërbime këto të cilat janë efektive, efikase, të drejta dhe transparente”¹.

Blerim Kuqi

Ministër i Punëve të Brendshme

Qeveria e Kosovës



Njoftim nga kryeshefi ekzekutiv



Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është mekanizëm i mbikëqyrjes policore i cili është plotësisht i pavarur nga policia dhe i përbërë nga shërbyes civil. I krijuar nën autoritetin e Rregullores së UNMIK–ut 2005/54 dhe Urdhresës Administrative 2006/9, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është Agjencion Ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Agjencioni kombinon dy funksionet primare në ndjekje të parimeve të përgjegjësisë dhe

transparencës – shtyllat e policisë demokratike. Së pari, kryen funksionin e auditimit që përfshinë mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave nga ana e menaxhmentit në çdo stacion dhe departament policor, në kuptim të efikasitetit, efektivitetit dhe pajtueshmërisë me ligjin (roli inspektues). Së dyti, IPK–ja ka kompetenca për të hetuar të gjitha supozimet për shkelje të rënda² nga ana e zyrtarëve të SHPK–së të gjitha gradave (roli hetues)

Siç shpjegohet në legjislacionin përkatës, zyrtarët e IPK–së kryejnë një sërë ‘inspektimesh të rëndomta’, 12–14 në çdo vit fiskal. Ky proces përfshinë vizitat dhe inspektimet në secilin stacion dhe departament/njësit policor. Me anë të përdorimit të protokolleve të shkruara me kujdes (formularët për intervista të strukturuar dhe mbledhje të të dhënave), zyrtarët e Inspektoratit mbledhin, krahasojnë dhe analizojnë të dhënat lidhur me 14 aspektet e punës së menaxhmentit policor (p.sh inspektimi i trafikut rrugor, inspektimi i menaxhimit të hetimit të krimeve, prokurimit, financave, etj). Gjatë çdo inspektimi të rëndomtë, zyrtarët e IPK–së përqendrohen në një fushë tematike dhe kërkojnë informata nga burime të ndryshme në mënyrë që të krijojnë një fotografi të qartë lidhur me performancën aktuale të SHPK–së. Theksi vihet në efektshmëri (realizimi i qëllimeve themelore policore), efikasitet (realizimi i qëllimeve në mënyrën më ekonomike) dhe në pajtueshmëri me ligjin (përfshirë standardet e Kodit Evropian të Etikës Policore). Pasi që të analizohen të dhënat, ato përdoren si bazë e një Raporti të Përkohshëm lidhur me performancën policore që përfshinë rekomandimet kryesore për veprimet e ardhshme të Komisarit të Policisë së UNMIK–ut dhe personelit të lartë të tij/saj. Është bërë përpjekje për të siguruar që raportet e përkohshme janë të balancuara në mënyrë të duhur dhe që rekomandimet të jenë reale dhe të arritshme, për shkak të kufizimeve të buxhetit dhe burimeve tjera policore. Në vitet që vijnë, IPK–ja pret përgjigje specifike lidhur me rekomandimet e bëra, duke ushtruar presion në

² Legjislacioni i ri bën dallimin në mes të shkeljeve ‘të rënda’ dhe të ‘lehta’: këto të fundit hetohen nga Njësitit i Standardeve Profesionale, në emër të Komisarit, përderisa shkeljet e rënda disiplinore hetohen nga IPK–ja.

personelin e lartë të SHPK-së për bashkëpunim në procesin e vazhdueshëm të zbatimit të reformave. Në fund të çdo viti fiskal, i tërë materiali i Raporteve të Përkohshme bashkohet dhe publikohet në një raport vjetor lidhur me performancën policore.

Ekzistojnë një numër përparësish në lidhje me qasjen e mbikëqyrjes policore, nëse kryhet për disa vite:

- Me publikimin e raportit vjetor, IPK-ja ofron një 'dritare' në organizatën policore për qytetarët, përforcon përgjegjësinë e qytetarëve dhe parimet demokratike;
- 'Dritarja' publike krijon një forcë pozitive për ndryshime dhe reforma, pasi që zyrtarët e lartë e pranojnë detyrën e tyre si shërbyes publik të cilët janë përgjegjës për atë se çka bëjnë dhe si e bëjnë;
- Përdorimi i inspektiveve tematike dhe protokolleve ofron një strukturë të lehtë për përdorim gjatë inspektimit të punës së menaxhmentit dhe të procesit të ndryshimit të menaxhimit në një organizatë të madhe policore
- Përdorimi i rekomandimeve kryesore të cilat 'shqyrtohen sërish' në vitet pasuese, bën presion pozitiv te zyrtarët e lartë policor për të bërë ndryshime;
- Raportet e përkohshme dhe rekomandimet kryesore të cilat i përmbajnë ato, ofrojnë një kornizë dhe vëmendje për ndihmë financiare nga donatorë të ndryshëm për reforma policore
- Raporti i përkohshëm dhe rekomandimet ndihmojnë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe partnerët ndërkombëtarë që t'i përcjellin ndryshimet pozitive përbrenda organizatës policore si dhe pajtueshmërinë me standardet e Kodit Evropian të Etikës Policore.

Roli hetues i IPK-së operon në bazë të parimit si ankesat (e rënda) kundër policisë duhet të kryhen nga një organ i cili është plotësisht i pavarur nga organizata policore. Me implementimin e tij të plotë, në tetor të viti 2007, ky rol do të shkaktojë ndryshime të mëdha në sistemin e mëparshëm të ankesave, në të cilin sistem të gjitha ankesat kundër policisë janë hetuar dhe zgjidhur nga policët tjerë. Sipas legjislacionit të ri, çfarëdo ankese nga qytetarët do t'i drejtohen IPK-së me ç'rast ato do të vlerësohen dhe regjistrohen nga IPK-ja. Vlerësimi përfshinë përcaktimin nëse supozimi për shkelje të keqe-nëse vërtetohet do të rezultojë në vepër penale, shkelje të rëndë apo të lehtë disiplinore. Sikurse në të kaluarën, supozimet për vepra penale i dërgohen Prokurorit publik për veprime përkatëse. Ankesat për shkelje të lehta IPK-ja do t'ia dërgojë komisarit policor për hetime që do të kryhen nga Njësi i Standardeve Profesionale të SHPK-së, një njësi i përbërë nga policë të zgjedhur. Në rast të supozimeve për shkelje të rëndë ndaj pjesëtarëve të policisë së të gjitha gradave -përfshirë format e korrupsionit- zyrtarët e IPK-së do të kryesojnë hetimet. Nëse ankesa për shkelje të rëndë vërtetohet, atëherë përgatitet një dosje e cila i dërgohet

Këshillit për Emërime të Larta Policore dhe Disiplinë (KELPD): një organ ky i pavarur dhe përfaqësues, përgjegjës për dëgjimet disiplinore si dhe për përzgjedhjen e kandidatëve policor për pozitat e larta menaxhuese. KELPD-ja ka kompetenca për të vendosur nëse gjatë seancës dëgjimore, zyrtari policor është fajtor sipas akuzave dhe rekomandon dënimin. Megjithatë vetëm komisar mund ta shqiptojë dënimin. Të gjitha ankesat dhe hetimet pasuese përcjellën dhe monitorohen vazhdimisht nga IPK-ja duke siguruar që afatet kohore ligjore respektohen dhe se ankuesi informohet me të rejat. Ekzistojnë një numër përparësish në lidhje me qasjen e hetimit të ankesave ndaj policisë:

- Një sistem i cili në masë të madhe kontrollohet dhe monitorohet nga një organ plotësisht i pavarur nga policia dhe i përbërë nga shërbyes civil e jo nga zyrtarë policor, fiton besimin e qytetarëve dhe përforcon përgjegjësinë policore dhe parimet demokratike;
- Një organ i pavarur dhe civil mund të arrijë paanshmëri më të madhe në hetimin e shkeljeve të rënda dhe mbron të drejtat e zyrtarëve të cilët janë subjekt i supozimeve keqdashëse, duke i plotësuar kërkesat e KEEP-së;
- Një organ i pavarur dhe civil ka më shumë gjasa që të nxitë zyrtarët policor që të japin dëshmi kundër zyrtarëve tjerë policor – veçanërisht për mbikëqyrësit- të cilët janë të përfshirë në korrupsion;
- Një organ i pavarur dhe civil, për dallim nga njësitë policor përgjegjës për hetime disiplinore, mund të veprojnë si forcë shtytëse në eliminimin e korrupsionit dhe keqpërdorimeve të mundshme nga ana e policisë;
- Ndërlidhja me rolin inspektues do të thotë që në rast se zyrtarët e IPK-së gjejnë dëshmi të cilat mund të tregojnë për ndonjë shkelje disiplinore, ato dëshmi mund të sigurohen menjëherë dhe të fillojnë hetimet përkatëse.
- IPK-ja për dallim nga entitetet e ngjashme në regjionin e Ballkanit, është e autorizuar që të hetojë ankesat ndaj zyrtarëve policor më të lartë të Shërbimit Policor të Kosovës. Kjo qasje ndaj përgjegjësisë policore përqendrohet në shumicën e këtyre çështjeve që aktualisht pengojnë luftimin e korrupsionit policor në disa shtete, të cilat kanë në funksion një sistem ku vetëm policia mund ta hetojë policinë.

Inspektorati Policor është i përgatitur të hyjë në vitin e tretë të operimit të tij, është me rëndësi që të vërehet kontributi vital i Misionit të OSBE-së në Kosovë në zhvillimin e agjencionit. Që nga themelimi në vitin 2005, Misioni i OSBE-së ka marrë rolin udhëheqës për ta ndihmuar Ministrinë që të zhvillojë një sistem të fortë dhe të qëndrueshëm të mbikëqyrjes policore. Kjo punë përfshinë krijimin e kornizës së kërkuar ligjore për Inspektoratin Policor, përgatitjen e buxhetit për vitin e parë të operimit; përgatitjen e strukturës organizative, përkrahjet e punës dhe procedurat standarde të operimit; këshillim dhe ndihmë në procesin e përzgjedhjes së personelit

të IPK-së, përfshirë përdorimin e një testi pranues mjaft të vështirë e që kërkohet të shmang ndërhyrjet politike dhe ndihmojë në identifikimin e kandidatëve më të mirë, dizajnimin dhe implementimin e një programi trajnues gjithëpërfshirës në dy faza, që i përgjigjen funksioneve të inspektimit dhe hetimit. Në qendër të kësaj përpjekjeje ka qenë programi trajnues që ka pasur për qëllim që zyrtarët e posa emëruar të IPK-së t'i pajisë me njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të kërkuara për t'i kryer funksionet e tyre ligjore. Bazuar në qasjen të 'mësuarit duke vepruar' për arsimimin e të rriturve, programi i OSBE-së për krijimin e kuadrove ka pasur për qëllim ta vë IPK-në në gjendje operative brenda disa javëve. Agjencioni dëshiron t'iu shpreh falënderim të veçantë të gjithë pjesëtarëve të Ekipit Implementues të OSBE-së dhe në veçanti z. Frank Harris (Menaxher i projektit) dhe Steave Smith (Menaxher për trajnim).

PK-ja është e frymëzuar dhe kërkon që të vërteton pajtueshmërinë e policisë me Kodin Evropian të Etikës Policore në si një kornizë e standardeve të kryerjes së detyrave policore në mënyrë demokratike. Implementimi i suksesshëm i këtij mekanizmi mbikëqyrës do t'i bind të gjitha komunitetet në Kosove që SHPK-ja mund dhe do të jetë përgjegjëse, qoftë kolektivisht apo individualisht, në rast se dështon në ofrimin e shërbimeve në përkrahje të një shoqërie të sigurt dhe stabile ose në rast se vepron në kundërshtim me ligjin. Pasi që IPK-ja është plotësisht e pavarur nga organizata policore në mbikëqyrjen e saj dhe nuk është e ndërlidhur me ndonjë parti politike, është në gjendje që të gëzoj besimin e qytetarëve dhe të veprojë në mbrojtjen e parimeve demokratike të qeverisjes. Modeli i IPK-së ofron një strategji radikale megjithatë reale drejt përpjekjes për të reduktuar dhe eliminuar korrupsionin dhe keqpërdorimin nga ana e policisë.

Enver Rustemi
Kryeshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme





Pjesa I

Inspektimet e jashtëzakonshme

SHQYRTIMI I SJELLJES SË SHPK-SË GJATË TRAZIRAVE QYTETARE, NË PRISHTINË MË 10 SHKURT, 2007

PJESA I: HYRJJE

1.1 Në bazë të kërkesës së Ministrit të Punëve të Brendshme, ushtruesi i detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv ka kërkuar nga Inspektorati Policor ta bëjnë një inspektim të jashtëzakonshëm të zyrtarëve të SHPK-së të angazhuar në detyrë gjatë trazirave qytetare në Prishtinë, të shtunën më 10 shkurt të vitit 2007, në të cilat dy persona janë vrarë tragjikisht dhe mbi 80-të të tjerë janë lënduar. Ky inspektim i jashtëzakonshëm është kryer nga data 12 deri 25 shkurt, 2007 sipas nenit 4 të Urdhëresës Administrative 2006/9.

1.2 Qëllimi kryesor i inspektimit ishte që të përcaktojë dhe ta vlerësojë punën zyrtarëve të lartë të SHPK-së, të cilët kanë qenë përgjegjës për sjelljen e zyrtarëve të SHPK-së në zonën e rrugës 'Nëna Terezë', gjatë trazirave qytetare të së shtunës, më 10 shkurt. Posaqërisht, IPK-ja kërkoi që të vlerësojë mënyrën sipas së cilës mbikëqyrësit e SHPK-së kanë menaxhuar policët e tyre dhe si i kanë marrë parasysh planifikimet e tyre para ngjarjes, komandimin dhe kontrollën gjatë demonstratës si dhe mësimet që kanë mundur të mësohen si rezultat i ngjarjes tragjike.

1.3 Sa i përket fushëveprimit, inspektimi i IPK-së nuk ka pasur për qëllim që të hetojë çfarëdo ankese për sjellje të keqe – qoftë penale apo disiplinore – nga ana zyrtarëve të SHPK-së apo policisë civile të UNMIK-ut³. Hetimi i këtillë është ndërmarrë nga një ekip i emëruar nga Komisarari i policisë së UNMIK-ut. Fokus i këtij raporti është SHPK-ja. Inspektorati policor nuk përpiqet të vë fajin në mënyrë individuale por të identifikojë mënyrat në të cilat SHPK-ja mund të mësojë nga kjo ngjarje si dhe të përmirësojë performancën e saj gjatë ballafaqimit me trazira qytetare në të ardhmen.

1.4 Poashtu, ky raport nuk ka të bëjë me marrëveshjen në mes të Komisarit të policisë së UNMIK-ut dhe Ministrit të Punëve të Brendshme që Inspektorati Policor të kryej një mbikëqyrje të pavarur mbi hetimet e UNMIK-ut rreth vdekjes së personave gjatë trazirave qytetare. Rezultatet e IPK-së në lidhje me këtë çështje do të jenë subjekt i një raporti të ndarë, që do të publikohet pas përfundimit të hetimeve nga ana e UNMIK-ut.

1.5. Në kuptim të metodologjisë, Inspektorati ka siguruar dhe analizuar të dhëna nga një numër burimesh: metrazhet filmike të trazirave, materiale të briefingjeve policore, intervista zyrtare me zyrtarët e SHPK-së, të të gjitha gradave. Kjo punë ka rezultuar

³ Sipas ligjit të aplikueshëm të Kosovës, IPK-ja nuk ka autorizim që të hetojë ankesat për sjellje të keqe të personave të angazhuar nga UNMIK-u si policë civil. Përderisa Rregullorja 2005/54 dhe Urdhëresa Administrative 2006/9 e autorizojnë IPK-në të hetojë ankese për sjellje të keqe të zyrtarëve të SHPK-së, këto autorizime nuk do të zbatohen plotësisht derisa të përfundojë plotësisht trajnimi për hetuesi nga ana e ekipit implementues të OSBE-së. Ky program trajnues duhet të përfundojë në fund të shtatorit të vitit 2007.

në raportin e tanishëm i cili përshkruan mënyrën se si kanë vepruar policët e SHPK-së dhe si i tillë jep rekomandime të qarta se si SHPK-ja mund të përmirësojë veprimet e saja në raste të incidenteve në të ardhmen

1.6 Duhet të përmendet që qëllimi I këtij raporti është që të përmbledhë një sasi të konsiderueshme të informatave – disa qindra faqe – të cilat rrjedhin nga dokumentet procedurale të SHPK-së, metrazhet filmike dhe incizimet e intervistave të bëra nga IPK-ja me një numër të madh policësh të cilët kanë qenë të angazhuar në ditën e trazirave, më 10 shkurt.

1.7 Përveq pikave referuese të përshkruara më lartë, ky inspektim I jashtëzakonshëm ka për qëllim të jep rekomandime se si menagjerët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave në realizimin e qëllimve në vijim:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54, Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, Urdhëresën Administrative 2003/2 dhe legjislacionin përkatës;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP);
- Përkrahjen e menaxhimit profesional policor gjatë tubimeve të mëdha publike dhe trazirave qytetare në Kosovë;
- Për të ndihmuar në ofrimin e shërbimeve cilësore në përkrahje të tërë personelit të SHPK-së; dhe
- Për të identifikuar dhe shpërndarë praktikën më të mirë në menaxhmentin policor

1.8 Gjatë rrjedhës së inspektimit, personeli i Inspektoratit Policor ka vizituar dhe intervistuar punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Gjeneral, nënkolonel Sheremet Ahmeti
- Gjen. Major Reshat Maliqi
- Komandanti regjional dhe zëvendës komandanti regjional, Prishtinë
- Kryesuesi I departamentit për rend publik
- Zyrtarët e NJRMO-së të angazhuar në detyrë në trazirat qatetare të datës 10/02/07 (TË RASTIT)
- Zyrtarët e shërbimit të inteligjencës në SHPK, të angazuar në detyrë gjatë trazirave qytetare të datës 10/02/07 (TË RASTIT)
- Policët patrullues të SHPK-së të angazhuar në detyrë gjatë trazirave qytetare të datës 10/02/07 (TË RASTIT)

1.9 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike i cili parim është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore

Ngjarjet e mëparshme

2.1 Ngjarjet tragjike të së shtunës së 10 shkurtit, 2007, ishin të nxitura nga aktivitetet e një grupi të vogël me interesa politike të njohur si Vetëvendosja. Përderisa motivi kryesor i lëvizjes- pavarësia e Kosovës – e vë në pah aspiratën themelore të të gjitha partive politike shqiptare në Kosovë, Vetëvendosja përkrah politikën e jonegociimit, mosbashkëpunimit dhe antagonizmin ndaj UNMIK–ut, Qeverisë kosovare dhe Bashkësisë Ndërkombëtare. Kjo lëvizje u zhvillua nga KAN–i (Rrjeti aktiv i Kosovës), një grup etnik shqipëtar i cili u formua në vitin 1997 dhe kundërshtonte okupimin serb të Kosovës. Megjithëse *Vetëvendosja* është një grup relativisht i vogël (rreth 200–300 anëtarë aktiv), ata kanë ushtruar një numër metodash për tërheqjen e vëmendjes publike në mbështetje të pikëpamjeve të liderit të saj, Z. Albin Kurti. Përveç nxitjes për përkrahje përmes TV–së dhe intervistave për shtyp, përkrahësit e Z.Kurtit kanë gjuajtur vezë në ndërtesën e shtabit të UNMIK–ut dhe kanë shkruajtur moton e tyre ‘Vetevendosje – jo negociata’ në ndërtesa, semaforë, dhe shenja të komunikacionit në Prishtinë dhe jashtë saj. Deri në vitin 2006 demonstratat dhe aktivitetet e Vetëvendosjes ishin kryesisht paqësore dhe të refuzuara nga qytetarët si largim jopërkatës i vëmendjes nga çështja serioze e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

2.2 Me fillimin e procesit të statusit final në vitin 2006, Vetëvendosja shtoi aktivitetet e saj në përkrahje të një qasje alternative. Z. Kurti organizoi disa demonstrata për ta shfaqur kërkesën e tij për t’i dhënë fund negociatave, duke bllokuar hyrjen e Shtabit të UNMIK–ut si rezultat i së cilës u arrestuan qindra përkrahës të tij. Ky ndryshim drejt shtimit të dhunës arriti kulminacionin, në nëntor të vitit 2006, gjatë së cilës dëme të mëdha iu shkaktuan ndërtesave qeveritare dhe shtabit të UNMIK–ut në Prishtinë. Përkrahësit e Vetevendosjes thyen dritare, hodhën ‘bomba ngjyre’ dhe u munduan që ta rrëzojnë murin mbrojtës nga betoni përreth shtabit të UNMIK–ut. Kjo rezultoi në shpenzimin e mijërave euro të takaspagusve për riparim dhe kritika në lidhje me atë se si policia nuk ishte në gjendje të mbrojë ndërtesat publike

2.3 Skena ishte përgatitur. Vendosmëria e Vetevendosjes për të vazhduar me demonstrata dhe dëshira e madhe për dhunë kundër pronës si metodë për tërheqjen e vëmendjes publike, tanimë u bë një sfidë e madhe për policinë civile të UNMIK–ut dhe SHPK–në. Edhe pse nuk është theksuar qartë, në rradhët e policisë ekzistonte një bindje e kuptueshme se demonstratat e Vetëvendosjes nuk do të rezultojnë në dëmtimin e ngjashëm të pronave publike me herën e kaluar. Kjo bindje në radhët e policisë u përforcua nga mosaprovimi i shtuar publik i metodave të aplikuara nga Vetëvendosja

2.4 Është me rëndësi të jemi të qartë për dilemën me të cilën hasën SHPK–ja dhe policia civile e UNMIK–ut më 10 shkurt. Karakteristikë e demokracisë është që qytetarët mund të gëzojnë të drejtat e shrehjes së lirë dhe lirinë për t’u mbledhur. E drejta e përkrahësve të Vetëvendosjes për t’u mbledhur në tubime publike dhe për të

shprehur pikëpamjet e tyre politike duhet të njihet dhe të respektohet pamvarësisht nga tendenca e tyre e shtuar për dhunë kundër pronës. Për më tepër, është detyrë e policisë të lehtësojë të drejtën e tubimeve publike duke siguruar menaxhimin e trafikut rrugor, menaxhimin e turmës, dhe siguri. Sidoqoftë, është detyrë e ligjshme e policisë që të mbajë rendin publik dhe dhe të mbrojë pronën, qoftë publike apo private. Në këtë mënyrë, policia duhet të angazhohet në lehtësimin e së drejtës së qytetarëve për të shprehur pikëpamjet e tyre politike në mënyrë paqësore dhe në të njëjtën kohë të pengojë çdo përpjekje- nga një numër I vogël I përkrahësve të Vetëvendosjes - për të shkaktuar dëme në pronën publike.

Përshkrimi i trazirave qytetare

2.5 Paragrafët në vijim paraqesin një përpjekje për të përmbledhur në mënyrë neutrale mënyrën sipas së cilës demonstratat e Vetëvendosjes së 10 shkurtit kaluan nga një tubim publik relativisht paqësor në demonstrata të dhunshme⁴. Ky konfrontim në mes të policisë dhe përkrahësve të Vetëvendosjes rezultoi me më shumë se 80 të lënduar, prej të cilëve tetë pësuan lëndime të rënda, ku edhe më pastaj vdiqën dy prej tyre.

2.6 Në përgjigje të fushatës së zgjeruar publike të Vetëvendosjes - përfshirë qindra afishe nëpër tërë Kosovën- një turmë e madhe filloi të mbledhet pas orës 12, të shtunën më 12 shkurt, në Pejton, vend në qendër të Prishtinës. Pikë takimi e mbledhjes së turmës ishte selia e Vetëvendosjes në Pejton. Në ora 14:11, turma filloi të lëvizë drejt pikës finale të tubimit në sheshin Nëna Terezë, përballë Teatrit Kombëtar. Përderisa vlerësimet e madhësisë së turmës sillen prej 2500 dhe 3000, përbërja e saj është e rëndësishme në kuptim të asaj se si është menaxhuar dhe kontrolluar nga ana e SHPK-së.

2.7 Përveq përkrahësve të Vetëvendosjes të cilët kishin veshur fanella me moton e lëvizjes, turmës iu kishin bashkangjitur një numër I të afërmëve të 'personave të zhdukur' (personat që janë raportuar si të zhdukur gjatë konfliktit në Kosovë) dhe persona tjerë për të cilët nuk mund të thuhet se janë përkrahës të Vetëvendosjes. Sipas njoftimeve nga mediat, njëri nga personat e vdekur nuk kishte qenë përkrahës I Vetëvendosjes dhe kishte qëndruar pranë turmës në rrugën Nëna Terezë vetëm nga kureshtja. Prania e qytetarëve kureshtar, është me rëndësi, në kuptim të çfarëdo reagimi policor ndaj trazirave, pasi që gjasat që këta persona të përdorin dhunë janë mjaft të vogla.

2.8 Edhpse është e pamundur të dihet numri I saktë, zyrtarlt e SHPK-së vlerësuan se mbi 1000 persona të pranishëm në turmë ishin vetëm spektatorë e jo pjesëmarrës aktiv. Edhe nëse kjo është e vërtetë, mund të themi se numri I përkrahësve të Vetëvendosjes është rritur në mënyrë të konsiderueshme: prej 300 sa ishin në nëntor

⁴ Koha dhe të dhënat në këtë pjesë janë të bazuara në të dhënat e zyrës së SHPK-së për evidencë.

të vitit 2006, në 1,500 ose 2,000 në shkurt të vitit 2007. Rritja e jashtëzakonshme e numrit të përkrahësve të cilët iu përgjigjen thirrjes së Vetëvendosjes për demonstrata sipas të gjitha gjasave është si rezultat i tensioneve të larta dhe frikës për statusin final të Kosovës. Veçanërisht, disa komentatorë tregojnë për përkrahje më të madhe të kundërshtimeve të Albin Kurtit në lidhje me masat e decentralizimit të përfshira në pakon e z. Marti Ahtisarit. Sidoqoftë, ajo që ishte me rëndësi nga këndëvështrimi policor është se vetëm një pjesë relativisht e vogël e turmës (200–300 persona) kanë qenë të prirur për të përdorur dhunën.

2.9 Para se të nisen, Z Kurti ua shpjegoi turmës udhëpërshkrimin: kryesisht nëpër rrugën Luan Haradinaj (duke kaluar shtabin e UNMIK–ut, të SHPK–së, dhe atë të OSBE–së), për në rrugën e UÇK–së dhe drejt ndërtesës së parlamentit. Megjithatë, ky rrugëtim i planifikuar është dashur të ndërrohet. Rruga Luan Haradinaj ishte bllokuar nga NJS e UNMIK–ut afër ndërtesës së UNMIK–ut dhe Z. Mr. Albin Kurti ishte i detyruar që të drejtojë turmën për në rrugën Garibaldi drejt Hotelit Grand e pastaj të vazhdojnë për në rrugën Nëna Terezë. Kur masa e demonstruesve kaloi përgjatë rrugës marshuese, përkrahësit e Vetëvendosjes me fanella të bardha luajtën ‘rolin e kujdestarit’ duke formuar një rresht përgjatë të dy anëve të kolonave të demonstruesve.⁵ Disponimi i turmës gjatë marshimit dukej të ishte paqësore, e organizuar dhe e qetë ndonëse një numër i vogël i pjesëtarëve të SHPK–së ishin të pozicionuar përgjatë rrugës.

2.10. Sipas planit të z. Kurtit, turma ndaloi përballë teatrit kombëtar rreth orës 14:55 dhe 50 metra nga ndërtesat e qeverisë, në rrugën ‘Nëna Terezë’. Të gjitha përpjekjet për t’iu afruar ndërtesave të qeverisë u bllokuan nga formacionet në vijim:

- a) Një kordon nga pengesat e çelikut, të cilat e përshkonin rrugën Nëna Terezë, nag lindja në perëndim;
- b) Një kordon policësh të Njësitit Regjional për Mbështetje Operative (NJRMO), të cilët ishin pozicionuar pas pengesave dhe ishin të pajisur me helmata, mbrojtëse për trup, mburoja dhe shufra të gjata;
- c) Kordonet tjera të policëve të Njësisë Speciale të UNMIK–ut, të pajisur me helmata, mburoja, shufra, hedhës të gazit lotsjellës, maska kundër gazit lotsjellës dhe armë me plumba gome; dhe
- d) Automjetet e blinduara të Njësisë Speciale të UNMIK–ut, të pajisuar me disa hedhës gazi lotsjellës.
- e) Rrugët që lidhen me RRugën Nëna terezë ishin ‘të rrethuara’ nga SHPK–ja dhe policia e UNMIK–ut

⁵ Në një numër organizatash policore është zakon që policia (në uniformë të rëndomtë) të kryej ‘rolin e kujdestarit’: kjo çështje do të përmendet përsëri në këtë raport.

2.11 Masat në vijim janë dëshmuar si të rëndësishme për t'u diskutuar në kuptim të asaj se çka është dashur të bëhet. Së pari, pengesat e çelikut nuk kanë qenë të lidhura fizikisht mes veti dhe kanë mundur të largohen shumë lehtë nga demonstruesit apo edhe të përdoren si mjete të mundshme vdekjeprurëse nga turma e tensionuar. Së dyti, edhe pse policët e NJRMO-së së SHPK-së janë të pajisur me maska gazi, asnjëri nga policët e përmendur në nën (b) nuk i kanë përdorur ato. Së fundi, vijat mbrojtëse të përmendura në (a) dhe (d) më sipër, nuk kanë mundur të shihen nga një numër i madh i njerëzve në turmë. Ky është dëshmuar si një faktor i rëndësishëm psikologjik. Pasiqë policët nuk ishin të pozicionuar në pikat tjera nëpër turmë dhe shumë protestues nuk ishin në dijeni për praninë e policisë, mund të thuhet se se ekzistonte një ndjenjë e pathyeshmërisë në mesin e turmës e posaqërisht kur Z.Kurti dhe bashkëpunëtorët e tij kryesor vendosën të lëvizin përpara.

2.12 Rreth orës 14:55, Z. Kurti dhe Z.Demaçi vendosën një automjet që shërbente si 'podium folës' i Vetëvendosjes i cili ishte vendosur përgjatë hyrjes kryesore të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Të dytë u mbajtën fjalimet e tyre turmës. Ishte e qartë se Z. Kurti, mund të shihte kordonët e policisë nga kjo pikë, të cilët kishin bllokuar rrugëkalimin e tij për në ndërtesat qeveritare. Gjatë gjithë kohës së fjalimit, turma në përgjithësi ishte e qetë, dhe nuk pati përpjekje për të thyer kordonin policor. Sidoqoftë, ishte e qartë se një pjesë e madhe e turmës –në rast nevojë për t'u shpërndarë shpejt– do të kishte vetëm një dalje kryesore për të ikur: kryesisht përgjatë pjesës jugore të rrugës Nëna Terezë.

2.13 . Rreth orës 14:58 disa përkrahës të Vetëvendosjes filluan t'i largojnë pengesat e çelikta dhe t'i vendosin në pjesën lindore të Rrugës Nëna terezë, duke krijuar një dalje që do t'i mundësonte turmës t'i afrohet kordoneve policore. Reagimi nga ana e policëve të NJRMO-së të SHPK-së ndaj këtij veprimi ishte mjaft pasiv. Policët e NJRMO-së nuk i rezistuan demonstruesve të cilët lëviznin pengesat dhe nuk ishte bërë asnjë përpjekje nga ana e tyre për t'i ndaluar apo arrestuar ata, edhe pse qëllimi i demonstruesve ishte i qartë. Në lidhje me këtë, Inspektorati policor vërejti (në metrazhet filmike të TV-së) një shkallë të konsiderueshme konfuzioni në mesin e policëve të NJRMO-së dhe mungesë të dhënies së udhëzimeve të qarta nga mbikqyrësit e tyre .

2.14 Në orën 14:59, pas një ngurrimi fillestar, elementet brenda turmës filluan të përpiqen të lëvizin përpara drejt kordonit policor të NJRMO-së së SHPK-së. Në orën 15.12 përkrahësit e *Vetëvendosjes* larguan automjetin e përdorur si 'platformë folëse' drejt kordoneve policore dhe në të njëjtën kohë i shtyen pengesat e çelikut kah këmbët e policëve e NJRMO-së të SHPK-së, duke iu shkaktuar lëndime disa policëve. Disa demonstrues pastaj filluan të gjuajnë gurë, copa druri, çadra dhe gjësende tjera drejt kordonit policor.

2.15 Në këtë moment, (rreth orës 15:22) policët e Njesisë Speciale të UNMIK–ut pas kordonit të thyer të SHPK–së filluan të hedhin gaz lotsjellës në drejtim të turmës e cila lëvizte përpara. Kur një pjesë e demonstruesve filloi të shpërndahej për shkak të sasisë së madhe të hedhur të gazit lotsjellës, disa policë të njesisë speciale të UNMIK–ut filluan të gjuajnë me plumba gome në drejtim të turmës. Kjo shkaktoi shpërndarjen intenzive të turmës dhe brenda disa minutave një pjesë e Rrugës Nëna Terezë në mes të kordonit fillestar të NJRMO–së të SHPK–së dhe kryqëzimit me Rrugën Tirana ishte pothuajse e zbrazët nga demonstruesit.


2.16 Në këtë moment policët e NJRMO–së së SHPK–së përsëri filluan të hezitojnë dhe shihej qartë se kishte mungesë udhëheqjeje. Në vend që të lëviznin përpara pas turmës që shpërndahej, policët e NJRMO–së qëndronin afër kordoneve të tyre fillestare derisa filluan të shtyhen që të lëvizin përpara nga policët e NJS të UNMIK–ut. Ndonëse ky hezitim dhe kjo sjellje e pavendosur ka mundur të jetë si pasojë e mungësës së përvojës së tyre, ishte mjaft zhgënjyese duke pasur parasysh investimet e mëdha në trajnimin e zyrtarëve të NJRMO–së. (shih pjesën 3 në vijim).

2.17 Në orën 15.36 SHPK–ja raportoi se janë qëlluar dhe janë plagosur dy persona në afërsi të hotelit Iliria për të cilët u kërkua ndihma e menjëhershme mjekësore. Në të njëjtën kohë, z.Kurti, I pajisur me megafon, u përpoq të riorganizojë përkrahësit e tij në udhëkryqin e rrugëve Nëna Terezë dhe Tirana. Për t’iu përgjigjur kësaj, policët e NJRMO–së së SHPK–së dhe NJS e UNMIK–ut filluan të lëvizin përgjatë rrugës Nëna Terezë drejt Hotelit Grand, duke shpërndarë grupe sporadike të turmës. Gazi lotsjellës dhe plumbat e gomës vazhduan të përdoren për të shpërndarë grupin që largohej, prej rreth 100 personash. Automjeti I përdorur si ‘platformë folëse’ u konfiskua dhe përmbante një grumbull sendesh të përdorura për gjuajtje dhe ‘bomba ngjyre’.

2.18 Në orën 17.48 Rruga Nëna Terezë dhe rrethina e saj ishin zbrasur përfundimisht nga demonstruesit. Gjithsejtë 13 persona u arrestuan gjatë kësaj demonstrate dhe në bazë të urdhërit të prokurorit publik, në orën 18.39 u arrestua z. Albin Kurti. Përveç vdekjes tragjike të dy personave dhe 80 qytetarëve të lënduar, gjatë trazirave pësuan lëndime gjithsejtë 6 policë të SHPK–së.

Historiku i NJRMO-së

3.1 Policët e NJRMO-së ('Njësi Regjional për Mbështetje Operative') janë pjesë shumë e rëndësishme e kontributit të SHPK-së në punët policore rreth demonstratës së vetëvendosjes. Përveç kombive të markës Mercedes, 335 policë të NJRMO-së janë të pajisur me pajisje mbrojtëse, jelekë ballistik(antiplumb), mburoja, shufra të gjata dhe maska gazi. Njësitet e NJRMO-së janë të pajisura me sprej kimik(CS) ose mjete tjera kimike të ngjashme, tuba uji, apo çfarëdo lloj armësh tjera, për raste të trazirave qytetare. Ata janë të trajnuar t'i përdorin një varg strategjish për trazira qytetare, bazuar në ato të përdorura nga policia daneze.



3.2 Programi trajnues që lansoi NJRMO-në dhe historia prapa saj është e lidhur drejtpërsëdrejti me inspektimet e IPK-së. Me ngjalljen e trazirave, civile në mars të vitit 2004 dhe rekomandimet specifike të raportit të Kai Eides në lidhje me ato ngjarje⁶, komesari i policisë së UNMIK-ut Kai Vittrup, urdhëroi krijimin e ekipeve të specialistëve të SHPK-së për t'u ballafaquar në të ardhmen me trazirat qytetare në Kosovë. Kai Vittrup ka pasur një karrierë madhështore, si ekspert policor lidhur me trazirat qytetare në Danimarkë, para emërimit të tij si komesar i UNMIK-ut. Duke u mbështetur në përvojën dhe ekspertizën e konsiderueshme të tij, Komesari ka drejtuar nisjen e elaboruar të programit për zhvillim të kuadrove, që ka qenë i bazuar në PNJTM (Parimet e Njësiteve Taktike Mobile). PNJTM-ja është sistem që është zhvilluar në Danimarkë më 1990, si rezultat i incidenteve të rënda të trazirave qytetare, në të cilat policët kanë përdorur armët e zjarrit dhe ju kanë shkaktuar lëndime pjesëmarrësve në trazira.

3.3. PNJTM-ja i shmanget përdorimit të armëve të zjarrit, plumbave të gomës, gazit lotsjellës, tubave të ujit dhe përdorimit të ngjashëm të forcës. Theksi bie më shumë në shpejtësi, gatishmëri, vendimmarrje taktike dhe largimin dhe arrestimin e liderëve të pjesëmarrësve në trazira, në mënyrë që ta kthejë zonën në gjendje normale. Zyrtarët policor janë të pajisur me pajisje mbrojtëse dhe shufra, rroba kundër zjarrit, si dhe kombi të modifikuar (për bartjen e personelit), të cilat janë në gjendje të

⁶ Rekomandimi 19. Ekziston një nevojë urgjente për të trajnuar dhe pajisur SHPK-në për t'u ballafaquar me punën në raste të trazirave civile. Planet kanë ekzistuar për përfafërsisht 3 vite për trajnimin e një kontigjenti të kufizuar të SHPK-së Gjithashtu janë premtuar edhe pajisje për këtë qëllim. Sidoqoftë, mospajtimet lidhur me prioritetet duket të kenë shpjer drejt shtyerjes së krijimit dhe të trajnimit të njësteve të tilla. Organizatë multi etnike e SHPK-së e trajnuar mirë do të ishte në pozitë më të mirë ta bënte kontrollin e trazirave dhe ta luftonte dhunës sesa policia ndërkombëtare. Trajnimit dhe pajisjes së njësiteve të tilla duhet patjetër t'i kushtohet vëmendje e menjëhershme.'

rezistojnë një numër sendesh dhe të veprojnë si barrikadë fizike në kontrollimin e masës. PNJTM-ja udhëheqet nga dy synime kyçe: (a) kontrollimi i turmës dhe (b) arrestimi i organizatorëve dhe i atyre të cilët kryejnë vepra penale. Përveç transportuesit të modifikuar të personelit, sistemi i PNJTM-së nuk përkrahë asnjë lloj të përdorimit të pengesave për turmë.

Trajnimi dhe strategjia e NJRMO-së

3.4 Në mes të prillit të vitit 2005 dhe majit të vitit 2006, gjithsejt 1.700 policë të SHPK-së iu kanë nënshtruar programit trajnues në shkollën e SHPK-së, në Vushtrri/Vučitrn, që ka qenë i bazuar në PNJTM dhe gjithashtu ka qenë i njohur si 'trajnim i NJRMO-së'. Edhe pse kostoja e saktë e trajnimit dhe e pajisjeve nuk dihet, mendohet se futja në përdorim e NJRMO-së i ka kushtuar taksapaguesve të Kosovës disa miliona EURO⁷. Programi trajnues i PNJTM-së ka qenë i ndarë në pjesët në vijim:

- Kursi themelor i PNJTM-së
- Kursi i liderit të grupit të PNJTM-së
- Kursi për platon lider i PNJTM-së
- Kursi për komandant të incidentit të PNJTM-së (grada toger deri në kapiten)
- Kursi për komandant operativ të PNJTM-së (Kolonel dhe mbi këtë gradë)
- Kursi për paramjekësorë të PNJTM-së
- Kursi për AOE-së (Automjetet Operative Emergjente)

3.5 Nuk është as praktike e as e nevojshme që të përshkruhen në hollësi, strategjitë dhe taktikat e ndryshme të përfshira në Doracakun e PNJTM-së, i cili është bazë e programit trajnues të SHPK-së dhe procedurave të NJRMO-së (ROSU). Megjithatë, është një ushtrim i dobishëm për qëllime të inspektimit aktual për krahasimin e angazhimit të NJRMO-së dhe mënyrës së kryerjes së detyrave më datën 10 shkurt, 2007, me atë që është përshkruar në doracakun e PNJTM-së. Për këtë qëllim, një ekspert për doracakun e programit trajnues të SHPK-së për PNJTM-në⁸ rishikoi një numër incizimesh nga incidenti I datës 10 shkurt dhe ofroi një numër vrojtimesh kritike. Me qëllim të shkurtësisë, këto vrojtme janë paraqitur në tabelën 1. Kolona e parë përshkruan rekomandimet si praktika më të mira në bazë të sistemit të PNJTM-së ndërsa kolona e dytë përshkruan mënyrën e angazhimit të NJRMO-së gjatë demonstratave dhe dhunës së fundit.

⁷ Kjo merr përsipër koston e largimit të zyrtarëve të SHPK-së nga punët e zakonshme operative në trajnim, blerjen e pajisjeve mbrojtëse, automjeteve speciale dhe koston e administrimit.

⁸ IPK-ja falenderon Heinz Schneider, pjesëtar I Misionit të OSBE-së në Kosovë, për vrojtmet e tij të hollësishme dhe të rëndësishme. Z. Schneider ishte i angazhuar në përshtatjen e sistemit danez të PNJTM-së për Kosovë, si dhe dizajnimin dhe zbatimin e përgjithshëm të programit të PNJTM-së për SHPK-në.

Tabela 1

Krahasimi i sjelljes së NJRMO-së me datën 10 shkurt të vitit 2007 dhe sistemi i POMTU


Sistemi i PNJTM-së	Sjellja e NJRMO-së
<p>1. Para ngjarjes SHPK-ja duhet të takohet me organizatorët dhe të shpjegojë rolin e policisë dhe pasojat e sjelljeve të kundërligjshme. Me ecjen e demonstruesve nga 'Qyteza Pejton' drejtë Teatrit Kombëtar, zyrtarët e NJRMO-së është dashur ta përdorin sistemin e 'shtrëngimit të dyfishtë' (p.sh. ecja në çdonjërin anë të kolonave të demonstruesve). Kjo i lejon NJRMO-së të reagojë në secilën trazirë spontane apo të planifikuar përgjatë rrugës.</p>	<p>1. Organizatorët refuzuan të takohen me policinë para demonstratave. Asnjë polic (i SHPK-së apo UNMIK-ut) nuk e ka përcjellur kolonën e demonstruesve, pasi që kishte lëvizur nëpër Prishtinë/Priština. Disa nga përkrahësit e Vetevendosjes kanë vepruar si 'kujdestarë të turmës' dhe e kanë përdorur sistemin e "shtrëngimit të dyfishtë".</p>
<p>2. Kur dihet se demonstruesit kanë për qëllim të mbledhet në vendin e caktuar, komandantët e SHPK-së duhet të përgatisin një plan të hollësishëm, për menaxhimin e turmës. Ky plan duhet të sigurojë që policët të marrin iniciativë dhe të janë në gjendje që të kontrollojnë pozitën e demonstruesve me anë të shpërndarjes së policëve dhe automjeteve të tyre, sa më shumë që është e mundur. Nëse dihet që elementet përbrenda turmës dëshirojnë që të sulmojnë ndërtesat apo personat e veçantë, plani duhet të mundësojë të krijojë distancë të mjaftueshme në mes të demonstruesve dhe caktat të synuar. Plani gjithashtu duhet të lejojë dalje për ndarjen e turmës dhe arrestimin e liderëve.</p>	<p>2. Demonstruesit kanë qenë të lejuar që të mbledhen përballë Teatrit Kombëtar dhe 50 metra nga ndërtesa qeveritare, duke krijuar 'ngushtim rruge' ku nuk kishte rrugë për ikje nga asnjëra anë. Pozita e barrierave të çelikut (shih 4-shin poshtë) ka qenë shumë afër caktat të synuar (psh. Ndërtesës së qeverisë) dhe asnjë automjet nuk ka qenë i vendosur në rrugë për t'i ndaluar fizikisht elementet brenda turmës të cilët shtuheshin përpara. Po të mbaheshin demonstruesit afër udhëkryqit të rrugës së Tiranës dhe rrugës Tringë Smajli, kjo do të kishte bërë të mundur shpërndarjen e shpejtë të tyre. (shih diagramin 1).</p>
<p>3. Pasi që demonstruesit ishin përballë Teatrit Kombëtar, NJRMO-ja është dashur ta aplikojë sistemin e 'shtrëngimit të dyfishtë' (psh. Të formojë rreshta në secilën anë të turmës së demonstruesve). Kjo i lejon demonstruesit që ta shohin policinë gjatë tërë kohës dhe ka efekt psikologjik tek ata të cilët mund të hezitojnë para se ta përdorin dhunën. Kjo gjithashtu i mundëson zyrtarëve të NJRMO-së të depërtojnë shpejtë në turmë, gjatë reagimit në trazira të planifikuara apo spontane (të largojnë organizatorët apo t'i ndajnë ata që e përdorin dhunën).</p>	<p>3. Zyrtarët e NJRMO-së kanë qenë të angazhuar vetëm në njërin anë (përgjatë rrugës Nëna Terezë), duke vepruar si pengesë në çfarëdo përpjekje të elementeve, përbrenda turmës që ta sulmojnë ndërtesën qeveritare. Kjo do të thotë që shumica e demonstruesve nuk ka mundur ta shoh SHPK-në në shumicën e kohës. Kjo u bë e rëndësishme kur demonstruesit ecën drejt rreshtit të zyrtarëve të NJRMO-së.</p>
<p>4. Kur është e nevojshme për të bllokuar lëvizjen e demonstruesve apo për të kontrolluar drejtimin turmës në lëvizje, Zyrtarët e NJRMO-së duhet të shfrytëzojnë automjetet e tyre si pengesa fizike. Për shembull, po të ishte ditur që elementet përbrenda përkrahësve të vetëvendosjes do të mund të tentonin të sulmonin ndërtesën e qeverisë, automjetet e NJRMO-së duhet të kishin qenë të pozicionuara përgjatë rrugës 'Nënë Tereza' për ta bllokuar shtegun e turmës.</p>	<p>4. Në vend të automjeteve, një numër i pengesave të çelikut ishin të vendosura përgjatë rrugës Nënë Tereza, për të bllokuar shtegun e demonstruesve. Pengesat qëndruan në mes të zyrtarëve të NJRMO-së dhe turmës. Pengesat nuk ishin të bashkuara apo të lidhura njëra me tjetrën, duke i mundësuar elementeve brenda turmës që me lehtësi t'i largojnë ato nga rruga. Kjo është në kundërshtim me parimet e PNJTM-së: pengesat kanë qenë pengesë për zyrtarët e NJRMO-së, nëse atyre iu është nevojitur të lëvizin shpejt drejt apo brenda turmës. Përveç kësaj, elementet brenda turmës mund t'i kenë përdorur pengesat si sende të forta për t'ia hedhur zyrtarëve të NJRMO-së, duke iu shkaktuar atyre lëndime të rënda.</p>
<p>5. Kur një turmë e qetë e protestuesve bëhet e shqetësuar dhe e paqëndrueshme, zyrtarët e NJRMO-së duhet shpejt të lëvizin përpara në turmë dhe 'të kapin dhe arresojnë' organizatorët.</p>	<p>5. Pasi që demonstruesin morrën iniciativë dhe larguan pengesat, zyrtarët e NJRMO-së qëndruan pasiv dhe nuk ishin të sigurtë se çfarë veprime duhet të ndërmarrin, përderisa kutitë e para të gazit lotsjellës u hodhën nga policët e NJSP-së së UNMIK-ut</p>
<p>6. Kur ekziston pika shtytëse e shkaktuar nga një turmë e hidhëruar e cila lëviz në drejtim të padëshiruar, automjetet e NJRMO-së duhet të lëvizin drejtë turmës, e cila lëviz përpara dhe të krijojë pengesa.</p>	<p>6. Pasi që elementet brenda turmës kanë filluar të shtyejnë përpara, zyrtarët e NJRMO-së nuk ishin në gjendje të rezistojnë lëvizjen përpara dhe shpejt u rrethuan derisa u shpërnda gazi lotsjellës. Asnjë automjet i NJRMO-së në atë zonë nuk ka qenë në gjendje të lëvizë përpara.</p>

3.6 Diagramet prej 1 - 4 tregojnë në mënyrë grafike mënyrën e organizimit të pjesëtarëve të NJRMO-së në sheshin Nëna Terezë më 10 shkurt, 2007 dhe skenarët alternativ të paraparë në sistemin e PNJTM-së. Në diagramin 1 është përshkruar angazhimi aktual, duke treguar vargun e pengesave të çelikut dhe rreshtin e policëve të njësitit të NJRMO-së. Në mungesë të automjeteve për të bllokuar orbitën e tyre, një numër relativisht i vogël i demonstruesve ishte në gjendje që të shtyjë kordonin e policëve të NJRMO-së drejt Ndërtesës së Qeverisë dhe kjo përshpejtoi vendimin për hedhjen e gazit lotsjellës dhe plumbave të gomës. Pasi që kjo kishte ndodhur, turma mund të lëvizte vetëm mbrapa ose në ndërtesat e afërta, për të ikur.


3.7 Diagrami 2 tregon mënyrën e angazhimit të policëve të NJRMO-së sipas sistemit të PNJTM-së, duke marrë parasysh pozitën e turmës në anën e kundërt të Teatrit Kombëtar. Duhet të përmendet se automjetet e NJRMO-së janë vendosur në rrugë në mënyrë efektive duke bllokuar rrugëkalimin e demonstruesve. Përveç kësaj, pjesëtarët e NJRMO-së janë pozicionuar- në numër të mjaftueshëm- afër turmës në të tri anët. Kjo mundësonte që shumica e demonstruesve të shohin policinë gjatë gjithë kohës dhe, sipas nevojës, i mundësonte policëve që të lëvizin në turmë dhe të izolojnë apo arrestojnë udhëheqësit e demonstruesve.

3.8 Diagrami 3 paraqet pozicionin alternativ të turmës siç preferohet nga sistemi PNJTM-së. Këtu turma ishte e detyruar që të grumbullohet në udhëkryqin e rrugës së Tiranës dhe Rrugës Tringë Smajli, duke i mundësuar policëve që të ndajnë turmën dhe të arrestojnë personat e dhunshëm. Automjetet e NJRMO-së janë të pozicionuara në rrugë më në jug, dhe përballë Hotelit Iliria, duke bllokuar turmën dhe duke krijuar në këtë mënyrë distance më të madhe me Ndërtesat e Qeverisë. Pjesëtarët e NJRMO-së janë pozicionuar në atë mënyrë duke krijuar 'rrethimin e dyfishtë' në të dy anët e udhëkryqit. Siç është paraqitur në diagramin 4, ky "rrethimi i dyfishtë" i mundëson policëve të NJRMO-së të izolojnë (veçojnë) udhëheqësit në krye të turmës, t'i arrestojë ata dhe t'i vendosë në mes automjeteve të NJRMO-së dhe zonës së sigurte dhe të arrestuarit mund të transportohen menjëherë nga vendi i ngajrjes. Zona e sigurtë është vendi ku mund të qëndrojnë edhe automjetet e ambulancës, për trajtimin e personave të lënduar.


3.9 Inspektorati policor është në dijeni se zinxhiri komandues i SHPK-së dhe vendimet operative të 10 shkurtit, 2007, janë pjesë e një sistemi më të madh, i organizuar dhe kontrolluar nga Policia Civile e UNMIK-ut. Prandaj shumica e vendimeve komanduese që janë diskutuar në figurën 1, nuk ishin marrë nga ana e mbikëqyrësve të NJRMO-së dhe komandantëve të SHPK-së. Sidoqoftë, këto vrojtme janë të rëndësishme për angazhimin e SHPK-së në të ardhmen gjatë intervenimeve në raste të demonstratave dhe trazirave të mundshme në Kosovë. Duke marrë parasysh investimet e konsiderueshme në trajnimin e PNJTM-së, Inspektorati policor rekomandon që në të ardhmen ky sistem të përdoret plotësisht. Përveç kësaj, ndryshimet në sistemin e PNJTM-së (në kuptim të procedurave operative dhe atyre të trajnimit) duhet të parashihen vetëm si rezultat i përvojave gjatë trazirave qytetare e jo në bazë të mendimeve të policëve të caktuar të NJRMO-së.




Diagrami 1 - Mënyra e organizimit të policëve të NJRMO-së- Rruga Nëna Terezë, 10 shkurt, 2007



Diagrami 2 - Mënyra e organizimit të policëve të NJRMO-së në bazë të sistemit të PNJMT-së, duke marrë parasysh pozitën e turmës në rrugën Nënë Terezë, 10 shkurt, 2007



Diagrami 3 - Mënyra e organizimit të policëve të NJRMO-së në bazë të sistemit të PNJMT-së, duke marrë parasysh pozitën alternative të turmës në rrugën Nënë Terezë, më 10 shkurt, 2007



Diagrami 4 - Mënyra e organizimit të policëve të NJRMO-së në bazë të sistemit të PNJMT-së, duke marrë parasysh pozitën alternative të turmës në rrugën Nënë Terezë dhe përpjekjet e turmës për të lëvizur përpara, më 10 shkurt, 2007

PJESA IV: ÇËSHTJET LIDHUR ME MËNYRËN E KRYERJES SË DETYRAVE NGA ANA E SHPK-së GJATË DEMONSTRATAVE

Strategjia për angazhim paraprak

4.1 Angazhimi i policëve të SHPK-së më 10 shkurt, është definuar në hollësi në Urdhërin Operativ, përgatitur në bazë të autorizimit të komesarit të policisë së UNMIK-ut. Urdhëri përshkruan metodologjinë, mbështetjen logjistike dhe administrative, si dhe komunikimin e nevojshëm për realizimin e qëllimit të përgjithshëm në ofrimin e sigurisë gjatë periudhës së demonstratave të organizuara nga Vetëvendosja. Dokumenti përshkruan një operacion të ndërlikuar në të cilin duhet të kordinohen aktivitetet e KFOR-it, policisë civile të UNMIK-ut dhe pjesëtarëve të SHPK-së si dhe të kontrollohen nga zyra qendrore përgjegjëse për atë incident.



4.2 Kontributi i SHPK-së ishte i konsiderueshëm dhe ndahet në tri grupe kryesore. Së pari, komanda regjionale në Prishtinë ofron përkrahje operative për të gjithë policët e angazhuar në dhe përreth shtabit të UNMIK-ut dhe ndërtesave të qeverisë, pika këto të njohura si pika tubimi për përkrahësit e Vetëvendosjes. Ky funksion mbështetës përfshin monitorimin e rrjedhës së trafikut përgjatë rrugëve kryesore në Prishtinë, shpërndarjen e broshurave⁹ personave që shkojnë në demonstrata dhe caktimin në detyrë të policëve patrullues në periferi të 'zonës demonstruese'. Së dyti, policët e specializuar të SHPK-së në vijim angazhohen në detyrë pranë ndërtesave qeveritare dhe shtabit të UNMIK-ut dhe janë pjesë e strategjisë për parandalimin e dëmtimit të ndërtesave dhe/apo lëndimit të personave:

- Prishtinë-NJRMO - 83 policë;
- Prizren -NJRMO - 57 policë;
- Pejë-NJRMO- 58 policë;
- NJIP (Njësi për Intervenim të parë), Shtab - 15 policë; dhe
- K-9 (Mbajtës të qenëve zyrtar) - 9 policë.

4.3 Së fundi, SHPK-ja kontribon në funksionin e kordinimit dhe kontrollit. Policët në vijim ishin të angazhuar në zyrën qendrore të incidentit, prej nga u kontrolluan operacionet e sigurisë në demonstrata:

⁹ Këto broshura përmbajnë informata për të bindur demonstruesit që të qëndrojnë të qetë dhe paqësor, si dhe ta respektojnë ligjin

- Gjen.nënkolonel . Sheremet Ahmeti
- Gjen. Major Reshat Maliqi
- Kol. Hahe Avdiu
- Kol. Shpend Maxhuni
- Nënkol. Naim Rexha
- Nënkol. Sami Shabanaj

4.4 Këta zyrtarë policor punojnë së bashku me kolegët e tyre nga UNMIK-u dhe KFOR-I dhe sigurojnë komunikimin efektiv të informatave dhe vendimeve për dhënien e urdhërave gjatë demonstratave.

Angazhimi

4.5 Në përgjithësi zyrtarët e SHPK-së treguan që përgatitja strukturore brenda Urdhërit operativ ka funksionuar mirë. Megjithatë, disa pjesëtarë të SHPK-së bënë disa vrojtime të cilat mund të përdoren për zhvillimin e mëtejshëm të mënyrës së kryerjes së detyrave në të ardhmen. Pragrafët në vijim theksojnë disa nga aspektet e rëndësishme për zhvillim.

4.6 Përgatitjet kishin kuptimin që komanda strukturore e SHPK-së ishte e ndarë në mënyrë efektive në mes të zyrës qendrore të incidentit dhe zyrës regjionale për kontrollë në Prishtinë. Kjo pati si rezultat ndarjen e zingjirit komandues dhe ngadalësimin e rrjedhës së informatave prej terrenit në bazë dhe anasjelltas. Rekomandohet që në operacionet e ardhshme SHPK-ja të mer parasysh përdorimin e një pike të vetme kontrolluese e jo të ndajë përgjegjësitë komanduese në dy grupe të zyrtarëve të lartë.

4.7 Janë bërë ankesa të shumta – veçanërisht nga zyrtarët e NJRMO-së- për komunikim të dobët. Këto ankesa kryesisht kanë të bëjnë me paisjet e radiolidhjes në dispozicion, për defekte në kufje të radiolidhjes për përdorim me helemeta në kokë ose radio të zakonshme për përdorimin e të cilave është dashur të largohet helmata nga koka, në raste të dërgimit apo pranimit të porosive. Këto probleme janë vështirësuar edhe më shumë nga zhurma në prapaskenë gjatë trazirave dhe shumë policë është dashur të mbështeten në shenjat e dorës. Rekomandohet që SHPK-ja të rishikojë dhe nëse është e nevojshme të zëvendësojë paisjet aktuale të kufjeve të radiolidhjes dhe të sigurojë që të gjithë policët e njësisë speciale të jenë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive gjatë trazirave qytetare.

4.8 Shumë zyrtarë të NJRMO-së u ankuan që kanë qenë të pajisur në mënyrë joadekuate, për t'u ballafaquar me rrethanata e së shtunës, 10 shkurt, 2007. Në veçanti, shumë prej tyre përmenden se nuk kanë qenë të pajisur me maska gazi

lotsjellës apo që maskat e tyre nuk kanë qenë të përshtatshme për mbrojtje nga gazit lotsjellës. Shumë prej tyre theksuan që automjetet e tyre (kombi të markës Mercedes) nuk mjaftonin të përdreshin si pengesa për turmë dhe si mburojë (siç është përmendur edhe në sistemin e PNJTM-së). Ata gjithashtu theksuan se iu mungonin paisjet për hudhjen e gazit lotsjellës ose tubave të ujit, si metoda alternative për shpërndarjen e turmës.

4.9 Një numër i zyrtarëve të NJRMO-së gjithashtu u ankuan se kishin marrë udhëzime joadekuate nga mbikëqyrësit e tyre gjatë operacionit. Për shembull, ata nuk ishin paralajmëruar për lansimin e menjëhershëm të gazit lotsjellës dhe për këtë arsye ata nuk kanë patur mundësi të vendosin maskat e tyre në kokë. Në momente të caktuara gjatë eskalimit të dhunës në turmë disa zyrtarë të NJRMO-së e pranuan që kanë qenë të çorientuar për shkak të mungesës së informatave dhe udhëzimeve të qarta.

4.10 Disa zyrtarë të caktuar të NJRMO-së e theksuan jo njëtrajtshmërinë e taktikave operative të prëdorura nga ekipe të ndryshme të NJRMO-së. Për shembull, policët e NJRMO-së në Prishtinë operuan sipas modelit danez në bazë të sistemit POMPTU, përderisa NJRMO në Pejë vepruan sipas sistemit të karabinierëve. Ajo që është edhe më shqetësuese është se që nga trajnimi i parë i POMPTU në shkollën e SHPK-së (shih pjesën e tretë në sipër) ekipet e NJRMO-së nuk u janë nënshtruar asnjë programi tjetër trajnues të përbashkët, në baza të rregullta. Kjo do të thotë që kur policët e NJRMO-së thirren që të reagojnë së bashku në një ngjarje siq ishte demonstrata e fundit, ata nuk do të jenë në gjendje të veprojnë së bashku si një njësi i vetëm operativ. Kjo e metë shkakton pasoja të papara në angazhimin e kombinuar të pjesëtarëve të NJRMO-së si reagim primar i SHPK-së në raste të trazirave qytetare të shkallës së lartë në Kosovë.

PJESA V: KRYERJA E DETYRAVE POLICORE NË RASTE TË TRAZIRAVE QYTETARE, NË TË ARDHMEN NË KOSOVË

5.1 Inspektorati policor e pranon një konsensus të shtuar që SHPK-ja duhet të merr përgjegjësi më të mëdha në kontrollimin e tubimeve të mëdha publike dhe demonstratave në Kosovë. Duke u pajtuar me mendimet e pjesës dërmuese në SHPK, Qeverisë së Kosovës, Parlamentit, dhe Policisë Civile të UNMIK-ut, Inspektorati Policor bënë thirrje për përsheptim të bartjes së përgjegjësive nga Policia Civile e UNMIK-ut në SHPK. Përgjegjësitë e bartura duhet të përfshijnë planifikimin operativ paraprak për ndonjë demonstratë, komandën operative gjatë ngjarjes, dhe angazhimin e personelit policor në raste të tubimeve publike. Një hap I tillë është në pajtim me detyrat e ligjshme të SHPK-së në bazë të Rregullores 2005/54 dhe parasheh funksionet e mundshme të shërbimit policor vendor sipas marrëveshjes së ardhshme për status.

Rekomandimi kryesor	Nr. 1
<i>Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK-së t'i jepen më shumë përgjegjësi lidhur me komandën, kontrollin dhe angazhimin aktiv gjatë demonstratave në Kosovë.</i>	

5.2 Vendimi për ta bartur këtë nivel të përgjegjësive për kontrollimin e tubimeve publike natyrisht se është i shoqëruar me një shkallë rreziku. Kritikat do të jenë të shpejta dhe do të shkojnë deri në atë masë që të theksojnë mundësitë për dështimin e komandantëve të SHPK-së, me mundësinë e shkaktimit të dëmit të pakthyesëm ndaj qytetarëve të pafajshëm, policëve dhe pronës. Sidoqoftë kontrollimi I trazirave qytetare nuk është shkencë ekzakte dhe shumica e organizatave policore në shtetet demokratike stabile tregojnë se kanë pasur dështime të konsiderueshme në dekadat e fundit. Vetëm me marrjen e kësaj përgjegjësie, komandantët e SHPK-së dhe pjesëtarët e NJRMO-së mund të shpresojnë të përfitojnë përvojë të konsiderueshme dhe ekspertizë në detyrën e ndërlikuar dhe të vështirë gjatë kontrollimit të tubimeve publike. Kjo vështirësi, siç u përmend më herët përqëndrohet në aftësinë e zyrtarëve të SHPK-së që me kujdes të vijnë në baraspeshë dy kërkesa të kundërta: të drejtën e ligjshme të qytetarëve për të shprehur haptasi pikëpamjet e tyre dhe nevojën për mbrojtjen e personave dhe pronës nga dëmet e paligjshme.

5.3 Me marrjen e vendimit për rritjen e përgjegjësive të SHPK-së, paraqitet nevoja për përkushtim dhe guxim në radhët e SHPK-së – veçanërisht tek zyrtarët e lartë. Bazuar në investimet e konsiderueshme në sistemin e trajnimit të PNJTM-së (shih pjesën e dytë më sipër) zyrtarët e lartë të SHPK-së duhet të tregojnë dëshirën dhe aftësinë e tyre për të mësuar shpejt nga gabimet e pashmangshme dhe të zhvillojnë mundësitë e pjesëtarëve të NJRMO-së dhe policëve të rëndomtë të uniformuar. Nga ana tjetër, media dhe qytetarët duhet të pranojnë se do të bëhen gabime dhe se udhëheqësia e SHPK-së është ende në zhvillim e sipër. Inspektorati policor, në pajtim me mandatin e tij ligjor, do të sigurojë që puna e SHPK-së të monitorohet për

së afërmi dhe (pas shtatorit, 2007) do të hetojë të gjitha supozimet për shkelje të rënda nga ana e pjesëtarëve të SHPK-së gjatë tubimeve publike.

5.4. Inspektorati policor beson se tri çështje të rëndësishme duhet të shqyrtohen shpejt nëse merret vendimi për bartjen e plotë të përgjegjësi tek SHPK-ja në fushën e kontrollimit të tubimeve publike: trajnimi I pjesëtarëve të NJRMO-së dhe të zyrtarëve të lartë, autorizimet ligjore të policisë dhe paisjet e SHPK-së. Këto çështje janë përmendur më herët në këtë raport por duhet të ritheksohen për shkak të rëndësisë së tyre..

5.5 Edhe pse janë bërë investime të konsiderueshme në trajnimin e mbi 1,700 zyrtarëve të SHPK-së në sistemin e PNJTM-së, ai sistem nuk është përdorur më 10 shkurt dhe nuk është përdorur gjatë përgatitjeve operative të SHPK-së, sipas informatave të marra nga Inspektorati policor. Përveq kësaj, trajnimi i kufizuar për 'komandën operative' sipas skemës së PNJTM-së për zyrtarët e lartë të SHPK-së sigurisht se nuk ka qenë I mjaftueshëm dhe I përcjellur me përvojë praktike. Për këtë arsye, ekziston nevoja për trajnime të mëtutjeshme për të gjithë pjesëtarët e SHPK-së e veçanërisht për ata të cilët do të jenë përgjegjës për planifikimin e operacioneve policore në raste të demonstratave. Trajnime të tilla duhet të bëhen rregullisht dhe të bazohen në praktikën e rasteve të vërteta, si ato të 10 shkurtit.

Rekomandimi kryesor

Nr. 2

Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK-ja të vendosë për një sistem të unifikuar të taktikave në raste të trazira qytetare dhe t'i inkorporojë plotësisht ato në një Doracak të vetëm të SHPK-së për kontrollimin e trazirave qytetare. Nevojitet trajnim I mëtutjeshëm për të gjitha nivelet e posaqërisht për ata zyrtarë të SHPK-së të cilët do të jenë përgjegjës për planifikimin e operacioneve policore në raste të demonstratave. Trajnime të tilla duhet të bëhen rregullisht dhe të bazohen në praktikën e rasteve të vërteta, si ato të 10 shkurtit.

5.6 Sikurse në rastin e armëve të zjarrit të SHPK-së (shih Raportin e Përkohshëm të IPK-së Nr. 1/2007) të gjithë zyrtarët policor të zgjedhur si të kualifikuar për angazhim në operacione të trazirave qytetare sipas sistemit të ri të SHPK-së duhet t'iu nënshtrohen trajnimeve të rregullta riçertifikuese. Një masë e tillë do të theksojë rendësin e madhe për t'u siguruar se të gjithë zyrtarët policor arrijnë standardin minimal të shkathtësive dhe kanë mundësi të praktikojnë rregullisht taktikat për kontrollimin e turmës. Trajnimet riçertifikuese gjithashtu do t'i bëjnë të mundur SHPK-së të testojë pajisjet e specializuara (p.sh. automjetet e NJRMO-së, radio pajisjet) dhe të siguroj që ato arrijnë standardet minimale të operimit, siç është përcaktuar në sistemin e ri të SHPK-së për trazira qytetare.

Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që të gjithë policët e emëruar si të kualifikuar për t'u angazhuar në detyrë në raste të trazirave qytetare siaps sistemit të ri të SHPK-së duhet t'i nënshtrohen trajnimit të rregulltë riçertifikues. Një masë e këtillë do të theksonte rëndësinë e madhe për të siguruar që të gjithë policët i plotësojnë standardet minimale të kontrollimit të trazirave qytetare dhe kanë mundësi të ushtrojnë rregullisht taktikat për kontrollimin e turmës.

5.7 Pasi që SHPK-ja të ketë vendosur zgjedhjen e sistemit të saj për trazira qytetare, duhet të siguroj që të gjithë zyrtarët policor të specializuar janë të pajisur si duhet në mënyrë që t'i vënë ato taktika në veprim. Kjo duhet të përfshijë radio pajisjet e duhura, automjetet e blinduara, mburojat, shufrat e gomës dhe pajisjet e tjera mbrojtëse. Ruajtja dhe inspektimi i këtyre pajisjeve të shtrenjëta duhet t'i nënshtrohet inspektimit dhe kontrollit të rregullt për tu siguruar se janë në gjendje të duhur dhe i plotësojnë standardet e larta.

Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK-ja të sigurohet që të gjithë policët e njësisë speciale të jenë të pajisur në mënyrë të duhur në mënyrë që t'i përdorin këto taktika në mënyrë efektive. Kjo duhet të përfshijë pajisjet e radio-lidhjes, automjetet e blinduara, mburojat, shufrat dhe mjetet tjera mbrojtëse. Ruajtja dhe inspektimi i këtyre pajisjeve të shtrenjëta duhet t'i nënshtrohet inspektimit të rregullt dhe azhurnimit për të siguruar se janë në gjendje të duhur dhe i plotësojnë standardet e larta.

5.8. Të gjithë janë pajtuar se SHPK-ja ka mungesë të dispozitave ligjore në lidhje me përdorimin e forcës së arsyeshme dhe proporcionale, si dhe autorizimeve parandaluese në lidhje me tubimet publike që kanë mundësi të rezultojnë me lëndime fizike të personave apo dëmtim të pronës. Inspektorati Policor në raportin e tij të fundit për menaxhimin e armëve të zjarrit ka ngritur çështjen e mungesës së legjislacionit lidhur me 'përdorimin e forcës' (shih Raportin e Përkohshëm të IPK-së Nr. 1/2007). Paragrafi 37 i Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP) thotë " policia mund të përdorë forcën vetëm kur është absolutisht e nevojshme dhe vetëm në atë masë që kërkohet për të arritur qëllimin e ligjshëm ". Është parim thelbësor i i policisë demokratike që gjithmonë duhet të ekzistojë bazë ligjore për veprime policore, përfshirë përdorimin e forcës. Përdorimi i tepruar i forcës nuk është i pranueshëm asnjëherë.

5.9. Në kohën e inspektimit Inspektorati Policor vërejti se nuk ekziston ndonjë ligj në fuqi i cili rregullon përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve të SHPK-së, në pajtim me KEEP-në, ligjet përkatëse të BE-së dhe ligjin ndërkombëtar. Shtatë vjet pas themelimit të SHPK-së, kjo *lacuna legis* (zbrazëti në ligj) është çështje për shqetësim dhe duhet të shqyrtohet sa më shpejt që është e mundur.

Inspektorati Policor nxit prezentimin e legjislacionit I cili ofron parime të qarta mbi përdorimin e forcës nga ana e pjesëtarëve të SHPK-së, sa më parë që të jetë e mundur. Ky legjislacion duhet të jetë në pajtim me Kodin Evropian të Etikës Policore(KEEP), ligjet përkatëse të BE-së, dhe ligjin ndërkombëtar.

5.10. Në bazë të Doracakut të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, përdorimi I forcës nga ana e zyrtarëve policor duhet të jetë I arsyeshëm dhe proporcional ndaj kërcënimit të perceptuar dhe duhet të përdoret forca minimale për të mënjanuar atë kërcënim¹⁰. Kjo është në përputhje me parimin e forcës së arsyeshme sipas paragrafit 37 të Kodit Evropian të Etikës Policore (KPEP). Ndonëse materiali për trajnimin themelor në Shkollën e SHPK-së/ QKSPEZH, Vushttri, përmban më shumë udhëzime në lidhje me të kuptuarit e forcës së arsyeshme, Doracaku I Parimeve dhe Procedurave nuk përmban hollësi të mjaftueshme.

5.11 Inspektorati policor rekomandon që definicioni I përdorimit të forcës të shtjellohet më në hollësi në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave. Përveç kësaj, Inspektorati konsideron që të gjithë zyrtarëve të SHPK-së t'iu sigurohet nga një kopje e Kodit të Etikës mbi përdorimin e forcës, bazuar në komentet zyrtare të KEEP-së. Paragrafi 37 I KEEP-së-thekson se përdorimi I forcës nga zyrtarët policor gjithnjë duhet të konsiderohet si masë e veçantë dhe, kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe nuk duhet të përdoret më shumë forcë sesa që është plotësisht e domosdoshme. Kjo do të thotë që forca e përdorur duhet të jetë në proporcion me qëllimin e ligjshëm I cili duhet të arrihet me anë të asaj mase të forcës. Prandaj duhet të ekzistojë një drejtpeshim përkatës në mes të përdorimit të forcës dhe situatës në të cilën është përdorur forca. Me fjalë tjera, anjëherë nuk duhet të përdoret forca fizike përveq nëse është plotësisht e domosdoshme: armët nuk duhet të përdoren, përveq nëse është plotësisht e domosdoshme; nëse mendohet se përdorimi i armëve vdekjeprurëse është I domosdohëm, nuk duhet të përdoren më shumë sesa që është plotësisht e domosdoshme për të mënjanuar kërcënimin.

Inspektorati Policor rekomandon që definicioni I forcës së arsyeshme të shqyrtohet më tutje në doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, si përpjekje drejtë përmirësimit të kapacitetit të SHPK-së për reagimet në incidentet e ardhshme të trazirave qytetare. Inspektorati rekomandon që të gjithë pjesëtarët e SHPK-së të pajisen me nga një kopje të Kodit të Etikës mbi përdorimin e forcës , bazuar në komentet zyrtare të KEEP-së.

5.12 Ligji I aplikueshëm I Kosovës jep autorizime parandaluese të pamjaftueshme për SHPK-në gjatë ballafaqimit me trazira të mëdha qytetare, siç janë ngjarjet e marsit të vitit 2004 dhe incidentet e fundit të Vetëvendosjes. Inspektorati policor

¹⁰ Doracaku I Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, p-4.14 (Azhurnuar më 24/02/2003)

përkrah krijimin e një varg autorizimesh ligjore për SHPK-në të cilat do të ndihmojnë në përpjekjen për ndalimin dhe çarmatosjen e personave të cilët mund të mbledhen me qëllim të shkaktimi të lëndimeve tek personat apo dëmeve në pronë. Është me rëndësi që këto dispozita të definohen me kujdes të madh, duke mos l kufizuar apo hequr pavend të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve. Inspektorati policor ka siguruar një mostër të draft ligjit që mund të përdoret si bazë për legjislacionin e ri.

Rekomandimi kryesor

Nr. 7

Inspektorati policor përkrah krijimin e një varg autorizimesh ligjore për SHPK-në të cilat do të ndihmojnë në përpjekjen për ndalimin dhe çarmatosjen e personave të cilët mund të mbledhen me qëllim të shkaktimi të lëndimeve tek personat apo dëmeve në pronë.

Deklarata e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencionit të Inspektoratit Policor mbi hetimet e UNMIK–ut lidhur me vdekjen e dy personave gjatë trazirave qytetare të datës 10 shkurt, 2007.

Në pasditen e të shtunës, më 10 shkurt 2007, dy persona u qëlluan për vdekje nga Zyrtarët Ndërkombëtarë të Policisë gjatë demonstratave të qytetarëve në Prishtinë. Dy tjerë ende janë në gjendje kritike dhe 80 persona tjerë janë lënduar po ashtu. Ky është ndër incidentet më të rënda të qytetarëve që kanë ndodhur gjatë demonstratave prej se Kombet e Bashkuara kanë filluar mandatin e vet në qershor 1999.

Komisari i Policisë së UNMIK–ut menjëherë e ka formuar ekipin hetimor Task Force të policisë së UNMIK–ut. Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm e dha një zotim të fortë se “nuk do të lëmë gur pa lëvizur dhe se dëshiroj të ju siguroj se do të bëjmë gjithçka si duhet për të gjetur se pse dhe si ka ndodhur”.

Prokurori Publik i cili është përgjegjës për hetimet e UNMIK–ut nuk ka ushtruar asnjë padi penale kundër asnjërit lidhur me gjuajtjet. Përderisa një mungesë e dëshmive të mjaftueshme të pavarura nuk i dhanë mundësinë Prokurorit Publik të identifikojë policët përgjegjës për gjuajtjet fatale, IPK–ja mendon se mënyra me të cilën janë marrë në pyetje policët e UNMIK–ut ishte nën një standard të pranueshëm.

Personat përgjegjës për dy rastet e vdekjes dhe dy me lëndime serioze ishin zyrtarë të policisë së UNMIK–ut të pajisur me armë dhe plumba të gomës të një lloji specifik. Gjithçka që përmban ky raport rrjedh nga ky fakt i qartë dhe i pamohueshëm.

1. Hyrje

1.1 Më 11 shkurt 2007 Komisari i Policisë së UNMIK–ut, Z. Steve Curtis, i bëri ftesë zyrtare Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit të Policisë së Kosovës (IPK), z. Enver Rrustemit, të bëjë një mbikëqyrje të pavarur të hetimeve të UNMIK–ut lidhur me vdekjen tragjike të dy personave gjatë trazirave qytetare në Prishtinë, të shtunën, më 10 shkurt 2007. Përderisa hetimet e UNMIK–ut fillimisht iu ngarkuan një zyrtari të Policisë së UNMIK–ut, PSSP–ja, në një njoftim për shtyp më 14 shkurt, e emëroi z. Robert Dean, Prokurorin Publik, në krye të hetimeve.

1.2 Është me rëndësi të kuptohet fushëveprimi i saktë i mandatit të Prokurorit Publik. Në takimin e parë me Kryeshefin Ekzekutiv, më 20 shkurt 2007, z. Dean i bëri të qarta dy drejtimet e njëkohshme të hetimeve. Së pari, se ai ishte përgjegjës të konstatojë se a paraqet vepër të mundshme penale shkaktari i vdekjes së Z. Mon Balaj dhe Z. Arben Xheladinit. Së dyti, në rast se shkaku i vdekjes paraqiste vepër të mundshme penale, atëherë do të ishte detyra e tij të zbulonte se a mund të identifikohet kryesi i veprës. Kjo len të kuptohet se hetimet, nuk kishin për qëllim të zbulojnë dëshmitë për vepra tjera – penale ose të ndonjë natyre tjetër – të kryera nga ana e policisë apo qytetarëve gjatë trazirave të 10 shkurtit 2007.¹¹

1.3 Duhet të theksohet se nuk na është dhënë fushëveprimi dhe objektivat e sakta (terms of reference) të mbikëqyrjes¹² së IPK–së nga asnjëri, as nga Komisionari, Z. Kurtis, pasuesi i tij apo Prokurori Publik, lidhur me hetimet. Për këtë arsye, është me rëndësi të qartësohet se çka IPK–ja konsideron si fushëveprimin dhe objektivat e tij për mbikëqyrje të hetimeve. Qëllimi ishte të përcaktohet se si dhe në çfarë mase Prokurori Publik i ka shfrytëzuar kompetencat e tij në kuadër të Kodit Procedural për të siguruar sa më shpejtë të gjitha dëshmitë në dispozicion lidhur me rastet e vdekjes dhe shqyrtojë vendimet e tij pasuese, duke u bazuar në dëshmi të tilla, se a është kryer një vepër (disa vepra) penale. Në kuadër të fushëveprimit të tij, IPK–ja do të merrej me pikat vijuese të veprimit:

- a) Kërkojë qasje në të gjitha dëshmitë që kanë të bëjnë me shkakun e vdekjes;
- b) Kërkojë sqarim me shkrim lidhur me çështjet që kanë qenë të paqarta sa i përket dëshmive; dhe
- c) Kërkojë sqarim me shkrim lidhur me veprimet hetuese që ishin të paqarta.

1.4 Në të dy konferencat publike për shtyp dhe gjatë takimeve private me Kryeshefin Ekzekutiv, z. Rrustemin, Prokurori Publik e përsëriti qëllimin e tij se mbikëqyrja e IPK–së do të jetë “e hapur dhe transparente”. IPK–ja mund të konfirmoj se z. Dean dhe kolegët e tij në Task Force u treguan në masë të madhe bashkëpunues dhe transparent, duke lejuar qasje në dëshmi, duke sqaruar çështjet hetimore dhe duke

¹¹ Gjatë një konference për shtyp më 28 mars, Prokurori Publik tha se fushëveprimi i hetimeve duhej të përcaktonte 1) nëse ka dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur paditë penale kundër ndonjërit polic dhe 2) për të vlerësuar aktivitetet e policisë (10 shkurt) përfshirë zinxhirin komandues, të planifikimit dhe vendimmarrjes

¹² Komisari e quajti mbikëqyrjen “shqyrtim (scrutiny)” gjatë një konference për shtyp më 13 shkurt

ju përgjigjur pyetjeve që ishin me rëndësi për punën e IPK-së.

1.5 Ky raport paraqet vërejtjet e IPK-së që kanë të bëjnë me objektivat e Prokurorit Publik (shih paragrafin 1.2 më lart) dhe janë të kufizuara në kuadër të fushëveprimit dhe objektivave (terms of reference) të përshkruara në paragrafin 1.3 më lart. Vërejtjet bazohen në mbikëqyrjen e IPK-së ku janë përfshirë intervistat me ekspertë, policë, KFOR-in dhe qytetarë, si dhe qindra faqe dokumentacioni. Në periudhën mes datës 11 shkurt dhe datës së këtij raporti, IPK-ja u takua me Prokurorin Publik ose udhëheqësit e Task Force disa herë me ç'rast i dorëzuan tetë kërkesa zyrtare përmes të cilave kërkonin dokumentacionin apo informatat kyçe

2. Shkaku i vdekjes

2.1 Në ditët që pasuan vdekjet e Z.Balajt dhe Z.Xheladinit, u ndërmor një autopsi e hollësishme nga një ekip ekspertësh, Kosovarë dhe të jashtëm. Rezultatet nga autopsia sollën dëshmi të qarta se të dy personat vdiqën si rezultat i drejtpërdrejtë nga goditja në kokë me plumba gome. Z. Balaj është goditur anash në kokë, pas dhe mbi veshin e majtë dhe Z. Xheladini është goditur në ballë. Sipas mendimit të mjekut që e bëri autopsinë, Z.Xheladini mund të jetë goditur dy herë në kokë. Në të dy rastet plumbat e gomës kanë depërtuar në kafkë dhe kanë shkaktuar lëndime vdekjeprurëse në tru. Këta plumba janë nxjerrë nga viktima dhe janë ruajtur si dëshmi.

2.2 Ekzaminimi i plumbave të marra nga viktimat zbulon se ato ishin të llojit të njohur si “plumba RB1” – një top me ngjyrë hiri të mbyllët nga goma e ngjeshur, me diametër 18.4 dhe peshë 5.8 gram. Task Force zbuloi se plumbat e këtij përshkrimi ishin në posedim vetëm të një grupi policësh më 10 shkurt 2007: përndryshe, nëntë policë të angazhuar në njësinë rumune FPU.¹³ Pjesëtarët e këtij grupi rumun ishin të pajisur me armë dhe një numër llojesh të plumbave të gomës, përfshirë llojin RB1. Ekzaminimi i IPK-së që i është bërë dokumentacionit të UNMIK-ut zbulon se gjithsej 232 plumba gome janë gjuajtur nga Policia Civile e UNMIK-ut atë ditë, prej të cilave, kontingjenti rumun ka gjuajtur 144 plumba¹⁴. 59 nga plumbat e gomës të gjuajtura nga policët rumun të FPU-së ishin plumba RB1. Përderisa policët tjetër të angazhuar nga UNMIK-u posedonin atë ditë armë dhe plumba gome, asnjëri nuk kishte plumba të llojit RB1. Kjo i mundësoi hetimeve të UNMIK-ut të ngushtojnë fushën e hetimeve në dy çështje kryesore:

- a) Dëshmitë që mund të krijojnë lidhje mes plumbave të gjetura te viktimat dhe armës së caktuar që e ka poseduar polici i caktuar nga grupi rumun; dhe
- b) Dëshmitë që mund të sugjerojnë se përdorimi i forcës nuk ishte ligjor në rrethanat e dhëna.

¹³ Njësitë e Formuara të Policisë (FPU) janë njësi individuale në kuadër të strukturës organizative të Njësisë Speciale të Policisë së UNMIK-ut (SPU).

¹⁴Kontingjenti rumun gjithashtu ka shkrepur 127.38 predha të gazit lotsjelles, 71 granata të gazit lotsjelles dhe 33 granata zhurmëkrijuese të këmbësorisë

3. Lidhja e plumbave të gjetur me policin e caktuar

3.1 Ndryshe nga plumbi konvencional i mbështjellur me metal i gjuajtur nga arma me tytë gjurmëlënëse ("rifled"), është tepër e vështirë të gjendet lidhja mes plumbit të gomës dhe armës me tytë të lëmuar, siç është pushka. Teknikët e mjekësisë ligjore zakonisht i krahasojnë shenjat unike në plumbin konvencional me një plumb testues të gjuajtur, mirëpo kjo teknikë nuk hyn në punë në rast të plumbit të gomës nëse gjuhet nga pushka. Shkurt, prokurori publik nuk ishte në gjendje të marrë dëshmi të qarta për të identifikuar se nga cila pushkë e rumunëve janë gjuajtur plumbat që kanë goditur viktimat.

3.2 Në mungesë të dëshmive forenzike, prokurori publik ka mundur të shpresojë në identifikimin e policit rumun përgjegjës vetëm përmes dëshmive që mund të nxirreshin nga tri burime: dëshmitarë okularë, metrazhe filmike dhe nga vetë policët rumun. Secili burim i dëshmive të mundshme është ekzaminuar me kujdes nga Task Force.

Shqyrtimi i dëshmive të dëshmitarëve nga IPK-ja

3.3 Kopjet e dëshmive me shkrim që i janë siguruar IPK-së nga Task Force, tregojnë se mbi 100 dëshmitarë të pavarur okular janë marrë në pyetje nga pjesëtarët e Task Force dhe kanë dhënë deklarata dëshmie. Mbikëqyrja e pavarur e dëshmive që i janë dhënë IPK-së kanë konfirmuar se asnjëri nga dëshmitarët nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë dëshmi që mund të tregojnë – në mënyrë të sigurt – identitetin e policëve të cilët kanë dhënë goditjet fatale më 10 shkurt. Kjo mungesë e identifikimit rezulton për shkak të rrethanave të caktuara të pashmangshme: policët rumun ishin të veshur me uniformë të njëjtë për trazira (dmth. material me ngjyrë të zezë, helmata dhe maska për fytyrë), me pamje të mjegullt të fytyrës dhe me tipare vështirë të dalluara. Si do që të jetë, përlëshja e përgjithshme do ta bënte jashtëzakonisht të vështirë për cilindo dëshmitarë të vërejë në të njëjtën kohë goditjen e viktimës nga plumbi dhe, në të njëjtën kohë, policin që e ka gjuajtur atë plumb.

Shqyrtimi i metrazheve filmike nga IPK-ja

3.4 Task Force i ka rishikuar të gjitha incizimet¹⁵ e njohura nga trazirat qytetare me 10 shkurt, përfshirë pamje të qarta të pjesëtarëve të FPU-së rumune duke gjuajtur në drejtim të turmës. Si në rastin e dëshmitarëve okularë, në asnjë moment nuk mund të nxirret dëshmi që mund të identifikonte policët përgjegjës për shkreplet dhe goditjet fatale. Dëshmi me rëndësi që është nxjerrë nga incizimi filmik është mënyra se si policët e caktuar rumun kanë gjuajtur me pushkët e tyre në drejtim të turmës: shihet se kanë në shënjestër lartësinë e kokës dhe atë në afërsi të madhe. Rëndësia e këtyre çështjeve për hetimin do të diskutohet më tutje.

3.5 Mungesa e një dëshmie të qartë nga dëshmitarët okular, nga metrazhet filmike dhe nga dëshmitë forenzike kanë krijuar një pengesë mjaft të madhe për qëllimin që

¹⁵ Më 3 prill, Task Force i ofroi IPK-së 35 DVD që përmbanin metrazhe filmike dhe pamje fotografike

prokurori publik të vërtetojë identitetin e policit (ëve) rumun përgjegjës për gjuajtjet fatale. Kjo mungesë e dëshmive të pavarura e bëri më të rëndësishëm burimin e mbetur të dëshmive – nëntë policët të cilët ishin të pajisur me plumba RB1. Mënyra me të cilën do merreshin në pyetje do të përbënte fazën më thelbësore të hetimeve të UNMIK–ut. Para se të merremi me mënyrën se si Task Force e ka zhvilluar procedurën e marrjes në pyetje të policëve, është me rëndësi të merret parasysh gjendja e pazakonshme e ligjit Kosovar lidhur me përdorimin e armëve vdekjeprurëse nga policia.

4. Marrja në pyetje e policëve rumun – përdorimi i forcës së arsyeshme

4.1 Në rast se një qytetar i zakonshëm në Kosovë e gjuan me qëllim një person në kokë dhe e vret atë, atëherë është kryer vepër penale e vrasjes sipas nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Sidoqoftë, në rastin e një polici supozohet se ai/ajo e ka mbrojtjen ligjore nëse forca vdekjeprurëse është përdorur në rrethana të caktuara. Përderisa në shumicën e legjislacioneve ekzistojnë dispozita të qarta ku përshkruhet qartë niveli i mbrojtjes (d.m.th. forca a arsyeshme), Kosova, ende nuk ka legjislacion të tillë. Neni 1.3 i Rregullores së UNMIK–ut 1999/24, që përkufizon ligjin aplikativ të Kosovës, thotë se “të gjithë personat që ndërmarrin detyrë publike ose kanë post publik në Kosovë duhet t’i përmbahen standardeve të njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut”. Pra mund të argumentojmë se – në mungesë të dispozitave specifike në Rregullore të UNMIK–ut apo në Ligjet e Asamblesë – përdorimi i forcës nga polici duhet të jetë në përputhshmëri me *Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara të Përdorimit të Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit*¹⁶ (tash e tutje PTHPF). Ky interpretim gjen mbështetje në përmbajtjen e Doracakut për Njësitë Speciale të Policisë së UNMIK–ut¹⁷ (tash e tutje DNSPU), një dokument që i është dhënë prokurorit publik si dëshmi dhe përmban udhëzime të hollësishme mbi përdorimin e forcës gjatë trazirave qytetare në Kosovë.

4.2 PTHPF–ja i përsërit tri parimet themelore lidhur me përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga policët: kryesisht, forcën që është e domosdoshme, proporcionale dhe minimale që kërkohet. Paragrafi 4 në PTHPF thotë se:

“[Zyrtarët e zbatimit të ligjit] mund të përdorin forcën dhe armët e zjarrit vetëm nëse mjetet tjera nuk janë efektive ose nuk premtojnë të arrijnë rezultatin e synuar”.

4.3 Në këtë mënyrë, paragrafi 4 flet për parimin e domosdoshmërisë në përdorimin e forcës, kur mjetet tjera gjykohet të jenë jo adekuate për t’u arritur një qëllim i ligjshëm (shih DNSPU, faqe 14). Kjo kualifikohet edhe më shumë në paragrafin 5(a) i cili kërkon nga polici që të “përmbahet nga përdorimi i tillë dhe të veprojë në

¹⁶ E aprovuar në Kongresin e Tetë të Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kryesve të Veprave, Havana, Kuba, 27 gusht deri më 7 shtator 1990.

¹⁷ Doracaku është nxjerrë më 15 janar 2001, nën autoritetin e DPKO, Nju Jork dhe Zyrës së këshilltarit Special të Komisarit të Policisë së UNMIK–ut.

proporcion me seriozitetin e shkeljes dhe qëllimit objektiv që duhet të arrihet”. Me fjalë tjera, kërkohet forca minimale për tu arritur objektiva legjitime dhe nuk duhet të jetë më shumë se sa është e domosdoshme për tu arritur ajo objektivë (shih DNSOU, faqe 14). Paragrafi 14 i PTHPF-së përsërit të njëjtin parim lidhur me shpërndarjen e tubimeve të dhunshme: “zyrtarët e zbatimit të ligjit mund të përdorin armët e zjarrit vetëm kur mjetet më pak të rrezikshme nuk janë praktike dhe vetëm në shkallë minimale të domosdoshme”.

4.4 Lidhur me përdorimin e armëve të zjarrit, PTHPF-ja i imponon kufizimet plotësuese të zyrtarët e zbatimit të ligjit. Përveç parimeve të domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe përdorimit minimal të forcës, Paragrafi 9 i PTHPF-së (shih DNSPU, faqe 15) kufizon përdorimin e armëve të zjarrit në llojet vijuese të kërcënimeve:

- a) Vetëmbrojtje apo mbrojtje e të tjerëve nga ndonjë kërcënim i pashmangshëm për vdekje apo lëndim serioz,
- b) Parandalim i kryerjes së ndonjë krimi të caktuar që nënkupton kërcënim serioz të jetës,
- c) Arrestim i personit që paraqet një rrezik të tillë dhe i reziston autoritetit të tyre, ose
- d) Parandalim i ikjes së tij/saj dhe vetëm në rast se mjetet më pak ekstreme nuk janë të mjaftueshme për tu arritur qëllimi.

4.5 Fjalët kyçe këtu janë “rrezik i pashmangshëm për vdekje apo lëndim serioz”. Vetëm nëse dhe kur një polic është i vetëdijshëm për një kërcënim të tillë (ndaj vetes apo dikujt tjetër) ai/ajo mundet të gjuajë në mbrojtje apo për të parandaluar një lëndim të tillë ose ta arrestojë personin i cili kërcënon të shkaktojë një lëndim të tillë. Paragrafi 9 vazhdon duke thënë se, në çfarëdo rrethanash, “përdorimi vdekjeprurës i qëllimshëm i armëve të zjarrit mund të bëhet vetëm kur është plotësisht e pashmangshme me qëllim të mbrojtjes së jetës”.

4.6 Paragrafi 10 i PTHPF-së (shih DNSPU, faqe 15 & 26) kërkon që zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të japin “paralajmërim të qartë lidhur me qëllimin e tyre të përdorimit të armëve të zjarrit, duke i dhënë kohë të mjaftueshme paralajmërimit për tu realizuar, përveç nëse kjo do t’i shkaktonte pa nevojë rrezik zyrtarëve të zbatimit të ligjit ose do të krijonte rrezik për vdekje apo dëmtim serioz personave të tjerë”.

4.7 Është e qartë se pushka, e përdorur për gjuajtjen e plumbave të gomës apo predhave tjera, është “armë zjarri” për qëllim të PTHPF-së. Për më tepër, çdo argument se pushka e përdorur për gjuajtje të plumbave të gomës nuk është *armë vdekjeprurëse* do të dukej i papërshtatshëm pas ngjarjeve tragjike të 10 qershorit. Paragrafët e cekur më lartë pasqyrohen në dispozitat e *Doracakut të Njësisë Speciale*

*Policore të UNMIK–ut*¹⁸ (DNSPU) dhe janë parime të rëndësishme kur intervistohet një polic i cili/e cila, si rezultat të përdorimit të armës së zjarrit, ka shkaktuar vdekje apo lëndim serioz. Këto principe mund të përkthehen shumë lehtë në pyetjet vijuese që do t'i prashtroheshin policit (es):

- a) Përshkruani natyrën e kërcënimit specifik që pruri vendimin tuaj për të hapur zjarr?
- b) Përshkruani opsionet tjera që ishin në dispozicion për tu ballafaquar me kërcënimin, përveç përdorimit të plumbave të gomës?
- c) Cilat opsione, përveç plumbave të gomës, ishin në dispozicion dhe janë përdorur?
- d) Sa kohë ka qenë prezent kërcënimi?
- e) A është dhënë ndonjë paralajmërim lidhur me qëllimin për hapjen e zjarrit?
- f) Sa plumba janë gjuajtur dhe në çfarë periudhe kohore?
- g) Cili ishte kërcënimi specifik në secilin rast kur është gjuajtur me plumba?

4.8 Duke pasur parasysh se Task Force i identifikoi shpejt se vetëm nëntë pjesëtarët e tërë forcës së policisë civile të UNMIK–ut kanë përdorur armë me plumba RB1 më 10 shkurt, është konsideruar e arsyeshme që të nëntë policët do të merreshin në pyetje sa më shpejt që do të ishte e mundur. Për më tepër, është pritur që secili polic rumun do të merret në pyetje lidhur me çështjet e përmendura më lart. Këto pritje nuk u realizuan, gjë që shkaktuan ngritjen e një mori shqetësimesh specifike lidhur me ecurinë e hetimeve të UNMIK–ut.

5. Procedurat që pasuan pas përdorimit të Armëve të Zjarrit – Çështjet me interes

5.1 Doracaku i Njesisë Speciale Policore të UNMIK–ut (dhe PTHPF) kërkon në mënyrë të qartë nga zyrtarët të cilët i kanë përdorur armët dhe kanë shkaktuar lëndime apo vdekje të ofrojnë një raport të hollësishëm¹⁹ mbikëqyrësve të tyre sa më shpejt që është e mundur. Në rastin e nëntë policëve rumun të pajisur me armë, secili polic ka dorëzuar një raport të nënshkruar me 11 shkurt komandantit të Zyrës së Koordinuesve të FPU–së. Nga një shqyrtim i raporteve të bëra nga IPK–ja, vërehet se asnjëri nga raportet nuk përmban informata që janë të përkufizuara dhe që kërkohen sipas aneksit “c” të DNSPU–së “Procedurat pas gjuajtjes”. Secili nga raportet e nënshkruara të policëve përmbanin shtatë rreshta të tekstit të shtypur dhe ishin me format dhe me fjalë të njëjta në gjuhën angleze. Për më tepër, tre komandantët e platonit rumun me përgjegjësi direkte komanduese të të nëntë policëve gjithashtu ofruan raporte mbikëqyrëse identike të shtypura dhe të nënshkruara në gjuhën angleze

¹⁸ Doracaku është nxjerrë më 15 janar 2001, nën autoritetin e DPKO, Nju Jork dhe Zyrës së këshilltarit Special të Komisarit të Policisë së UNMIK–ut

6. Hetuesit Rumun të Task Force

6.1 Gjatë takimit të martën më 13 shkurt mes Kyeshefit Ekzekutiv të IPK-së dhe Task Force të UNMIK-ut, janë dhënë garanci se zyrtarët e të njëjtës kombësi si ato që janë angazhuar më 10 shkurt, nuk do të jenë në përbërje të ekipit hetues të Task Force të UNMIK-ut. I është dhënë një 'organogram' IPK-së të premtën më 23 shkurt të Task Force, edhe pse kombësitë e zyrtarëve të angazhuar në kuadër të Task Force nuk ishin cekur në atë tabelë. Është bërë një kërkesë me shkrim Task Force -it për këtë informatë me datën 24 shkurt dhe në të njëjtën ditë Task Force ka sjellur një kopje tjetër të organogramit IPK-së ku qartë u pa se dy nga zyrtarët hetues ishin me kombësi rumune.

6.2 Të hënën, më 26 shkurt, ditën e parë kur dy inspektorë të IPK-së u përfshinë në Task Force,²⁰ ishte e qartë se dy policët rumun ishin ende duke punuar në kuadër të Task Force. Po të njëjtën ditë, iu dorëzua një shkresë Task Force ku kërkohej sqarim lidhur me prezencën e zyrtarëve rumun. Një përgjigje me shkrim u dha më 3 mars me sqarimin se prezenca e hetuesve rumun ishte e nevojshme për shkak se policët rumun të FPU-së *"kishin njohuri të kufizuara apo nuk e njihnin fare gjuhën angleze"*. Kjo parashtron pyetje se si ishte e mundur që secili polic rumun FPU të përpilojë raportin e nënshkruar dhe të shkruar në gjuhën angleze më 11 shkurt siç u cek në paragrafin 5.1 më lartë. Shkresa e Task Force gjithashtu sqaroi se hetuesit rumun të Task Force u nevojitën për të zhvilluar intervistën e dëshmitarëve dhe për të ofruar përkthim nga rumanishtja në anglisht.

7. Dëshmitë e policëve rumun

7.1 Me 15 shkurt, dy hetuesit rumun të Task Force, të ndihmuar nga hetues tjerë ndërkombëtarë të Task Force, intervistuan policët rumun të pajisur me armë dhe nga ta u morën deklaratatë dëshmie, të shkruara me dorë në gjuhën rumune. Sidoqoftë, një shqyrtim i IPK-së i disa deklaratave që u ofruan nga Task Force ngrisin disa çështje serioze.

- a) Rezultatet e raporteve të autopsisë që i janë dhënë Task Force të UNMIK-ut më 12 shkurt, të cilat ngrisin pyetjet se pse nëntë policët rumun të pajisur me armë janë intervistuar si (a) dëshmitarë e jo të dyshuar më 15 shkurt dhe b) pse Prokurori Publik personalisht nuk i ka marrë në pyetje? Këto çështje do të diskutohen më hollësisht në paragrafin 7.2 deri 7.8 më poshtë.
- b) Një shqyrtim i dorëshkrimit të deklaratës së dy policëve rumun FPU, (L.I 15/2/07 and GG 15/2/07)²¹ zbuloi një mospërputhje të dukshme të transkriptit të shtypur në gjuhën angleze të përgatitur më vonë nga hetuesit rumun të Task Force. Versioni i shtypur në gjuhën angleze përmbante

²⁰ Me 22 shkurt, Prokurori Publik dhe KSHE i IPK-së u pajtuan që dy Inspektorë të IPK-së, të ndihmuar nga një përkthyes, do të përfshiheshin në Task Force dhe angazhimi i tyre filloi të hënën më 26 shkurt. Zëdhënësi i Shtypit të UNMIK-ut, gabimisht raportoi gjatë brifingut të së mërkurës 21 shkurt, se IPK-ja ishte veç e 'përfshirë plotësisht në Task Force dhe se ka qasje në të gjitha dosjet e Task Force'

²¹ Inicialet e personit të intervistuar dhe data e intervistës

rreshta të tekstit që përmbanin rregullat e angazhimit të FPU-së; sasinë dhe llojin e plumbave të gomës të shpërndara para demonstratave; hapësirën e caktuar e angazhimit; urdhrat rumun me të cilat është autorizuar përdorimi i plumbave të gomës dhe numrin e plumbave të gjuajtur. Asnjëra nga këto rreshta të tekstit të shtypur në gjuhën angleze nuk janë të përfshira në dorëshkrimet e deklaratave të shkruara nga policët rumun të FPU-së. IPK-ja mundet vetëm të konkludojë se Task Force nuk i ka dhënë kopjet e plota të deklaratave me shkrim me çka do të sqarohet pjesa plotësuese e dëshmisë ose hetuesi rumun i Task Force ndoshta është përpjekur të shtrembërojë ecurinë e drejtësisë

- c) Një polic rumun FPU i ka dhënë deklaratë dëshmie hetuesve të Task Force me 5 mars (IC 5/3/07) në të cilën ai cek se e ka zëvendësuar përkohësisht një polic rumun për afërsisht 15 minuta gjatë kulmit të trazirave. Ai e ka marrë pushkën por ka mohuar se ka gjuajtur ndonjë plumb gome. Sidoqoftë, në deklaratën e dytë dhënë hetuesve të Task Force, (IC 6/3/07) ai cek se ai në të vërtetë e ka përdorur pushkën për të gjuajtur plumba gome. Mospërputhja shumë e qartë në dy rastet e drejton dyshimin kah polici dhe e tregon policin e dhjetë rumun i cili ishte me interes të veçantë për Prokurorin Publik.
- d) Një ekzaminim i IPK-së i të gjitha deklaratave të policëve rumun ka zbuluar në mënyrë vendimtare një mungesë të përsëritur të detajeve lidhur me kërcënimin specifik që ka çuar në shkrepjen e plumbave të gomës. Mungesa e detajeve në të gjitha deklaratat bën që IPK-ja të përfundojë se nuk ka pasur kërcënim specifik për të arsyetuar gjuajtjen e plumbave të gomës ose zyrtarët e Task Force që i kanë marrë në pyetje kanë dështuar në punën e tyre për të nxjerrë informata të hollësishme dhe precize nga policët rumun të FPU-së. Njeri polic rumun tha në deklaratën e tij si dëshmitar.
- e) Njeri polic rumun tha në deklaratën e tij si dëshmitar (SP 10/3/07) “Mbrapa të dy këndeve të anës së majtë dhe të djathtë të ndërtesës kishte persona që fshiheshin. Ata janë personat në të cilët kemi gjuajtur”. Kjo informatë shërben si dëshmi e qartë e mos respektimit të plotë dhe moskokëçarjes ndaj PTHPF-së dhe DNSPU-së. Polici i ka gjuajtur gjashtë plumba gome por nuk ka ofruar arsyetim apo sqarim lidhur me kërcënimin specifik ndaj të cilit është ekspozuar. Është vështirë të jepet një sqarim i tillë nëse kemi parasysh se personat mundoheshin të fshiheshin kur polici ishte duke gjuajtur në ta.

7.2 Pasi rezultatet e autopsisë u dorëzuan më 12 shkurt, ishte e qartë për anëtarët e Task Force se të dy viktimat kanë vdekur si rezultat i goditjes në kokë me plumba RB1. Gjithashtu, ishte e qartë se vetëm nëntë (dhe më vonë dhjetë) policë të angazhuar nga Policia Civile e UNMIK-ut kishin në posedim plumba RB1. Këto fakte, në kombinim me inçizimet filmike ku duket se shihen disa policë të caktuar rumun që i kanë të drejtuara armët në lartësinë e kokës dhe atë në distancë prej 30 metrash²² së bashku me deklaratat e dëshmive²³, sugjerojnë se nëntë (e më vonë

²² DVD 1 e IPK-së – 5 min 42 sek deri 6min 04 sek dhe 6 min 30 sek. DVD 2 e IPK-së 52min 50 sek

dhjetë) policë rumun të pajisur me armë duhet të trajtohen si të dyshuar (apo të pandehur) e jo si dëshmitarë sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tutje KPPPK). Kjo do tu mundësonte këtyre policëve të drejtat e tyre të plota kur të merreshin në pyetje lidhur me veprimet e tyre gjatë trazirave qytetare.

7.3 E drejta e të pandehurit – pa marrë parasysh i paraburgosur apo në liri – sipas KPPPK-së përfshin të drejtën për avokat (Neni 218[1]), të drejtën për përkthyes (neni 232[3]) dhe të drejtën për tu informuar mbi pikat vijuese sipas nenit 231[2] të KPPPK-së:

- a) Veprën penale për të cilën ai/ajo akuzohet;
- b) Të drejtën për të heshtur dhe për të mos u përgjigjur në asnjë pyetje, përveç informacionit mbi identitetin e tij/saj;
- c) Të drejtën në përkthim falas nëse ai/ajo nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura e marrjes në pyetje;
- d) Të drejtën për ndihmën e mbrojtësit dhe konsultimit me të para dhe gjatë marrjes në pyetje;
- e) Faktin se deklarimi i tij/saj mund të përdoret si provë para gjykatës; dhe
- f) Faktin se ai/ajo mund të kërkojë marrjen e provave për mbrojtjen e tij.

7.4 Pasojat e mos trajtimit të dhjetë policëve si të pandehur dhe të informimit të tyre për të drejtat e tyre janë të mëdha. Provat e marra në kundërshtim me këto dispozita të KPPPK-së janë të papranueshme (KPPPK 235) pasi që gjykata nuk mund të mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme (KPPPK 153[2]). Për këtë arsye, provat që janë marrë gjatë intervistës me dhjetë policët rumun si dëshmitarë (e jo si të pandehur) do të përjashtohen (konsiderohen të papranueshme).

7.5 Normalisht, marrja në pyetje e një të pandehuri do të kryhet nga Prokurori Publik, më së voni, para përfundimit të hetimeve përveç nëse procedura rezulton me pushim (KPPPK 229). Përderisa Nenet 218[2] & 231 të KPPPK i referohen autoritetit të Prokurorit Publik për t'ia besuar marrjen në pyetje policisë në rrethana të veçanta, hetimi për dy rastet e vdekjes në duart e policisë duket si një shfrytëzim i pavend i këtij përjashtimi të rregullave.

7.6 Siç është cekur më parë, ky rast është përqëndruar në aplikimin e ligjit lidhur me përdorimin e forcës nga policët në Kosovë. Po të ishin identifikuar si të dyshuar, secili nga dhjetë policët rumun do të duhej të merrej në pyetje lidhur me vendimet e tyre individuale për të gjuajtur plumba gome. Në veçanti, marrja në pyetje do të duhet të përqëndrohej në pikat e dhëna më lart në paragrafin 4.7 si dhe në çështjet vijuese:

- a) Natyra specifike e kërcënimit – për secilin rast – që çoi deri te vendimi për të

²³ Deklaratat (DL 23/2/07) (HI 28/2/07) (NP 16/2/07) (NM 22/2/07) (SP 28/2/07) (NA 17/2/07) (LB 19/2/07) (MS 28/2/07)

gjuajtur;

- b) Distanca – për secilin rast – me personin më të afërt në vijën e zjarrit;
- c) Gjasat apo e kundërta – në secilin rast – të personit në vijën e zjarrit të goditet mbi lartësinë e mesit.

7.7 Më 23 mars 2007 UNMIK lëshoi një komunikatë për shtyp ku lajmëronte se të gjithë pjesëtarët e njësitit rumun janë larguar nga Kosova dy ditë më parë, më 21 mars. Grupi që u largua përfshinte edhe dhjetë policët të cilët kishin përdorur plumba RB1 dhe mbikëqyrësit e tyre të 10 shkurtit. Nuk ishte bërë asnjë përpjekje për të informuar IPK-në për këtë ngjarje para komunikatës për shtyp dhe, çka është më me rëndësi, nuk është bërë asnjë përpjekje për tu konsultuar me Ministrin e Punëve të Brendshme. Komunikata për shtyp tregonte se largimi u bë një muaj pas datës së caktuar të përfundimit të detyrës së tyre në Kosovë dhe se autoritetet rumune nuk janë pajtuar me kërkesën e UNMIK–ut që dhjetë policët të mbeten në Kosovë për të ndihmuar në hetimet që ishin në vazhdim e sipër.

7.8 Largimi i policëve rumun, së bashku me armët e tyre, efektivisht i dha fund hetimeve, në kuptimin që e mbylli derën e përpjekjes së fundit për të vërtetuar cilët nga dhjetë policët kanë bërë goditjet fatale. Sipas mendimit të IPK–së mundësia për t'i marrë në pyetje si duhet dhjetë policët gjatë 5 javëve që kanë mbetur në Kosovë, sipas dispozitave të KPPPK–së, është shfrytëzuar dhe menaxhuar shumë dobët nga ana e Task Force. Është mendimi i IPK–së se kanë ekzistuar dëshmi të mjaftueshme gjatë javës së gjuajtjeve fatale për Prokurorin Publik për të marrë në pyetje dhjetë policët si të dyshuar (apo të pandehur) në bazë të ligjit të KPPPK–së.

8. Roli i policëve komandues

8.1 Siç është cekur në paragrafin 4.1 më lart, ligji aplikativ i Kosovës pohon se çdo polic ka përgjegjësi individuale në rast se merr vendim për të përdorur forcë apo armë zjarri. Ai vendim, në rast të armës së zjarrit, duhet të bazohet në gjykimin individual të policit lidhur me natyrën e kërcënimit të konsideruar dhe se a është forca e përdorur e nevojshme dhe proporcionale. Sidoqoftë, në rast të demonstratave për të cilat policia ka pasur njoftim paraprak dhe e cila i është nënshtruar një planifikimi të gjerë policor, roli i oficerëve komandues është me rëndësi për shkak të vendimeve në përdorimin e armëve dhe vendimit për ndalimin e përdorimit të armëve. Paragrafi 24 i PTHPF–së thotë se:

“Qeveria dhe agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të sigurojnë se zyrtarët e lartë mbajnë përgjegjësi nëse janë të njoftuar apo duhet të kenë qenë të njoftuar se zyrtarët e zbatimit të ligjit nën komandën e tyre janë duke filluar ose kanë filluar përdorimin e paligjshëm të forcës dhe armëve të zjarrit, dhe nuk i kanë marrë të gjitha masat në bazë të autoritetit të tyre në parandalimin, ndalimin apo raportimin e përdorimit të tillë”.

8.2 Dëshmia e zbuluar në rastin e vdekjes së z.Balaj dhe z.Xheladini përbën bazë për një hetim të nivelit shumë më të lartë në këtë episod tragjik. Plani Operativ i UNMIK–ut për 10 shkurt, që iu sigurua më në fund IPK–së më 22 mars, tregon se komandantët kanë marrë vendim me të cilën autorizohej angazhimi i njëjësive me pajisje të plotë. Lidhur me standardet e angazhimit të FPU–së, kjo nënkupton se policët do të kenë gaz lotsjellës dhe armë për gjuajtjen e plumbave të gomës RB1 dhe lloje tjera të plumbave të gomës. Sidoqoftë, komandantët nuk i kanë kontrolluar më pastaj përdorimin e këtyre armëve pasi që u bë e dukshme se janë shkaktuar lëndime serioze. Gjithsej 232 plumba gome janë gjuajtur gjatë trazirave, shumica prej tyre janë gjuajtur pasi janë lënduar katër persona për shkak të goditjes me plumba gome mbi lartësinë e belit dhe për këtë komandantët e UNMIK–ut nuk kanë mundur të mos jenë në dijeni. Mungesa e komandës dhe kontrollit të veprimtarisë policore bëhet edhe më e zyrtë për shkak të dëshmive të qarta se armët janë përdorur në afërsi të madhe (më pak se 30 metra), kanë pasur për shënjestër lartësinë e kokës dhe turmën që ishte duke u tërhequr. Këto fakte sugjerojnë se policët FPU të UNMIK–ut nuk kanë pasur kontroll dhe drejtim nga zyrtarët e tyre komandues.

8.3 Urdhri Operativ i UNMIK–ut thotë qartë se polici në komandë të plotë i demonstratave ishte Zëvendës Komisari për Operativë i UNMIK–ut.²⁴ Ky polici ka kontrolluar dhe koordinuar të gjitha operacionet nga dhoma për incidente (incident room) në Shtabin e Policisë më 10 shkurt. Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Operativës kishte përgjegjësi t'i informojë komandantët e FPU–së para demonstratave në ora 11:00. Ai i raportoi direkt Zëvendës Komisarit, ai u angazhua në Teatrin Kombëtar gjatë demonstratave dhe dha urdhrat në vendngjarje. Përderisa shumica e policëve të UNMIK–ut të cilët dhanë deklaratatë dëshmie tregojnë se Komandanti i Zyrës Koordinuese të FPU–së ishte udhëheqësi në rrugën “Nëna Terezë” afër Teatrit Kombëtar, komandanti i Zyrës Koordinuese të FPU–së, në deklaratën e vet të dhënë, (AM 18/2/07) thotë se *“nuk kishte ndërlidhje të organizuar mes njëjësive të FPU–së, koordinatorëve dhe ROSU/MSU edhe pse i kemi vendosur disa ndërlidhje në terren. Sa jam i njoftuar, nuk ka ekzistuar një person që ka udhëhequr me situatën gjatë demonstratës..”*. Përkundër kërkesave të reshtura të bëra nga IPK–ja për Task Force, emri dhe titulli i komandantit në vend i cili udhëhiqte veprimet e policëve në rrugën “Nëna Terezë” nuk u siguruan. Hutia e dukshme se kush ishte në krye të zyrtarëve të FPU–së në rrugën “Nëna Terezë” ndoshta shpjegon se pse kishte mungesë të kontrollit të qartë, por përbën një ndjenjë të përgjithshme së Policisë së UNMIK–ut i ka munguar një menaxhim i duhur dhe profesional.

9. Përfundim

9.1 Në përgjithësi, IPK–ja mund të konfirmojë se hetimi i Prokurorit Publik lidhur me vdekjen e z. Balaj dhe z.Xheladini është kryer si duhet dhe në masë të madhe në pajtim me ligjin aplikativ të Kosovës. Fakti që nuk janë siguruar dëshmi të

²⁴ Komisari i Policisë së UNMIK–ut ia ka deleguar komandën e përgjithshme operative zëvendës komisarit por ai nuk ka siguruar një mbikëqyrje strategjike gjatë operimit dhe kjo ka qenë e përcaktuar në dokumentet “Qasja Strategjike” dhe “Qëllimi Strategjik” i komisarit të cilat i janë bashkangjitur planit operativ.

mjaftueshme për të ndjekur penalisht një apo më shumë pjesëtarë të FPU-së rumune qëndron më shumë në natyrën e dëshmimeve të marra se sa në mënyrën se si janë marrë. Një plumb gome i gjuajtur nga një pushkë me tytë të lëmuar nuk mund të identifikohet, në mënyrë të sigurt, nga aspekti forensik me pushkën nga e cila ka dalë. Dëshmitë e dëshmitarëve okularë dhe metrazhet filmike, gjithashtu, nuk kanë mundur të ofrojnë një dëshmi të qartë se cili (cilët) policë kanë gjuajtur goditjet fatale.

9.2 Ndërkaq, përkundër faktit se IPK-ja kritikon mënyrën se si janë marrë në pyetje policët rumun, pranohet fakti se ekziston mundësia – gjatë përlëshjes në trazira – polici i caktuar të mos dijë se a e ka goditur personin e caktuar dhe, po ta ketë ditur, sipas gjasave nuk do të tregonte gjatë marrjes në pyetje nga Prokurori Publik. Pa dëshmi të qarta dhe të padiskutueshme nga një burim i pavarur, Prokurori Publik nuk ka mundur të krijojë baza për ndjekje penale. IPK-ja e pranon se ky rezultat do ta rrisë në masë të madhe ndjenjën e dhimbjes dhe padrejtësisë që do ta ndjejnë familjet e të ndjerëve dhe personave tjerë të lënduar, disa prej tyre rëndë.

9.3 Në të njëjtën kohë, IPK-ja beson se janë humbur mundësitë qenësore gjatë marrjes në pyetje të nëntë (më vonë dhjetë) policëve rumun. Në periudhën prej pesë javësh para se të largohen, Prokurori Publik nuk e ka ushtruar autoritetin e tij sipas KPPPK-së për të marrë në pyetje në mënyrë të tërësishme këta policë si të pandehur dhe t'i parashtrijë atyre pyetje lidhur me gjuajtjet e vazhdueshme në turmën që tërhiqej, në afërsi të madhe dhe mbi lartësinë e belit. Një qasje e tillë, ka mundur, me të drejtë, të rezultojë në akuza për tentim vrasjeje ose, të paktën, në shkelje serioze të rregulloreve të KB-së.

9.4 Edhe pse hetimi penal ka arritur në një përfundim të pasuksesshëm, IPK-ja i nxit fuqishëm autoritetet e UNMIK-ut të përfundojnë procedurën e paraparë në paragrafin 24 të PTHPF-së. Siç është cekur më herët në këtë raport, dëshmitë e siguruar nga Prokurori Publik shërbejnë si bazë e konsiderueshme për të marrë masa disiplinore kundër policëve që kishin përgjegjësinë komanduese për aktivitete policore më 10 shkurt 2007. Për momentin, mund të thuhet se po të kishin ushtruar policët komandues kontroll të duhur dhe profesional ndaj FPU-së, nuk do të vinte deri te rastet e vdekjes së dy personave dhe dy rasteve të lëndimeve të rënda. Hetimi i sugjeruar duhet të vërtetojë se sa dhe në çfarë mase kjo deklaratë është e vërtetë.

Enver Rustemi

Kryeshef ekzekutiv

Inspektorati Policor i Kosovës

INSPEKTIMI I SHPK-së LIDHUR ME PAJTUESHMËRINË ME NENIN 7 TË RREGULLORES 2005/54

PJESA I: HYRJE

1. Në bazë të kërkesës së Ministrit të Punëve të Brendshme, kryeshefi ekzekutiv ka angazhuar Inspektoratin Policor në një inspektim të jashtëzakonshëm të SHPK-së lidhur me pajtueshmërinë me pikat e nenit 7-të, të Rregullores 2005/54, për emërimet e komandanëve të stacioneve dhe çështjeve përkatëse. Kjo pjesë e kornizës së brendshme ligjore për SHPK-në ka të bëjë me një varg çështjesh që janë të lidhura me ‘marrëdhëniet me bashkësinë’. Sidoqoftë, fushat e veçanta që lidhen me punën e zyrtarëve të lartë të SHPK-së përfshijnë emërimin e komandantëve të stacioneve (neni 7.11 & 7.12), kërkesat që komandantët e stacioneve t’ia dorëzojnë një raport vjetor Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive (KKSb) mbi kryerjen e detyrave policore (neni 7.13[a]), dhe kërkesat që komandantët e stacioneve t’ia dorëzojnë një plan vjetor KKSb-së, mbi kryerjen e detyrave policore (neni 7.13[b]).



1.2 Rëndësia e këtyre dispozitave të Rregullores 2005/54 nuk mund të mbitheksohet: ato formojnë një pjesë qendrore në kornizën e tanishme ligjore për përgjegjshmërinë e policisë, si dhe një mekanizëm të rëndësishëm që siguron se SHPK-ja u përgjigjet nevojave të të gjitha bashkësive etnike në Kosovë. Rregullorja 2005/54 përcakton një sistem ku bashkësitë lokale mund të angazhohen plotësisht në proceset e vendimmarrjes së SHPK-së, që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë në nivel lokal. Me formimin e KKSb-ve – të kryesuara nga kryetarë të kuvendëve komunale përkatëse, përfaqësuesit e bashkësive lokale mund të diskutojnë çështjet që kanë të bëjnë me policinë, sigurinë dhe rendin publik (neni 7.7), dhe kanë rol konsultativ në përzgjedhjen e komandantëve të stacioneve, në themelimin e këshilleve lokale për sigurinë publike dhe përbërjen e policisë të caktuar në komunë (neni 7.7[a] - [b]).

1.3 Procedura e përzgjedhjes së komandantëve të stacioneve kërkon një konsultim të dyanshëm, duke pasqyruar parimet e përgjegjshmërisë policore të përshkruar në nenet 13, 19, dhe 59, të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP). Përderisa Komisari Policor mbanë autoritetin për të emëruar komandantët e stacioneve në nivel lokal, në bazë të nenit 7.11, nga ai kërkohet që në mënyrë aktive të konsultohet me zëvendës komisarin e SHPK-së, Ministrin e Punëve të Brendshme dhe kuvendin komunal përkatës. Para se ta dërgojë listën e (jo më pak se) tre kandidatëve në komunë, Komisari i Policisë duhet të konsultohet me ministrin dhe zëvendës komisarin. Kuvendi komunal pastaj e ka detyrë ligjore që ta bëjë ranglistën e kandidatëve në mënyrën e tij të preferuar (neni 7.12).

1.4 Neni 7.13 fuqizon parimet e përgjegjshmërisë në nivel lokal – siç mbështetet nga paragrafi 59-të i KEEP-së – duke kërkuar nga komandantët e stacioneve që në mënyrë aktive të konsultojnë KKSB-në lidhur me formulimin e planeve për kryerjen e detyrave policore, pastaj raportimin tek KKSB-ja në fund të çdo viti, lidhur me progresin e arritur të SHPK-së në realizimin e këtyre planeve. Prandaj, ligji kërkon nga komandantët e stacioneve të bëjnë më shumë sesa raportimin në lidhje me progresin, i cili rezulton nga politikat dhe strategjia ekzistuese të SHPK-së. Rregullorja 2005/54 i jep përgjegjësi ligjore komandantëve të stacioneve, që në mënyrë aktive të konsultohen me KKSB-të e tyre para se ta sajojnë planin vjetor për kryerjen e detyrave policore, që në mënyrë specifike i përgjigjet të priturave nga bashkësia. Në fund të vitit fiskal, komandanti i stacionit duhet të përgatitë një raport që ofron informata të hollësishme për atë se sa është realizuar plani i mëhershëm.

1.5 Përveç pikave referuese të përshkruara më lartë, ky inspektim i jashtëzakonshëm ka për qëllim të jep rekomandime se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund ta përmirësojnë mënyrën e kryerjes së detyrave policore në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)
- Përkrahjen e përgjegjshmërisë policore në nivelin lokal;
- Përkrahjen e menaxhimit profesional për kryerjen e detyrave policore në nivelin lokal;
- Ndhmën në përgatitjen e shërbimeve policore kualitative për të gjitha bashkësitë etnike në Kosovë; dhe
- Identifikimin dhe shpërndarjen e praktikës më të mirë në menaxhmentin policor.

1.6 Neni 7-të i Rregullores 2005/54 i referohet një numri të personave kyç në përgjegjshmërinë policore në nivel lokal dhe është e rëndësishme që Inspektorati Policor ka siguruar të dhëna nga të gjithë ata persona të përfshirë. Gjatë rrjedhës së inspektimit janë intervistuar personat në vijim:

- TË 35 komandantët e stacioneve (apo zëvendësi nëse komandanti i stacionit nuk ka qenë i emëruar)
- TË 6-të komandantët regjional (apo zëvendësi nëse komandanti regjional nuk ka qenë i pranishëm)
- TË gjithë kryetarët e kuvendeve komunale (apo zëvendësi nëse kryetari nuk ka qenë i pranishëm)
- Zëvendës Komisari, gjen. nën. kol. Sheremet Ahmeti

1.7 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike, i cili është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

PJESA e II-të: PËRZGJEDHJA E KOMANDANTËVE TË STACIONEVE

2.1 Rregullorja 2005/54 ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2005, kur është nënshkruar dhe miratuar nga PSSP-ja. Sidoqoftë, pasi që neni 7-të i referohet nevojës që Komisari i Policisë të konsultohet me Ministrin e Punëve të Brendshme (shih nenin 7.12), dispozitat që kanë të bëjnë me përzgjedhjen dhe emërimin e komandantëve të stacioneve nuk kanë mundur të vехet në fuqi deri në emërimin e ministrit të parë, në maj të vitit 2006.

2.2 Aktualisht ekzistojnë 35 stacione policore në tërë Kosovën dhe shumica e tyre kanë të emëruar komandantët e stacioneve. Secili stacion është i kategorizuar sipas dendësisë së popullatës dhe numrit të personelit të SHPK-së të caktuar në stacione, si dhe, varësisht nga kategoria (p.sh A1, A2, B1, B2, B3, B4) vetëm një zyrtar me gradë të caktuar mund të emërohet si komandant i stacionit (p.sh toger, kapiten).

Në disa raste ka policë të cilët kryejnë detyrën e 'ushtruesit' të detyrës së komandantit të stacionit, në rast të mungesës së përkohshme të komandantit të emëruar të stacionit, ose gjatë procesit të përzgjedhjes së komandantit të përhershëm të stacionit. Inspektorati Policor vërejti se, në disa raste, SHPK-ja nuk ka qenë në gjendje që t'i plotësojë pozitat për komandantë të stacioneve në periudhën gjashtë mujore, për shkak të mungesës së zyrtarëve me grada të kërkuara (p.sh. toger, kapiten). Inspektorati mendon se kjo periudhë e zgjatur e vendit të zbrazët të punës pasqyron një praktikë të keqe dhe vendosmërisht rekomandon që Drejtoria e Administratës t'i jep përparësi detyrës për identifikimin e zyrtarëve të kualifikuar dhe të përshtatshëm për dhënien e gradave relevante.

Tabela 1
Shqyrtimi i stacioneve të SHPK-së, komandantëve të stacioneve dhe pajtueshmëria me nenin 7-të, të Rregullores 2005/54

Stacioni Policor	Komandanti i stacionit	Data e emërimit	A është aplikuar Rreg. 2005/54?	A kanë mbledhje me KKSb-të?	A kanë njohuri për nenin 7-të?
Prishtinë – Qendra	Kap. Afrim Ahmeti	24.01.2005	Jo	Po	Po
Prishtinë –Veri	Kap. Gezim Dibrani	21.08.2006	Po	Po	Po
Prishtinë –Jug	Kap. Isak Ejupi	06.06.2006	Jo	Jo	Jo
Stacioni Lipjan	Kap. Bajram Ademi	03.07.2006	Po	Po	Po
Stacioni policor Graçanicë	Kap. Stojan Milloshoviq	29.02.2002	Jo	Po	Jo i pranishëm gjatë inspektimit
Stacioni–Fushë Kosovë	Tog. Safet Jashari	06.06.2006	Po	Po	Po
Stacioni –Obiliq	Tog. Sejdi Zeqiri	02.06.2004	Jo	Po	Po
Stacioni –Glllogvc	Kap. Valdet Bujupi	10.02.2005	Jo	Po	Po
Stacioni –Podujevë	Kap. Njazi Jashari	10.07.2006	Po	Po	Po
Stacioni– Pejë	Kap. Enver Gashi	12.06.2006	Po	Po	Po
Stacioni– Istog	Kap. Jah Jahaj	23.09.2006	Jo	Po	Po
Stacioni – Klinë	Tog.Rexh Berisha	23.09.2006	Ushtrues	Po	Po
Stacioni Deçan	Tog. Rasim Sylja	28.12.2006	Ushtrues	Po	Po
Stacioni –Gjakovë	Kap. Bekim Avdiu	27.12.2006	Ushtrues	Po	Po
Stacioni –Prizren	Kap. Harris Dida	12.06.2006	Po	Jo	Jo
Stacioni– Suharekë	Kap. Arsim Berisha	01.02.2005	Jo	Po	Jo
Stacioni –Malishevë	Kap. Arben Paqarrizi	15.08.2004	Jo	Po	Po
Stacioni –Rahovec	Kap. Adem Krasniqi	08.06.2006	Po	Po	Jo

Tabela 2 (vazhdim)

Shqyrtimi i stacioneve të SHPK-së, komandantëve të stacioneve dhe pajtueshmëria me nenin 7-të, të Rregullores 2005/54

Stacioni Policor	Komandanti i stacionit	Data e emërimit	A është aplikuar Rreg. 2005/54?	A kanë mbledhje me KKSb-të?	A kanë njohuri për nenin 7?
Stacioni – Dragash	Kap. Gëzim Zogaj	01.01.2007	Po	Po	Jo
Stacioni– Gjilan	Kap.Basri Kastrati	06.06.2006	Po	Po	Po
Stacioni – Kamenicë	Kap.Lubisha Periq	Korrik 2005	Jo	Po	Jo i pranishëm gjatë inspektimit
Stacioni Viti	Kap.Afrim Halili	22.09.2005	Jo	Po	Jo i pranishëm gjatë inspektimit
Stacioni– Novobërdë	Tog.Boban Todorovic	17.07.2006	Po	Po	Po
Stacioni – Jug Mitrovicë	Kap. Bashkim Spaihu	22.07.2006	Po	Po	Po
Stacioni – Veri Mitrovicë	Kap.Milija Milloshovic	20.02.2006	Po	Jo	Po
Stacioni– Skenderaj	Kap.Avni Zabeli	14.09.2005	Jo	Po	Po
Stacioni– Vushtrri	Kap. Abdylaziz Hoxha	14.09.2005	Jo	Po	Po
Stacioni– Zubin Potok	Kap.Drazho Bozhovic	21.03.2005	Jo	Jo	Po
Stacioni – Leposaviç	Tog. Rade Radosvleviq	18.03.2004	Jo	Jo	Po
Stacioni – Zveçan	Kap. Dragan Stefanovic	21.03.2005	Jo	Jo	Po
Stacioni– Ferizaj	Tog. Qazim Reka	02..02.2005	Ushtrues	Jo	Jo
Stacioni – Shtërpce	Rresht. Dragan Ivanovic	21.09.2006	Ushtrues	Jo	Po
Stacioni – Shtimje	Tog. Emrush Lalinovci	06.07.2006	Jo	Jo	Jo
Stacioni– Kaçanik	Kap.Ismail Fejzullahu	20.09.2006	Po	Po	Po

Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që Drejtoria e Administratës së SHPK-së t'i jep përparësi detyrës për identifikimin e zyrtarëve të kualifikuar dhe të përshtatshëm për dhënien e gradave të caktuara, me qëllim të zvogëlimit të periudhës së zgjatur të vendit të lirë të punës për pozitat e komandantëve të stacioneve.

2.3 Inspektorati Policor vërejt se, shumica e komandantëve të stacioneve të cilët janë emëruar pas majit të vitit 2006, kryesisht janë zgjedhur në pajtim me nenin 7-të të Rregullores 2005/54. Tabela 1 tregon ato stacione të SHPK-së në të cilat zyrtarët janë emëruar në bazë të procedurës në vijim, të miratuara nga Komisari i Policisë së UNMIK-ut, në vitin 2006. Pasi që shpallet vendi i lirë i punës për komandant të stacionit, Drejtoria e Administratës, e cila vepron nën autoritetin e deleguar të Komisarit Policor, përgatit listën e kandidatëve me kualifikim të duhur dhe e dërgon te komandanti përkatës regjional. Ai e rishikon listën dhe e zvogëlon atë në tre kandidatë të preferuar, pastaj e kthen listen tek drejtoria e administratës. Lista prej tre kandidatëve pastaj i dërgohet kryetarit të komunës për stacionin përkatës, i cili e rishikon listën, e refuzon atë në tërësi ose e bënë renditjen e preferuar. Kur kryetari i komunës e aprovon listën, të renditur në mënyrë të preferuar, e kthen atë në Drejtorinë e Administratës dhe kandidati i sukseshëm emërohet nga drejtorati në emër të komisarit.

2.4 Sipas kryetarëve të komunave ky sistem ka funksionuar mirë dhe është në pajtueshmëri me nenin 7.12. Shihet se, pothuajse në të gjitha rastet, kandidati i preferuar nga kryetari i komunës përkatëse përfundimisht ka qenë i emëruar nga Drejtoria e Administratës. Në ato raste kur lista refuzohet nga kryetari i komunës, çështja më vonë zgjidhet me krijimin e një liste më të pranueshme nga ana e Drejtorisë së Administratës. Në të vërtetë, kryetari i kuvendit komunal i ka treguar Inspektoratit Policor se ata mendojnë që emërimet e të gjithë komandantëve të stacioneve- duke i përfshirë edhe ato para majit të vitit 2006- duhet t'i nënshtohen këtij procesi. Përderisa Inspektorati Policor e mirëpret implementimin e sukseshëm të nenit 7.12, është shumë i shqetësuar për aspektet e lëna anash.

2.5 Sipas nenit 7.11, procesi i përzgjedhjes duhet të nisët nga ana e Komisarit Policor- Rregullorja 2005/54 nuk ofron në mënyrë të hollësishme një mundësi për delegimin e këtij autoriteti. Si hap i parë, nga Komisari i Policisë kërkohet të konsultojë zëvendës komisarin dhe Ministrin e Punëve të Brendshme. Në bazë të nenit 7.12, lista e kandidatëve nga kuvendi komunal - sipas zgjedhje së preferuar - duhet t'i dorëzohet 'Komisarit të Policisë dhe Ministrin të Punëve të Brendshme'. Çka është më me rëndësi, Komisari i Policisë mund të emërojë vetëm kandidatin e sukseshëm ' pas konsultimit me Ministrin e Punëve të Brendshme'. Siç është treguar në tabelën 1, kërkesat për t'u konsultuar me ministrin para dërgimit të listës në kuvendin komunal, ofrimi i zgjedhjes nga ana e kuvendit komunal dhe konsultimi i ministrit para emërimit nuk është respektuar.

2.6 Përderisa mosveprimi ligjor i zbuluar nga Inspektorati Policor me sa duket rezulton nga vendimi i Komisarit të Policisë për delegimin e autoritetit të tij tek Drejtoria e Administratës së SHPK-së, prapseprap është e sigurtë se moskonsultimi i ministrit rezulton në shkelje të rëndë të ligjit. Nëse pranohet se ekziston shkelje e rëndë e ligjit në të gjitha rastet, gjithashtu mund të thuhet se të gjitha emërimet e bëra janë pa bazë ligjore. Inspektorati Policor rekomandon një rishikim urgjent të procedurave lidhur me emërimin e komandantëve të stacioneve, sa më shpejtë që është e mundur. Ky rishikim duhet të ketë për qëllim që ta vë në përdorim procedurën e korigjuar, e cila në tërësi është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 7-të të Rregullores 2005/54, duke përfshirë këtu konsultimin aktiv me Ministrin e Punëve të Brendshme.

Rekomandimi kryesor

Nr. 2

Inspektorati Policor rekomandon një rishikim urgjent të procedurave lidhur me emërimin e komandantëve të stacioneve sa më shpejtë që është e mundur. Ky rishikim duhet të ketë për qëllim që ta vë në përdorim procedurën e korigjuar e cila në tërësi është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 7-të të Rregullores 2005/54, duke përfshirë këtu konsultimin aktiv me Ministrin e Punëve të Brendshme.

PJESA III: PLANET DHE RAPORTET VJETORE TË KRYERJES SË DETYRAVE POLICORE

3.1 Në bazë të nenit 7.13, të Rregullores 2005/54, nga komandantët e stacioneve të SHPK-së kërkohet që për çdo vit, t'i paraqesin tek këshilli përkatës komunal për sigurinë e bashkësive (KKSB):

- a) Të dhënat mbi kryerjen e detyrave policore në vitin paraprak së bashku me rezultatet e arritura në regjionin e mbuluar nga ai stacion (duke përfshirë edhe të dhëna statistikore për shkallën e krimeve në atë rajon, numrin e hetimeve dhe numrin e rasteve të zgjidhura)



- b) Planin për detyrat e policisë në nivel lokal gjatë vitit vijues për rajonin e mbuluar nga stacioni, duke i përfshirë edhe prioritetet për atë vit, burimet e njerëzore dhe financiare në dispozicion dhe ndarjen e planifikuar të këtyre burimeve së bashku me planin e punës të përcaktuar nga Shërbimi Policor i Kosovës si tërësi dhe për atë stacion. Plani për policinë në nivel lokal duhet të jetë në përputhje me ligjin në fuqi, me planin vjetor të Shërbimit Policor të Kosovës mbi detyrat e policisë dhe me politikën e policisë të përcaktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

3.2 KKSB-të janë grupe konsultative, të planifikuara për të ndihmuar bashkëpunimin në mes të SHPK-së, autoriteteve komunale dhe përfaqësuesve të bashkësive, për ngritjen e sigurisë së pjesëtarëve të të gjitha bashkësive në çdo komunë (Neni 7.3). Inspektorati Policor ka vërejtur, me disa përjashtime, se KKSB-të janë themeluar dhe funksionojnë në të gjitha komunat e Kosovës. Gjithashtu, Inspektorati ishte i kënaqur që shumica e komandantëve vendorë të SHPK-së – në të dyja nivelet regjional dhe atë të stacioneve – kanë mbledhje të rregullta me KKSB-të e tyre përkatëse dhe në mënyrë aktive angazhohen në aktivitetet e KKSB-së.

3.3 Është e qartë që në shumicën e zonave ekzistojnë marrëdhënie të mira në mes të kuvendeve komunale, KKSB-ve dhe komandantëve të SHPK-së, dhe kjo qartë është e krijuar nga mbledhjet e rregullta dhe rrjedha e informatave verbale dhe ato të shkruara. Në shumë zona Inspektorati Policor ka vërejtur që komandantët e stacioneve duhet të paraqesin 'raporte mbi situatën ditore', 'raporte mbi progresin mujorë', 'raporte mbi progresin tre mujorë', dhe raporte vjetore. Kjo praktikë është e vlefshme dhe e qartë në rritjen e përgjegjshmërisë policore në nivel lokal, gjithashtu edhe si një ndjenjë mirëbesimi midis përfaqësuesve komunal. Në shumë raste, raportet mujore/tremujore dhe vjetore kanë përmbajtur statistikat e krimeve, statistikat e trafikut, statistikat e ndalimeve dhe arrestimeve dhe statistikat e tiketave mbi kundërvajtjet në trafik, siç kërkohet nga neni 7.13(a). Sidoçoftë, në këto raporte

kanë munguar referencat lidhur me numrin dhe llojin e hetimeve penale dhe të atyre hetimeve që kanë rezultuar në ndjekje penale, siç kërkohet në nenin 7.13(a).

3.4 Inspektorati Policor ka gjetur shumë pak dëshmi lidhur me atë që komandantët e stacioneve respektojnë dispozitat e nenit 7.13(b). Edhe pse në disa zona, komandantët e stacioneve ia dërgojnë KKSB-ve (ose kryetarit të komunës) planet vjetore regjionale të SHPK-së, keto plane nuk i plotësojnë kushtet që kërkohen në nenin 7.13. Megjithëse këto dokumente përfshijnë prioritetet e 'përgjithshme' të vitit, atyre ju mungojnë referencat për 'burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion dhe planifikimi për shfrytëzimin e këtyre burimeve, së bashku me synimet për kryerjen e detyrave të caktuara nga Shërbimi Policor i Kosovës si tërësi dhe për atë stacion. Synimet e mënyrës së kryerjes së detyrave policore duhet të lidhet me nevoja specifike të bashkësisë brenda territorit të stacionit dhe çka është më e rëndësishme synimet duhet të jenë rezultat i procesit të konsultimit aktiv të pjesëtarëve të KKSB-së dhe përfaqësuesve të bashkësive të tjera. E gjithë kjo duhet të shkruhet hollësisht në tekstin e planeve vjetore për mënyrën e kryerjes së detyrave policore .

3.5 Ishte e qartë se shumica e komandantëve të stacioneve (dhe komandantët regjional) nuk e kanë kuptuar lidhjen në mes të nenit 7.13(a) dhe 7.13(b): d.m.th. idea që në fillim të vitit komandantët duhet të pajtohen me synimet e qarta të KKSB-së për vitin e ardhshëm, pastaj në fund të vitit komandantët duhet t'i raportojnë KKSB-së lidhur me sukseset e tyre në arritjen e këtyre synimeve. Ky proces lë të kuptohet se synimet duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme dhe reale. Ato duhet të jenë synime që komandanti i stacionit i përkrahur nga komandanti regjional dhe shtabi qendror mund t'i përmbushë brenda 12 muajve.

3.6 Është e qartë se, përderisa komandantët bëjnë përpjekje të përbashkëta që t'i përmbushin kërkesat për paraqitjen e raportit vjetor të KKSB-të, në bazë të nenit 7.13(a), ekziston një fushë e rëndësishme për përmirësim. Inspektorati Policor ka vërejtur që, shumica e komandantëve të stacioneve përveç se nuk kanë pasur njohuri të qarta për dispozitat e nenit 7-të në përgjithësi (veçanërisht për sistemin e emërimit të komandantëve të stacioneve), shumica prej tyre asnjëherë nuk e kanë lexuar dokumentin dhe kanë pasur njohuri të pakta lidhur me kërkesat specifike të planifikimit dhe raportimit në bazë të nenit 7.13. Gjithashtu, të gjithë komandantët e stacioneve kanë pranuar se nuk kanë pasur asnjë trajnim të specializuar sa u përket përgjegjësive për planifikim dhe raportim, para apo pas emërimit. Zyrtarët e njejtë nuk kanë qenë në dijeni për asnjë udhëzues të hollësishëm nga komandantët regjional apo shtabi i SHPK-së lidhur me këto përgjegjësi të rëndësishme. Inspektorati Policor rekomandon që Shtabi i SHPK-së të zhvillojë një pako gjithëpërfshirës këshillash dhe udhëzimesh për komandantët e stacioneve lidhur me funksionet e tyre planifikuese dhe raportuese, sipas nenit 7.13, të Rregullores 2005/54. Pasi që të krijohet udhëzuesi zyrtar, duhet të jetë bazë e programit të përshatshëm trajnues për komandantët e stacioneve.

Inspektorati Policor rekomandon që Shtabi i SHPK-së të zhvillojë një pako gjithpërfshirës këshillash dhe udhëzimesh për komandantët e stacioneve lidhur me funksionet e tyre planifikuese dhe raportuese, sipas nenit 7.13 të Rregullores 2005/54. Ky udhëzues formal duhet të jetë bazë e programit të përshtatur trajnues për komandantët e stacioneve dhe duhet të zbatohet sa më parë që të jetë e mundur.

3.7 Sistemi aktual në SHPK për përzgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm për komandantë stacionesh përqëndrohet vetëm në përvetësimin e suksesshëm të ndonjë grade të posaçme, varësisht nga kategoritë e stacionit. Nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme kërkesave të posaçme lidhur me rolin e komandantit të stacionit, pavarësisht gradave. Inspektorati policor rekomandon që të bëhet një rishikim i menjëhershëm i Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së që kanë të bëjnë me funksionin vendimtar që kryejnë komandantët e stacionit në sigurimin e ofrimit të shërbimeve cilësore policore për të gjitha komunitetet. Ky rishikim duhet të përfshijë shqyrtimin e përshkrimit të punës dhe profilit të punës të komandantëve të stacionit: të dyja këto duhet të theksojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme për t'u konsultuar me KKSb-të, të jenë të njohur me pikëpamjet e grupeve minoritare etnike, të krijojnë plane policore lokale bazuar në konsultime, dhe të përgatitin raporte të hollësishme vjetore lidhur me aktivitetet policore.

Inspektorati Policor rekomandon për një rishikim të menjëhershëm të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së që kanë të bëjnë me funksionin vendimtar të komandantëve të stacionit, në sigurimin e ofrimit të shërbimeve cilësore policore për të gjitha komunitetet. Ky rishikim duhet të përfshijë shqyrtimin e përshkrimit të punës dhe profilit të punës së komandantëve të stacionit: të dyja këto duhet të theksojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme për t'u konsultuar me KKSb-të, të jenë të njohur me pikëpamjet e grupeve minoritare etnike, të krijojnë plane policore lokale bazuar në konsultime, dhe të përgatitin raporte të hollësishme vjetore lidhur me aktivitetet policore.

PJESA IV: PËRFUNDIM

4.1 Në përgjithësi, SHPK-ja është duke treguar një nivel të kënaqshëm të pajtueshmërisë me nenin 7-të të Rregullores 2005/54. KKSBB-të janë themeluar në shumicën e vendeve; komandantët e stacioneve dhe komandantët regjional janë të angazhuar në mënyrë aktive me KKSBB-të; komandantët e stacioneve KKSBB-ve iu ofrojnë raporte të shpeshta lidhur me aspektet e aktiviteteve të tyre policore; dhe kuvendet komunale janë të angazhuara në procesin e përzgjedhjes së komandantëve të stacionit, siç kërkohet në nenin 7-të.

4.2 Në të njëjtën kohë, Inspektorati identifikoi një shkelje të vazhdueshme të ligjit. Përderisa kushtet tjera të parapara në nenin 7.11 dhe 7.12 janë plotësuar, asnjëherë nuk është konsultuar Ministri i Punëve të Brendshme gjatë procesit të emërimit të komandantëve të stacioneve, pas majit të vitit 2006. Poashtu, Inspektorati vërejt një nivel të dobët të mirëkuptimit në mesin e komandantëve të stacioneve për përgjegjësitë e tyre planifikuese dhe raportuese.

4.3 Shumica e dështimeve aktuale në zbatimin e plotë të nenit 7-të duhet të rishikohen përmes intervenimit të zyrtarëve të lartë të SHPK-së, veçanarisht nga ana e komandantëve regjional dhe zëvendës komandantëve regjional. Ata duhet të sigurojnë se posedojnë njohuri të hollësishme të nenit 7-të, e çka është më me rëndësi, duhet të tregojnë përkushtim dhe aftësi udhëheqëse në procesin e implementimit të plotë të këtij neni. Kjo nënkupton që ata bëjnë kontrollimin nëse komandantët e stacioneve veprojnë në pajtim me ligjin, e nëse nuk ndodh një gjë e tillë, të ndërmarrin masa rishikuese për të siguruar pajtueshmëri të plotë me pikat e këtij neni.

INSPEKTIMI I SHPK-së LIDHUR ME MENAXHIMIN E LABORATORIT TË KRIM-TEKNIKËS NË SHPK

PJESA I: HYRJE

1.1 Në bazë të kërkesës nga Ministria e Punëve të Brendshme, Kryeshefi Ekzekutiv ka angazhuar Inspektoratin Policor që ta bëjë një inspektim të jashtëzakonshëm në laboratorin e krim-teknikës së SHPK-së, në Prishtinë/Priština. Ky inspektim është bërë me datën 6, 9 dhe 10 korrik të vitit 2007, në bazë të nenit 4 të Urdhëresës Administrative 2006/9.



1.2 Synimi i përmendur i inspektimit ishte që t'i sigurojë dhe vlerësojë sistemet dhe procedurat ekzistuese për të garantuar sigurinë dhe integritetin e pjesës më të ndjeshme të SHPK-së. Gjithashtu, qëllimi ka qenë që IPK-ja ta vlerësojë performancën e zyrtarëve të lartë të SHPK-së, të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e laboratorit të krim-teknikës, dhe të mbledhë informata në lidhje me marrëveshjet e bëra me universitete të caktuara private. Sidoqoftë, IPK-ja nuk u përpoq që të hetojë çfarëdo supozimi për sjellje të keqe – vepër penale apo shkelje disiplinore – nga ana e zyrtarëve të SHPK-së, të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e laboratorit dhe për krijimin e marrëveshjeve me universitete private, të cilët funksionojnë për përfitim. Prandaj, raporti përqendrohet në menaxhmentin e SHPK-së dhe mënyrat në të cilën ai mund të përmirësohet.

1.3 Gjithashtu, raporti nuk ka të bëjë me marrëveshjet e bëra nga ana e Komisarit të Policisë së UNMIK-ut dhe/apo përfaqësuesve të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, para transferimit të laboratorit të krim-teknikës tek Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse, Administrata e SHPK-së, në tetor të vitit 2006. Interesimi i Ministrit të Punëve të Brendshme është në atë që, pas transferimit të fundit të laboratorit, ky institucion të menaxhohet sipas standardeve më të larta të mundshme.

1.4 Sa i përket metodologjisë, Inspektorati ka siguruar dhe analizuar të dhëna nga një numër burimesh: nga procedurat standarde të operimit dhe politikat përkatëse në lidhje me laboratorin e krim-teknikës, shënime të mbledhura me anë të intervistave me menaxherët përkatës të SHPK-së dhe përfaqësuesit nga universitetet private, dhe kopjet e marrëveshjeve të bëra me universitetet e njëjta. Kjo punë ka rezultuar në raportin e tanishëm i cili përshkruan mënyrën në të cilën menaxherët e SHPK-së janë sjellur dhe, si e tillë, bënë rekomandime të qarta se si SHPK-ja mund të përmirësojë performancën e vet në të ardhmen.

1.5 Përveç pikave referuese të përfshkruara më lartë, ky inspektim i jashtëzakonshëm ka për qëllim që të jep rekomandime në lidhje me atë se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund ta përmirësojnë performancën policore në realizimin e qëllimeve në vijim.:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren e UNMIK–ut 2005/54, Rregulloren e UNMIK–ut 2001/36, Urdhëresën Administrative 2003/2 dhe legjislacionin përkatës;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)
- Të inkurajojë menaxhim policor profesional të laboratorit të krim–teknikës;
- Ndhimjojë në përgatitjen e shërbimeve kualitative të krimteknikës në dobi të sistemit të drejtësis penale në Kosovë; dhe
- Identifikimin dhe shpërndarjen e praktikës më të mirë në menaxhmentin policor.
- Policët e patrullës të angazhuar në detyrë gjatë trazirave civile të 10shkurtit të vitit 2007 (MOSTËR)

1.6 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike, i cili është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

Organizimi i laboratorit të krim–teknikës

2.1 Gjatë zhvillimit të një sërë teknologjish të reja, shkenca e krim–teknikës dhe laboratorët e shkencës së krim–teknikës janë duke luajtur një rol të rëndësishëm në luftimin e krimit në tërë botën. Duke ju falenderuar zemërgjerësisë së Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kosova ka laboratorin e krim–teknikës i cili është i njëjtë me shumë laboratore në Amerikën veriore dhe evropën perëndimore, sa i përket infrastrukturës dhe pajisjeve. Në mes të fushave tjera, laboratorit i krimteknikës së SHPK-së ka kapacitet potencial që të kryej analizat e gjurmëve të gjishtërinjëve, analizat e dokumenteve, analizat toksikologjike(narkotikëve), analizat e fijeve sintetike, analizat e bojës dhe xhamit, analizat e armëve të zjarrit dhe substancave eksplozive dhe analizat e AND-së së gjakut dhe lëngjeve të tjera trupore. Ky objekt i ofron sistemit të drejtësis penale në Kosovë një shpresë reale të një potenciali të madh për të zbuluar dhe ndjekur penalish kundërvajtësit për vepra të rënda penale.

2.2 Natyrisht nevojiten më shumë se pajisje të shtrenjëta dhe ndërtimi i një objekti të krim–teknikës për të lehtësuar këtë potencial të pamasë. Kërkohen katër elemente shtesë: teknik të trajnuar dhe të certifikuar (apo personel i specializuar), një sistem të standardeve minimale të krim–teknikës të cilat janë të verifikuara në mënyrë të pavarur, një përmbjedhje e legjislacionit që rregullon përdorimin e krim–teknikës në gjykatë, dhe një sistem të fuqishëm menaxhues që siguron integritetin dhe sigurinë e objektit. Edhe pse detyra primare e ndërtimit të laboratorit të krim–teknikës së

SHPK-së, instalimi i pajisjeve dhe krimjimi i procedurave standarde të operimit tanimë ekziston, shumica e elementeve mbeten të papërfunduara gjatë kryerjes së inspektimit nga ana e Inpektoratit Policor.

2.3 Personeli i laboratorit të krim-teknikës përbëhet prej 68 punonjësve të SHPK-së dhe 28 punonjësve të kompanisë nga SHBA-të, të cilët ofrojnë siguri dhe shërbime për pastrim. Aktualisht një nën-kolonel i SHPK-së është bashkëdrejtor, pranë një drejtori të SHBA-ve (PNNTHK)²⁵, deri në tranzicionin përfundimtar, deri në shtator të vitit 2007. Gjithashtu janë të punësuar edhe dy ekspertë nga UNMIK-u për të ofruar ndihmë sa i përket analizave të gjurmëve të gishtërinjëve dhe të armëve të zjarrit. Pasi që Kosova nuk ka pasur teknik të kualifikuar për përdorimin e mjeteve moderne dhe për krijimin e raporteve të kërkuara analitike, programit të financuar nga SHBA-të për të krijuar laboratorin e SHPK-së, i është dashur të rekrutojë dhe trajnojë spacialistë. Kjo punë vazhdon në fushat më teknike të analizimit të AND-së dhe të toksikologjisë. Që nga themelimi është marrë parasysh se laboratorin e krim-teknikës do të jetë nën kontrollin e SHPK-së dhe prandaj është mbështetur nga personeli i SHPK-së. Kjo qasje nuk është adaptuar nga shtete²⁶ të caktuara të BE-së dhe parashtron pyetje të rëndësishme në lidhje me neutralitetin dhe pavarësinë e laboratorit të krim-teknikës –si burim i vetëm i ekspertizës së krim-teknikës në Kosovë– në procesin e ndjekjes penale të kundërvajtësve. Nëse laboratorin e krim-teknikës në Kosovë është i kontrolluar dhe i përbërë nga personeli i SHPK-së, atëherë, nuk mund të bëhet asnjë kërkesë neutrale në procesin e ndjekjes penale të kundërvajtësit dhe nuk ekziston asnjë mjet efektiv përmes të cilit i pandehuri mund ta sfidojë saktësinë e rezultateve të laboratorit.

Rekomandimi kryesor

Nr. 1

Inspektorati Policor rekomandon që, në rrethana të përshtatshme, Ministria e Punëve të Brendshme ta kryejë një rishikim të rolit të laboratorit të krim-teknikës në sistemin e drejtësisë penale. Ky rishikim duhet të ketë parasysh mënyrat në të cilat mund të shtohet neutraliteti i shërbimeve të krim-teknikës.

2.4 Është e qartë se, për shkak të shpenzimeve të konsiderueshme, Kosova nuk mund të financojë më shumë se një laborator të krim-teknikës nga shpenzimet publike. Për këtë shkak, duhet të krijohet lidhje dhe marrëveshje bashkëpunimi me laboratorët e krim-teknikës të shteteve fqinje, të bazuar në një kornizë të përbashkët standardesh. Për një bashkëpunim të tillë kërkohet një harmonizim dhe autorizim zyrtar, në bazë të një standardi të pranuar ndërkombëtar, si ISO/IEC 17025²⁷. E fundit ofron kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve për testim dhe kalibrim, duke përkrahur tendencat aktuale drejt autorizimit zyrtar, i vëzhguar jo vetëm në Evropë por edhe në shkencat e krimteknikës në pjesë të ndryshme të

²⁵ Programi Ndihmës Ndërkombëtar për Trajnimet e Hetimit të Krimin (PNNTHK).

²⁶ Për shembull, në Gjermani, Austri, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar funksionojnë laboratorët të cilat janë të pavarura nga policia, të përbëra nga ekspertët civil dhe të lidhura me Ministrinë përkatëse.

²⁷ Shih WWW.ISO.org (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim).

botës. Në pjesën hyrëse, ISO/IEC 17025 theksohet se “pranimi i rezultateve të testimit dhe kalibrimit në mes të shteteve duhet të ndihmohet nëse laboratorët punojnë në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe nëse ato sigurojnë autorizim zyrtar nga organet të cilat kanë hyrë në marrëveshjen e përbashkët me organe të njëjta, me shtetet tjera të cilët e përdorin këtë standard ndërkombëtar.” gjithashtu, është theksuar që përdorimi i këtyre standardeve ndërkombëtare do të ndihmojë në harmonizimin e standardeve dhe procedurave.

2.5 Si pjesë e planit implementues për laboratorin e SHPK-së, donatori i SHBA-së është duke organizuar autorizimin e vet zyrtar nga Shoqata Ndërkombëtare për Shkencat e Krimteknikës (SHNSHK), një shoqatë e njohur e cila bashkon akademikët dhe profesionalistët e disiplinave të ndryshme të shkencës së krimteknikës. Këta profesionalistë përfshijnë ata persona që punojnë në polici, në laboratore qeveritare apo private të krimteknikës, të cilët merren me gjurmët e gishtërinjëve, grupimin biokimik, analizën e narkotikëve, toksikologji, ballistikë, ekzaminimin e gjurmëve dhe rikonstruimin e aksidenteve. SHNSHK-ja ka për qëllim të zhvillojë shkencat e krimteknikës, të ndihmojë shkencëtarët e krimteknikës dhe të tjerët që të shkëmbejnë informata shkencore dhe teknike, dhe të organizojnë takime tri-vjetore. Kjo iniciativë është e mirëseardhur nga Inspektorati Policor, si mjet i zhvillimit të kompetencave të përgjithshme të objektit të krimteknikës dhe personelit të tij në Kosovë. Sidoqoftë, Inspektorati Policor rekomandon që autorizimi zyrtar i SHNSHK-së të përkrahet nga ISO/IEC 17025.

2.6 Përderisa laboratori i krimteknikës së SHPK-së ka një marrëveshje zyrtare me laboratorin e krimteknikës në Kroaci, kjo është një masë e brendshme për të ofruar shërbime të krimteknikës që nuk janë të mundshme në Kosovë, për shkak të mungesës së personelit të specializuar. Nuk ekziston asnjë marrëveshje reciproke përmes së cilës laboratorët kryejnë kontrolla dytësore lidhur me punën e njëri-tjetrit dhe poashtu nuk ekziston asnjë marrëveshje e përbashkët në lidhje me standardet e kalibrimit, siç është ISO/IEC 17025. Si pjesë e strategjisë së saj afat-gjate për t'i përmirësuar aftësitë shkencore të krimteknikës në Kosovë, Inspektorati Policor beson se Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përpiqet të krijojë marrëveshje zyrtare me vendet fqinje në Ballkan. Marrëveshje të tilla duhet të bazohen në grup standardesh të përbashkëta, siç është ISO/IEC 17025, të lejojë kontrollime të rastësishme të verifikimit të standardeve, të ofrojë analiza dytësore në raste të profilit të lartë dhe një forum për trajnim të përbashkët dhe ndarje të informatave. Një qasje e tillë do të ofronte dobi të konsiderueshme për të gjitha vendet në një 'skicë të bashkëpjesëmarrjes së krimteknikës', dhe jo më pak rolin e shtuar të shkencës së krimteknikës në luftimin e krimeve të rënda dhe të oraganizuara në regjion.

Inspektorati Policor rekomandon që, si pjesë afatgjate e strategjisë së shkencës së krimteknikës, Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përpiqet të krijojë marrëveshje zyrtare me vendet në Ballkan. Marrëveshje të tilla duhet të bazohen në grup standardesh të përbashkëta, siç është ISO/IEC 17025, të lejojë kontrollime të rastësishme të verifikimit të standardeve, të ofrojë analiza dytësore në raste të profilit të lartë dhe një forum për trajnim të përbashkët dhe ndarje të informatave.

2.7 Inspektorati Policor vërejtë se laboratorit i krimteknikës së SHPK-së ka një grumbull gjithpërfshirës dhe të rëndësishëm të procedurave standarde të operimit, i përgatitur nga donatori SHBA-së. Kjo mbulon secilin aspekt të organizimit të laboratorit dhe të aktivitetetve, nga siguria deri te protokollet operative për disa pajisje të sofistikuara. Sidoqoftë, aktualisht nuk ekziston asnjë legjislacion që porcakton parimet e caktuara themelore, si nevojën për neutralitete, pavarësi dhe integritet, siç u diskutuan më lartë. Përderisa Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës ka dispozita që kanë të bëjnë me kualifikimet e dëshmitarëve ekspertë dhe dëshmitë e ekspertëve, nuk ekziston asgjë në ligjin aktual që rregullon kualifikimin minimal të specialistëve të krimteknikës, standardet minimale në shkencën e krimteknikës dhe përdorimin e shërbimeve të shkencës së krimteknikës në vendet tjera. Inspektorati Policor rekomandon që si pjesë afat-gjate e strategjisë së shkencës së krimteknikës, Ministria e Punëve të Brendshme duhet të merr rolin udhëheqës në paraqitjen e legjislacionit që rregullon laboratorin e krimteknikës së SHPK-së dhe përdorimin e shërbimeve të krimteknikës në Kosovë.

Inspektorati Policor rekomandon që si pjesë afat-gjate e strategjisë së shkencës së krimteknikës, Ministria e Punëve të Brendshme duhet të merr rolin udhëheqës në paraqitjen e legjislacionit që rregullon laboratorin e krimteknikës së SHPK-së dhe përdorimin e shërbimeve të krimteknikës në Kosovë.

2.8 Është një veçori themelore e laboratorit të krim-teknikës që është në gjendje të demonstrojë integritetin e plotë të analizave dhe rezultateve të tij. Pavarësisht nga ekspertiza e personelit të tij, kalibrimi dhe efektshmëria e pajisjeve të tij, atmosfera e kontrolluar (p.sh. pa pluhur dhe temperatura të larta) dhe procedurat e fuqishme, integriteti i këtillë duhet të mbështetet në një regjim të ashpër sigurie, për të siguruar që dëshmitë nuk janë të kontaminuara dhe procedurat nuk janë të kompromituara. Zonat e ekzaminimit duhet të mbahen të sigurta dhe vetëm personeli kryesor duhet të ketë qasje në zonat e tyre të ekzaminimit: ata të cilët nuk janë pjesëtarë të personelit (apo ata që janë të përfshirë në punën e mirëmbajtjes) nuk duhet t'u lejohet hyrja në atë pjesë, e aq më pak në një zonë ekzaminimi.

2.9 Inspektorati Policor ka vërejtur se procedurat e sigurisë të përfshira në procedurat standarde të operimit (PSO), janë adekvate për të siguruar integritetin e

nevojshëm të asaj zone. *Policia Civile Ndërkombëtare* (PCN), kompania e SHBA-së e vendosur në atë zonë aktualisht ofron 24 orë siguri për tërë laboratorin e krimteknikës së SHPK-së, sipas kontratës së financuar nga donatori i SHBA-së. Ndonëse nuk i është bërë e qartë Inspektoratit Policor, supozohet se kontrata e PCN-së do të përfundojë kur të bëhet transferi i plotë, në shtator të vitit 2007, dhe SHPK-ja do të ofrojë sigurinë për atë zonë. Procedura 1.12 e PSO-së së laboratorit të SHPK-së lidhur me sigurinë (e regjistruar më 13.11.2005) thekson se drejtori është përgjegjës për sigurinë e përgjithshme dhe mundet, nëse ka nevojë, që të emërojë një zyrtar për siguri si person përgjegjës për siguri. Deri në kohën e inspektimit kjo nuk është bërë, me sa duket për shkak të kontratës me PCN-në. Procedura 1.13 (5.8) bënë të qartë se qasja në atë zonë është rreptësisht e kufizuar për ata të cilët kanë 'punë zyrtare' dhe përderisa shoqërohen nga pjesëtarët e personelit të laboratorit të krimteknikës së SHPK-së. Kjo ka hyrë në fuqi nga një memorandum i brendshëm i nënshkruar nga bashkëdrejtori, me 15 mars të vitit 2000, me anë të së cilit personelit i është bërë e ditur se personave të paautorizuar nuk i lejohet hyrja në asnjë rrethanë.

2.10 Gjatë inspektimit të librit për vizitorët zyrtarë të laboratorit të krim-teknikës, Inspektorati Policor gjeti një numër të madh shënimesh të studentëve nga dy universitete private: të ashtëquajtura, Kolegji i Arteve dhe Shkencave (FAMA) dhe Akademia e Arteve të Bukura²⁸ (AAB). Në secilën prej këtyre universiteteve funksionon fakulteti i kriminalistikës, i cili përfshinë shkencat e krim-teknikës si pjesë e programit mësimor. Kjo shpie në një shkelje të rëndë të procedurave dhe – për shkak se ndodhin më shpesh, numri i studentëve të përfshirë si dhe sugjerimet e planifikuara – dështim të konsiderueshëm të menaxhmentit. Inspektorati Policor rekomandon që Komisar i Policisë duhet të merr parasysh procedurat formale disiplinore në lidhje me ata zyrtarë policor të cilët me dijeni kanë qenë të përfshirë në këtë shkelje të sigurisë.

Rekomandimi kryesor

Nr. 4

Inspektorati Policor rekomandon që Komisar i Policisë duhet të merr parasysh procedurat formale disiplinore në lidhje me ata zyrtarë policor të cilët me dijeni kanë qenë të përfshirë në lejimin e studentëve të universiteteve të caktuara private për të hyrë në labororet e krim-teknikës, duke bërë shkelje të sigurisë.

2.11 Gjatë inspektimeve të tjera, Inspektorati Policor ka qenë në gjendje të vërtetojë se lidhja në mes të laboratorit të krim-teknikës së SHPK-së dhe universiteteve të caktuara private kalon përtej vendimit të dhënies së autorizimit studentëve për hyrje në atë zonë. Është siguruar një kopje e draft 'Memorandumit për bashkëpunim' në mes të SHPK-së dhe Fakultetit të Kriminalistikës, brenda Kolegjit të Arteve dhe Shkencave (FAMA) dhe ofrimi i qasjes në laboratorin e krim-teknikës për trajnim dhe ushtrime praktike. Dokumenti nuk është i nënshkruar dhe as i datuar dhe sipas

²⁸ Akademia e Arteve të Bukura (AAB) poashtu është e njohur edhe si Arena e Edukimit Bashkëkohor.

zëvendësndihmës komisarit (për administratë) nuk është ratifikuar dhe as nuk është vënë në veprim në dobi të studentëve të universitetit FAMA. Megjithatë, siç është cekur në pragrafit 2.10, ekzistojnë dëshmi të qarta që një numër i studentëve të universitetit FAMA kanë hyrë në laboratorin e krim–teknikës, Inspektorati Policor nuk ka siguruar asnjë dëshmi se është mbajtur ndonjë trajnim apo që vizitat kanë qenë të autorizuara sipas Memorandumit të Bashkëpunimit.

Është e qartë se një polic i SHPK–së i cili poashtu është pjesëtar i personelit të laboratorit të krim–teknikës është gjithashtu personel me pagë në Fakultetin e Kriminalistikës, brenda Kolegjit të Arteve dhe Shkencave (FAMA). Përveç pjesëtarit të personelit i cili ligjëron në universitetin FAMA, Inspektorati Policor ka zbuluar që bashkë–drejtori i laboratorit të krim–teknikës është pjesëtar me pagë i personelit ligjërues në Fakultetin e Kriminalistikës brenda Akademisë së Arteve të Bukura (AAB). Kjo ka lidhje me vizitat e një numri studentësh të këtyre universiteteve private në laboratorin e krim–teknikës. Hetimet në Ministrin e Arsimit kanë vërtetuar që Fakultetit të Kriminalistikës, AAB i është refuzuar liçensa për të funksionuar për shkak të mungesës së pajisjeve dhe objektit adekvat.

2.12 Përfshirja e personelit të laboratorit të krim–teknikës në universitetet private, në veçanti në institucionet e paliçensuara, ngjallë disa shqetësime serioze rreth integritetit të objektit. Posaçërisht, Inspektorati Policor beson se një përfshirje e tillë mund të krijojë konflikt aktual apo potencial të interesave – me fjalë të tjera një konflikt interesash private në mes të zyrtarëve të SHPK–së (p.sh. ligjërimi në një universitet privat) dhe obligimet e tij/saj publike (p.sh. për të siguruar integritetin e laboratorit të krim–teknikës dhe procedurave të tij). Çfarë masash ekzistojnë, për shembull, për të parandaluar personelin përkatës të SHPK–së nga referimi i materialit të krim–teknikës në klasë që ka lidhje me një rast që është *sub judice* (apo në pritje të gjyqimit në gjyq)? Në cilindo rast, shfaqet të ketë dëshmi të qarta të keqpërdorimit të autoritetit ku një zyrtar policor i SHPK–së, në shkelje të procedurave, u lejon qasje studentëve të një universiteti në të cilin ai është i punësuar dhe nga i cili ai merr të ardhura financiare. Inspektorati Policor rekomandon që Komisari i Policisë të fillojë hetim disiplinor në lidhje me pjesëtarët e personelit të laboratorit të forensikës të cilët kanë aranzhuar qasje në objekt për studentët e tyre të universitetit privat.

Rekomandimi kryesor

Nr. 5

Inspektorati Policor rekomandon që Komisari i Policisë duhet të fillojë hetime disiplinore në lidhje me pjesëtarët e personelit të laboratorit të krim–teknikës, të cilët kanë aranzhuar qasje në objekt për studentët e tyre të universitetit privat

2.13 Incidenti në të cilin janë përfshirë personeli i laboratorit të krim–teknikës dhe universitetet private nxjerr në pah nevojën për legjislacion zyrtar, i cili do të rregullonte sigurinë dhe integritetin e këtij objekti shumë të ndjeshëm. Një legjislacion i tillë gjithashtu duhet të adresojë edhe çështjen nëse personeli i laboratorit të krim–teknikës duhet të ligjërojnë në lëndët të cilat lidhen me punën e tyre, nëse është ashtu, nëse duhet të aplikohen rrethana në mënyrë që të mbojnë të

dhënat e ndjeshme që kanë të bëjnë me çështjet *sub judice*. Inspektorati Policor rekomandon që si pjesë e strategjisë afat-gjatë të krim-teknikës, Ministria e Punëve të Brendshme të merr parasysh legjislacionin i cili rregullon përdorimin e të dhënave të mbledhura nga personeli i laboratorit të krimteknikës gjatë punës së tyre si dhe të drejtën për ta përdorur këtë njohuri gjatë punës së tyre sekondare.

Rekomandimi kryesor

Nr. 6

Inspektorati Policor rekomandon që si pjesë e strategjisë afatëgjate të krim-teknikës, Ministria e Punëve të Brendshme të merr parasysh legjislacionin i cili rregullon përdorimin e të dhënave të mbledhura nga personeli i laboratorit të krimteknikës, gjatë punës së tyre si dhe të drejtën për ta përdorur këtë njohuri gjatë punës së tyre sekondare.

Lista e rekomandimeve kyçe – Inspektimet e jashtëzakonshme

Inspektorati Policor i Kosovës ia paraqet rekomandimet në vijim Komisarit të Policisë së UNMIK–ut dhe personelit të lartë të SHPK–së, në pajtim me dispozitat e Rregullores 2005/54 dhe Urdhërësës Administrative 2006/9.

1. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK–së t’i jepen më shumë përgjegjësi lidhur me komandën, kontrollin dhe angazhimin aktiv gjatë demonstratave në Kosovë.
2. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK–ja të vendosë për një sistem të unifikuar të taktikave në raste të trazira qytetare dhe t’i inkorporojë plotësisht ato në një Doracak të vetëm të SHPK–së për kontrollimin e trazirave qytetare. Nevojitet trajnim i mëtutjeshëm për të gjitha nivelet e posaqërisht për ata zyrtarë të SHPK–së të cilët do të jenë përgjegjës për planifikimin e operacioneve policore në raste të demonstratave. Trajnime të tilla duhet të bëhen rregullisht dhe të bazohen në praktikën e rasteve të vërteta, si ato të 10 shkurtit.
3. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që të gjithë policët e emëruar si të kualifikuar për t’u angazhuar në detyrë në raste të trazirave qytetare siaps sistemit të ri të SHPK–së duhet t’i nënshtrohen trajnimit të rregulltë riçertifikues. Një masë e këtillë do të theksonte rëndësinë e madhe për të siguruar që të gjithë policët i plotësojnë standardet minimale të kontrollimit të trazirave qytetare dhe kanë mundësi të ushtrojnë rregullisht taktikat për kontrollimin e turmës .
4. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK–ja të sigurohet që të gjithë policët e njësisë speciale të jenë të pajisur në mënyrë të duhur në mënyrë që t’i përdorin këto taktika në mënyrë efektive. Kjo duhet të përfshijë pajisjet e radio–lidhjes, automjetet e blinduara, mburojat, shufrat dhe mjetet tjera mbrojtëse. Ruajtja dhe inspektimi i këtyre pajisjeve të shtrenjëta duhet t’i nënshtrohet inspektimit të rregullt dhe azhurnimit për të siguruar se janë në gjendje të duhur dhe i plotësojnë standardet e larta.
5. Inspektorati Policor nxit prezentimin e legjislacionit i cili ofron parime të qarta mbi përdorimin e forcës nga ana e pjesëtarëve të SHPK–së, sa më parë që të jetë e mundur. Ky legjislacion duhet të jetë në pajtim me Kodin Evropian të Etikës Policore(KEEP), ligjet përkatëse të BE–së, dhe ligjin ndërkombëtar.
6. Inspektorati Policor rekomandon që definicioni i forcës së arsyeshme të shqyrtohet më tutje në doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK–së, si përpjekje drejtë përmirësimit të kapacitetit të SHPK–së për reagimet në incidentet e ardhshme të trazirave qytetare. Inspektorati rekomandon që të gjithë pjesëtarët e SHPK–së të pajisen me nga një kopje të Kodit të Etikës mbi përdorimin e forcës , bazuar në komentet zyrtare të KEEP–së.
7. Inspektorati policor përkrah krijimin e një varg autorizimesh ligjore për SHPK–në të cilat do të ndihmojnë në përpjekjen për ndalimin dhe çarmatosjen

e personave të cilët mund të mbledhen me qëllim të shkaktimi të lëndimeve tek personat apo dëmeve në pronë.

8. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që drejtorja e administratës së SHPK-së t'i jep përparësi detyrës për identifikimin e zyrtarëve të kualifikuar dhe të përshtatshëm për dhënien e gradave të caktuara me qëllim të zvogëlimit të periudhës së zgjatur të vendit të lirë të punës për pozitat e komandantëve të stacioneve.
9. Inspektorati Policor rekomandon një rishikim urgjent të procedurave lidhur me emërimin e komandantëve të stacioneve sa më shpejtë që është e mundur. Ky rishikim duhet të ketë për qëllim që ta vë në përdorim procedurën e korrigjuar e cila në tërësi është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 7-të të Rregullores 2005/54, duke përfshirë këtu konsultimin aktiv me Ministrin e Punëve të Brendshme.
10. Inspektorati policor rekomandon që Shtabi i SHPK-së të zhvillojë një pako gjithëpërfshirës këshillash dhe udhëzimesh për komandantët e stacioneve lidhur me funksionet e tyre planifikuese dhe raportuese, sipas nenit 7.13 të Rregullores 2005/54. Ky udhëzues formal duhet të jetë bazë e programit të përshtatur trajnues për komandantët e stacioneve dhe duhet të zbatohet sa më parë që të jetë e mundur.
11. Inspektorati policor rekomandon për një rishikim të menjëhershëm të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së që kanë të bëjnë me funksionin vendimtar të komandantëve të stacionit në sigurimin e ofrimit të shërbimeve cilësore policore për të gjitha komunitetet. Ky rishikim duhet të përfshijë shqyrtimin e përshtatshmërisë së punës dhe profilit të punës së komandantëve të stacionit: të dyja këto duhet të theksojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme për t'u konsultuar me KKSBB-të, të jenë të njohur me pikëpamjet e grupeve minoritare etnike, të krijojnë plane policore lokale bazuar në konsultime, dhe të përgatisin raporte të hollësishme vjetore lidhur me aktivitetet policore.
12. Inspektorati policor rekomandon që, në rrethana të përshtatshme, Ministria e Punëve të Brendshme të kryej një rishikim të rolit të laboratorit të krim-technikës në sistemin e drejtësisë penale. Ky rishikim duhet të ketë parasysh mënyrat në të cilat mund të shtohet neutraliteti i shërbimeve të krim-technikës.
13. Inspektorati Policor rekomandon që, si pjesë afatgjate e strategjisë së shkencës së krimtechnikës, Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përpiqet të krijojë marrëveshje zyrtare me vendet në Ballkan. Marrëveshje të tilla duhet të bazohen në grup standardesh të përbashkëta, siç është ISO/IEC 17025, të lejojë kontrollime të rastësishme të verifikimit të standardeve, të ofrojë analiza dytësore në raste të profilit të lartë dhe një forum për trajnim të përbashkët dhe ndarje të informatave.

14. Inspektorati Policor rekomandon që si pjesë afat-gjate e strategjise se shkencës së krimteknikës, Ministria e Punëve të Brendshme duhet të merr rolin udhëheqës në paraqitjen e legjislacionit që rregullon laboratorin e krimteknikës së SHPK-së dhe përdorimin e shërbimeve të krimteknikës në Kosovë.
15. Inspektorati Policor rekomandon që Komisari i policisë duhet të merr parasysh procedurat formale disiplinore në lidhje me ata zyrtarë policor të cilët me dijeni kanë qenë të përfshirë në lejimin e studentëve të universiteteve të caktuara për të hyrë në laboratorët e krim-teknikës, duke bërë shkelje të sigurisë.
16. Inspektorati Policor rekomandon që Komisari i Policisë të fillojë hetime disiplinore në lidhje me pjesëtarët e personelit të laboratorit të forensikës të cilët kanë aranzhuar qasje në objektet për studentët e tyre në universitete privat.
17. Inspektorati Policor rekomandon që si pjesë e strategjisë afatëgjate të krim-teknikës, Ministria e Punëve të Brendshme të merr parasysh legjislacionin i cili rregullon përdorimin e të dhënave të mbledhura nga personeli i laboratorit të krimteknikës, gjatë punës së tyre si dhe të drejtën për ta përdorur këtë njohuri gjatë punës së tyre sekondare



Pjesa II

Inspektimet e zakonshme





Raport i përkohshëm i inspektimit 1

Menaxhimi i kryerjes së detyrave në fushën
e armëve të zjarrit nga ana e SHPK-së

MENAXHIMI I KRYERJES SË DETYRAVE NË FUSHËN E ARMËVE TË ZJARRIT NGA ANA E SHPK-së

1.1 Inspektimi i parë i zakonshëm i SHPK-së në vitin 2007 është bërë me datën 31 janar dhe 2 shkurt, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqëndrua vetëm në menaxhimin e kryerjes së detyrave në fushën e armëve të zjarrit nga ana e SHPK-së dhe është ndërmarrë nga Z. Enver Rrustemi, ushtrues i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 18 inspektorëve. Vizitat u bënë në Shtabin e SHPK-së, në të gjitha shtabet regjionale dhe në një numër stacionesh policore nëpër tërë Kosovën. Pa përjashtim, zyrtarët e Inspektoratit policor hasën në bashkëpunim dhe gatishmëri të plotë nga ana e personelit të SHPK-së.

1.2 Që nga themelimi i saj në vitin 1999, SHPK-ja ka operuar sipas stilit *civil* e jo sipas atij *ushtarak* (xhandarmëri). Ky dallim është i rëndësishëm kur merret parasysh mënyra se si SHPK-ja përdorë armët e zjarrit gjatë kryerjes së detyrave policore. Një numër shtetesh përfshirë shtetet e BE-së kanë zhvilluar modelin e organizimit policor në formë të xhandarmërisë²⁹ (p.sh. *Arma dei Carabinieri* në Itali dhe Kil, *Gendarmerie Nationale* në Francë, *Guardia Civil* në Spanjë, *Gendarmerie në Argjentinë*). Si rezultat i detyrave të tyre në shoqëri, xhandarmëria nganjëherë përshkruhet më shumë si forcë paraushtarake sesa ushtarake, edhe pse ky përshkrim nuk i përgjigjet statusit dhe kapacitetit të tyre zyrtar. Xhandarët më shumë angazhohen në intervenime ushtarake, nganjëherë në shtetet e tyre, por më shpesh në vendet tjera në mënyrë humanitare. Sidoqoftë, vendet tjera kanë përdorur modelin e policisë civile, i cili model mënjanon çfarëdo ngajshmërie me ushtri dhe përpiqet të zvogëlojë nivelin e përdorimit të armëve të dukshme të zjarrit. (p.sh. Gjermania, Holanda, Suedia, Norvegjia, Danimarka, SHBA-të).³⁰ Përveç pistoletave, zyrtarët policor në këto vende gjatë incidenteve të caktuara përdorin armë të stilit më ushtarak (pushkë gjysëm automatike, pushkë automatike, etj) dhe shpesh këto armë përdoren nga policë të njësiteve speciale. SHPK-ja është e organizuar sipas këtij modeli.

1.3 Ky raport synon të përmbledhë një sasi të konsiderueshme të informatave – më shumë se treqind faqe – të përfshira në raportet paraprake regjionale dhe në dokumentet mbështetëse të zyrtarëve të SHPK-së.

²⁹ Fjala 'gendarme' rrejdhet nga fjala frënge *gens d'armes*, ose njerëzit e armëve që historikisht i është referuar njerëzve të cilët janë të autorizuar të bartin armë, një e drejtë që ishte mjaft e kufizuar.

³⁰ Vëreni se organizatat policore në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Republikën e Irlandës kanë një traditë që të mos i armatosin zyrtarët policor.

1.4 Qëllimi i këtij inspektimi të zakonshëm është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren e UNMIK–ut 2005/54, Rregulloren e UNMIK–ut 2001/36, Urdhëresën Administrative 2003/2 dhe legjislacionin përkatës;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të *Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)*;
- Përkrahjen e menaxhimit profesional dhe përdorimin e armëve zyrtare të zjarrit;
- Për të ndihmuar në ofrimin e shërbimeve cilësore në përkrahje të tërë personelit të SHPK-së; dhe
- Për të identifikuar dhe shpërndarë praktikën më të mirë.

1.5 Gjatë inspektimit, pjesëtarët e Inspektoratit policor vizituan dhe intervistuan punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Ndhmës I Zëvendës Komisarit, Operativë
- Shefi, Drejtorati për financa
- Drejtori, Departamenti I Njësitit të Specializuar
- Komandantët regjional (ose zëvendës komandantët regjional)
- Kryesuesit e Njësiteve Regjionale për Përkrahje Operative
- Komandantët e stacioneve
- Zyrtarët e lartë të Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës (QKSPEZH)
- Personeli për trajnim me armë të zjarrit, Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (QKSPEZH)

1.6 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike i cili parim është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

2. KRYERJA E DETYRAVE NË MENAXHIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT

Organizimi aktual

2.1 Zyrtarët policor të SHPK-së janë të pajisur me një numër armësh mbrojtëse përfshirë sprejin, shufrën metalike dhe pistoletë të llojit Glock 9.9mm. Kjo e fundit është një armë zjarri moderne e lehtë, që përdoret në shumë organizata policore në botë. Sa i përket njësiteve të specializuara në SHPK, ato përbëhen prej policëve të trajnuar të angazhuar në njësitin e Mbrojtjes së personave mjaft të rëndësishëm



(VIP), në NJPI (Njësitin e Parë Intervenues) dhe në NJRPO (Njësitin Regjional për Përkrahje Operative). Që nga janari i vitit 2007, 15 zyrtarë të SHPK-së janë përzgjedhur dhe janë trajnuar për pjesëtarë të Njësitit të Parë Intervenues (NJPI), të cilët janë të pajisur me pushkë të llojit MP-5. Qëllimi i NJPI-së është që të ofrojë përkrahje taktike me armë të specializuara sipas kërkesave dhe në përkrahje të komandantëve regjional. Momentalisht janë 86 policë të angazhuar në njësitin për mbrojtje të përafërt të VIP-ve.

2.2 Në çdo regjion të SHPK-së, ekzistojnë njësite të NJRPO-së (ROSU), të trajnuar dhe të pajisur në mënyrë speciale për të intervenuar në raste të trazirave qytetare. Përpos kombive të markës Mercedes, 335 pjesëtarët e NJRPO-së janë të pajisur me paisje mbrojtëse, jelekë ballistikë (antiplumb), mburoja, shufra të gjata dhe maska gazi. Njësitet e NJRPO-së nuk janë të pajisur me sprej kimik (CS) ose mjete tjera kimike të ngajshme, kanon uji, apo çfarëdo lloj armësh tjera për raste të trazirave qytetare. Ata janë të trajnuar për përdorimin e një varg strategjive për trazira qytetare bazuar në ato të përdoruara nga policia daneze. Në muajt e fundit, pjesëtarët e NJRPO-së gjithashtu janë pajisur me një numër të vogël të pushkëve automatike të llojit MP-5 (rreth 5 të tilla në çdo njësit regjional). Ndonëse në fazën e hershme të zhvillimit, NJRPO-ja tanimë është duke dëshmuar se është në gjendje të ofrojë metoda efektive dhe mjaft profesionale në përkrahje operative të komandantëve regjionalë. Si shembull, gjatë vitit 2006 njësitin I NJRPO-së në Ferizaj ka konfiskuar 70 armë të zjarrit të mbajtura ilegalisht dhe 2579 plumba. Inspektorati policor i konsideron njësitet e NJRPO-së si shembull i praktikës më të mirë, në kuptim të menaxhimit të resurseve në realizim të qëllimeve policore.

Gjendja aktuale

2.3 Që nga viti 1999 janë vrarë gjithsejtë 8 persona, si rezultat i përdorimit të armëve të zjarrit të SHPK-së dhe një polic i SHPK-së është lënduar gjatë përdorimit të armës së tij të zjarrit³¹. Edhe pse këto humbje jete janë për keqardhje, pa dyshim

³¹ Kjo nuk ka të bëjë me policët të cilët janë vrarë tragjikisht si rezultat i përdorimit të paligjshëm të armëve të zjarrit në Kosovë.

që pasqyrojnë nivelin e veprave penale ku përfshihet dhuna dhe numrin e mbajtjeve të paligjshme të armëve të zjarrit në Kosovë. Përveç numrit të panjohur të mbajtjeve të paligjshme të armëve, janë aprovuar mbi 3400 kërkesa për LPA (leje për posedim të armëve) dhe në vitin 2006³² në Kosovë janë aprovuar mbi 11,300 zgjatje afati për LPA. Kjo tregon se ekzistojnë më shumë se 14,000 mbajtje të ligjshme të armëve të zjarrit në Kosovë.

2.4 Menaxhimi I incidenteve nga ana e SHPK-së në raste të incidenteve që përshijnë zbrazjen (shkrepjen) e armëve nga ana e zyrtarëve policor dhe metodat e menaxhimit në lidhje me shpenzimin e municionit policor, është një fushë në të cilën Inspektorati policor është I interesuar. Inspektorati policor pa se procedurat dhe praktikat e SHPK-së në lidhje me kontrollimin rutinor të armëve të zjarrit dhe armëve të tjera zyrtare, janë joadekuate. Praktika aktuale më së miri mund të përshkruhet si ad hoc, e pastrukturuar dhe e pamjaftueshme. Në pothuajse të gjitha regjionet, ekziston një nivel I papranueshëm I armëve të zjarrit me defekte, përdorim I municionit jozyrtar, 'zbrazje aksidentale e armës së zjarrit, dhe municion që mungon e që nuk shpjegohen arsyet. Si shembull, tabela 1 paraqet një përmbledhje të rezultateve nga inspektimi I fundit I armëve të zjarrit në Gjilan.

Tabela 1	
Përmbledhje e rezultateve nga inspektimi I fundit I armëve të zjarrit në regjionin e Gjilanit ³³	
Përshkrimi i defekteve	Numri I rasteve
Municion jozyrtar	13
Shënjestra jo e nivelizuar	15
Shënjestra e parë duhet të zëvendësohet	22
Shënjestra e dytë duhet të zëvendësohet	4
Armë të papastërta	27
Bllokimi I gjilpërës goditëse	5
Këllëfi I dëmtuar	1
Karikatori I papastërt	3
Karikatori I dëmtuar	3
Kafka e bllokuar	1

³² Këto shifra janë siguruar nga Shtabi I SHPK-së.

³³ Këto të dhëna janë siguruar nga komandanti regjional I Gjilanit në janar të vitit 2007.

2.5 Është parë se një numër i defekteve të vërejtura gjatë inspektimit në Gjilan/Gnjilane ishin të tilla që armën ta bënin jofunksionale dhe të padobishme për policin përkatës. Inspektorati policor nuk ishte në gjendje të mbledhë të dhëna krahasuese në lidhje me SHPK-në si tërësi për shkak të mungesës së një metode të qëndrueshme dhe të njëtrajtshme për inspektimin e armëve të zjarrit nëpër të gjitha regjionet. Rezultati i sistemit të tanishëm të inspektimit të armëve të zjarrit nuk mund të krijojë një bazë të centralizuar të dhënash të cilat do të ndihmonin menaxhmentin e SHPK-së në marrjen e vendimeve për ndryshimin e politikave dhe strategjive. Me fjalë të tjera momentalisht nuk ekziston asnjë sistem i analizimit të trendeve për sjelljet e SHPK-së (në lidhje me armë të zjarrit) dhe përdorimin e rezultateve në marrjen e vendimeve për trajnim, testim dhe ndëshkime disiplinore. Inspektorati policor e konsideron sistemin e përdorur në Gjilan/Gnjilane si një shembull i praktikës më të mirë dhe rekomandon që SHPK-ja ta përdorë këtë qasje në të gjitha regjionet.

Rekomandimi kryesor

Nr. 1

Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK-ja të zhvillojë një metodologji të vetme në lidhje me inspektimin e armëve të zjarrit në të gjitha regjionet. Ky sistem duhet të bazohet në parimin që çdo armë e zjarrit duhet t'i nënshtrohet një kontrollimi të obliguar mujor, duke përdorur një formular zyrtar të SHPK-së dhe të evidentohen në bazën e të dhënave regjionale/qëndrore. Këto të dhëna mund të analizohen për të identifikuar trendet për sjelljen e SHPK-së (në lidhje me armët e zjarrit) dhe rezultatet e tyre mund të përdoren për të marrë vendime në lidhje me trajnim, testim dhe ndëshkime disiplinore.

2.6 Përveç defekteve që janë hasur gjatë inspektimit rutinor të armëve të zjarrit nga ana e mbikëqyrësve regjional, Inspektorati policor është i interesuar për numrin e rasteve të mungesës së municionit (e që nuk shpjegohen arsyt) dhe 'zbrasjen aksidentale' të armëve të policëve. Për shembull, gjatë inspektimit rutinor të armëve të zjarrit në Prizren, gjatë vitit 2006 ekzistonin gjithsejtë 12 raste të mungesës së municionit përfshirë më shumë se 50 plumba për të cilët nuk shpjegohen arsyt. Disa raste të ashtuquajtura 'zbrasje aksidentale' në të vërtetë janë mjaft të qëllimshme dhe si pasojë e keqpërdorimit të pamatur të armëve të zjarrit nga ana e zyrtarëve policor, siç është rasti i incidentit në Ferizaj ku një zyrtar policor kishte shtier me armën e tij Glock në një dasëm. Incidentet e tilla paraqesin sjellje të rënda të këqija në bazë të Urdhëresës Administrative 2006/9 dhe panevojë diskreditojnë SHPK-në në tërësi. Inspektorati policor udhëzon që ndaj zyrtarëve policor të tillë të papërgjegjshëm të ndërmerren masa të ashpra në mënyrë që të ngritet imazhi profesional i organizatës.

Rekomandimi kryesor

Nr. 2

Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që SHPK-ja ta përdorë një politikë për largim të menjëhershëm nga puna kur ekzistojnë dëshmi të qarta se polici ka shtënë me armën e tij të zjarrit në mënyrë të pakujdeshme dhe të papërgjegjshme .

2.7 Në bazë të procedurave të SHPK-së, çdo polic duhet të përpilojë një raport në lidhje me çfarëdo zbrazje të armës së tij/saj – qoftë zbrazje aksidentale apo ndryshe – sa më shpejt që të jetë e mundur dhe çdoherë para se polici të përfundojë orarin e punës, në ditën kur ka ndodhur incidenti. Raporti i paraqitet mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë dhe brenda 7 ditëve i dërgohet zëvendës komisarit (nëpërmjet komandantit të stacionit dhe komandantit regjional), në Administratë, Shtab. Në të njëjtën kohë një kopje e raportit i dërgohet ‘Komisionit për vlerësimin e përdorimit të forcës’ për të vlerësuar dhe përcaktuar sasinë e përdorimit të forcës. Nëse ekzistojnë dëshmi ‘prima facie’ (e mbështetur në përshtypjen e parë) për ta përkrahur procedurën disiplinore, raporti i dërgohet Njësitit për Standarde Profesionale.

2.8. Tabela 2 ofron një analizë të llojeve të armëve të zjarrit dhe veprave penale të kryera me armë zjarri nga ana e pjesëtarëve të SHPK-së gjatë vitit 2006. Edhe pse numri i përgjithshëm i rasteve (24) duket mjaft i vogël si përqindje e numrit të përgjithshëm të zyrtarëve të SHPK-së (0.33), rastet e vrasjeve dhe tentim vrasjeve nga ana e SHPK-së janë shqetësuese. Në kohën e inspektimit, Inspektorati Policor nuk ka qenë në gjendje të sigurojë të dhëna krahasuese nga organizatat tjera policore për të përcaktuar gjendjen aktuale të SHPK-së në këtë fushë të rëndësishme. Poashtu, Inspektorati Policor nuk ka mundur që të sigurojë hollësi në lidhje me rastet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe nëse këto informata i janë dërguar departamentit për trajnim në SHPK. Vetëm duke i shikuar për së afërmi këto hollësi departamenti i trajnimit do të mund të modifikojë sistemin e riçertifikimit në mënyrë që të zvogëlohet numri i incidenteve të tilla.

Rekomandimi kryesor

Nr. 3

Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që NJSP-ja rregullisht t’ia dërgojë informatat departamentit të trajnimit të SHPK-së në lidhje me procedurat disiplinore që përfshijnë keqpërdorimin e armëve të zjarrit, si pjesë e përpjekjes së vazhdueshme për zvogëlimin e incidenteve të tilla nëpërmes trajnimeve riçertifikuese dhe testimeve.

Tabela 2

Keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga ana e zyrtarëve të SHPK-së – rastet me të cilat është marrë NJSP në 2006³⁴

Lloji i incidentit	Numri i incidenteve
Vrasje	2
Tentim vrasje	1
Zbrasje e armës së zjarrit	4
Goditja e ndonjë personi me armë të zjarrit	2
Përdorimi i municionit jozyrtar në armën zyrtare	2
Kërcënimi jo i ligjshëm me përdorimin e armës së zjarrit	7
Humbja e armës së zjarrit	3
Humbja e armës së zjarrit dhe karikatorit	2
Shitja e armës së zjarrit	1
Gjithsejtë	24

2.9 Një fushë tjetër e interesimit është ruajtja aktuale e armëve dhe municionit të SHPK-së, në kuptim të sigurisë si dhe shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. Në disa vende, siguria e vendeve për ruajtjen e armëve është joadekuate: për shembull, disa policë të njësitit NJRPO-së në Mitrovicë I ruajnë pushkët e tipit MP-5 në sirtarë dokumentesh jo të kyçur. Në shumicën e vendeve, municioni ruhet në një dhomë të sigurtë që është pjesë e objektit policor pa alarme tymi dhe zjarri. Pothuajse në të gjitha regjionet Inspektorati evidentoi ankesa për municion në gjendje jo të rregulltë. Shpesh këto kanë të bëjnë me prodhimin e dobët të gëzhgjës së plumbave 9 mm dhe kjo mund t'iu shkaktojë lëndime policëve me rastin e shkreptjes së armës.

Rekomandimi kryesor Nr. 4

Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK-ja në strategjinë e armëve të zjarrit të përfshijë sigurinë minimale dhe standardet e sigurisë, dhe që këto standarde të implementohen në mënyrë të njëjtë në tërë organizatën sa më shpejt që të jetë e mundur.

³⁴ Këto shifra janë marrë nga NJSP, Shtabi I SHPK-së.

Politika dhe strategjia

2.10 Paragrafi 37 i Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP) thotë se “policia mund të përdorë forcë vetëm nëse është plotësisht e nevojshme dhe vetëm në atë masë që kërkohet për të arritur një qëllim të ligjshëm”. Është parim themelor I policisë demokratike që gjithmonë duhet të ekzistojë bazë ligjore për veprimet policore, përfshirë përdorimin e forcës. Përdorimi I arbitrar I forcës është I papranueshëm. Në kohën e inspektimit Inspektorati Policor vërejti se nuk ekziston ndonjë ligj në fuqi I cili rregullon përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve të SHPK-së, në pajtim me KEEP-në, ligjet përkatëse të BE-së dhe ligjin ndërkombëtar. Shtatë vjet pas themelimit të SHPK-së, kjo *lacuna legis* (zbrazëti në ligj) është çështje për shqetësim dhe duhet të shqyrtohet sa më shpejt që është e mundur.

2.11 Gjatë vitit 2005 UNMIK-u mori rolin kryesues në përpilimin e ligjit policor I cili ishte hedhur poshte nga shumica në Kuvendin e Kosovës dhe nga Kryeministri, sipas parimit se qeveria duhet të përpilojë ligjin për SHPK-në. Rregullorja e UNMIK-ut 2005/54 (*mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës*) – një verzion I përmbledhur I draft ligjit të UNMIK-ut – paraqet një masë të përkohshme për krijimin e bazës ligjore për SHPK-në dhe I mungojnë dispozitat mbi përdorimin e forcës. Ministria e Punëve të Brendshme tani kryeson një grup ekspertësh në përpilimin e një ligji gjithpërfshirës policor.

Rekomandimi kryesor

Nr. 5

Inspektorati Policor rekomandon që procesi I prezentimit të legjislacionit I cili rregullon përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve të SHPK-së, të përfundojë sa më parë që të jetë e mundur.

2.12 Në bazë të Doracakut të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, përdorimi I forcës nga ana e zyrtarëve policor duhet të jetë I arsyeshëm dhe proporcional ndaj kërcënimit të perceptuar dhe duhet të përdoret forca minimale për të mënjeluar atë kërcënim³⁵. Kjo është në përputhje me parimin e forcës së arsyeshme sipas paragrafit 37 të Kodit Evropian të Etikës Policore (KPEP). Ndonëse materiali për trajnimin themelor në Shkollën e SHPK-së/ QKSPEZH, Vushtrri/Vučitrn, përmban më shumë udhëzime në lidhje me të kuptuarit e forcës së arsyeshme, Doracaku I Parimeve dhe Procedurave nuk përmban hollësi të mjaftueshme.

2.13 Inspektorati policor rekomandon që definicioni I përdorimit të forcës të shtjellohet më në hollësi në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave. Përveç kësaj, Inspektorati konsideron që të gjithë zyrtarëve të SHPK-së t’iu sigurohet nga një kopje e Kodit të Etikës mbi përdorimin e forcës, bazuar në komentet zyrtare të KEEP-së. Paragrafi 37 I KEEP-së–thekson se përdorimi I forcës nga zyrtarët policor gjithnjë duhet të konsiderohet si masë e veçantë dhe, kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe nuk duhet të përdoret më shumë forcë sesa që është plotësisht e

³⁵ Doracaku I Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, p-4.14 (Azhurnuar më 24/02/2003)

domosdoshme. Kjo do të thotë që forca e përdorur duhet të jetë në proporcion me qëllimin e ligjshëm i cili duhet të arrihet me anë të asaj mase të forcës. Prandaj duhet të ekzistojë një drejtpeshim përkatës në mes të përdorimit të forcës dhe situatës në të cilën është përdorur forca. Me fjalë tjera, anjëherë nuk duhet të përdoret forca fizike përveq nëse është plotësisht e domosdoshme: armët nuk duhet të përdoren, përveq nëse është plotësisht e domosdoshme; nëse mendohet se përdorimi i armëve vdekjeprurëse është i domosdoshëm, nuk duhet të përdoren më shumë sesa që është plotësisht e domosdoshme për të mënjanuar kërcënimin.

Rekomandimi kryesor

Nr. 6

Inspektorati policor rekomandon që definicioni i forcës së arsyshme të shtjellohet më tutje në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave, dhe të gjithë zyrtarëve të SHPK-së duhet t'iu sigurohet nga një kopje e Kodit të Etikës mbi përdorimin e forcës, bazuar në KEEP.

2.14 Paragrafi 29 I KEEP-së thekson se 'trajnimi praktik mbi përdorimin e forcës dhe kufizimeve në lidhje me parimet e përcaktuara të të drejtave të njeriut, e veçanërisht Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e drejta e saj precedente, duhet të përfshihet në të gjitha nivelet e trajnimeve policore'. Prandaj përpilimi I programit trajnues për armë të zjarrit për të gjithë zyrtarët policor të SHPK-së duhet të bazohet në dispozitat e KEEP-së dhe të përfshijë shembuj të hollësishëm në lidhje me atë se si duhet të operojë në praktikë parimi I forcës së arsyshme. Zbatimi I këtij parimi do të vë një barrë të madhe te të gjithë zyrtarët policor dhe thekson nevojën për përgatitje të madhe fizike, shkathtësi të mira psikologjike dhe të atyre për marrje të vendimeve. Trajnimi në lidhje me përdorimin e forcës dhe të armëve të zjarrit duhet të përqëndrohet në metodat e vlerësimit të këtyre shkathtësive të rëndësishme.

2.15 Departamenti për trajnime I SHPK-së ka futur në përdorim një qasje për trajnime të obligueshme për armë të zjarrit që parimisht pasqyron praktikën më të mirë në shumicën e organizateve policore demokratike: dmth, trajnimi themelor, trajnimi I specializuar dhe riçertifikimi. Trajnimi themelor për armë të zjarrit është pjesë e programit 6 mujor të trajnimit themelor në Shkollën e SHPK-së (QKSPEZH), në Vushtrri, dhe përbëhet nga një numër I synimeve të mësimi, teorike dhe praktike për një periudhë prej përafërsisht gjithsejtë 10 ditësh. Kadetët e SHPK-së njoftohen me parimet e forcës së arsyeshme (siç përshkruhet në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së) dhe metodat e 'eskalimit të forcës' në vijim:

- Kontrolla Verbale (përpjekjet për të bindur me anë të bisedës);
- Kontrolla me duar të zbrazëta (Përpjekjet për të bindur me anë të përdorimit të teknikave të kontrollit fizik e jo armëve);
- Përdorimi I shufrës/sprejit (përpjekjet për të bindur me anë të përdorimit të shufrës dhe sprejit); dhe

- Përdorimi I forcës vdekjeprurëse (përpjekjet për të bindur, me anë të përdorimit të armës së zjarrit).

2.16 Ky sistem i trajnimit rezulton në praktikën më të mirë në shumë shoqëri demokratike dhe nxit zyrtarët policor që të përdorin vetëm atë forcë, të nevojshme për të bindur një person. Përveq kësaj, kadetët e SHPK-së njoftohen me teknikat themelore të ndihmës së parë, përdorimin e sigurtë të pistoletës Glock 9mm, I nënshtrohen vlerësimit të shkathtësive për marrjen e vendimeve në ushtrimet simuluese në pajset FATS dhe testet e gjuajtjes me armë të zjarrit në poligonet për gjuajtje. Vlerësimi formal bëhet në tri fusha: testi teorik me shkrim (përqindja minimale 70%), shkathtësitë e gjuajtjes (përqindja minimale 80%), dhe ushtrimet për marrje të vendimeve në pajset e FATS-it (minimumi prej 3 vlerësimeve të 'suksesshme).

2.17 Disa zyrtarë të lartë të SHPK-së mendojnë që edhpse struktura dhe përmbajtja e programit themelor trajnues për armë të zjarrit është e mirë, periodha e trajnimit është e pamjaftueshme që rekrutët të zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për përdorimin e armës së zjarrit. Inspektorati policor pajtohet me këtë mendim dhe rekomandon që departamenti I trajnimeve në SHPK duhet të shqyrtojë mundësinë e zgjatjes së periudhës trajnuese në teori dhe praktikë për përdorimin e forcës, nga ana e zyrtarëve policor.

Rekomandimi kryesor

Nr. 7

Inspektorati policor rekomandon që departamenti I trajnimeve në SHPK të shqyrtojë mundësinë e zgjatjes së periudhës trajnuese mbi përdorimin e forcës në teori dhe praktikë, për kadetët e trajnimit themelor.

2.18 Përveç programit trajnues themelor, Departamenti për Trajnime i SHPK-së në masë të madhe është duke ofruar trajnime të specializuara për përdorimin e armëve të zjarrit në mbështetje të funksioneve të reja të specializuara në SHPK. Njësitë i posafomuar I NJPI-së(Njësitë I parë Intervenues), NJPOR (Njësitë për Përkrahje Regjionale Operative) dhe disa policë kufitar janë trajnuar për përdorimin e pushkëve MP-5 AK-47. Sipas Shkollës së SHPK-së (QKSPEZH), në vitin 2006, gjithsejtë 149 zyrtarë policor i janë nënshtruar trajnimit për përdorimin e MP-5 dhe AK- 47. Në bazë të praktikës nëpër shumë organizata tjera policore, departamenti I trajnimeve në SHPK posedon rregulloren për trajnimin e obligueshëm riçertifikues në përdorimin e armëve të zjarrit që do të thotë, së paku një herë në vit çdo zyrtar I SHPK-së i cili është i autorizuar të mbajë armën e zjarrit duhet t'i nënshtrohet trajnimit përkatës dhe testimit.

2.19 Trajnimi riçertifikues vazhdon të jetë një sfidë e madhe për zyrtarët e lartë të SHPK-së. Parimi dhe qëllimi I riçertifikimit të obligueshëm për armë të zjarrit është I definuar mirë dhe njëjtë I njohur në shumicën e shteteve demokratike të cilat pajisin

zyrtarët policor me armë të zjarrit. Për shkak të sigurisë së zyrtarëve policor dhe qytetarëve, është thelbësore që zyrtarët policor t'i nënshtrohen trajnimeve dhe testeve të shpeshta në mënyrë që të jenë kompetent për mbajtjen e armës së zjarrit. Me fjalë tjera, trajnimi dhe testimi i tillë duhet të jetë një parakusht i nevojshëm për vendimin e autorizimit të zyrtarit policor për mbajtje të armëve të zjarrit të çfardo lloji. Edhe pse ky parim është i përfshirë në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, SHPK-ja vazhdon të mos përmbushë standardin e kërkuar. Sipas shkollës së SHPK-së në vitin 2006, gjithsejtë 2553 policë kanë kryer trajnimin riçertifikues, i cili numër paraqet përafërsisht 35% të numrit të përgjithshëm të zyrtarëve policor. Përkundër procedurave të SHPK-së - dhe praktikave më të mira - zyrtarët policor, prej gradës toger e lartë nuk i nënshtrohen trajnimit riçertifikues por vazhdojnë të mbajnë armë të zjarrit.

2.20 Është e qartë se gjatë vitit 2006 SHPK-ja ka bërë përpjekje të shumta për shqyrtimin e problemit të riçertifikimit të obliguar. Që nga viti 1999 problemi i përmendur ekziston për shkak të hapësirave të pamjaftueshme për trajnim nëpër tërë Kosovën. Hapësirat për trajnim me armë të zjarrit në shkollën e SHPK-së në Vushtrri/Vučitrn kurrë nuk kanë mjaftuar për plotësimin e nevojave të identifikuar të një organizate prej më shumë se 7000 policë, dhe deri në vitin 2006, rreth 300 kadetë në vit. Ende nuk janë siguruar poligone të mbyllura për gjuajtje dhe të gjitha gjuajtjet me armë të zjarrit bëhen në një poligon gjuajtje të hapur në një distancë nga Vushtrri³⁶, duke i rritur shpenzimet në kuptim të transportit dhe mungesës së policëve nga vendi i punës. Përderisa zvogëlimi i numrit të kadetëve që nga viti 2005 ka krijuar kapacitete shtesë në Vushtrri për riçertifikim, një pjesë e madhe e kapaciteteve të liruara është zënë nga organizatat tjera (p.sh dogana, shërbimi korrektues) pasi që shkolla e SHPK-së plotësisht është duke kaluar në Qendër të Kosovës për Siguri Publike dhe Zhvillim (QKSPEZH)³⁷.

2.21 Siç është bërë e ditur nga një numër i zyrtarëve të lartë të SHPK-së, zgjidhja e problemit për të siguruar se të gjithë pjesëtarët e SHPK-së kryejnë trajnimin e riçertifikimit së paku një herë në vit, kërkon një plan afatgjatë i cili do të merrte parasysh kapacitetin e kufizuar të objekteve të QKSPEZH-it. Ky plan duhet të përfshijë disa hapa: përpilimin me kujdes të rregulloreve për riçertifikim, të bazura në standardet e BE-së dhe praktikave më të mira; përgatitjen e dispozitave primare dhe sekondare ligjore të cilat bazohen në rregulloret e aprovuara dhe të përfshira në draft ligjin aktual policor; implementimin e legjislacionit përmes një varg qendrash trajnuese regjionale.

³⁶ SHPK-ja përdor dy poligone të hapura të gjuajtjes, një në Fsh. Kqiq i vogël-Shupkocv (Mitrovicë) dhe tjetri në Kamenicë-Verdhëz, Liqeni (Gjilan).

³⁷ QKSPEZH është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/54 si entitet pasues i Shkollës së SHPK-së në lokacionin e shkollës policore, në Vushtrri. Siç tregon edhe vetë emri, QKSPEZH është institucion i cili ofron trajnim dhe përkrahje edukative për të gjitha organizatat për siguri publike në Kosovë. Në këtë mënyrë, policia do të shfrytëzojë këto objekte bashkë me Doganën, shërbimin korrektues, etj.

Inspektorati policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të zhvillojnë një plan afatgjatë për prezentimin e trajnimit riçertifikues për të gjithë zyrtarët e SHPK-së së paku një herë në vit. Ky plan duhet të bazohet në standardet e njohura të BE-së dhe praktikën më të mirë; këto rregulla duhet të përfshihen në dispozitat ligjore në draftin e ligjit policor.

2.22 Si pjesë e përpjekjes së vazhdueshme për restaurimin dhe zgjerimin e objekteve të SHPK-së në tërë Kosovën (shih raportin e përkohshëm të IPK-së 2/2006 - Menaxhimi I ndërtesave të SHPK-së), IPK-ja rekomandon që plani të bazohet në modelin rajonal dhe të përfshijë ndërtimin e poligoneve të mbyllura për gjuajtje, të përshtatshme për trajnime me armë të zjarrit. Përdorimi i poligoneve të mbyllura do ta barazonte SHPK-në me shumë organizata tjera policore, në mënyrë të konsiderueshme do të zvogëlonte shpenzimet e transportit dhe nivelin e mungesës së personelit në punë për shkak të udhëtimit, dhe do të ofronte objekte të cilat nuk varen nga moti i mirë. Duke i ditur obligimet e rënda financiare të SHPK-së, Inspektorati rekomandon që plani për ndërtimin e poligoneve të mbyllura të integrohet në planet ekzistuese për renovimin e ndërtesave policore dhe ndërtimin e objekteve të reja.

Inspektorati policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të marrin parasysh ndërtimin e poligoneve të mbyllura për gjuajtje nëpër regjione si objekte të rëndësisë primare që do të mundësonin zbatimin e planit të SHPK-së për trajnime riçertifikuese. Planin për ndërtimin e këtyre poligoneve mund të integrohet në planet aktuale për renovimin dhe ndërtimin e stacioneve të reja policore dhe në këtë mënyrë të zvogëlojë barrën financiare afatgjate.

The police shall be accountable to the state, the citizens and their representatives. They shall be subject to efficient external control (paragraph 59). The police shall be accountable to the state, the citizens and their representatives. They shall be subject to efficient external control (paragraph 59).

The police shall be accountable to the state, the citizens and their representatives. They shall be subject to efficient external control (paragraph 59).

The police shall be accountable to the state, the citizens and their representatives. They shall be subject to efficient external control (paragraph 59).

The police shall be accountable to the state, the citizens and their representatives. They shall be subject to efficient external control (paragraph 59). The police shall be accountable to the state, the citizens and their representatives. They shall be subject to efficient external control (paragraph 59).

Raport i përkohshëm i inspektimit 2

Menaxhimi i ankesave dhe disiplinës në SHPK

MENAXHIMI I ANKESAVE DHE DISIPLINËS NË SHPK

1. HYRJE

1.1 Inspektimi i dytë i *rëndomtë* i SHPK-së në vitin 2007 është bërë me datën 29-të dhe 30-të mars, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqëndrua vetëm në menaxhimin e SHPK-së me ankesa kundër policëve dhe është ndërmarrë nga z. Enver Rustemi, kryeshef ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 18 inspektorëve. Vizitat u bënë në zyret e Njësitit për Standarde Profesionale (NJSP) në Shtabin e SHPK-së dhe në të gjitha shtabet regjionale. Pa përjashtim, zyrtarët e Inspektoratit Policor hasën në bashkëpunim dhe gatishmëri të plotë nga ana e personelit të NJSP-së.

1.2 Temë kryesore në Kodin Evropian të Etikës Policore është bindja se mënyra e kryerjes së detyrave policore në shoqërinë demokratike duhet të karakterizohet me një organizatë që përkrahë sundimin e ligjit, në kuptimin e zbatimit të ligjit të shtetit e me këtë duke siguruar qetësinë publike e poashtu në të njëjtën kohë vepron vetëm në bazë të ligjit dhe në këtë mënyrë i respekton të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Nevoja për përgjegjësi është bërë qartë në nenin 59-të të KEEP-së.

Policia është përgjegjëse ndaj shtetit, qytetarëve dhe perfaqësuesve të tyre. Ajo është objekt i një kontrolli të jashtëm të efektshëm (neni 59).

1.3 Përgjegjësia e policisë mund të interpretohet qoftë në kuptim të ngushtë dhe të kufizuar apo në një mënyrë më të gjerë dhe më tërësore. Interpretimi i ngushtë do të thotë që policia mund të *jetë përgjegjëse* vetëm atëherë nëse dhe kur ekziston një akuzë që ata kanë vepruar jashtë ligjit, siç definohet në legjislacionin primar dhe dytësor. Në këtë mënyrë procesi i përgjegjësisë mund të fillohet nga një ankesë e bërë nga ana e qytetarit apo nga ndonjë zyrtar tjetër policor dhe pëmban një varg hapash, nga hetimi deri te dëgjimi disiplinor dhe vendimi përfundimtar. Ngjashëm me sistemin e së drejtës penale, kjo qasje ndaj përgjegjësisë policore është plotësisht reaktive: kërkon që t'i dënojë dhe qortojë ata të cilët janë përgjegjës për sjellje të keqe dhe veprime jo të ligjshme, *pas ngjarjes*. Sikurse në sistemin e së drejtës penale, prapseprap, ekziston një vetdijësim më i rritur për përparësitë e mundshme të kuptimit më të gjerë të përgjegjësisë policore. Kjo e kushtëzon përdorimin e qasjes proaktive apo parandaluese që e plotëson dhe, sigurisht, e zvogëlon nevojën për funksionin e tërë reaktiv.

1.4 Që nga themelimi i organizatës në vitin 1999, disiplina në SHPK është rregulluar me anë të *Udhëzuesit të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së*. Kjo nënkuptonte që përgjegjësia policore në Kosovë ka përcjellur qasjen tradicionale *reaktive* – d.m.th. veprimi ndërmerret vetëm atëherë pasi që të jetë bërë ankesa për sjellje të keqe. Kjo nënkuptonte se ankesat kundër zyrtarëve të SHPK-së janë hetuar nga zyrtarët tjerë policorë, të Policisë Civile të UNMIK-ut apo të pjesëtarëve të Njësitit për Standarde

Profesionale të SHPK-së (NJSP). Sidoqoftë, Rregullorja 2005/54 dhe Urdhëresa Administrative 2006/9 paraqet qasje më të re dhe më gjithpërfshirëse ndaj përgjegjësive të SHPK-së. Pasi që të zbatohet legjislacioni plotësisht në vitin 2007, IPK-ja do të marrë përgjegjësitë e plota për trajtimin e ankesave kundër zyrtarëve të SHPK-së.

1.5 Rregullorja 2005/54 dhe Urdhëresa Administrative 2006/9 përmban parimin që ankesat e rënda kundër policisë duhet të kryhen nga ana e IPK-së, organ i cili është plotësisht i pavarur nga organizata policore. Sipas legjislacionit të ri, ankesa e qytetarit i drejtohet IPK-së, vlerësohet dhe regjistrohet. Vlerësimi përfshinë vendimin nëse sjellja e keqe e supozuar –nëse dëshmohet– mund të rezultojë në vepër penale ose shkelje të rëndë apo të lehtë disiplinore. Sikurse në të kaluarën, akuzat penale i dërgohen prokurorit publik për masa të duhura. Ankesat që kanë të bëjnë me shkelje të lehta nga IPK-ja dërgohen tek Komisari i policisë që të hetohen nga Njësi të Standarde Profesionale (NJSP), ekip i cili është i përbërë prej zyrtarëve policor të zgjedhur me kujdes. Në rastet kur supozimet kanë të bëjnë me shkelje të rënda kundër policisë të *çfarëdo grade* duke përfshirë edhe llojet e korrupsioneve– IPK-ja i kryeson hetimet. Kur ankesat e rënda vërtetohen, përgatitet dosja dhe i dërgohet Këshillit për Emërime të Larta Policore dhe Disiplinore (KELPD-së): një organ i pavarur dhe përfaqësues i cili është përgjegjës për dëgjime disiplinore dhe ka autoritet për të vendosur nëse, gjatë seancës dëgjimore, polici është fajtor ashtu siç sipas akuzave dhe në bazë të tyre rekomandon dënimin. Sidoqoftë, vetëm komisar mund ta shqiptojë dënimin. Të gjitha ankesat dhe hetimet pasuese gjurmohen dhe monitorohen në mënyrë aktive nga IPK-ja, duke siguruar që plotësohen kufizimet kohore ligjore dhe ankuesi informohet lidhur me progresin.

1.6 Ky Inspektim i rëndomtë ka domethënie të rëndësishme si një hap paraprak drejtë implementimit të plotë të legjislacionit të ri. Është me rëndësi të rishikohet mënyra aktuale e kryerjes së detyrës nga ana e personelit të NJSP-së, në mënyrë që të shqyrtohet efikasiteti i tyre në bazë të dispozitave aktuale të UNMIK-ut. Pasi që të fillon faza e II-të e projektit implementues të IPK-së në maj të vitit 2007, OSBE-ja do të kryejë trajnimin e përbashkët me pjesëtarët e IPK-së dhe atyre të NJSP-së. Kjo do të jetë një pjesë e rëndësishme e qëllimit të përgjithshëm të sigurimit të asaj që të dy grupet janë në gjendje t'i integrojnë përpjekjet e tyre në bazë të legjislacionit të ri dhe të bashkëpunojnë në mënyrë aktive.

1.7 Qëllimi i këtij inspektimi të zakonshëm është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me dispozitat relevante të Udhëzuesit të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të *Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)*;

- Përkrahjen profesionale të menaxhimit të ankesave ndaj zyrtarëve policor dhe të hetimeve përkatëse;
- Identifikimin dhe shpërndarjen e praktikës më të mirë.

1.8 Gjatë inspektimit, pjesëtarët e Inspektoratit Policor vizituan dhe intervistuan punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Komandantët regjional (apo zëvendës komandantët regjional)
- Kryesuesin e bordit të ankesave të SHPK-së, Shtabi i SHPK-së
- Drejtorin e Drejtoratit Qendror të Njësistit për Standarde Profesionale, Shabi i SHPK-së
- Shefat e Njësiveve për Standarde Profesionale në të gjitha regjionet (NJSP-të)
- Njësitin Regjional të SHPK-së për Standarde Profesionale (NJSP), hetuesit (DISA PREJ TYRE)
- Njësitin Regjional për Standarde Profesional (NJSP), hetuesit civil (DISA PREJ TYRE)
- Anëtarët e Bordit për ankesa të SHPK-së (DISA PREJ TYRE)
- Komandantët e stacioneve (DISA PREJ TYRE)

1.9 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike i cili parim është i mbështetur në nenin 19-të të *Kodit Evropian të Etikës Policore*.

2. KRYERJA E DETYRAVE NË MENAXHIMIN E ANKESAVE DHE DISIPLINËS

Organizimi aktual

2.1 Gjatë kohës së inspektimit, Drejtorati I Standardeve Profesionale (NJSP) është duke kaluar nëpër ndryshime strukturale gjithpërfshirëse si pjesë e riskstrukturimit të gjërë në SHPK. Pavarësisht kërkesave, materialet e përmbledhura dokumentare që kanë të bëjnë me modelin përfundimtar të NJSP-së nuk ishin në dispozicion për Inspektoratin Policor. Ky mund të jetë rezultat i disa paqartësive në SHPK për nevojat e përpikta të sistemit të ri të ankesave dhe disiplinës, sipas Rregullores 2005/54 dhe Urdhërësës Administrative 2006/9. Por është e qartë se është i nevojshëm dhe përkatës një reduktim i konsiderueshëm i numrit të personelit të NJSP-së, edhe me sasinë aktuale të detyrave të punës. Prandaj, kjo pjesë e këtij raporti do të përqëndrohet në organizimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e NJSP-së në vitin 2006 dhe pjesën e parë të vitit 2007, para ndryshimeve strukturale.

2.2 Në tetor të vitit 2005 Policia civile e UNMIK-ut barti kompetencat për menaxhimin dhe hetimin e ankesave ndaj pjesëtarëve të SHPK-së, tek Njësitin I

Standardeve Profesionale të SHPK-së (NJSP). Puna e NJSP-së do të vazhdojë të monitorohet në mënyrë aktive nga zyrtarët e UNMIK-ut deri në largim të këtyre të fundit. Në vitin 2006 NJSP-ja numëronte 92 pjesëtarë, të caktuar në të gjitha gjashtë regjionet dhe Shtabin e SHPK-së përfshirë 16 hetues civil dhe 76 policë të SHPK-së, në rolin e kryerjes së hetimit dhe menaxhimit. Kontigjenti I SHPK-së përfshinë një kolonel, një major, 8 togerë, 28 rreshterë dhe 38 policë patrullues. Inspektoratit Policor iu bë e ditur se si pjesë e ristrukturimit të propozuar, pjesëtarët civil dhe policët patrullues do të largohen nga NJSP-ja. Kjo masë është mirëpritur, meqenëse ajo vërteton parimin se një zyrtar policor i cili është subjekt i ndonjë ankesë formale duhet t'i nënshtrohet hetimit nga ndonjë zyrtar tjetër me së paku një gradë më të lartë.

2.3 Siç do të përshkruhet më në hollësi, sistemi aktual i procesimit të ankesave ndaj pjesëtarëve të SHPK-së përfshin; 'Bordin e ankesave', organ ky i cili mirret me ankesat e zyrtarëve të SHPK-së të cilët kanë qenë subjekt të procedurës disiplinore dhe janë shpallur fajtorë. Bordi përbëhet prej gjithësejt 43 zyrtarë të lartë të SHPK-së (togerë, kapitenë dhe majorë), të cilët mbledhen në formë paneli prej 5 ose më shumë personash. Kjo do të thotë që tërë procesi disiplinor, nga hetimi deri te dëgjimi, nga shqiptimi i dënimeve dhe seancave dëgjimore të ankesave, kryhet ekskluzivisht nga pjesëtarë tjerë të SHPK-së. Duket se nuk ekziston ndonjë mekanizëm formal me anë të të cilit një zyrtar policor mund të ankohet në ndonjë organ kompetent ose gjykatë jashtë organizatës së SHPK-së.

2.4 Inspektorati policor vërejti se në përgjithësi pjesëtarët e NJSP-së punojnë në kushte mjaft të vështira pune. Ngjashëm me situatën në zyret (njësitet) tjera në SHPK, zyret janë të meremetuara keq, hapësira është e pamjaftueshme dhe e papërshtatshme. Veçanërisht, personeli i NJSP-së nuk ka zyre të mjaftueshme për të kryer intervistimet e besuara me ankuesit dhe zyrtarët e akuzuar në mënyrë të papenguar dhe të pandërprerë. Gjithashtu pjesëtarët e NJSP-së kanë qasje të kufizuar në automjetet e dedikuara, dhe në këtë mënyrë kufizohet lëvizshmëria gjatë hetimeve. Këta faktorë, bashkë me pasigurinë për të ardhmen e NJSP-së në ristrukturimin aktual, duket të kenë zvogëluar moralin dhe efikasitetin e pjesëtarëve të NJSP-së.

2.5 Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit të NJSP-së është ajo që brengos Inspektoratin Policor. Në raste të pozitive të lira të punës në NJSP, konkursi shpallet brenda organizatës dhe rrethi i ngushtë i kandidatëve dhe intervistimi i tyre bëhet nga panelet *ad hoc*, të përbëra prej personelit të Drejtoratit të Standardeve Profesionale. Ngjashëm me kërkesat e përgjithshme të pranimit, pjesëtarët e NJSP-së duhet të posedojnë vetëm diplomën e shkollimit të mesëm, pa ndonjë trajnim paraprak të specializuar. Gjatë këtij inspektimi, SHPK-ja nuk kishte mundësi për të ofruar trajnim të specializuar për pjesëtarët e NJSP-së. Ndonëse një numër i vogël i policëve kishin kryer kursin 5 ditor të NJSP-së në Shkollën e SHPK-së në vitin 2004, dhe të tjerët kishin përfunduar kursin trajnues për hetime krimi, duket se mungon një rregullore e qartë lidhur me standardet minimale për kompetencë. Mungesa e

qartësimin të standardeve minimale në këtë fushë, tregon që SHPK-ja ka dështuar në identifikimin e rolit vendimtar të NJSP-së, në marrëdhëniet e saj me shoqërinë dhe nivelin deri te I cili organizata vlerëson përgjegjshmërinë si mjet I rritjes së besimit të qytetarëve. Kjo çështje do të rishikohet më tutje në këtë raport.

Kryerja e detyrave

2.6 Sistemi ekzistues i trajtimit të ankesave ndaj zyrtarëve të SHPK-së, i përshkruar në *Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së*, përbëhet prej pesë fazave kryesore:

- 1) Pranimi I ankesës dhe veprimet fillestare (përfshirë procesin joformal të zgjidhjes)
- 2) Hetimi formal nga ana e NJSP-së (në rast të shkeljeve disiplinore) ose nga ana e Prokurorit publik (vepra penale);
- 3) Rishikimin përfundimtar dhe vendimin nga ana e Drejtoratit të Standardeve Profesionale;
- 4) Miratimin e vendimit të drejtoratit dhe shqiptimin e dënimit nga ana e Zëvendës komisarit (Administratë);
- 5) Procesin e të ankuarit ndaj vendimit të Drejtoratit të Standardeve Profesionale I kryer nga 'Bordi I ankesave'.

2.7 Fillimisht, procedura disiplinore ndaj një zyrtari policor të SHPK-së mund të inicohet qoftë me pranimin e ankesës formale nga ndonjë qytetar ose me urdhër të mbikëqyrësit. Varësisht nga pesha (forma) e sjelljes së supozuar, mbikëqyrësi I stacionit ose departamentit policor përkatës mund të kërkojë që të zgjidh atë çështje në mënyrë joformale. Në rast të pranimin të ankesës nga ndonjë qytetar, mbikëqyrësi I SHPK-së fton së bashku ankuesin dhe zyrtarin e akuzuar për të diskutuar çështjen përkatëse. Nëse në këtë mënyrë mund të zgjidhet shkaku I ankesës sipas pëlqimit të ankuesit, atëherë nuk do të ndërmerren vendime tjera ndaj zyrtarit policor. Megjithatë, në raste kur tema e ankesës është e papërshtatshme për zgjidhje joformale ose nëse metoda joformale nuk është e pranueshme për ankuesin, rasti I referohet zyres regjionale të NJSP-së për hetime të mëtutjeshme.

2.8 Inspektorati policor vërejtë se rastet që janë zgjidhur në mënyrë joformale nuk janë evidentuar me shkrim dhe se nuk ekziston ndonjë bazë qëndrore të dhënash lidhur me këto ankesa. Kjo mungesë e kontrollit të menaxhmentit , e kombinuar me mundësinë e konsiderueshme për keqpërdorim nga ana e mbikëqyrësve të cilët përvetësojnë një pozitë të njëanshme në favor të policit të akuzuar, paraqet dobësi të konsiderueshme në sistemin e tanishëm të trajtimit fillestar të ankesave. Hyrja në fuqi e Urdhresës Administrative 2006/9, në fund të vitit 2007, do të sigurojë që të gjitha ankesat- sado të lehta - të rexhistohen nga zyrtarët policor (ose ndonjë organ tjetër kompetent) dhe t'i përcjellen Inspektoratit për t'i futur ato në Bazën e të

Dhënave për ankesat policore. Ndërkohë, Inspektorati policor rekomandon që zëvendës komisarit për Administratë, sa më parë, të paraqesë një sistem të evidentimit të të gjitha ankesave ndaj pjesëtarëve të SHPK-së.

Rekomandimi kryesor

Nr. 1

Inspektorati policor rekomandon që zëvendës komisarit për administratë, sa më parë të paraqesë një sistem të evidentimit të të gjitha ankesave ndaj pjesëtarëve të SHPK-së. Ky sistem duhet të përfshijë ankesat që zgjidhen në mënyrë joformale me hollësitë e zyrtarit policor të akuzuar dhe mbikëqyrësit.

2.9 Me pranimin e ankesës, NJSP-ja ka për detyrë të hetojë çështjen në tërësi brenda periudhës kohore prej 60 ditësh, përveç nëse çështja rezulton në vepër penale –nëse ka dëshmi për t'u vërtetuar. Supozimet për sjellje kriminale I dërgohen prokurorit publik kompetent për hetime në bazë të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (2004). Kur NJSP regjional të përfundojë hetimin, dosja e rastit I dërgohet Drejtoratit të Standardeve Profesionale për vendimin final. Drejtorati pastaj, në bazë të dëshmive dhe rekomandimeve në dosje, e hudh rastin (që do të thotë nuk ndërmerret ndonjë veprim I mëtutjeshëm ndaj policit të akuzuar) ose kërkon hetim të mëtutjeshëm ose rastin ia përcjell zëvendës komisarit (administratë) me rekomandimin se zyrtari policor është shpallur fajtor sipas akuzave. Vetëm zëvendës komisarit (administratë) ka autoritet për të caktuar fajësinë dhe për të shqiptuar dënimin. Në rast se pjesëtari I SHPK-së shpallet fajtor, ai mund t'ia paraqesë ankesën me shkrim Bordit të ankesave, brenda 8 ditëve.

2.10 Përveq funksionit të hetimit të ankesave ndaj policëve, NJSP-ja gjithashtu bënë 'hetimet nga e kaluara'. Ky funksion përfshinë shqyrtimin e të dhënave personale të kandidatëve që i bashkohen SHPK-së (për dënimet paraprake, përgatitja shkollore), zyrtarët e SHPK-së që përpiqen të gradohen apo të ndërrojnë vendin e punës, dhe ata të cilët dëshirojnë të ndryshojnë mbiemrin e tyre nga ai në dokumentet e ish RF të Jugosllavisë para viti 1999. Kjo krijon një sasi të konsiderueshme të punës. Në vitin 2006 NJSP-ja ka kryer gjithsejtë 1,385 kontrollime nga e kaluara, rreth 15 raste për polic.

2.11 Inspektimi I një numër dosjesh të rastit në NJSP – të zgjedhura si mostra- nxorri në pah faktin se personeli I NJSP-së vepron në pajtueshmëri me dispozitat e Doracakut të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së. Megjithatë, gjatë intervistimit të policëve të SHPK-së të cilët I janë nënshtruar hetimit nga ana e NJSP-së, Inspektorati policor nxorri në pah një konsensus të fuqishëm se sistemi aktual I disiplinës nuk perceptohet si I barabartë, I panshëm dhe I drejtë. Mendimi I përbashkët- I përmbledhur me thënien "NJSP-ja është për disa policë njerke e për disa nënë" – është se shumë procedura disiplinore inicohen nga mbikëqyrësit apo policët tjerë për qëllime të këqija. Ndonëse këto raste shpesh nuk rezultojnë në shpallje të fajësisë apo shqiptim dënimi, duket të dëmtojnë policin e akuzuar, organizatën dhe procesin e përgjegjshmërisë. Inspektorati policor vërtetoi se kjo dëshmi është në masë të

madhe e pasigurtë dhe mund të pasqyrojë paragjykimet e policëve të cilët në të vërtetë janë fajtor për shkelje disiplinore dhe nuk janë të kënaqur që janë zënë duke bërë shkelje disiplinore. Megjithatë, është diskutabile se kjo çështje kërkon hetime të mëtutjeshme dhe fuqimisht rekomandohet që Komisari I policisë duhet të bëjë një shqyrtim gjithpërfshirës në përdorimin dhe keqpërdorimin e mundshëm të sistemit disiplinor nga mbikqyrësit e SHPK-së.

Rekomandimi kryesor	Nr. 2
<p><i>Inspektorati policor fuqimisht rekomandon Komisari I policisë duhet të bëjë një shqyrtim gjithpërfshirës në përdorimin dhe keqpërdorimin e mundshëm të sistemit disiplinor nga mbikqyrësit e SHPK-së. Kjo duhet të përfshijë një studim të numrit të rasteve disiplinore të inicuar nga mbikqyrësit ose policët tjerë dhe numrin e rasteve të tilla që rezultojnë në shpalljen e fajësisë.</i></p>	

2.12 Tabela 1 ofron një analizë të shkurtë për numrin dhe klasifikimin e rasteve të ankesave në tre muajt e parë të vitit 2007, të krahasuara me të njëjtën periudhë të vitit 2006. Numri i ankesave dukshëm është shtuar në vitin 2007 si dhe janë bërë ndryshime të rëndësishme lidhur me mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve. Edhe pse është ballafaquar saktësisht me numrin e njëjtë të ankesave në periudhën e njëjtë në të dy vitet (d.m.th 31), bordi i ankesave ka ndërruar jashtëzakonisht shumë në favor të hudhjes poshtë të vendimeve fillestare të Drejtoratit të Standardeve Profesionale dhe të ndryshimit të ankesave. Fakti që 74.1% e të gjitha rasteve të ankesave janë ndryshuar në tre muajt e parë të vitit 2007, tregon se ekzistojnë baza të fuqishme për hetime të mëtutjeshme të menaxhmentit. Ky numër kaq i madh i ankesave të suksesshme tregon se sistemi I NJSP-së ka të meta serioze apo procedura e ankesës është shumë e lehtë. Në të dy rastet, nëse ky sistem vazhdon të funksionojë, do ta dëmtojë në masë të madhe besueshmërinë e popullatës në sistemin e SHPK-së sa i përket ballafaqimit me sjelljen e rëndë të keqe nga ana e zyrtarëve policor. Inspektorati Policor nxit Komisararin e Policisë së UNMIK-ut të iniciojë një hetim urgjent në lidhje me zhvillimet e tanishme në vendimet e marra nga Bordi i Ankesave, me qëllim të implementimit të masave të menjëhershme të caktuara për të rikthyer besueshmërinë e popullatës në sistemin e tanishëm disiplinor.

Table 1

Analiza e rasteve të ankesave të cilat i ka shqyrtuar 'Bordi i ankesave' (Krahasimi në mes të muajit janar – mars, 2006 dhe 2007)

Viti	Numri total i ankesave	Numri total i ankesave të hudhura poshtë (% e rasteve të trajtuara)	Numri total i ankesave të ndryshuara (% e rasteve të trajtuara)	Numri total i ankesave të pazgjidhura ('të hapura')
2006(Janar- Mars)	34	17 (54.8%)	14 (45.1%)	3
2007 (Janar – Mars)	52	8 (25.8%)	23 (74.1%)	21

Rekomandimi kryesor Nr. 3

Inspektorati Policor nxit Komisarin e Policisë së UNMIK–ut të inicojë një hetim urgjent në lidhje me zhvillimet e tanishme në vendimet e marra nga bordi i ankesave, me qëllim të implementimit të masave të menjëhershme të caktuara për të rikthyer besueshmërinë e popullatës në sistemin e tanishëm disiplinor.

2.13 Ekzistojnë një numër shqetësimesh për mënyrën e menaxhimit të të dhënave dhe statistikave nga ana e NJSP-së. Inspektorati Policor vërejti se ekziston mungesë e të dhënave të hollësishme lidhur me llojin e shkeljeve që janë nën hetim (p.sh. shkelje disiplinore apo veprat penale) dhe numrin e rasteve të shqyrtuara brenda 60 ditëve apo më herët. Në të vërtetë Inspektorati ka vërejtur që të dhënat statistikore të ofruara nga NJSP-ja janë të pjesërishme, të pakompletuara dhe të padobishme, sa i përket menaxhimit të mënyrës së kryerjes së detyrës. Sipas një dokumenti nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, ka pasur gjithsejt 364 raste disiplinore aktive në vitin 2006, prej të cilave 272 janë hetuar në nivel lokal (të stacionit apo regjionit) dhe 74 i janë referuar Drejtorisë për vendimin përfundimtarë. Sidoqoftë, sipas statistikave në tabelën 2 – gjithashtu të ofruara nga Drejtoria – gjithsejt 308 zyrtarëve policorë të SHPK-së iu kanë përfunduar rastet disiplinore në vitin 2006 (278 zyrtarë të SHPK-së i janë nënshtruar masave disiplinore dhe 130 zyrtarë janë shpallur të 'pafajshëm'). Nëse dokumenti i parë është i saktë, NJSP-ja ka shqyrtuar 346 raste (rreth 3.7-të raste për një pjesëtar të NJSP-së për vit); ndërsa, nëse tabela 2 është e saktë, NJSP-ja ka shqyrtuar 854 raste në vitin 2006 (rreth 9.2 raste për një pjesëtar të NJSP-së për vit).

Tabela 2

Analiza e rasteve disiplinore në vitin 2006³⁸

	Llojet e shqiptuara të masave disiplinore	Numri
1	Zyrtarët e larguar nga puna	48
2	Zyrtarët e suspenduar me pagesë	87
3	Zyrtarët të cilët i kanë degraduar	5
4	Zyrtarët e transferuar	13
5	Masat tjera të shqiptuara	91
6	Numri total i zyrtarëve të cilëve iu janë shqipëtuara masat disiplinore	278
7	Zyrtarët të cilët nuk janë 'shpallur fajtor'	130
8	Rastet e pazgjidhura ('të hapura') nga 2006	67
9	Rastet e 'hetimeve preliminare'	85
10	Rastet e kthyer në nivel lokal për zgjidhje	50
11	Totali (të gjitha kategoritë)	854

2.14 Sigurimi i të dhënave lidhur me mënyrën e zgjidhjes së rasteve pa iu përgjigjur llojit apo kategorisë së shkeljes së supozuar ka vlerë të parendësishme. Inspektorati Policor mendon se statistikat aktuale të ofruara nga NJSP-ja nuk e plotësojnë standardin e transparencës, i shpjeguar në nenin 62 të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP). Përgjegjësia policore kërkon që SHPK-ja të jetë në gjendje të ofrojë të dhëna të qarta dhe të sakta lidhur me numrin e ankesave për secilën kategori (penale apo disiplinore), numrin e ankesave për secilin lloj të shkeljeve (p.sh. forca e tepruar, keqpërdorimi i autoritetit), numri i rasteve të përfunduara brenda 60 ditëve dhe numri i zyrtarëve të shpallur fajtorë për secilën kategori apo lloj të shkeljeve. Pa këto të dhëna të qarta nuk mund të ketë besueshmëri të popullatës në sistemin e ankesave policore. Inspektorati Policor rekomandon që sa më shpejtë SHPK-ja të rishikojë sistemin e menaxhimit të informatave për rastet disiplinore. Duhet të krijohet një formë e re, e bazuar në shkeljet sipas Urdhëresës Administrative 2006/9 dhe të ofrojë të dhëna të qarta dhe të sakta në lidhje me numrin e rasteve për secilin lloj të shkeljes dhe numrin e zyrtarëve të shpallur fajtorë.

³⁸ Statistikat e ofruara nga drejtori i Drejtorisë për Standarde Profesionale (Mars, 2007)

Inspektorati Policor rekomandon që sa më shpejtë SHPK-ja të rishikojë sistemin e menaxhimit të informatave për rastet disiplinore. Duhet të krijohet një formë e re e bazuar në shkeljet sipas Urdhëresës Administrative 2006/9 dhe të ofrojë të dhëna të qarta dhe të sakta në lidhje me numrin e rasteve për secilin lloj të shkeljes dhe numrin e zyrtarëve të shpallur fajtorë.

Politika dhe strategjia

2.15 Në kohën e inspektimit të rëndomtë, Inspektorati Policor ka vërejtur se Drejtorja e Standardeve Profesionale nuk ka dokument të shkruar të politikave apo strategjisë³⁹ dhe mbështetet vetëm në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së. Ekziston nevoja për një politikë të ankesave policore dhe strategji përkatëse. Ajo duhet të përqëndrohet në nevojën e ngritjes së besueshmërisë së popullatës në sistemin e krijuar për të siguruar se rastet e sjelljes së keqe të policëve të zgjidhen me shpejtësi dhe në pajtueshmëri të plotë me Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, dhe pastaj në bazë të Urdhëresës Administrative 2006/9. Gjithashtu, duhet të përpiqet të shtoj rrjedhën e saktë dhe të qartë të të dhënave lidhur me ankesat policore për menaxherët e lartë të SHPK-së, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe publikun. Duhet të ndihmojë në përdorimin e 'qarkut të informatave' që mundëson personelit të SHPK-së të paraqesë, nëse është nevoja, trajnimin dhe masat e tjera të burimeve njerëzore, për të zvogëluar llojet e caktuara të sjelljes së keqe (p.sh. shkathtësitë komunikuese për zyrtarët të cilët dështojnë për t'u ballafaquar me pjesëtarët e popullatës, në mënyrë të qetë, të kujdesshme dhe të sjellshme).

Inspektorati Policor rekomandon që Drejtorja e Standardeve Profesionale të zhvillojë një politikë të ankesave policore dhe strategji përkatëse. Ajo duhet të përqëndrohet në nevojën e ngritjes së besueshmërisë së popullatës në sistemin e krijuar, për të siguruar se rastet e sjelljes së keqe të policëve të zgjidhen me shpejtësi dhe në pajtueshmëri të plotë me Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, dhe pastaj në bazë të Urdhëresës Administrative 2006/9. Gjithashtu, duhet të përpiqet të shtoj rrjedhën e saktë dhe të qartë të të dhënave lidhur me ankesat policore për menaxherët e lartë të SHPK-së, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe publikun. Duhet të ndihmojë në përdorimin e 'qarkut të informatave' që mundëson personelit të SHPK-së të ndër marrë masa proaktive në mënyrë që të zvogëlojë llojet e caktuara të sjelljeve të këqija.

³⁹ Është e rëndësishme të jetë e qartë se çka nënkupton IPK-ja me këto shprehje. Politika është një grup idesh që janë të formuluar si deklarata lidhur me veprimet e qëllimshme të SHPK-së lidhur me problemet e njohura të sjelljes së keqe nga ana e policëve dhe çështjeve përkatëse. Politika e ankesave policore duhet të tregojë qëllimet specifike të cilat zyrtarët e lartë përkatës mundohen t'i përbushin gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ndërsa, strategjia është një plan i hollësishëm për përbushjen e atyre qëllimeve të përcaktuara në dokumentin e politikave. Politika e ankesave policore duhet të sigurojë udhëzime të hollësishme për personelin përkatës të NJSP-së lidhur me atë se çka duhet të bëhet, metodat dhe taktikat e preferuara, si dhe burimet të cilat do të jenë në dispozicion.

2.16 Përveç kësaj, politika dhe strategjia e ankesave policore duhet të përcaktojë plane të qarta pune dhe standarde për mënyrën e kryerjes së punës nga ana e personelit të saj. Këto standarde duhet të shqyrtojnë nevojën për informim të rregullt të ankuesit lidhur me rrjedhën e hetimeve, si dhe rezultatin përfundimtar. Si pjesë e përgatitjes për implementim të plotë të Urdhëresës Administrative 2006/9, Inspektorati Policor rekomandon që Drejtoria e Standardeve Profesionale të rishikojë politikat e përzgjedhjes dhe trajnimit për personelin e NJSP-së. Me këtë iniciativë duhet t'iu ipet prioritet trajnimeve të mëtutjeshme lidhur me shkathhtësitë e përpilimit të raporteve. Kjo politikë duhet të përfshijë vlerësimin nga ana e SHPK-së që zyrtarët e NJSP-së kanë rol vendimtar në masat e përgjegjësisë së organizatës dhe duhet të sigurojë që zyrtarët e përzgjedhur dhe të trajnuar të NJSP-së në kuptim të kompetencave dhe profesionalizmit, janë baras me rolin e përmbushjes së të priturve gjithnjë e më të mëdha të popullatës.

Rekomandimi kryesor

Nr. 6

Inspektorati Policor rekomandon që Drejtoria e Standardeve Profesionale të rishikoj politikat e përzgjedhjes dhe trajnimit për personelin e NJSP-së, si pjesë e përgatitjes për implementim të plotë të Urdhëresës Administrative 2006/9. Kjo politikë duhet të përfshijë vlerësimin nga ana e SHPK-së që zyrtarët e NJSP-së kanë rol vendimtar në masat e përgjegjësisë së organizatës dhe duhet të sigurojë që zyrtarët e përzgjedhur dhe të trajnuar të NJSP-së në kuptim të kompetencave dhe profesionalizmit, janë baras me rolin e përmbushjes së të priturve gjithnjë e më të mëdha të popullatës.



Raport i përkohshëm i inspektimit 3

Menaxhimi i buxhetit dhe financave në SHPK

MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE NË SHPK

1. HYRJE

1.1 Inspektimi I tretë I zakonshëm mbi SHPK-në në vitin 2007 është bërë prej 2 deri më 4 maj, në pajtim me Rregulloren 2005/54 dhe Urdhëresën Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqendrua vetëm në menaxhimin e buxhetit dhe financave nga ana e SHPK-së dhe është ndërmarrë nga Z. Enver Rustemi, kryeshef ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 18 inspektorëve. Vizitat janë bërë në zyret e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa në Shtabin Qendror të SHPK-së dhe në të gjitha shtabet regjionale. Pa përjashtim, zyrtarët e Inspektoratit Policor hasën në bashkëpunim dhe gatishmëri të plotë nga ana e personelit të SHPK-së, si nga ata civil ashtu edhe nga ata të uniformuar.

1.2 Në rrugën e vet drejt bartjes së plotë të përgjegjësive policore nga policia civile e UNMIK-ut, SHPK-ja është ballafaquar me sfidën e financimit të aspekteve të krijuara kohëve të fundit dhe atyre ekzistuese të një organizate e cila është duke kaluar nëpër ndryshime. Siç është bërë e ditur nga inspektimet e mëparshme, kjo sfidë përfshinë detyrën e vështirë të alokimit të investimeve të mjaftueshme kapitale për përmirësimin e kushteve në stacione policore dhe qendra të ndalimit, përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë informative dhe komunikimit dhe programeve tjera të shtrenjta. Këto kërkesa duhet të financohen nga një burim i caktuar i të hyrave (me mundësi zvogëlimi) për disa vite të ardhshme. Këto çështje të ndërlikuara do të kërkojnë zgjuarsiri, kreativitet, dhe planifikim të vëmendshëm nga ana e menaxherëve të lartë të SHPK-së, duke punuar nën udhëheqjen aktive të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

1.3 Qëllimi i këtij inspektimi të zakonshëm është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me dispozitat përkatëse të Rregullores 2005/54, Politikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Doracakut të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante të *Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)*;
- Nxitjen e planifikimit të buxhetit dhe financave, në përkrahje të synimeve afatshkurta të SHPK-së;
- Nxitjen e planifikimit të buxhetit dhe financave, në përkrahje të synimeve afatmesme të SHPK-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Identifikimin dhe përhapjen e praktikave më të mira.

1.4 Gjatë rrjedhës së inspektimeve, Inspektorati policor vizitoi dhe intervistoi punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Zëvendës komisarit (Administratë)
- Komandantët regjional (ose zëvendës komandantët regjional)
- (Ushtruesi i detyrës) Drejtori i Drejtoratit të Financave dhe Buxhetit
- Udhëheqësi i zyrës për Buxhet, (U.d) Drejtori i Drejtoratit të Financave dhe Buxhetit në SHPK

1.5 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike i cili parim është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

2. KRYERJA E DETYRAVE NË MENAXHIMIN E BUXHETIT DHE FINANCE

Organizimi aktual

2.1 Duke vepruar nën autoritetin e zëvendës komisarit të SHPK-së (Administratë), Drejtorati për Buxhet dhe Financa, pjesë e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse (Shtabi qendror), është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aspekteve të Buxhetit dhe Financave të SHPK-së. Drejtorati është i ndarë në gjashtë funksione kryesore: zyra për buxhet, zyra për paga, zyra për kontabilitet, zyra për zyra për menaxhimin e pronës dhe asetëve, zyra për mbajtjen e parave të imta (petty cash) dhe zyra e të hyrave nga kompensimi i dëmeve në aksidente. Ekziston një zyrtar financiar në nivel regjional për mbajtjen e parave të imta (petty cash⁴⁰), nën udhëheqjen e zëvendës komandantit regjional (Administratë). Në përpjekjen për të pasqyruar praktikën më të mirë në shumë organizata policore të vendeve të BE-së, SHPK-ja me sukses ka arritur të zhvillojë një ekip ekspertësh të përbërë nga pjesëtarë civil (e jo policë) në fushën e menaxhmentit financiar. Pothuajse i tërë personeli i Drejtoratit janë shërbyes civil, me një përqindje të lartë të personelit të gjinisë femërore (42%) dhe të diplomuarve (78%). Megjithatë, drejtori aktual është vetëm në pozitë të 'ushtruesit të detyrës' për shkak të ngrirjes së procesit të rekrutimit të jashtëm të shërbyesve civil nga Ministria e Shërbimeve Publike. Inspektorati policor arsyeton dhe përsëritet përpjekjet e SHPK-së që Drejtorati të jetë i përbërë nga pjesëtarët civil dhe të krijojë ekipin prej ekspertëve financiar si shembull i praktikës më të mirë.

2.2 Ndonëse kompetencat për administrimin e buxhetit të SHPK-së dhe menaxhmentit financiar janë bartur nga Policia Civile e UNMIK-ut në tetor të vitit 2006, Komisari i Policisë së UNMIK-ut mbetet personi kompetent i fundit për vendimmarrjet buxhetore. Ngjashëm me fushat tjera të menaxhmentit në SHPK,

⁴⁰ 'Petty cash' është shuma e parave (aktualisht 2,500 €) për pagesa të vogla me para të gatshme.

ekzistojnë probleme shoqëruese në planifikimin e buxhetit të një organizate e cila është duke kaluar nëpër ndryshime të vazhdueshme në procesin e bartjes së përgjegjësi nga UNMIK-u. Për shembull, në vitin e kaluar, pjesëtarëve të SHPK-së u janë dhënë përgjegjësi të larta drejtuese për një numër aspektesh të kontrolluara më parë nga UNMIK-u. Kjo ka shkaktuar ndryshime në mëditje dhe paga (për gradime) dhe investime kapitale (rinovimin e zyrave, pajisjeve dhe automjeteve) në Shtabin Qendror të SHPK-së. Prandaj vërejtjet e Inspektoratit policor janë bërë duke marrë parasysh vështirësitë që pasojnë nga ndryshimet të cilat nuk mund të parashikohen saktësisht para fillimit të vitit fiskal.

2.3 Dy aspektet e qeverisjes financiare në SHPK, në ligjin e aplikueshëm ende nuk janë realizuar plotësisht në praktikë. Ligji I aplikueshëm kërkon që Ministria e Punëve të Brendshme të merr rolin udhëheqës në Buxhetin dhe Financat e SHPK-së dhe implikon nevojën për konsultime në mes komandantëve të policisë në nivel lokal. Aneksi XVI I Rregullores nr. 2005/53⁴¹ përmend se Ministria e Punëve të Brendshme, *inter alia* duhet të ‘ drejtojë çështjet financiare dhe buxhetore të Shërbimit Policor të Kosovës [...] në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave’. Që nga themelimi I saj në prill të vitit 2006, Ministria nuk ka qenë e angazhuar në mënyrë aktive në administrimin e buxhetit ose çështjeve financiare në SHPK. Roli I Ministrisë, I paraparë në ligjin e aplikueshëm duhet të përfshijë pjesëmarrjen aktive në planifikim të buxhetit për vitin vijues fiskal dhe zhvillimin e një strategjie buxhetore afatgjate e cila do të sigurojë që SHPK-ja është në gjendje të ofrojë shërbime në mënyrë më të leverdishme. Një rol I tillë duhet të përfshijë angazhimin në vendimet lidhur me investimet e mëdha kapitale në objektet e SHPK-së, parkun e automjeteve, infrastrukturë të teknologjisë informative dhe komunikim dhe në pajisje tjera.

2.4 Në bazë të nenit 7.13(b) të Rregullores 2005/54, çdo komandant stacioni I SHPK-së duhet të përgatisë “një plan lokal policor për vitin e ardhshëm për zonën e kontrolluar nga stacioni përkatës, përfshirë prioritetet për atë vit, *resurset njerëzore dhe financiare* në dispozicion dhe ndarjen e planifikuar të këtyre resurseve, së bashku me planin e punës të përcaktuar nga Shërbimi Policor I Kosovës si tërësi dhe në kuadër të stacionit”. Kjo pjesë e Rregullores ka të bëjë me përgjegjshmërinë policore dhe nevojën që SHPK-ja t’i përgjigjet të priturve të bashkësive lokale me anë të një plani policor të bazuar në konsultime në nivel lokal. Parimi qendror është I thjeshtë: (a) komandanti I stacionit duhet të konsultohet në mënyrë aktive me bashkësitë lokale dhe të njoftohet me problemet e tyre; (b) të përcaktojë synimet policore në nivel lokal si përgjigje në këto probleme; (c) të angazhojë resurset e nevojshme njerëzore dhe financiare për realizimin e këtyre synimeve; dhe (d) të zbatojë dhe monitorojë planin e krijuar për realizimin e synimeve.

2.5 Është e qartë se neni 7.13(b) fuqimisht kërkon që komandantët e stacioneve të jenë të angazhuar në mënyrë aktive në procesin e planifikimit të buxhetit të SHPK-

⁴¹ Ndryshimi I Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi degën e ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetqeverisëse në Kosovë

së në nivel lokal. Kjo duhet të kërkojë nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa që së paku të konsultohet me komandantët lokal të stacionit për nevojat e tyre për resurse në përkrahjen e planeve policore vjetore. Megjithatë, Inspektorati Policor vërejtë se shumica e komandantëve regjional u ankuan për mungesën e konsultimeve përkatëse dhe mos përfshirjen në vendimet buxhetore dhe financiare. Sipas këtyre zyrtarëve, konsultimet të cilat aktualisht ekzistojnë, janë të pakuptimta dhe vetëm të shkruara në letër pa ndonjë rezultat të dukshëm, në nivel lokal. Për këtë arsye Inspektorati policor nxitë SHPK–në që të implementojë plotësisht dispozitat e ligjit të aplikueshëm, që kanë të bëjnë me rolin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe atë të komandantëve të stacioneve. Në mënyrë specifike dhe në bashkëpunim me Ministrinë, Procedurat Standarde të Operimit duhet të përpilohen në atë mënyrë që të definojnë qartë procesin e planifikimit të buxhetit dhe çështjeve përkatëse dhe të përfshijnë konsultimet e duhura me komandantët regjional dhe komandantët e stacioneve.

Rekomandimi kryesor

Nr. 1

Inspektorati policor nxitë SHPK–në që të implementojë plotësisht dispozitat e ligjit të aplikueshëm që kanë të bëjnë me rolin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe atë të komandantëve të stacionit. Në mënyrë specifike dhe në bashkëpunim me Ministrinë, Procedurat Standarde të Operimit duhet të përpilohen në atë mënyrë që të definojnë qartë procesin e planifikimit të buxhetit dhe çështjeve përkatëse dhe të përfshijnë konsultimet e duhura me komandantët regjional dhe komandantët e stacioneve

Kryerja e detyrave

2.6 Tabela 1 ofron një analizë të shkurtë të buxhetit të aprovuar në SHPK për vitin 2005, 2006 dhe 2007. Meqenëse kjo ishte një periudhë e zhvillimit të shpejtë si përgjigje ndaj politikave të UNMIK–ut lidhur me bartjen e përgjegjësi, buxheti i alokuar shënoi rritje prej 6.1% në vitin 2006 dhe një rënie të ultë (0.3%) në vitin 2007. Në vitin 2005, buxheti i SHPK–së mori pjesë me 7.4% të shpenzimeve të përgjithshme të IPVQ–së. Siç është supozuar, mëditjet dhe pagat paraqesin përqindjen më të madhe të buxhetit, duke u rritur deri në gati 50% në vitin 2007. Investimet kapitale paraqesin pjesën e dytë më të madhe të buxhetit të SHPK–së, duke u rritur prej 12 milion € që ishin në vitin 2005 në 14 milion € në vitin 2007, për mbështetje të zhvillimit të ndërtesave dhe infrastrukturës së organizatës. Me arritjen e organizatës në pikën e tranzicionit të plotë dhe përfundimin e përpjekjeve të vazhdueshme të përmirësimit të infrastrukturës së vet, investimet kapitale duhet të zvogëlohen në mënyrë të konsiderueshme.

Tabela 1 – Analizë e buxhetit të ‘aprovuar’ të SHPK-së (2005 – 2007)

Kategoria	2005	%	2006	%	2007	%
Mëditjet dhe pagat	24,799,537	46.4	26,508,256	46.6	27,990,051	49.4
Mallrat dhe shërbimet	15,190,818	28.4	14,766,925	25.9	13,236,324	23.3
Shërbimet Komunale	1,058,400	1.9	1,000,000	1.7	1,150,000	2.0
Investimet kapitale	12,200,782	22.8	14,471,000	25.4	14,169,105	25.0
Subvencionet	100,000	0.1	100,000	0.1	100,000	0.1
Totali (+/-%)	53,349,537	-	56,846,181	+6.1%	56,645,475	-0.3%

2.7 Tabela 2 – 4 ofron një ndarje më të hollësishme të buxhetit (të aprovuar) të SHPK-së në vitin 2005, 2006 dhe 2007. Kategoritë kyçe të buxhetit për mëditje, mallra dhe shërbime dhe investimeve kapitale më tutje janë ndarë në tetë ‘programe’: menaxhim, operative, operative speciale, hetime, shërbime administrative, shërbime mbështetëse, trajnim dhe polici kufitare. Ndonëse ndarja e mëditjeve dha pagave nëpër programe është detajizuar në vitin 2005, për vitet pasuese nuk ekzistojnë fare informata përveç një shume të mbledhur pranë shërbimeve administrative. Sistemi I ‘programeve’ ofron pak informata të dobishme për komandantët regional, komandantët e stacionit ose pjesëtarëve të bashkësive lokale. Ai sistem nuk ofron informata për shpenzimet në Prishtinë, në krahasim me Mitrovicë apo Prizren. Gjithashtu, nuk ekzistojnë informata për alokimin e investimeve kapitale për zhvillimin e ndërtesave dhe infrastrukturës në çdo regjion. Shkurt, me anë të kësaj paraqitje të të dhënave financiare është e pamundur për Ministrinë, komandantët e stacionit dhe pjesëtarët e bashkësisë që të përshkruajnë lidhjen në mes synimeve policore lokale dhe alokimit të resurseve të SHPK-së.

2.8 Nëse vazhdohet me formën aktuale të shpenzimeve për investime kapitale do të ishte mjaft e dobishme nëse do të ofroheshin informata tjera për arsyetimin e alokimit të mjeteve financiare dhe lidhur me atë se çka është realizuar deri në fund të vitit. Përpos mjeteve financiare të konsiderueshme publike të zbatuara në Shkollën e SHPK-së Vushtrri/Vučitrn⁴², që nga viti 2005 gjithsejtë 1.4 milion Euro janë alokuar në Departamentin e trajnimeve të SHPK-së. Pavarësisht kërkesës, Inspektorati policor nuk ishte në gjendje të sigurojë informata të hollësishme për arsyen pse janë kërkuar investime kaq të mëdha kapitale për trajnim kur ky funksionin është

⁴² Duhet të përmendet se Shkolla e SHPK-së financohet nga Qendra e Kosovës për Siguri Publike , Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH), si institucion i pavarur nga SHPK-ja .

përkrahur nga njëra nga institucionet më të mira për arsimimin e të rriturve në Kosovë (d.m.th Shkolla e SHPK-së). Kjo anomali e qartë është veçanërisht e pazakonshme nëse shuma e investimeve kapitale në 'menaxhim' (gjatë periudhës tri vjeçare) krahasohet me atë të Departamentit të Trajnimit. Të parët pranuan gjithsejtë 834,100€ ose 571,000€ më pak se departamenti për trajnim dhe pavarësisht nevojës urgjente për investime në hapësirat e punës në shtabin e SHPK-së dhe shtabet regjionale. Inspektorati policor rekomandon që, si pjesë e raportit gjithëpërfshirës vjetor mbi aktivitetet e SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së duhet të ofrojnë informata të hollësishme lidhur me përdorimin e mjeteve financiare (fondeve). Në veçanti, kjo duhet të saktësojë shpenzimet e personelit në çdo regjion dhe çdo departament në Shtab si dhe çka është realizuar me anë të investimeve kapitale.

Tabela 2 – Analizë e buxhetit (të aprovuar) të SHPK-së për vitin 2005						
Programi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shërbimet komunale	Investimet kapitale	Subvencionet⁴³	Totali
Manaxhmenti	538,517	58,624	-	200,800	-	781,424
Operativa	19,375,506	1,657,704	-	780,020	-	2,437,724
Operativa speciale	782,793	336,130	-	1,792,000	-	2,128,130
Hetime	1,393,482	218,179	-	721,100	-	939,279
Shërbime administrative	893,827	926,294	-	158,573	100,000	1,184,867
Shërbimet mbështetëse	1,163,086	10,321,571	1,058,000	7,127,539	-	17,449,110
Departamenti i trajnimit ⁴⁴	574,602	705,412	-	421,000	-	1,126,412
Policia kufitare	77,724	444,904	-	999,750	-	1,444,654
Totali	24,799,537	15,190,818	1,058,400	12,200,782	100,000	53,349,537
Të korigjuara	25,650,952	17,998,542	-	16,348,801	350,000	59,190,656
Shpenzimet aktuale	25,186,057	14,027,306	-	15,572,337	237,796	55,023,496
Të pa shpenzuara	464,895	3,971,236	-	1,069,767	112,204	5,618,103

⁴³ Këto mjete financiare u janë shpërndarë për kompensim familjeve të zyrtarëve policor të cilët kanë humbur jetën në detyrë

⁴⁴ Vëni re se kostoja nën Departamentin e Trajnimeve nuk përfshin ato të Shkollës së Shërbimit Policor (QKSPEZH)

Inspektorati Policor rekomandon që, si pjesë e një raporti vjetor gjithëpërfshirës të aktiviteteve të SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së duhet të ofrojnë informata të hollësishme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve financiare. Veçanërisht, duhet të saktësoj pagesën e personelit në secilin regjion dhe në departamentet e Shtabit Qendror, si dhe atë se çfarë është arritur përmes investimeve kapitale.

Tabela 3 – Analizë e buxhetit (të aprovuar) të SHPK-së për vitin 2006

Programi	Paga dhe mëditje	Mallrat dhe shërbimet	Shërbimet komunale	Investimet kapitale	Familjet e policëve të vdekur	Totali
Manaxhmenti	-	136,387	-	623,000	-	759,387
Operativa	-	675,515	-	264,000	-	939,515
Operativa speciale	-	323,500	-	2,131,000	-	2,454,500
Hetimet	-	126,869	-	442,000	-	568,869
Shërbime administrative	26,508,256	423,842	-	95,000	100,000	27,127,098
Shërbimet mbështetëse	-	11,774,912	1,000,000	9,281,000	-	22,055,912
Departamenti i trajnimit	-	699,600	-	751,000	-	1,450,000
Policia kufitare	-	606,300	-	884,000	-	1,490,300
Totali	26,508,256	14,766,925	1,000,000	14,471,000	100,000	56,846,181
Të korrigjuara	27,428,596	16,910,885	-	13,176,181	172,470	57,688,134
Shpenzimet aktuale	27,164,819	14,082,358	-	9,494,702	89,881	50,831,762
Të pa shpenzuara	263,778	2,953,269	-	4,977,097	82,588	8,276,733

Politika dhe strategjia

2.9 Në kohën e inspektimit, Inspektorati Policor vërejti se në Drejtoratin e Buxhetit dhe Financave nuk ekziston asnjë dokument i shkruar lidhur me strategjinë apo politikat⁴⁵ ndërsa – sa i përket planifikimit – përqendrohet vetëm në përgatitjen e buxhetit vjetor, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Megjithëse, Inspektoratit Policor i është prezantuar një kopje e 'Planit Strategjik tre vjeçar: 2006 – 2009' (Administrata e SHPK-së, shkurt 2007)⁴⁶, është vërejtur se dokumenti përmban të dhëna mbi të kaluarën dhe nuk planifikon apo përshkruan objektivat për të ardhmen dhe mënyrën e përmbushjes së tyre.

2.10 Përderisa SHPK-ja vazhdon të rritet dhe zhvillohet, ekziston një nevojë e qartë për të siguruar një planifikim të përshtatshëm dhe më afatgjatë në fushën e financave dhe buxhetit. Kjo nevojë është veçanërisht e rëndësishme në klimën e tanishme ekonomike dhe parashikimet e zymta për rritjen e të ardhurave vjetore qeveritare në të ardhmen. Një numër I kërkesave të ndryshme dhe urgjente të SHPK-së duhet të përmbushen brenda një burimi të caktuar (dhe me mundësi zvogëlimi) të të hyrave⁴⁷. Ajo çfarë kërkohet është një strategji financiare e planifikuar me kujdes. Gjatë gjithë inspektimeve që nga korriku i vitit 2006, IPK-ja ka vërejtur mungesën e strategjive të shkruara në fusha të ndryshme të aktiviteteve të SHPK-së. Ndoshta më shumë alarmuese është mungesa e një strategjie të përbashkët financiare – p.sh. një strukturë e cila do të formalizonte objektivat dhe politikat e SHPK-së, si dhe do të formonte dhe drejtonte konceptin e organizatës.

⁴⁵ Është e rëndësishme të jetë e qartë se çka nënkupton IPK-ja me këto shprehje. Politika është një grup idesh që janë të formuluar si deklaratat lidhur me mënyrat se si SHPK-ja synon t'i drejtoj resurset e saj financiare në mbështetje të objektivave të organizatës. Politika e buxhetit dhe financave duhet bazohet në konsultime aktive me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe komandantët lokal dhe të tregojë qëllimet specifike të cilat zyrtarët e lartë përkatës mundohen t'i përmbushin gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ndërsa, strategjia është një plan i hollësishëm për përmbushjen e atyre qëllimeve të përcaktuara në dokumentin e politikave.

⁴⁶ Shih 'Planin strategjik tre vjeçar: 2006 – 2009', Shkurt 2007.

⁴⁷ Referohuni në 'Ndikimi I UNMIK-ut në ekonominë e Kosovës: Efektet shpenzuese 1999 – 2006 dhe pasojat e mundshme të zvogëlimit të numrit të personelit', UNMIK, Shtylla e Unionit Evropian, korrik, 2006.

Tabela 4 – Analizë e buxhetit (të aprovuar) të SHPK-së për vitin 2007

Programi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shërbimet komunale	Investimet kapitale	Familjet e policëve të vdekur	Totali
Manaxhmenti	-	148,318	-	10,300	-	158,618
Operativa	-	496,279	-	750,000	-	1,246,279
Operativa speciale	-	392,903	-	2,304,402	-	2,697,305
Hetime	-	329,569	-	1,060,000	-	1,389,569
Shërbime administrative	27,990,051	225,644	-	50,500	100,000	28,366,195
Shërbimet mbështetëse	-	10,946,951	1,150,000	9,240,900	-	21,337,851
Departamenti i trajnimit	-	456,772	-	233,900	-	690,672
Policia kufitare	-	239,888	-	519,102	-	758,990
Totali	27,990,051	13,236,324	1,150,000	14,169,105	100,000	56,645,475

2.11 Mungesa e një strategjie të tillë në një organizatë të madhe policore mund të rezultojë që menaxherët të punojnë me qëllime të ndryshme dhe në situata në të cilat qëllimet e zyrtarëve të lartë mund të mos komunikohen qartë te personeli me gradë më të ulët në hierarki, prej të cilëve pritet që t'i vënë në zbatim këto qëllime. Pa një strategji të qartë ndryshimi ndodh vetëm përmes vlerësimit subjektiv apo intuitiv, dhe është e vështirë të ndryshohet sjellja e vjetër. Natyrisht krijimi i një strategjie të re kërkon përpjekje, imagjinatë dhe kreativitet. Kjo fillon me procesin e konsultimeve që përfshin Ministrinë e Punëve të Brendshme (siç kërkohet në Rregulloren 2005/53) dhe të gjithë anëtarët e ekipit udhëheqës të zyrtarëve të lartë të SHPK-së, dhe bazohet në pyetje të caktuara kyçe:

- Si duhet të duket SHPK-ja brenda tri viteve ? (p.sh. vizion të përbashkët)
- Cilat janë objektivat e rëndësishme të SHPK-së gjatë tri viteve të ardhshme në secilin regjion/departament që do të lejonin përmbushjen e vizionit të përbashkët?
- Çfarë resurse/aktivitete mbështetëse do të kërkohen për të arritur këto objektiva në secilin regjion/departament?
- Sa do të kushtojnë këto resurse/aktivitete mbështetëse?

- e) Cilat janë të hyrat e planifikuara të SHPK-së gjatë 1–3 vitet e ardhshme?
- f) Çfarë kriteri duhet të shfrytëzohet për të klasifikuar apo kategorizuar objektivat?
- g) Nëse kërkohet, aty ku mund të bëhen kursime me qëllim të financimit të zonave me prioritet më të lartë?


2.12 Prandaj, procesi fillon me një version të miratuar se si organizata do të duket në vitin 2009. Për shembull, mund të thuhet që SHPK-ja do të ketë 'X' numër të stacioneve policore plotësisht të rinovuara (apo të reja) dhe të pajisura, një sistem kompjuterik të integruar për 'komandë dhe kontroll' i cili regjistron incidentet dhe personelin policor në dispozicion. Përveç objektivave të investimeve kapitale, plani strategjik do t'i referohet qëllimeve të punës që kanë implikime financiare; psh. përzgjedhja, trajnimi dhe shpërndarja e 'X' numrit të policëve gjyqësor, të cilët janë në gjendje të kryejnë teknika të vëzhgimit të fshehtë dhe të gjejnë kriminelët e organizuar dhe zyrtarët qeveritar të korruptuar. Natyrisht mund të mos jetë e mundur që të financohet secili aspekt i versionit të miratuar gjatë një periudhe 3 vjeçare. Kjo do të kërkojë një proces të priorizimit të objektivave të ndryshme sipas versionit të përbashkët dhe sigurimin se mjetet financiare shfrytëzohen për qëllime më të rëndësishme.

2.13 Sistemi I përshkruar më lartë është sistem i cili karakterizohet me transparencë. Vendim marrja nuk është e përqendruar vetëm në një apo dy individ por në një grup më të madh që përfshinë edhe Ministrinë dhe komandantët e SHPK-së në nivel lokale. Kjo rezulton në një dokument publik që i lejon tatimpaguesit të shohin se si janë duke u shpenzuar të hollat publike dhe çfarë rezultatesh janë duke u arritur. Më e rëndësishmja, qasja e propozuar paraqet lidhje të qarta dhe evidente në mes synimeve specifike organizative dhe atyre të punës, si dhe alokimit të resurseve financiare të nevojshme për realizimin e këtyre objektivave. Inspektorati Policor rekomandon që ekipi udhëheqës i zyrtarëve të lartë të SHPK-së – në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme – duhet të krijojë një sistem të planifikimit strategjik afatmesëm. Ky sistem duhet të përpiqet të identifikojë një vizion të përbashkët të miratuar, synime specifike organizative dhe ato të punës të nevojshme për realizimin e atij vizioni, si dhe alokimin e planifikuar të resurseve financiare për realizimin e objektivave.

Rekomandimi kryesor

Nr. 3

Inspektorati Policor rekomandon që ekipi udhëheqës i zyrtarëve të lartë të SHPK-së – në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme – duhet të krijojë një sistem të planifikimit strategjik afatmesëm. Ky sistem duhet të përpiqet të identifikojë një vizion të përbashkët të miratuar, synime specifike organizative dhe ato të punës të nevojshme për realizimin e atij vizioni, si dhe alokimin e planifikuar të resurseve financiare për realizimin e objektivave



Raport i përkohshëm i inspektimit 4

Menaxhimi i zhvillimit të karrierës në SHPK

MENAXHIMI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS NË SHPK

1. HYRJE

1.1 Inspektimi *i katërt i zakonshëm* i SHPK-së është bërë prej datës 22 maj deri më 26 qershor, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqëndrua vetëm në menaxhimin e zhvillimit të karrierës së zyrtarëve policor dhe është ndërmarrë nga Z. Enver Rrustemi, kryeshef ekzekutiv i Inspektuarit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 18 inspektorëve. Vizitat u bënë në Departamentin e Shërbimeve Administrative, Shtabin e SHPK-së, dhe në të gjitha shtabet regjionale. Zyrtarët e Inspektoratit Policor edhe kësaj rradhe u ndanë të kënaqur me bashkëpunimin e plotë të personelit të SHPK-së dhe gatishmërinë e tyre për të ndihmuar.

1.2 Ekziston një fjalë e urtë që thotë se një organizatë është aq e mirë sa janë të mirë njerëzit që punojnë në të. Kjo mund të vlejë për organizatat e sektorit publik dhe privat. Qoftë fjala për prodhimin e automobilave, drejtimin e një vije ajrore ose ofrimin e shërbimeve policore, cilësia e produkteve apo shërbimeve matet me angazhimin e resurseve njerëzore. Nevoja për një personel të aftësuar, motivuar dhe dinamik ekziston në të gjitha nivelet dhe aspektet e një organizate të suksesshme. Vetëm me anë të një sistemi të efektiv të zhvillimit të karrierës, organizatat e mëdha si SHPK-ja, mund të sigurojnë se kanë njerëzit e duhur në pozitat e duhura.

1.3 Me sa duket, testi më i madh i sistemit të zhvillimit të karrierës në një organizatë të re është ai i identifikimit të atyre zyrtarëve policor të cilët kanë potencial për të qenë udhëheqës (lider) dhe për t'i pajisur ata me mjetet për marrjen e roleve udhëheqëse. Shprehjet 'lider' and 'menaxher' nuk janë të njëjta; poashtu, fakti që një person posedon një gradë të lartë (zyrtar i SHPK-së) nuk do të thotë që në mënyrë magjike do të jetë i pajisur me cilësitë e një lideri të vërtetë. Udhëheqësia në këtë rast përdoret për të përmendur një grumbull shkathtësish dhe cilësish personale që i mundësojnë një zyrtari të lartë që të krijojë një vizion për të ardhmen e pastaj për të drejtuar personelin policor drejt realizimit të atij vizioni. Në këtë mënyrë, udhëheqësia krijon ndjenjën e energjisë dhe shqetësimit me anë të së cilave dëshiron të arrijë atë vizion dhe si pjesë të tij, mundësitë personale. Udhëheqësia motivon, i jep energji dhe shtyen përpara organizatën. Është i njohur fakti se udhëheqësia nuk funksionon e vetme. Përderisa udhëheqësia duhet të jetë e shoqëruar nga një strategji e qartë dhe një sistem menaxhmenti i cili mund të kanalizojë energjinë dhe përkushtimin e personelit drejt arritjes së rezultateve, mungesa e një numri të mjaftueshëm të udhëheqësve të fuqishëm në SHPK do të zvogëlojë mundësinë për t'u zhvilluar në një organizatë të fuqishme dhe të aftë.

1.4 Qëllimi i këtij inspektimi të zakonshëm është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore lidhur me zhvillimin e karrierës në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me dispozitat përkatëse të Rregullores 2005/54, dhe Doracakut të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së
- Pajtueshmërinë me standardet relevante të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP);
- Nxitjen e planifikimit për zhvillimin e karrierës, në përkrahje të synimeve afatgjata të SHPK-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Identifikimin dhe përhapjen e praktikave më të mira identify and spread best practice.

1.5 Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorati Policor intervistojë gjithsejtë 947 zyrtarë policor, rreth 13.1% të numrit të përgjithshëm të zyrtarëve të SHPK-së (shih tabelën.1). Pjesa më e madhe e policëve të intervistuar ishin në gradën e rreshterit ose më lartë –914) dhe përfaqësonin 74.4% të të gjithë policëve në pozita menaxheriale apo mbikëqyrëse. Në këtë mënyrë Inspektorati Policor mund të deklarojë për një masë të madhe të objektivitetit në mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit të zhvillimit të karrierës. Duhet të përmendet se në grupin e policëve të intervistuar ishte e përfshirë vetëm njëra nga gradat më të larta (grada e gjeneral nën-kolonelit dhe gjeneral majorit).

Tabela 1

Analizë e policëve të intervistuar të SHPK-së nga IPK-ja

Regjioni	Gjeneral major	Kolonel	Nën kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	zyrtar Policor	Gjithsejtë
Shtabi	1	8	14	15	29	62	94	9	232
Prishtinë		1	2	2	8	33	65		111
Prizren		1	3	3	10	17	94	4	132
Pejë		1	2	2	6	36	91	4	142
Gjilan		1	2	2	10	26	79	8	128
Mitrovicë		2		3	8	28	64	5	110
Ferizaj		1	1	3	7	33	44	3	92
TOTALI	1	15	24	30	78	235	531	33	947

1.6 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike i cili parim është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

2. PERFORMANCA E MENAXHMENTIT PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS

Mendimet e të anketuarve të SHPK-së

2.1 Si pjesë e këtij inspektimi, Inspektorati Policor bëri një anketë në mesin e 947 policëve (shih tabelën 1). Nga çdo polic është kërkuar që të përmendin ato që ata mendojnë se janë anë pozitive apo negative të sistemit aktual të gradimit, si dhe aspektet të cilat do të përfitonin nga ndryshimet. Tabela 2 ofron një përmbledhje të përgjigjeve më të shpeshta në këtë grup të ndryshëm të policëve. Duhet të përmendet se policët ishin të inkurajuar të përmendin më shumë se një faktor nën secilën kolonë (anët pozitive, dobësitë/anët negative dhe ndryshimet e dëshiruara) dhe në asnjë mënyrë nuk ishin të nxitur nga zyrtarët e Inspektoratit Policor. Rezultatet në tabelën 2 janë mjaft të rëndësishme për vlerësimin e plotë të sistemit aktual të gradimit: ato tregojnë perceptimet e shumicës së pjesëtarëve të SHPK-së në gradën e rreshterit dhe më lartë.

2.2 Katër anë pozitive ishin identifikuar vazhdimisht nga 30% e grupit mostër: mënyra sipas së cilës sistemi ofroi mundësi të barabarta; mënyra sipas së cilës sistemi mund të reagojë shpejt në plotësimin e vendeve të lira të punës, dhe përdorimi i testeve me shkrim dhe intervistave gojore si mjete përzgjedhëse. Ndonëse kishte më pak konsensus në mesin e policëve të intervistuar për dobësitë aktuale, dy aspekte ishin të rëndësishme së njëjti për zyrtarët e SHPK-së. Rreth 32% të tyre mendojnë se sistemi aktual nuk vë theks të mjaftueshëm për arritjet në arsimim dhe 23 % besojnë se sistemi aktual nuk merr parasysh përvojën dhe rezultatet në punë. Këta faktorë janë përmendur edhe më shumë në përgjigjet më të shpeshta në pyetjen se si duhet të përmirësohet sistemi i gradimit. Mbi 39% – përgjigja më e shpeshtë në tërë analizën (anketën), menduan se sistemi i gradimit duhet të vë më shumë theks në përvojën dhe rezultatet në punë dhe gati 37.5% theksuan se duhet të mirren më shumë parasysh arritjet akademike.

Tabela 2

Perceptimet e zyrtarëve të SHPK-së për sistemin ekzistues të gradimit në SHPK (qershor 2007)

Anët pozitive	Përgjigjet		Anët negative	Përgjigjet		Ndryshimet e dëshiruara	Përgjigjet	
	Nr.	%		Nr.	%		Nr.	%
Mundësi të barabarta për gradim	306	32.3	Mungesë theksi në arritjet arsimore	307	32.4	Më shumë theks në përvojën dhe rezultatet në punë	372	39.2
Aftësia për t'iu përgjigjur nevojave urgjente në strukturën hierarkike	288	30.4	Mungesë theksi më përvojë dhe rezultatet në punë	219	23.1	Më shumë theks në arritjet arsimore	355	37.4
Testi me shkrim	286	30.2	Mungesë transparence	173	18.2	të jetë një sistem më transparent	207	21.8
Intervista me gojë	240	25.3	Bordi përzgjedhës subjektiv	94	10	Bordi përzgjedhës të jetë më objektiv	182	19.2

2.3 Deri në një masë të caktuar mund të themi se pikëpamjet e shprehura janë mendimet e fituesve dhe të humbësve në sistemin e gradimit. Për shembull, ndonëse një numër i konsiderueshëm i grupit mostër (25.3%) beson se intervista e përzgjedhjes ishte anë pozitive e sistemit, 10% e tyre beson se bordet përzgjedhëse janë shumë subjektive dhe 19.2% theksuan se këto borde duhet të jenë më objektive. Sidoqoftë, shkalla e konsensusit lidhur me nevojën për të marrë parasysh përvojën në punë, përgatitjet shkollore dhe rezultatet në punë është e atillë që kërkon kujdes më të madh.

2.4 Si pjesë e anketës së njëjtë, Inspektorati Policor kërkoi nga të gjithë pjesëtarët e këtij grupi mostër që të tregojnë nivelin e kënaqshmërisë me sistemin aktual të gradimit, prej 1 deri në 5 (duke treguar me 1 për 'shumë pakënaqshëm dhe me 5 'shumë kënaqshëm'). Rezultatet e paraqitura në tabelën 3, tregojnë një mostër të ngjashme përgjigjesh në tërë organizatën. Shumica e policëve u shprehën kënaqshëm (2.9) me sistemin aktual dhe nuk kishte pikëpamje të polarizuara-për ose kundër sistemit të promovimit. Natyrisht këto përgjigje duhet të jenë të lidhura me të kaluarën jo të rëndomtë të SHPK-së. Siç do të diskutohet, shumica e policëve në grupin mostër kanë qenë përfitues të një periudhe unike të gradimit të shpejtë. Asnjë organizatë tjetër policore në Evropë nuk ka dëshmuar një lëvizje të tillë nëpër grada gjatë një periudhe relativisht të shkurtë kohore.

Tabela 3

Niveli i kënaqësisë në mesin e zyrtarëve të SHPK-së me sistemin e aktual të përzgjedhjes
Notat 1 - 5 (1 = 'shumë jokënaqshëm' dhe 5 = 'shumë kënaqshëm')

Regjioni	Niveli i kënaqësisë
Shtabi Qendror	3.3
Prishtinë	2.7
Prizren	2.9
Pejë	3.0
Gjilan	2.5
Mitrovicë	2.9
Ferizaj	3.0
Mesatarja e përgjithshme	2.9

Historia e gradimeve të SHPK-së

2.5 Procesi i transferimit të kompetencave policore nga policia civile e UNMIK-ut te SHPK-ja ka filluar në nëntor të vitit 2002, tri vjet pas diplomimit të grupit të parë të pjesëtarëve të SHPK-së në shkollën e SHPK-së në Vushtrri. Stacioni Policor në Graçanicë dhe regjioni i Prishtinës ishin stacionet e para policore që u transferuan nga policia e UNMIK-ut te komanda e SHPK-së. Pas kësaj, tranzicioni i stacioneve policore në përgjithësi ishte i ngadalshëm deri në ngjarjet e dhunshme të marsit 2004. Nga këtu e më tutje kanë ekzistuar dëshmi të përpjekjes së përbashkët që në mënyrë të shpejtë në grada të larta të promovohen zyrtarë të SHPK-së, të bëhet transferimi i stacioneve policore në komandë të SHPK-së dhe zhvillimi i një strukturë organizative. Në gusht të vitit 2004 ishin më shumë se 6000 zyrtarë të SHPK-së, përfshirë 410 rreshter, 100 toger, 22 kapiten, nëntë major, nëntë nënkolonel dhe një kolonel (Deklaratë për shtyp e UNMIK-ut: Gusht 2004). Në mars të vitit 2005 UNMIK-u ishte në gjendje të shpall që 31 nga 33-i stacionet policore në tërë Kosovën dhe dy komanda regjionale (Prizren dhe Gjilan) ishin transferuar tek SHPK-ja. 20 stacione policore janë transferuar brenda një periudhe kohore prej vetëm tetë muajsh.

2.6 Tabela 4 dhe 5 ofron dëshmi të qarta për ngritjen e shpejtë në grada të disa zyrtarëve të caktuar gjatë periudhës së tranzicionit. Siç është treguar në tabelën 4, një grup prej 16 zyrtarëve të lartë policor kanë qenë subjekt të vendimeve për t'i lejuar ata të kapërcejnë një apo më shumë grada.

Në gjashtë raste zyrtarët policor kanë kapërcyer katër grada, që është e njëjtë sikurse kalimi nga grada e rreshterit në gradën e kolonelit me një lëvizje të vetme.

Tabela 5 tregon se një grup prej 147 policëve në gradën e rreshterit apo më lartë (gati 12%) janë graduar në dy apo më shumë grada në një periudhë kohore prej vetëm dymbëdhjetë muajsh ose më pak. Ndonëse vendimi për përshejtimin e tranzicionit pas marsit të vitit 2004 ishte i mirëseardhur pas një periudhe fillestare të ngadalshëm të transferimi të përgjegjësive te SHPK–ja, ritmi i shpejtë i gradimeve në mes të zyrtarëve të caktuar të SHPK–së ka mundësi të krijoj probleme në këtë organizatë të re.

Tabela 4

Numri i rasteve në të cilat zyrtarët e SHPK–së kanë kapërcyer disa grada (që do të thotë kalimi në një gradë më të lartë duke shmangur një apo më shumë grada)⁴⁸

Numri i gradave të kapërcyera	1	2	3	4	5
Numri i rasteve	3	3	3	6	1

Tabela 5

Numri i zyrtarëve të SHPK–së të cilët janë graduar në dy apo më shumë grada brenda një periudhe kohore prej 12 muaj apo më pak⁴⁹

Region	Two ranks in 12 months (Number of cases)	Three ranks in 12 months (Number of cases)
Regjioni	Dy grada për 12 muaj (Numri i rasteve)	Tri grada për 12 muaj (Numri i rasteve)
Shtabi Qendror	69	17
Prishtinë	12	1
Mitrovicë	8	5
Gjilan	18	1
Pejë	25	0
Ferizaj	2	0
Prizren	10	4
Totali	119	28

⁴⁸ Këto statistika janë marrë nga Departamenti I Personelit , Shtabi I SHPK–së (Qershor, 2007)

⁴⁹ Këto statistika janë marrë nga Departamenti I Personelit , Shtabi I SHPK–së (Qershor, 2007)

2.7 Problemi më evident dhe më i drejtpërdrejtë qëndron në faktin se zyrtarët policor të cilët janë graduar në mënyrë të shpejtë nuk janë në gjendje të demonstrojnë se ata kanë arritur gradë të lartë përmes përvojës së dëshmuar dhe konkurrencës së drejtë. Kjo paraqet një problem si për individët poashtu edhe për organizatën. Një polic i cili ka kaluar në mënyrë të shpejtë përmes disa gradave – apo ka kapërcyer një numër të gradave – brenda një periudhe të shkurtë kohore, është ballafaquar me çështjen e rëndësishme të kredibilitetit në mesin e kolegëve të cilët janë graduar apo do të gradohen sipas 'sistemit normal'. Për organizatën do të paraqiten rreziqe të konsiderueshme nëse në radhët e saj angazhon liderë të cilët nuk kanë demonstruar aftësi të lidërshiptit përmes të disa formave të vlerësimit objektiv. Mund të thuhet se disa nga pjesëtarët e graduar shpejt, kanë pasur si përparësi përvojën si zyrtarë të lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) në ish RF të Jugosllavisë. Inspektorati Policor e vëren rëndësinë e pranisë së zyrtarëve me përvojë paraprake në grada të larta, në veçanti kur ndërmarrin detyra të vështira dhe të komplikuara në ndërtimin e një organizate të re policore. Megjithatë, vlera e një përvoje të tillë do të ishte më lehtë e pranuar nëse zyrtarët përkatës do të kishin marrë gradat e SHPK-së përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues

2.8 Në një botë të përkryer procesi i transferimit të kompetencave për kryerje të detyrave policore në Kosovë do të duhej të udhëheqej nga nevoja për të zhvilluar aftësitë organizative të SHPK-së. Një qasje e tillë do të kishte rezultuar në një proces në të cilin struktura e gradave dhe ajo organizative do të ishin zhvilluar në mënyrë të shkallëzuar dhe të harmonizuar. Në këtë mënyrë, transferimi i kompetencave do të varej nga aftësitë e vërtetuara, bazuar në vlerësimin e secilit nivel të ri të strukturës së re organizative dhe performancës së dëshmuar të liderëve të saj në nivelet pasuese. Gradimi do të duhej të ishte bërë në mënyrë të shkallëzuar, në hap me zhvillimin e organizatës dhe i bazuar në një qëllim, procesin transparent dhe konkurrues të përzgjedhjes. Në këtë mënyrë, gradimi do të kishte qenë i lidhur me nivelet pasuese të përgjegjësive dhe përvojës së transferuar. Arsyet e përvetësimit të qasjes alternative të transferimit të kompetencave të SHPK-ja në mes viteve 1999 dhe 2006, nuk janë të njohura për Inspektoratin Policor. Ajo që dihet është që Ministria e Punëve të Brendshme do të bëhet faktor udhëheqës për të zhvilluar një strategji të ardhme për zhvillimin e karrierës në SHPK. Hapi i parë në zhvillimin e një strategjie të tillë afatgjatë përfshinë vlerësimin e anëve pozitive dhe atyre negative të sistemit të tanishëm

Sistemi i tanishëm i zhvillimit të karrierës

2.9 Në kohën e kryerjes së këtij inspektimi, Inspektorati Policor ka vërejtur që komisarit mban autoritetin për emërime ndërsa ndihmëszëvendës komisarit për administratë ia ka transferuar përgjegjësinë për emërime të të gjitha gradave përveç të atyre më të larta. Nën autoritetin e këtij të fundit, Departamenti i Personelit është përgjegjës për procesin e gradimit në secilin nivel (apo gradë) ndryshe nga gradat më të larta. Përzgjedhja dhe emërimi i kandidatëve në gradën e zëvendës komisarit dhe ndihmëszëvendës komisarit aktualisht kryhen në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54.

2.10 Komisioni për emërimet të larta policore dhe disiplinë (KELPD) është përgjegjës për intervistat përzgjedhëse për gradat më të larta të SHPK-së. Sipas nenit 5 të Rregullores 2005/54 KELPD-ja do të mbledhet vetëm nëse është e nevojshme për kryerjen e seancave dëgjimore disiplinore apo intervista përzgjedhëse për emërimet të larta në SHPK. Të gjithë sekretarët e përhershëm të ministrisë kanë të drejtë të marrin pjesë në KELPD, si dhe personat e caktuar nga kuvendi komunal. Është e qartë se jo të gjithë personat janë të angazhuar në një mbledhje të komisionit; është e nevojshme që vetëm pesë persona të jenë të pranishëm në KELPD për kryerjen e detyrave, qofshin ato dëgjime disiplinore apo çështje që kanë të bëjnë me emërimet. Për qëllime të këtyre funksioneve KELPD-ja do të mbledhet në formë të panelit, i cili duhet të përbëhet nga kryesuesi, zëvendëskryesuesi, dy sekretarë të përhershëm dhe tre përfaqësues të kuvendeve komunale. Në mars të vitit 2006 KELPD-ja është mbledhur për herë të parë dhe ka kryer procesin e përzgjedhjes që rezultoi me emërimin e zëvendës komisarit të tanishëm të SHPK-së dhe katër ndihmëszëvendës komisarëve. Draft ligji më i fundit i kuvendit për inspektoratin Policor të Kosovës – është në pritje të miratimit nga Ministri i Punëve të Brendshme – ky draft ligj përmban dispozita në lidhje me KELPD –në të cilat do të vazhdojnë të përkrahin këtë qasje për emërimet të larta.

2.11 Neni 6.2 I Rregullores së UNMIK–ut 2005/54 thotë ‘Kandidat për emërim në postin e zëvendëskomisarit të SHPK-së, të ndihmëszëvendësit të komisarit të policisë ose të komandantit regjional nuk mund të përzgjidhet asnjë person i cili nuk i plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) Të ketë diplomë universitare ose shkallë të barasvlerëshme arsimore profesionale të cilën e ka fituar në ndonjë institucion të pranuar arsimor të policisë në Kosovë apo jashtë Kosovës,
- (b) Të ketë përvojë të gjatë në punët policore,
- (c) Të ketë shërbyer në post dy grada më të ulëta se ai për të cilin është zgjedhur për emërim, qoftë ai post i vërtetë apo si ushtrues detyre në atë post,
- (d) Të mos jetë shpallur fajtor për ndonjë vepër penale apo shkelje të rëndë disiplinore,
- (e) Të ketë dosje shembullore të shërbimit dhe
- (f) Të ketë demonstruar cilësi shembullore udhëheqëse.

2.12 Prandaj, ligji vë theksin në aftësitë kognitive, të demonstruara përmes posedimit të diplomës universitare (apo ekuivalente), si kusht paraprak për udhëheqës policor në nivelin më të lartë. Kjo është në përputhje me konkluzionet e inspektimit të Inspektoratit Policor sipas të cilit një numër i konsiderueshëm i policëve besojnë se sistemi i gradimit duhet t’i jap rëndësi më të madhe të arriturave arsimore. Në të vërtetë shumë teori të lidhshme tregojnë se aftësia kognitive është tipar themelor i karakterit të liderëve të suksesshëm. Tabela 6 ofron një përmbledhje të kualifikimeve arsimore të tanishme të pjesëtarëve të SHPK-së. Siç mund të shihet përqindja e pjestarëve të SHPK-së të cilët posedojnë diploma universitare nga grada e mesme deri në ato të larta është relativisht e ultë.

Tabela 6

Përmbledhje e kualifikimeve arsimore të pjesëtarëve të SHPK-së sipas gradës

Grada	Niveli I arritjeve arsimore						Totali
	Fakultet	%	Shkolla e lartë	%	Shkolla e mesme	%	
Kolonel	8	50	3	18.7	5	31.2	16
Nënkolonel	8	29.6	3	11	16	59.2	27
Major	11	35.4	7	22.5	13	42	31
Kapiten	17	18.4	13	14.1	62	67.3	92
Toger	50	16.1	36	11.6	223	72,1	309
Rreshter	120	13.8	75	8.6	674	77.5	869
Policë patrulle	285	4.8	259	4.3	5352	90.7	5896
TOTALI	499	6.8	396	5.4	6345	87.6	7240

Rekomandimi kryesor Nr. 1

Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti I Personelit duhet në mënyrë aktive të inkurajojë zyrtarët policor, veçanërisht ata në pozita udhëheqëse që të angazhohen në kurse universitare. Kjo iniciativë duhet të përfshijë përpjekjet për të inkurajuar Universitetin e Prishtinës si dhe universitetet tjera private (të licensuara) të ofrojnë kurse të avancuara studimi në lëndët lidhur me policinë.

2.13 Paragrafi 22 i Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP) thotë, procesi i përzgjedhjes së personelit policor në çdo nivel duhet të bëhet “mbi bazën e kualifikimit dhe përvojës personale, e cila duhet të jetë në përputhje me objektivat e policisë.” Me fjalë të tjera procesi i përzgjedhjes duhet të përqendrohet në identifikimin e kandidatëve më të mirë të mundshëm, sa i përket kualifikimeve dhe përvojës që ka të bëjë me pjesën qendrore të punës së policisë. Organizatat policore përvetësojnë qasje të ndryshme sa i përket detyrës së rëndësishme për identifikimin e kandidatëve më të mirë për grada dhe funksione të specialistëve. Ekzaminimet kognitive, qendrat e vlerësimit, vlerësimet e personelit, kurset para përzgjedhjes dhe intervistat e strukturuar janë mekanizmat të cilët shfrytëzohen më së shpeshti, qoftë vetëm apo në kombinime të ndryshme.

2.14 Tabela 7 ofron një përmbledhje të procesit të përzgjedhjes së zyrtarëve të SHPK-së për secilën gradë, siç është vendosur në tetor të vitit 2006. Duhet të vërehet

se e vetmja pjesë e sistemit aktual që është e rregulluar me ligj është emërimi për gradat më të larta (si zëvendës komisar i SHPK-së apo gradën e gjeneral nëkolonelit dhe gjeneral majorit apo ndihmëzëvendës komisarit), sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/54. Të gjitha gradat e tjera janë të rregulluara në bazë të dispozitave të cilat gjenden në Manualin e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, për shkak se gradat më poshtë se ato më të larta nuk rregullohen me Rregulloren 2005/54. Inspektorati Policor është në dijeni që Ministria e Punëve të Brendshme aktualisht është duke zhvilluar një draft ligj të kuvendit për SHPK-në dhe kjo duhet të përmbajë dispozita të hollësishme lidhur me kriterin e përzgjedhjes për të gjitha gradat e SHPK-së.

Rekomandimi kryesor

Nr. 2

Inspektorati Policor rekomandon që draft ligji I kuvendit për SHPK-në duhet të përmbajë dispozita të hollësishme lidhur me kriterin e përzgjedhjes për të gjitha gradat e SHPK-së, si dhe udhëzime lidhur me metodat e vlerësimit që shfrytëzohen për identifikimin e kandidatëve më të mirë.

2.15 Tabela 7 nxjerr në pah disa anomali të dukshme në sistemin ekzistues të përzgjedhjes së policëve. Më e rëndësishmja është mënyra e përpjekjeve të përbashkëta për verifikimin e përshtatshmërisë në tri gradat e para të mbikëqyrjes dhe menaxhimit nuk vazhdon të aplikohet në pesë gradat tjera më të larta. Zyrtarët policor të cilët dëshirojnë të gradohen në gradën e rreshterit, togerit dhe kapitenit duhet që së pari të arrijnë notën minimale në provim e përbërë nga pyetjet me shumë përgjigje dhe pastaj të marrin pëlqimin e panelit për intervista përzgjedhëse. Kandidatët për gradën e majorit duhet të bëjnë një prezantim formal në menaxhimin e një incidenti kritik, prezantim I cili vlerësohet nga paneli. Mirëpo, për zyrtarët policor të cilët duan të gradohen në gradën e nënkolonelit dhe më lartë nevojitet vetëm të kalojnë një intervistë përzgjedhëse. Nuk është e qartë për Inspektoratin Policor se si një vlerësim aq I kufizuar është në gjendje të identifikoj kandidatët më të mirë të mundshëm për pozitat më të larta. Për shembull, duket më se e qartë që një polic i cili ka treguar rezultate mesatare të punës në gradën e majorit mund të kalojë mirë në intervistë dhe të marrë gradën tjetër, përderisa një polic tjetër I cili ka një dosje të shkëlqyeshme në gradën e majorit ka një prezantim të dobët në intervistë dhe nuk gradohet. Është një këndvështrim i prerë i Inspektoratit Policor që sistemi i gradimit kërkon një rishikim urgjent për sa I përket aftësive për identifikimin e kandidatëve më të mirë të mundshëm në secilën gradë. Ky rishikim duhet të marrë parasysh shfrytëzimin e mekanizmave shtesë, si rishikimin e kryerjes së punës nga ana e presonelit, qendrat e vlerësimit dhe programet trajnuese për zyrtarë të lartë, programe të cilat përqendrohen në verifikimin e shkathtësive të lidërshiptit para gradimit. Secila nga këto fusha do të ekzaminohet më për së afërmi.

Tabela 7

Sistemi i përzgjedhjes për secilën gradë të SHPK-së (qershor 2007)

Grada	Provimi përzgjedhës	Intervista	Komisioni për emërimet të larta policore dhe disiplinë (KELPD)
Rreshter	Provimi prej 150 pyetjeve me shumë përgjigje të mundshme. Përfshinë Doracakun e Parimeve dhe Procedurave, Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Penal si dhe aspektet tjera të ligjit të aplikueshëm.	Përfshinë fushat e shkathësive thelbësore, si komunikimin, lidërshpin, marrjen e vendimeve, njohuritë/përvojën profesionale, motivimin dhe vlerësimin.	Nuk aplikohet
Toger	Provimi prej 150-të pyetjeve me shumë përgjigje të mundshme. Përfshinë Doracakun e Parimeve dhe Procedurave, kodin e procedurës penale dhe kodin penal si dhe aspektet tjera të ligjit të aplikueshëm.	Përfshinë fushat e shkathësive thelbësore, si komunikimin, lidërshpin, marrjen e vendimeve, njohuritë/përvojën profesionale, motivimin dhe vlerësimin. Gjithashtu punën grupore, mundësitë e barabarta, shumëllojshmërinë kulturore, vetëdijësimin mbi bashkësitë, menaxhimi i kohës, plani operativ dhe kreativitetin.	Nuk aplikohet
Kapiten	Provimi prej 150-të pyetjeve me shumë përgjigje të mundshme. Përfshinë Doracakun e Parimeve dhe Procedurës Penale dhe Kodin Penal si dhe aspekte tjera të ligjit të aplikueshëm.	Nga kandidatët kërkohet që të bëjnë një prezantim formal në një temë të caktuar dhe vlerësohen sa i përket komunikimit, marrjes së vendimeve, punës grupore, mundësive të barabarta shumëllojshmërisë kulturore, vetëdijësimin mbi bashkësitë, menaxhim të kohës, plani operativ dhe kreativitet.	Nuk aplikohet
Major	Pa provim	Nga kandidatët kërkohet që të bëjnë një prezantim formal lidhur me një incident të kritik vlerësohen për komunikim, marrje të vendimeve, punës grupore, mundësive të barabarta shumëllojshmëri kulturore, vetëdijësimin mbi bashkësitë, menaxhim të kohës, plani operativ dhe kreativitet	Nuk aplikohet
Nënkolonel	Pa provim	Paneli intervistues	Nuk aplikohet
Kolonel	Pa provim	Paneli intervistues	Nuk aplikohet
Gjeneral Major	Pa provim	Nuk aplikohet	KELPD-ja interviston kandidatët dhe përgatitë një listë të ngushtë për Komisararin e policisë së UNMIK-ut
Gjeneral Nënkolonel	Pa provim	Nuk aplikohet	KELPD-ja interviston kandidatët dhe përgatitë një listë të ngushtë për Komisararin e policisë së UNMIK-ut.

Inspektorati Policor rekomandon që sistemi I gradimit duhet t'i nënshtrohet një rishikimi urgjent sa I përket aftësive të tij për identifikimin e kandidatëve më të mirë të mundshëm për secilën gradë. Ky rishikim duhet të marrë parasysh shfrytëzimin e mekanizmave shtesë, si rishikimin e kryerjes së punës nga ana e presonelit, qendrat e vlerësimit dhe programet trajnuese për zyrtarë të lartë, programe të cilat përqendrohen në verifikimin e shkathtësive të lidershit para gradimit.

2.16 Rishikimet lidhur me performancën e personelit janë të rëndomta dhe mjaft të shprehura në organizatat policore, si një komponent kyç i zhvillimit të karrierës dhe vlerësimit para gradimit. Nëse ky rishikim është i përpiluar dhe i implementuar si duhet, ky mjet për zhvillimin e personelit duhet të vlerësoj performancën aktuale dhe të kaluarën, si dhe të identifikojë fushat në të cilat kërkohen veprime të mëtejshme për përmirësimin e performancës. Sigurisht që cilësia e të dhënave varet plotësisht nga cilësia e procesit të rishikimit dhe rishikimi i personelit të përfshirë. Megjithëse SHPK-ja ka vënë në funksion skemën e vlerësimit të personelit për disa vite, ajo ende nuk është plotësisht e integruar brenda një strategjie për zhvillimin e karrierës dhe nuk përdoret si mekanizëm qendror në sistemin e gradimit. Ky dështim është I lidhur me një numër problemesh organizative, por nuk është më pak I rëndësishëm fakti që formularët të cilët aktualisht përdoren nuk mjaftojnë që plotësisht dhe në hollësi të përshkruajnë mungesat dhe dobësitë individuale dhe organizative. Një problem tjetër ka dalur në pah gjatë intervistave që ka zhvilluar Inspektorati Policor me më tepër se 900 policë. Ekziston një perceptim I përgjithshëm se skema e vlerësimit të personelit ka mungesë kredibiliteti dhe shfrytëzimi i saj është diskreditues. Një vlerësim I tillë është bërë I nevojshëm por përfundimisht një ritual I pakuptimtë.

2.17 Sidoçoftë Inspektorati Policor e mirëpret draftin e fundit 'Skema për vlerësimin e personelit'⁵⁰, një iniciativë e re nga ana e departamentit të personelit (Shtabi Qendror I SHPK-së). Departamenti I personelit inkurajohet të lejojë që skema për vlerësimin e personelit të bëhet një burim I të dhënave të regjistruara në mënyrë të saktë dhe objektive lidhur me zhvillimin e karrierës, duke përdorur përshkrimin e vendit të punës dhe profilit të punës si udhëzues standardë. Kjo përpjekje duhet të përqendrohet në dy çështje. Së pari, formularët e përdorur në intervista duhet të përpilohen në atë mënyrë që të paraqesin performancën personale dhe nevojat për zhvillimin e karrierës në një format standard, duke ljeuar në këtë mënyrë shfrytëzimin e informatave në procesin e përzgjedhjes dhe gradimit. Ai format duhet të jetë tërësisht në përputhje me fushat e shkathtësive në përshkrimin e vendit të punës dhe profilit të punës. Së dyti, skema për vlerësimin e personelit duhet të bazohet në takime dhe diskutime të rregullta në mes të policit dhe menaxherit të parë të tij/saj.

⁵⁰ Shih PSO DP-6.01 Vlerësimi I Performacës, 21 Qershor 2007

2.18 Gjatë anketimit të 947 policëve, Inspektorati Policor vërejti se një numër I konsiderueshëm I tyre nuk kishin përshkrimin e punës. Tabela 7 ofron një përmbledhje të atyre policëve të cilët e pranuan se nuk kishin përshkrimin e punës. Të dhënat statistikore janë alarmuese dhe sugjerojnë që ‘definimit të rolit’, një element I rëndësishëm në çdo organizatë efektive, nuk I jepet prioriteti I duhur në SHPK. Është me rëndësi që të gjithë zyrtarët policor – e posaqërisht ata në pozita menaxherike– të dijnë se cila është puna e tyre dhe si ndërlidhet ajo me ata të cilët I mbikëqyrin. Gjithashtu, pa një përshkrim pune të definuar qartë është vështirë të paramendohet se si një menaxher I drejtpërdrejtë mund të shpresoj të vlerësojë performancën e dikujt që ai/ajo dëshiron të vlerësojë. Pa përshkrim të punës nuk mund të ketë standarde të definuara me anën e së cilave mund të matet performanca e individëve. Inspektorati Policor nxit Departmanetin e personelit, që si çështje prioriteti, të sigurojë se të gjithë pjesëtarët e SHPK–së të cilët janë në pozitë menaxheri apo kryejnë ndonjë rol specialist, në gradën e rreshterit e më lartë, janë të pajisur me përshkrim pune të hollësishëm I cili do të defononte rolin e tyre dhe standardet e punës.

Tabela 8

Numri I zyrtarëve policor të cilët nuk posedojnë përshkrim pune

Regjioni	Numri	%
Shtabi	67	28.8
Prishtinë	75	67.5
Prizren	103	78.0
Pejë	72	50.7
Gjilan	121	94.5
Mitrovicë	60	54.5
Ferizaj	25	27.1
TOTALI	522	57.3

2.19 Ato përshkrime të punës të cilat janë ekzaminuar nga Inspektorati Policor tregojnë mungesën e një formati dhe strukture të standardizuar. Mungojnë elemente të caktuara dhe në disa raste policët të cilët kryejnë funksion të njëjtë në lokacione të ndryshme kanë përshkrim pune të ndryshëm. Sidoçoftë, Inspektorati mirëpret punën e vazhdueshme të Departamentit të Personelit për dizajnimin dhe implementimin e pershkrimeve të standardizuara të punës nëpër tërë SHPK–në dhe rekomandon angazhim të një numri më të madh resursesh për të kompletuar këtë detyrë brenda 12 muajsh.

Inspektorati Policor nxit Departamentin e Personelit që të angazhojë më shumë resurse për përkrahjen e përpjekjes së vet për paraqitjen e përkrahjeve të standardizuara të punës për të gjithë pjesëtarët e SHPK-së të cilët janë në pozitë menaxhuese apo kryejnë role specialiste. Inspektorati Policor nxit Departamentin e personelit, që si çështje prioriteti, të sigurojë që të gjithë pjesëtarët e SHPK-së të cilët janë në pozitë menaxheri apo kryejnë ndonjë rol specialist, në gradën e rreshterit e më lartë, janë të pajisur me përshkrim pune të hollësishëm i cili do të defononte roline tyre dhe standardet e punës.

2.20 Një identifikimi i suksesshëm i zbrazëtirave në punë përmes skemës së vlerësimit të personelit varet shumë nga cilësia e formularëve e edhe më shumë nga shkathtësitë dhe aftësitë e vlerësuesit (menaxherit të drejtpërdrejtë). Nëse këta faktorë janë të pranishëm, ka mundësi të shmanget vlerësimi subjektiv i punës së policëve ose kategorizimi mekanik i çështjeve dhe problemeve. Nëse kjo iniciativë e re do të shpie në një zhvillim karrierë të qëndrueshëm dhe objektiv, Departamenti i Personelit duhet të sigurojë se menaxherët e drejtpërdrejtë (vijës së parë), trajnohen përkatësisht lidhur me përdorimin e formularëve dhe vlerësimit personal të punës (performacës). Përveç kësaj, detyra e vlerësimit të punës së personelit duhet të bëhet shkathtësi kryesore e përshkrimit të punës së të gjithë zyrtarëve policor të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e personelit policor.

Inspektorati policor rekomandon që Departamenti i Personelit të dizajnojë dhe implementojë një skemë të përmirësuar të vlerësimit të personelit si pjesë e strategjisë afatgjate të zhvillimit të karrierës në SHPK. Kjo skemë e korrigjuar duhet të sigurojë vlerësimin objektiv të punës së personelit dhe të ofrojë lidhje të qarta me përzgjedhjen dhe gradimin për të gjitha gradat. Përveç kësaj, kjo skemë duhet të përfshijë një program trajnues gjithpërfshirës dhe të detyrueshëm për të gjithë mbikëqyrësit dhe vlerësimi i performancës personale duhet të jetë shkathtësi kryesore në përshkrimet e punës së të gjithë mbikëqyrësve.

2.21 Qendrat e vlerësimit paraqesin elementin më të ndërlikuar të metodologjisë së përzgjedhjes në një proces gradimi, në kuptim të shpenzimeve dhe ndërlikueshmërisë. Ato paraqesin kombinimin final të një numri të teknikave si intervistat, testet me shkrim, simulimet, ushtrimet grupore dhe ushtrimet individuale. Me anë të përdorimit të një morie të tillë teknikash qendra e vlerësimit mund të fitoj një fotografi gjithpërfshirëse për mundësitë ekzistuese dhe ato të mundshme të pjesëtarit të caktuar të personelit për të kryer detyrat sipas standardeve (nivelit) të definuara. Në korrik, të vitit 2004, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK) inicoi diskutimet lidhur me një sistem adekuat përmes së cilit do të identifikoheshin liderët e ardhshëm të SHPK-së. Gjatë kohës së inspektimit është vërejtur se në sistemin e SHPK-së ndihet mungesa e një bordi të pavarur për vlerësim si dhe metodat e pavaruara për identifikimin e liderëve të mundshëm. Misioni i OSBE-së në Kosovë propozoi krijimin dhe implementimin e një ekzaminimi

me shkrim më rigoroz, bazuar në një seri rregullash dhe programesh mësimore të mbikëqyruar nga bordi i pavarur për vlerësim si dhe një proces 'të zhvillimit të lidershipit' i cili do të identifikonte zyrtarët policor të cilët kanë demonstruar veçori të caktuara të lidershipit, si motivim, iniciativë, marrje të vendimeve, vet besim, dhe shkathtësi në zgjidhje të problemeve. Duke filluar me gradimin e zyrtarëve policor në gradën e rreshterit dhe togerit, skema e propozuar do të nënkuptonte që zyrtarët policor rezultatet e të cilëve në testin me shkrim gjenden në 5% e parë automatikisht do të kulaifikoheshin për një pozitë në procesin e 'zhvillimit të lidershipit'.

2.22 Propozimi i OSBE-së nuk u implementua plotësisht. Drafti i gjatë 'doracaku për ekzaminim' (përfshirë rregullat, programin mësimor dhe mjetet e konkretizimit) ishte përgatitur nga OSBE-ja, Misioni në Kosovë, por asnjëherë nuk u fut në përdorim nga ana e SHPK-së. Poashtu, disa qendra për vlerësim të lidershipit u organizuan nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në baza 'pilot' dhe nxoren në pah të dhëna shumë të dobishme për mundësitë e lidershipit të disa qindra policëve, në kuptim të vendimarrjeve, përdorimit të iniciativës, dhe motivimit të ekipeve të vogla. Nuk është e qartë pse qendrat për vlerësim, që janë vetëm një element i skemës për 'zhvillimin e lidershipit' asnjëherë nuk u integruan plotësisht në sistemin e gradimit në SHPK. Skema e OSBE-së, Misioni në Kosovë, tregoi një numër problemesh (bregash) të përmendura nga zyrtarët e SHPK-së për mungesë transparence dhe objektiviteti në sistemin ekzistues të gradimit. Veçanërisht, ishte një bregë e përhapur gjërë që integriteti i testeve ekzistuese për promovim për gradën e rreshterit dhe togerit ishte komprometuar nga testet që kanë 'rrjedhur'. Ishte mendim i shumë policëve që menaxherët e vijës së parë kishin mjaft kompetenca në sistemin e vlerësimit të personelit, dhe se policët e angazhuar në detyrë në shtab kanë pasur përparësi të qarta dhe reale, përmes afërsisë së tyre me ata që marrin pjesë në intervistat përzgjedhëse. Kjo jo vetëm që shkatërroi aspiratat për karrierë të shumë policëve të talentuar por edhe dëmtoi nevojën e organizatës për liderë transformues.

2.23 Qendrat e vlerësimit kërkojnë një dizajnim të bërë me kujdes për të siguruar se testet e ndryshme dhe simulimet me saktësi pasqyrojnë kërkesat për gradën përkatëse. Përveç kësaj, ata kërkojnë një ekip prej vëzhguesve të talentuar të cilët rekomandohet të mos i takojnë grupit cak dhe nuk janë të njohur për ta. Rezultatet e nxjerra nga ushtrimet e qendrave për vlerësim duhet të analizohen me kujdes. Kjo dhe aspektet tjera të qendrave të vlerësimit i bëjnë ato të jenë ushtrime që kushtojnë mjaft në kuptim të shpenzimeve të grupit vëzhgues dhe shpenzimeve të konsiderueshme për organizatën për shkëputjen e grupit vlerësues nga vendi i punës për një periudhë kohore prej një ose më shumë ditë. Për shkak të shpenzimeve, qendrat e vlerësimit zakonisht përdoren për zhvillimin e zyrtarëve të lartë, identifikimin e liderëve të ardhshëm policor dhe menaxherët e njësive speciale si njësitet për hetime penale dhe për vëzhgim. Qendrat e vlerësimit janë dëshmuar si mjete mjaft efektive në ato organizata policore të cilat aplikojnë politikat e identifikimit të shpejtë të policëve të talentuar për grada të larta dhe Inspektorati Policor fuqimisht përkrah futjen në funksion të tyre si pjesë e një strategjie afatgjate të SHPK-së për zhvillimin e karrierës.

Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që Departamenti I Personelit të shqyrtojë mundësinë e përcaktimit të një bordi të pavarur vlerësues për procesin e gradimit të policëve, si pjesë e një strategjie afatgjate për zhvillimin e karrierës. Vetëm një bord I tillë I pavarur mund të sigurojë transparencë dhe një sistem të drejtë përzgjedhës për të gjithë kandidatët. Gjithashtu rekomandohet që si pjesë e strategjisë afatgjate, Departamenti I Personelit të shqyrtojë mundësinë e futjes në funksion të qendrave të vlerësimit të cilat do të kontrollohen nga një organ plotësisht I pavarur.

Strategjia e zhvillimit të karrierës

2.24 Gjatë inspektimit Inspektorati Policor ka vërejtur që SHPK-ja ende nuk ka zhvilluar një strategji afatëgjatë për zhvillimin e karrierës. Megjithatë që kur SHPK-ja ka marrë përgjegjësi të plotë për përzgjedhjen dhe gradimin e pjestarëve të SHPK-së në tetor të vitit 2006, departamenti i personelit ka demonstruar përkushtim të qartë në përmirësimin e menaxhimit të sistemit ekzistues të përzgjedhjes dhe gradimit, siç është përshkruar në tabelën 6. Inspektorati Policor gjithashtu e mirëpret krijimin e Drejtorisë së SHPK-së për politika dhe analiza strategjike, drejtori e cila do të jetë përgjegjëse për zhvillimin e kapacitetit të planifikimit strategjik të SHPK-së

2.25 Ndonëse gjatë inspektimit të fundit kanë ekzistuar dyshime të përbashkëta tek Inspektoratit Policor dhe shumë zyrtarë policor rreth historisë së fundit të gradimit në SHPK, tani është koha që të zhvillohet një vizion I përbashkët për të ardhmen e SHPK-së. Zyrtarët e lartë dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet të vendosin për llojin e organizates që është e dëshirueshme për 5 deri 10 vitet e ardhshme. Çfarë liderë do t'i nevojiten organizatës? Mund të duket e çuditshme që të mendohet për çështje pune për një të ardhme të largët, duke ditur që shumica e zyrtarëve të lartë janë me të drejtë të brengosur për çështje më urgjente. Megjithatë, zhvillimi dhe implementimi i një sistemi gjithpërfshirës për zhvillimin e karrierës kërkon vite të tëra, që të vihet në funksion.

2.26 Leadershipi I SHPK-së duhet të krijohet në kuptim të drejtimit të ndryshimeve organizative dhe duhet të ndërlihet me strategjinë dhe strukturën organizative. Me qëllim të përkrahjes së leadershipit si komponent kyç i zhvillimit të SHPK-së, është e rëndësishme që të jemi të qartë rreth kuptimit të leadershipit dhe se si mund të identifikohen liderët potencial dhe si mund të lejohen të kalojnë në pozita në të cilat do të ndihmojnë zhvillimin e organizatës. Hapi I parë përfshinë përcaktimin e llojit të liderëve të cilët i nevojiten SHPK-së. Kjo detyrë mund të përqendrohet në ekzaminimin e tipareve dhe cilësive të liderëve të cilët në mënyrë të suksesshme kanë drejtuar organizatat policore drejt ndryshimeve dhe përmirësimeve pozitive, si dhe në mënyrën se si një individ I caktuar i përdor këto veçori në detyrën e zgjidhjes së problemeve dhe bërjes së ndryshimeve. Me fjalë të tjera, detyra përfshinë përshkrimin e stilit të leadershipit që rezulton në ndryshime pozitive organizative.

Tabela 9

Liderët transaksional dhe transformues⁵¹

Lloji i lidershipit (udhëheqësisë)	Stili	Përshkrimi
Liderët transaksional	Menaxhmenti me anë të përjashtimit (aktiv)	Vëzhgon dhe kontrollon për devijime nga rregullat dhe standardet, ndërmerr veprime korigjuese.
	Menaxhimi me anë të përjashtimit (pasiv)	Ndërhyn vetëm nëse nuk përmbushn standardet
	Menaxhmenti shpërblyes	Njih të arriturat, premtion shpërblyes për rezultatet të mira pune
	Menaxhmenti Laissez-faire	Heq dorë nga përgjegjësitë, i shmanget vendimmarrjeve.
Liderët transformues	Inspirimi	Komunikon të priturat e larta, përdor simbole për të drejtuar përpjekjet, shpreh qëllime të rëndësishme në mënyra të thjeshta.
	Stimulimi intelektual	Përkrah inteligjencën, arsyeshmërinë dhe zgjidhjen e kujdesshme të problemeve.
	Shqyrtimi individual	Ofron vëmendje personale, trajton secilin punëtor individualisht, këshillon dhe mbikëqyrë.
	Ofron vizion	Ofron vizionin dhe botëkuptimin e misionit, rrënjësorë, fiton respekt dhe besim

2.27 Një qasje e tillë është ajo e Bass-it (1990) i cili ka ndarë liderët në organizatë në dy kategori kryesore: 'transaksional' dhe 'transformues'. Tabela 7 krahason dhe shpjegon ndryshimin në mes stileve tipike të liderëve në të dy grupet. Dallimi themelor përqendrohet në fushëveprimin e ndryshëm që këta liderë sjellin në organizatën policore. Liderët transaksional zakonisht janë të shumtë në organizata policore dhe mund të bëjnë vetëm ndryshime të vogla në misionin e organizatës, strukturën, menaxhimin e resurseve njerëzore; përderisa liderët transformues nuk do të bëjnë vetëm ndryshime të mëdha në këto tri fusha por ata gjithashtu shkaktojnë ndryshime rrënjësore në efikasitetin dhe kapacitetin e organizatës.

⁵¹ *Burimi: Bazuar në punën e Bass-it, B. M. (1990), 'Nga lidershipi transaksional në atë transformues: të mësuarit e ndarjes së vizionit', Dinamikat Organizative, Winter, p. 22.*

2.28 Një vështrim I shpejtë I karakteristikave të stilit të liderëve transakcional në tabelën 7 nxjerr në pah mostra të njohura të sjelljes në mesin e menaxherëve të SHPK-së. Këto janë veçoritë e stilit të shumë liderëve të cilët thjeshtë sigurojnë se puna- siç kërkohet në Parime dhe Procedurat e SHPK-së- kryhet në baza ditore. Megjithatë, këta nuk janë pjesëtarë të personelit të cilët do të identifikojnë problemet dhe do të bëjnë lloje të ndryshimeve të cilat në masë të konsiderueshme do të përmirësojnë mënyrën e kryerjes së detyrave në organizatë para syve të qytetarëve. Ky lloj ndryshimi është shkaktuar nga lideshipi transformues, I karakterizuar nga inspirimi, stimulimi intelektual, mendimi dhe vizioni individual. Ky lloj lidershipi është vazhdimësi e lidershipit transakcional dhe rezulton në një nivel më të lartë të përpjekjeve dhe rezultateve të punës së vartësve se sa në rastin e përdorimit të qasjes plotësisht transakcionale. Gjithashtu raporti në mes lidershipit transformues, ekipit dhe performancës organizative është një faktor I rëndësishëm për zhvillimin pozitiv të SHPK-së.

2.29 Inspektorati Policor bënë të ditur se nuk ekziton ndonjë model përfundimtar i lidershipit dhe secila organizatë duhet - përmes eksperimenteve dhe gabimeve - të krijoj botëkuptimin e saj se çka është një lider efektiv. Megjithatë kjo nuk e arsyeton sistemin që nuk e bënë të qartë llojin e liderëve të cilët kërkohen e as nuk demonstroi mënyrat përmes të cilave mund të promovohen liderët e tillë. Thjeshtë është e papranueshme që një proces t'i lihet rastit/gjasave. Nuk ekziston asnjë dëshmi për të sugjeruar që liderët e fuqishëm policor - sikurse salmoni në një lum në mal - do të gjejnë rrugën e tyre deri në majë, pavarësisht nga procesi apo sistemi. Prandaj SHPK-ja nxitet të zhvillojë strategjinë për zhvillimin e lidershipit që përcakton veçoritë e nevojshme dhe stilin e liderëve të ardhshëm policor, si dhe mënyrat përmes të cilave ata identifikohen, zhvillohen dhe vlerësohen. Procesi I miratimit të një strategjie për zhvillimin e lidershipit të SHPK-së fillon me një varg pyetjesh:

- Çfarë lloj lidershipi I nevojitet SHPK-së në të ardhmen?
- A është në gjendje sistemi aktual I gradimit dhe zhvillimit të karrierës të sjell lider të tillë të së ardhmes?
- Çfarë ndryshime nevojitet të bëhen për t'u siguruar që sistemi ka mundësi të sjell liderët më të mirë?

2.30 Kur ministria dhe SHPK-ja të vendosin për llojin e lidershipit që do të kërkohet në të ardhmen ato duhet të kalojnë në hapin tjetër - përplimin e një sistemi gjithpërfshirës për zhvillimin e karrierës I cili do të identifikonte liderët potencial dhe do t'i lejonte ata të zhvilloheshin. Ky hap i ndërlikuar duhet të bazohet në hulumtime gjithpërfshirëse lidhur me përvojën e organizatave tjera policore dhe të marrë parasysh një varg të tërë opcionesh, përfshirë qendrat e vlerësimit, bordet e pavarura ekzaminuese, akademinë për zyrtarë të lartë, programin universitar për

leadership policor dhe një skemë të vlerësimit të performancës të bazuar në të dhëna objektive dhe të evidentuara në mënyrë të duhur.

Rekomandimi kryesor Nr. 7

Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të marrin përsipër zhvillimin e një sistemi afatgjatë për zhvillimin e karrierës. Ky sistem duhet të bazohet në definimin e miratuar të stilit të lidershit të SHPK-së që do të jetë I nevojshëm në të ardhmen. Gjithashtu duhet të përfshijë një skemë gjithpërfshirëse bazuar në hulumtime të gjëra në prëvojën e organizatave tjera policore dhe të jetë në gjendje të bëjë identifikimin e liderëve të mundshëm si dhe t'i pajisë ata me mjetet e nevojshme për zhvillim.

2.31 Vizioni I lidershit të ardhshëm në SHPK gjithashtu duhet të sigurojë se liderët reflektojnë përbërjen etnike dhe gjinore të SHPK-së siq kërkohet në paragrafin 25 të *Kodit Evropian të Etikës Policore*. Aneksi A ofron një analizë të hollësishme të përbërjes etnike në SHPK sipas gradave. Ndonëse në përgjithësi organizata e SHPK-së përbënë një përzjerje etnike të Kosovës, ajo nuk arrinë ta bëjë një gjë të tillë në nivel të të gjitha gradave në SHPK. Edhe pse nuk është treguar në ankesin A, është e qartë që femrat nuk përbëjnë përfqësimit të mjaftueshëm në gradat mbikëqyrëse dhe menaxheriale të SHPK-së. Inspektorati Policor rekomandon që strategjia afatgjate e SHPK-së për zhvillimin e karrierës duhet në veçanti të kërkojë mënyrat për rritjen e numrit të përfaqësuesve të grupeve etnike dhe përfaqësimit të gjinisë femërore nga gradat e mesme deri te gradat e larta të SHPK-së.

Rekomandimi kryesor Nr. 8

Inspektorati Policor rekomandon që strategjia afatgjate e SHPK-së për zhvillimin e karrierës duhet në veçanti të kërkojë mënyrat për rritjen e numrit të përfaqësuesve të grupeve etnike dhe përfaqësimit të gjinisë femërore nga gradat e mesme deri te gradat e larta të SHPK-së.

2.32 Gjatë rrjedhës së inspektimit ishte e qartë që shumë prej zyrtarëve të SHPK-së të cilët u intervistuan shprehen shqetësim për efektivitetin e Programit trajnues të Trajnimit themelor dhe programet e ndryshme të trajnimit në fushën e menaxhmentit të mbajtura në Shkollën e SHPK-së, Qendrës për Edukim dhe Zhvillim të Shërbimeve për Siguri Publike. Mendimi I përgjithshëm ishte që programet aktuale për edukim dhe zhvillim për rekrutët fillestar dhe menaxherët e SHPK-së nuk janë të mjaftueshme dhe duhet të bëhet rishikimi I tyre, si pjesë e strategjisë së re për zhvillimin e karrierës. Për shkak të ndërlikueshmërisë së problemeve të paraqitura, Inspektorati Policor ka vendosur që të mos I shtjellojë ato në këtë raport por t'i adresojë në një inspektim të veçantë të Shkollës së SHPK-së më vonë gjatë vitit 2007.



Raport i përkohshëm i inspektimit 5

Menaxhimi i policisë kufitare të SHPK-së

MENAXHIMI I POLICISË KUFITARE TË SHPK-së

1. HYRJE

1.1 Inspektimi *i pestë i zakonshëm* i SHPK-së është bërë prej datës 15 gusht deri më 17 gusht, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqendrua vetëm në menaxhimin e policisë kufitare dhe është ndërmarrë nga Z. Enver Rustemi, kryeshef ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit të inspektorëve. Vizitat u bënë në Departamentin e Policisë Kufitare (Komandën Kryesore të Policisë Kufitare, në të gjitha shtabet regjionale të policisë kufitare dhe në të gjitha portat e policisë kufitare. Zyrtarët e Inspektoratit Policor edhe kësaj radhe u ndanë të kënaqur me bashkëpunimin e plotë të personelit të SHPK-së dhe gatishmërinë e tyre për të ndihmuar.

1.2 Detyra e SHPK-së nëpër kufijtë e Kosovës, në bashkëpunim me KFOR-in dhe Policinë Civile të UNMIK-ut, me sa duket është njëra nga detyrat më të rëndësishme, sa i përket ofrimit të sigurisë dhe luftimit të krimit të organizuar. Që nga tetori i vitit 2006 SHPK-ja ka marrë një shkallë të madhe të përgjegjësisë për parandalimin dhe zbulimin e krimit, në vendkalimet kufitare dhe përgjatë territorit të kufijve. Ky inspektim i rëndomtë do të përpiqet që t'i shqyrtojë komandën dhe kontrollin e policisë kufitare, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre, qasjen kolektive të SHPK-së/UNMIK-ut/KFOR-it, në kontrollimin e kufijve, iniciativat për ta përmirësuar kontrollin në kufij, projektet për t'u marrë me krimet në vendkalimet kufitare, bashkëpunimin dhe komunikimin, menaxhimin e informatave dhe rekomandimet për ta përmirësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore në kufi. Gjithashtu do të hetojë rolin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në bazë të Rregullores 2005/53, përfshirë rolin e politikave strategjike të Ministrisë, në lidhje me detyrat policore në kufij, imigrim dhe çështjet tjera përkatëse.

1.3 Qëllimi i këtij inspektimi të zakonshëm është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore lidhur me zhvillimin e karrierës në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me dispozitat relevante të ligjit të aplikueshëm dhe Parimet dhe Procedurat e SHPK-së;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP);
- Të inkurajojë strategjitë më të mira policore proaktive dhe reaktive, për të ofruar siguri në kufi dhe kontrolluar migrimin;
- Të inkurajojë strategjitë me të mira policore për ta luftuar krimin e organizuar në vendkalimin kufitar; dhe
- Të identifikojë dhe përhapë praktikatat me të mira.

1.4 Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorati Policor intervistoi këta zyrtarë të SHPK-së:

- Asistentin e Zëvendës Komisarit të SHPK-së;
- U. D së Udhëheqësit të Drejtorisë (Policisa kufiare);
- Udhëheqësin e Drejtorisë për Administratë (Policia kufitare);
- Udhëheqësin e Drejtorisë për Operativë (Policia kufitare)
- Drejtorin i Drejtorisë së SHPK-së për të Huajt dhe Migrim;
- Komandantët Regjional të Policisë Kufitare;
- Kryesuesin e Policisë Kufitare të SHPK-së, në Aeroportin e Prishtinës;
- Zyrtarët e SHPK-së- përgjegjës për vendkalimet kufitare;
- Zyrtarët e SHPK-së të caktuar në detyrë në policinë kufitare;

1.5 Inspektimi i policisë kufitare ka qenë e përqendruar në këto fusha:

- Policia kufitare – Strategjia
- Policia kufitare – Personeli dhe struktura
- Policia kufitare – Pajisjet dhe trajnimi

2. GJENDJA AKTUALE

Nevoja për një strategji të policisë kufitare

2.1 Departamenti i Policisë Kufitare të SHPK-së është themeluar në qershor të vitit 2006, në bazë të vendimit për transferimin e kompetencave të këtij funksioni policor të rëndësishëm, nga Policia Civile e UNMIK-ut te SHPK-ja. Departamenti ka një strukturë të thjeshtë dhe funksionale brenda Shtabit Qendror: Drejtoria për Operativë, Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për të Huaj dhe Migrim. Rregullorja nr. 2005/53 (korrigjim i Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje në Kosovë) ka filluar procesin e transferimit të kompetencave për sigurimin e kufijve dhe çështjet tjera lidhur me të, nga UNMIK-u te Ministria e posaçmërisht e Punëve të Brendshme. Në bazë të shtojcës XVI-të të Rregullores, Ministria pretendon të marrë përgjegjësi në një numër fushash që kanë të bëjnë me punën e policisë kufitare të SHPK-së, përfshirë:

- Përgjegjësinë për implementimin e sistemit të menaxhmentit të integruar kufitar, në bashkëpunim me UNMIK-un dhe në lidhje me marrëveshjet e bëra për kufij/ vendkalime kufitare në pajtueshmëri me standardet e caktuara nga Bashkësia Evropiane, dhe në veçanti për koordinimin efektiv në mes të policisë dhe autoriteteve tjera publike të përfshira në kontrollimin e vendkalimeve kufitare (paragrafi iii);
- Implementimin e ligjit të aplikueshëm lidhur me lëvizjen e personave brenda dhe jashtë Kosovës, në bashkëpunim me UNHCR, ndihmën në vlerësimin e

aplikacioneve për statutin e refugjatëve, në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm (paragrafi iv);

2.2 Në këtë mënyrë kompetenca ekzekutive për sigurimin e kufijve në pajtueshmëri me standardet e BE-së, dhe kontrollimi i personave që hyjnë apo e lëshojnë Kosovën, i takon Ministrisë së Punëve të Brendshme në bashkëpunim me UNMIK-un, e të cilat ishin pjesë të rezervuara të kompetencave të UNMIK-ut. Prandaj, Ministria tani ka detyrën e krijimit dhe implementimit të politikave strategjike, në lidhje me sigurimin e kufijve dhe migrimin, përmes SHPK-së dhe është detyrë e Inspektoratit Policor që ta përcaktojë dhe vlerësojë performancën e menaxhmentit të SHPK-së për kufij, në arritjen e këtyre synimeve strategjike të caktuara nga Ministria. Në gusht të vitit 2007, Ministria ka publikuar planin e saj strategjik për periudhën kohore 2007–2010. Një numër karakteristikash të planit strategjik janë të lidhura drejtpërsëdrejti me Departamentin e Policisë Kufitare të SHPK-së. Veçanërisht, në bazë të synimit strategjik 1, Ministria do të përpiqet t'i zhvillojë shërbimet policore të cilat janë efektive, efikase, të hapura dhe transparente. Synimi strategjik 5 thotë që Ministria do të përpiqet që të zhvillojë Departamentin për Kufi, Azil dhe Refugjatë (shih FKR 5.3) dhe “të përforcoj bashkëpunim me policinë kufitare dhe pjesëmarrësit tjerë në sistemin e menaxhmentit të integruar kufitar”. Hapi tjetër në procesin përmes së cilit Ministria drejton synimin strategjik të policisë kufitare në Kosovë do të jetë publikimi i synimeve kryesore të Ministrit (shih FKR 1.3).

2.3 Është detyrë e Inspektoratit Policor për të mbledhur të dhëna të sakta në lidhje me performancën aktuale të policisë kufitare të SHPK-së, në lidhje me aftësinë e tyre për të ofruar shërbime që janë “efektive, efikase, të hapura dhe transparente” (Synimi strategjik 1). Këto të dhëna do të përdoren për ta drejtuar funksionin e Ministrisë lidhur me definimin e synimeve kryesore policore në fushën e policisë kufitare, duke ndihmuar në këtë mënyrë në përmirësimin e sigurisë kufitare në Kosovë. Gjatë kohës së inspektimit, Inspektorati Policor vërejti se në Departamentin e Policisë Kufitare nuk ekziston ndonjë startegji formale dhe e shkruar, qoftë afatmesme apo afatgjate. Zëvendës komisar (Policia Kufitare) thekson nevojën për ta finalizuar urgjentisht strategjinë e policisë kufitare të SHPK-së, dhe Inspektoratit Policor ia bëri të ditur se ky dokument do të botohet në një të ardhme të afërt.

2.4 Si pikënisje e qartë në procesin e përcaktimit të synimeve strategjike për policinë kufitare në SHPK është aspekti i ligjit të aplikueshëm që ka të bëjë me policinë kufitare. Në kohën e inspektimit, Inspektorati Policor vërejti se detyrat dhe përgjegjësitë e SHPK-së lidhur me policinë kufitare nuk janë të definuara plotësisht me ligj. Neni 3 (g) i Rregullores së UNMIK-ut 2005/54 (mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës) thotë se SHPK-ja ka për detyrë që të “mbrojë dhe kontrollojë kufijtë shtetëror dhe administrativ, në bashkëpunim me Shërbimin Doganor të UNMIK-ut dhe me agjencitë tjera kufitare, në pajtim me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane”. Megjithatë, aktualisht nuk ekzistojnë dispozita të hollësishme në ligjin e aplikueshëm, që kanë të bëjnë me policinë kufitare. Në bazë të dispozitave në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave

të SHPK-së dhe në bazë të informatave të marra nga menaxherët e policisë kufitare të SHPK-së, lista e funksioneve në vijim paraqet praktikën aktuale në SHPK:

- a) Zbatimi i qasjeve të pranueshme dhe efektive dhe metodave për kontrolluar dhe ruajtur kufijtë territorial dhe kufijtë ajror të Kosovës në bashkëpunim me UNMIK-un dhe KFOR-in;
- b) Kontrollimi dhe ruajtja e lëvizjeve ilegale të kontrabandës, narkotikëve, armëve dhe automjeteve, në bashkëpunim me Shërbimin Doganor të Kosovës;
- c) Kontrollimi dhe ruajtja e lëvizjeve ilegale të personave, në bashkëpunim me UNMIK-un dhe KFOR-in;
- d) Zbulimi dhe identifikimi i dokumenteve të falsifikuara;
- e) Ballafaqimi me azilkërkuesit, në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë;
- f) Zbulimi i tregtisë ilegale me qeniet njerëzore, droga, automjete dhe armë të zjarrit;
- g) Ndërmarrja e masave proaktive kundër formave të imigrimit ilegal, kontrabandës dhe trafikimit të qenieve njerëzore;
- h) Ndalja e lëvizjeve ilegale të elementeve kriminale përgjatë kufijve;
- i) Zhvillimi i kapacitetit njerëzor të SHPK-së, informatat për personelin, dhe resurset teknologjike të nevojshme për përmbushjen e synimeve operative në një mënyrë efektive, efikase dhe të vazhdueshme;
- j) Sigurimi që kalimet kufitare të bëhen në mënyrë jo të komplikuar dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur, pa e kompromentuar parandalimin efektiv të krimit.

2.5 Përveç listës së funksioneve të njohura në pikën 2.4 më sipër, dhe në mungesë të strategjisë së SHPK-së, e cila mund të formojë bazën e një vlerësimi të hollësishëm të punës së policisë kufitare të SHPK-së – për qëllim të inspektimit– do të ndihmonte qartësimi i synimeve të mundshme për një strategji të ardhme afatmesme. Lista e synimeve strategjike në vijim është sajuar nga ana e Inspektoratit Policor për qëllim të këtij inspektimi:

- a) Të sigurohet numri përkatës i personelit të SHPK-së, të caktuar në strukturën organizative e cila është në fuqi, në kuptim të kryerjes së funksioneve të sigurisë së kufijve;
- b) Të sigurohet që personeli I policisë kufitare të SHPK-së është I pajisur në mënyrë të duhur për përmbushjen e funksioneve të sigurisë së kufijve; dhe
- c) Të sigurohet se personeli I policisë kufitare të SHPK-së është I trajnuar në mënyrë të duhur për përmbushjen e funksioneve të sigurisë së kufijve.

2.6 Nuk është sugjeruar që këto synime strategjike paraqesin listën e plotë dhe përfundimtare. Megjithatë, ato do të shërbejnë si një udhëzues I dobishëm për një

vlerësim fillestar të punës, në mungesë të synimeve strategjike të definuara nga Departamenti I Policisë kufitare të SHPK-së. Poashtu, është shpresuar që të dhënat rezultuese të Inspektoratit Policor do të ndihmojnë Ministrinë në detyrën e saj të përcaktimit të synimeve kryesore policore për policinë kufitare dhe migrimin.

Personeli dhe struktura

2.7. Që nga tetori I vitit 2006, Policia kufitare e SHPK-së vepron në katër regjione: regjioni I lindjes, I perëndimit, I veriut dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës/Priştina I cili për shkak të rëndësisë së veçantë mbanë statusin e regjionit. Aspekti gjeografik I përgjegjësisë është I konsiderueshëm. Kosova shtrihet në sipërfaqe prej 10,878 km katror, dhe 695 kilometra të saj kufizohen me Shqipërinë, Serbinë dhe Maqedoninë. Regjioni I lindjes, me komandë në Kaçanik, operon në katër pika kufitare në Glloboçicë, Hani i Elezit, Portën 5 dhe në Portën 6 (Myqibaba). Përderisa regjioni I veriut ka komandën në Luzhan dhe pikat kufitare në portat 1, 3, 4, dhe 31, dhe regjioni I prëndimit ka komandën në Gjakovë dhe pikat kufitare në Kullë, Qafa e Morinës, Qafa e Prushit dhe Vërmicë.

2.8 Tabela 1 ofron një përmbledhje analizash lidhur me personelin e caktuar në policinë kufitare të SHPK-së në vitin 2007. Me gjithsejt 1079 zyrtarë policor, Departamenti I Policisë Kufitare përbën rreth 15% të burimeve njerëzore të SHPK-së. Për shkak të funksioneve kryesore të policisë kufitare, shumica e personelit janë të caktuar në regjionet operative (94.2%) dhe përbëhen kryesisht prej policëve patrullues dhe rreshterëve (83.5%). Është me rëndësi të përmendet se nëpunësit civil përbëjnë vetëm 3.2% të personelit në këtë departament dhe me siguri që është reflektim I fazës së hershme të tranzicionit. Inspektorati policor këshillon që ky departament duhet të shqyrtojë më tutje mundësinë për zgjerimin e rolit të nëpunësve civil, veçanërisht në funksionet mbështetëse të cilat ekzistojnë në shtabin kyresor dhe ato regjionale.

2.9 Brengë e madhe e Inspektoratit Policor janë aspektet e caktuara të 'spektrit të kontrollit' brenda Departamentit të Policisë Kufitare të SHPK-së . Spektri I kontrollit I referohet numrit të vartësve të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë I raportojnë menaxherit apo mbikëqyrësit të caktuar. Në tabelën 1, në kllapa është paraqitur numri I spektrit të kontrollit për gradat kryesore, atë të rreshterit deri te kapiteni. Ndonëse nivelet e përgjithshme të spektrit të kontrollit paraqesin ato në SHPK si tërësi (që do të thotë kapiten 2.4, togert 3.7 dhe rreshter 7), ekziston një moster e ndryshme në nivel të regjioneve. Përderisa rreshterët në regjionin e përendimit mesatarisht mbikëqyrin 5.2 policë patrullues, në regjionin e verut arrinë në 7.2, 7.8 në aeroport dhe 10.3 në regjionin e lindjes. Një mostër e ngjashme mund të shihet në gradën e togerit dhe kapitenit në tabelën 1. Siç është bërë e ditur në një raport të mëparshëm, Inspektorati Policor rekomanon që SHPK-ja duhet të përpiqet të krijojë një strukturë më të thjeshtë organizative dhe një spektër kontrolli më të njëtrajtshëm⁵². Natyrisht spektri optimal I kontrollit në këtë nivele të rëndësishme të

⁵² Shih paragrafet 2.6 – 2.8 e Raportit të përkohshëm nr. 5 (2006) –Kryerja e detyrave në menaxhimin e resurseve njerëzore në SHPK

menaxhmentit duhet të diktohet nga një numër faktorësh, e jo vetëm nga përshkrimi I punës që në mënyrë të qartë tregon fushëveprimin dhe natyrën u funksioneve mbikëqyrëse të këtyre zyrtarëve. Është diskutabile që, për dallim nga rolet tjera operative dhe mbështetëse, funksionet e policisë kufitare janë më të përcaktuara dhe të definuara më lehtë, duke e bërë në këtë mënyrë më të lehtë definimin e roleve mbikëqyrëse dhe siguruar një spektër të njëtrajtshëm kontrolli.

Tabela 1 – Analizë e personelit dhe strukturës së SHPK-së (gusht 2007)						
Regjionet e policisë kufitare						
RANKS	HQ	Airport	North	West	East	Totals/ %
GRADAT	Shtab	Aeroport	Veri	Perendim	Lindje	Totalet/ %
Gjeneral Major	1					1
Kolonel	1					1
Nën. Kolonel	2					2
Major	1			1	1	3 (0.2%)
Kapiten	3 [Span = 3.3]	1 [Span = 4]	5 [Span = 1]	3 [Span = 2.3]	2 [Span = 4]	14 (1.2%) [Span = 2.4]
Toger	10 [Span = 1]	4 [Span = 3.5]	5 [Span = 6.2]	7 [Span = 6.1]	8 [Span = 3.7]	34 (3%) [Span = 3.7]
Rreshter	10 [Span = 3.1]	14 [Span = 7.8]	31 [Span = 7.2]	43 [Span = 5.2]	30 [Span = 10.3]	128 (11.4%) [Span = 7]
Polic patrullues	31	110	224	224	307	896 (80.3%)
Nënpunës civil	6	2	7	11	10	36 (3.2%)
Totali/ %	65 (5.8%)	131 (11.7%)	272 (24.3%)	289 (25.9%)	358 (32.1%)	1115

Rekomandimi kryesor Nr. 1

Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti i Policisë Kufitare të SHPK-së duhet të rishikojë strukturën e vet organizative dhe të përpiqet të arrijë një spektër më të njëtrajtshëm kontrolli në tri nivelet e para të menaxhmentit.

2.10 Tabela 2 – 4 paraqet të dhënat e marra nga Departamenti I Policisë kufitare, në lidhje me numrin e automjeteve dhe personave që kanë hyrë dhe dalë nga Kosova nëpër vendkalimet zyrtare kufitare dhe ofron një analizë të thjeshtë të produktivitetit të Policisë Kufitare të SHPK-së. Tabelat e njëjta gjithashtu tregojnë numrin e automjeteve dhe personave që iu është refuzuar hyrja apo dalja. Një krahasim i tabelës 2 (Janar – Qershor 2006) me tabelën 3 (korrik – dhjetor 2006) tregon qartë ndryshimet dramatike gjatë lëvizjeve sezonale brenda dhe jashtë Kosovës. Gjithsejt 3,644,540 persona u kontrolluan nga policia kufitare e SHPK-së në pikën e hyrjes në vitin 2006 – mesatarisht 303,711 në muaj. Shifra prej 160,418 në shkurt (4.4% e totalit vjetor) që tregon numrin e personave që hyjnë në Kosovë, rritet në 582,015 (15.9%) në korrik dhe 435,291 (11.9%) në gusht. Kjo do të thotë që sasia mesatare e punës për pjesëtarët e policisë kufitare pothuajse dyfishet në korrik, duke krijuar një problem të konsiderueshëm në menaxhment në kohën kur shumica e zyrtarëve të SHPK-së preferojnë të marrin pushimin vjetor.

Tabela 2. Hyrjet / daljet e personave dhe automjeteve – Janar– Qershor 2006								
	Numri i personave të kontrolluar		Numri i personave që iu është refuzuar hyrja		Numri i automjeteve të kontrolluara		Numri i veturave që iu është refuzuar hyrja	
	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje
Janar	252982	267413	103	118	79957	75928	88	29
Shkurt	160418	156281	34	77	52705	49708	50	14
Mars	262930	249660	96	98	86118	78436	82	30
Prill	330543	301589	174	160	86711	77839	112	47
Maj	205002	193129	107	81	64664	59456	63	35
Qershor	321698	258482	138	492	101521	92703	138	109
Total	1533573	1426554	652	1026	399714	434070	533	264
Totalet	2,960,127		1678 (0.05%)		833784		797 (0.09%)	
[Nr. për polic]	[3042]		[1.7]		[856]		[0.8]	

2.11 Është me rëndësi të vlerësohet deri në çfarë mase numri aktual i pjesëtarëve të policisë kufitare është i mjaftueshëm për përmbushjen e funksioneve të tyre ligjore. Në mungesë të çfarëdo matësi të performancës nga ana e Departamentit të Policisë Kufitare, Inspektorati Policor ka përfshirë një analizë të thjeshtë të produktivitetit të policisë kufitare në fund të tabelave 2 – 4. Kjo analizë bazohet në supozimin që shumica e personave dhe automjeteve janë kontrolluar nga rreshterë dhe policë

patrullues në nivel regjional (973 policë). Si rrjedhim, mund të shihet se (mesatarisht) çdo zyrtar policor ka kontrolluar 3042 persona dhe 856 automjete në gjashtë muajt e parë të vitit 2006, dhe 4209 persona dhe 1360 automjete në gjysmën e dytë të vitit – që është një tregues i qartë i ndërrimit të konsiderueshëm sezonal të sasisë së punës për zyrtar policor. Prandaj, gjatë tërë vitit, çdo polic është ballafaquar me 7251 persona (ose 19.8 në ditë), dhe 2217 automjete (ose 6 në ditë). Megjithatë, Tabela 4 (Janar – qershor 2007), tregon një rritje në sasi: 3843 persona (ose 21.1 në ditë) dhe 1234 automjete (ose 6.7 në ditë). Do të jetë interesante të shihet nëse 20% e rritjes në sasi (lëvizja e personave) në 2007 tregon një trend të vazhdueshëm.

2.12 Është pranuar se shifrat e mësipërme më shumë paraqesin një vlerësim të përafërt dhe duhet të konsiderohet mundësia që të bëhen disa ndryshime gjatë ndërrimeve sezonale, mungesës së personelit për shkak të trajnimeve dhe pushimeve. Megjithatë, këto shifra janë të dobishme si tregues të plotë dhe tregojnë se numri aktual i personelit në policinë kufitare është më se adekuat për përmbushjen e kërkesave të trafikut qarkullues në vendkalimet kufitare zyrtare. Edhe nëse kërkohet ndryshim (përshtatje) 100% për trajnim, pushim, dhe ndërrime sezonale, sasia e punës prej 42 persona dhe 14 automjete të kontrolluara (për një polic brenda një dite) tregon që ky numër është më se i mjaftueshëm dhe mundëson një shkallë të lartë të fleksibilitetit në angazhimin e resurseve nga ana e menaxherëve të lartë të departamentit.

Tabela 3. Hyrjet /Daljet e personave dhe automjeteve – Korrik– Dhjetor 2006 ⁵³								
	Numri i personave të kontrolluar		Numri i personave që iu është refuzuar hyrja		Numri i automjeteve të kontrolluara		Numri i veturave që iu është refuzuar hyrja	
	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje
Korrik	582015	481827	100	472	144721	128219	100	43
Gusht	435291	461876	147	313	125103	127425	63	24
Shtator	271214	278418	111	112	99913	95144	50	26
Tetor	221732	214557	58	71	87853	82780	43	18
Nëntor	222184	227207	72	93	74534	149553	24	38
Dhjetor	378531	320826	30	42	110691	98194	46	49
Totali	2110967	1984711	518	1103	642815	681315	326	198
Totalet	4095678		1621 (0.03%)		1324130		524 (0.03%)	
[Nr. per polic]	[4209]		[1.6]		[1360]		[0.5]	
Totali vjetor	7,055,805		3299 (0.04%)		2,157,914		1321 (0.06%)	
[Nr. per polic]	[7251]		[3.3]		[2217]		[1.3]	

⁵³ Burimi: Zyrja e personelit / Shtabi I Policisë Kufitare

2.13 Tabelat 2 – 4 gjithashtu tregojnë numrin e personave dhe automjeteve të cilëve iu është refuzuar leja për të hyrë apo për të lëshuar Kosovën në vendkalimet kufitare zyrtare. Në vitin 2006 janë refuzuar gjithsejt 3299 persona, vetëm 0.04% nga numri total i personave që kanë tentuar të hyjnë apo dalin nga Kosova. Është me rëndësi të përmendet shembulli i rasteve të refuzuara lidhur me personat dhe automjetet. Përderisa shumica e rasteve të refuzimit të personave (64.5%) tregojnë numrin e personave të cilët janë përpjekur të dalin e jo të hyjnë në Kosovë, e kundërta ndodh në rastin e automjeteve ku 65% e tyre janë refuzuar të hyjnë në Kosovë. Këto trende pasqyrojnë gjendjen ekonomike në Kosovë, ku shumë persona përpiqen të migrojnë pa dokumente ligjore dhe shumë persona përpiqen të sjellin automjete të përdorura brenda territorit. Të dhënat e tilla janë të dobishme për formulimin e strategjisë së policisë kufitare dhe për caktimin e burimeve njerëzore dhe materiale në mënyrë të atillë që të synojnë në ndalimin e kësaj dukurie.

2.14 Sikurse në aspektet tjera të menaxhmentit informativ të SHPK-së, Inspektorati Policor vërejtë se ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme në mes të të dhënave të marra nga Shtabi i SHPK-së dhe atyre të marra nga regjionet e Policisë Kufitare. Për shembull komandat regjionale tregojnë se në gjashtë muajt e parë të vitit 2007, 1,988,422 persona janë kontrolluar gjatë hyrjes në Kosovë, krahasuar me numrin e dhënë nga Shtabi që është gjithsejt 1,924,021. Mospërputhje të ngjashme vërehen në numrin e automjeteve që hyjnë/dalin dhe numrin e personave dhe automjeteve që iu është refuzuar hyrja. Është e domosdoshme që Policia Kufitare e SHPK-së të zhvillojë një sistem të qëndrueshëm për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave pasi që gabimet e tilla në menaxhimin e të dhënave të rëndësishme mund të dobësojnë kredibilitetin e të dhënave statistikore të SHPK-së. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që të rishikohet sistemi aktual i policisë kufitare për numrimin e personave dhe automjeteve dhe të futet në përdorim një sistem më i qëndrueshëm.

Rekomandimi kryesor

Nr. 2

Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që të rishikohet sistemi aktual i policisë kufitare për numrimin e personave dhe automjeteve dhe të futet në përdorim një sistem më i qëndrueshëm.

Tabela 4. Hyrjet /daljet e personave dhe automjeteve – Janar– Qershor 2007⁵⁴

	Numri i personave të kontrolluar		Numri i personave që iu është refuzuar hyrja		Numri i automjeteve të kontrolluara		Numri i veturave që iu është refuzuar hyrja	
	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje
Janar	276298	283378	65	54	77499	74390	44	20
Shkurt	205060	201838	53	40	59726	55180	39	20
Mars	339396	263764	95	98	119353	110604	99	46
Prill	356401	332676	74	88	114826	104464	178	79
Maj	361726	343265	93	99	118009	115664	127	56
Qershor	385140	390357	67	78	126763	124497	113	59
Total	1924021	1815278	447	457	616176	584781	600	280
Totalet	3739299		904 (0.02%)		1200957		880 (0.07%)	
[Nr. për polic]	[3843]		[0.9]		[1234]		[0.9]	

2.15 Siç është përmendur në pikën 2.4 më lartë, detyra e policisë kufitare në ruajtjen e kufijve, në bashkëpunim me agjencitë tjera për siguri të cilat veprojnë në Kosovë, përshfshin parandalimin dhe luftimin e krimit. Vlerësimi se sa është efektiv Departamenti i Policisë Kufitare në luftimin e krimit ndër-kufitar, është një detyrë e ndërlikuar me variabla të numërta dhe me supozime të shumta të cilat nuk mund të testohen. Tabela 5 tregon numrin e rasteve të regjistruara kriminale si dhe incidentet tjera të cilat nuk kanë të bëjnë me krime, me të cilat është marrë policia kufitare në gjashtëmujorin e parë të vitin 2007. Numri total prej 599 i rasteve kriminale me të cilat është marrë policia kufitare, paraqet mesatarisht vetëm 3.2 raste në ditë. Ky numër i vogël duket të jetë në përputhje me shkallën e përgjithshme të ulët të krimeve të regjistruara në Kosovë⁵⁵.

2.16 Përveç shkallës së regjistruar të krimeve, tabela 5 ofron të dhëna tjera të dobishme në lidhje me produktivitetin e policisë kufitare të SHPK-së. Ajo tregon numrin e rasteve kriminale dhe incidenteve tjera me të cilat është marrë secili regjion gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2007, si dhe në kllapa tregon numrin mesatar për polic, duke u bazuar në supozimin e njëjtë se rreshterët dhe zyrtarët policor i kryejnë shumicën e kontrollimeve. Mund të shihet menjëherë se ekzistojnë lëvizje të konsiderueshme në numrin e rasteve nëpër regjione. Aeroporti ka shkallën më të

⁵⁴ Burimi: Zyrja e personelit / Shtabi I Policisë Kufitare

⁵⁵ Për detaje të mëtejshme lidhur me shënimet e SHPK-së për krime, shih raportin e përkohshëm të IPK-së Nr. 6 (2006) – Menaxhimi i hetimit të krimeve.

lartë të aktiviteteve, me 2.1 raste kriminale dhe 5.4 raste që nuk janë kriminale për secilin zyrtar policor, përderisa regjioni verior ka shkallën më të ulët të aktiviteteve, me vetëm 0.2 raste kriminale dhe 0.3 incidente tjera për një zyrtar policor. Në shikim të parë nuk mund të jetë e qartë se pse ekzistojnë ndryshime të tilla të konsiderueshme në mes të regjioneve. Ekzaminimi më i hollësishëm i arsyeve për këto ndryshime mund të ofrojë të dhëna të dobishme për strategjinë afat-mesme të Departamentit të Policisë Kufitare, si dhe për synimet e Ministrit lidhur me këtë Departament. Për shembull, mund të zbulohet se metodat e përdorura në aeroport janë më produktive apo që rrethanat në aeroport mund të rezultojnë në më shumë incidente jokriminale.

Tabela 5 – Aktivitetet e Policisë Kufitare të SHPK-së (Janar – Qershor 2007)					
Regjioni	Rastet kriminale	Incidentet jo kriminale	Persona të arrestuar	Persona të ndaluar	Numri i tiketave të lëshuara të trafikut
Lindje [Nr. për polic]	121 [0.3]	204 [0.6]	11	0	56
Përendim [Nr. për polic]	146 [0.5]	358 [1.3]	94	51	245
Veri [Nr. për polic]	67 [0.2]	86 [0.3]	18	7	144
Aeroport [Nr. për polic]	265 [2.1]	673 [5.4]	223	40	40
Total [Nr. për polic]	599 [0.6]	1321 [1.3]	346 [0.3]	98	485 [0.4]

Rekomandimi kryesor Nr. 3

Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që Departamenti i Policisë Kufitare (Ministria e Punëve të Brendshme) ta kryej një studim më të hollësishëm të niveleve të personelit dhe të produktivitetit në porta të ndryshme kufitare, me qëllim të përdorimit të të dhënave rezultuese në hartimin e strategjisë afatmesme të Departamentit.

2.17 Një funksion shumë i rëndësishëm i Departamentit të Policisë Kufitare është kontrollimi i lëvizjes së të huajve dhe ballafaqimi me azil kërkuesit, në bazë të dispozitave të ligjit të aplikueshëm. Edhe pse e papërfunduar në shumë aspekte, Rregullorja e UNMIK–ut 2005/16 (Mbi lëvizjen e personave brenda dhe jashtë Kosovës) është legjislacioni i parë në këtë fushë. Në të ardhmen e afërt Ministria e Punëve të Brendshme do të përpiqet që ta ratifikojë një ligj të kuvendit për të huajt, i cili do t'i zgjerojë dhe zëvendësojë dispozitat e Rregullores 2005/16. Drejtoria për

të Huaj dhe Migrim formon pjesën e Departamentit (Shtabi kryesor I SHPK-së) dhe ka përgjegjësi të përgjithshme për zbatimin e ligjit të aplikueshëm në lidhje me migrantët dhe azil kërkuesit.

2.18 Gjithashtu, Drejtoria për të Huaj dhe Migrim ka zyret e veta në të gjitha regjionet e policisë kufitare dhe të gjithë të huajt (dmth. personat të cilët nuk janë “banorë të përhershëm të Kosovës”) të cilët vijnë në Kosovë janë të obliguar që t’i vizitojnë këto zyre për regjistrim formal. Procesi i fundit përfshinë dispozitën dhe verifikimin e dokumentit në lidhje me aktivitetet e personit të cilat synon t’i ketë në Kosovë, kohëzgjatjen e qëndrimit të tij dhe banimin e përkohshëm. Nëse ekziston dyshim i bazuar se aplikuesi mund të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet të paligjshëm (p.sh. trafikimin me qenje njerëzore, prostitucion, kontrabandë) apo nuk mund ta tregojë një shkak të mirë për qëndrimin e tij në Kosovë, policia kufitare e SHPK-së do ta refuzojë hyrjen e tij. Të huajt të cilët e kanë lejeqëndrimin, iu lëshohet një kartë e përkohshme për identifikim nga Drejtoria për të Huaj dhe Migrim, e cila vlen një vit. Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2007, Drejtoria i ka lëshuar 1427 karta identifikimi, krahasuar me 967 në periudhën e njëjtë të vitit 2006 – një rritje prej 32%. Nëse ky trend vazhdon, Departamenti duhet ta korrigjojë strategjinë e saj afatmesme si dhe caktimin e burimeve.

Tabela 6. Nr. i personave të deportuar dhe refugjatët e kthyer – krahasimi i vitit 2006 me vitin 2007

	2006		2007			2006	
	Të deportuar	Refugjatë	Të deportuar	Refugjatë		Të deportuar	Refugjatë
Jan	317	111	322	85	Korrik	394	138
Shkurt	231	102	329	24	Gusht	468	152
Mars	394	133	283	78	Shtator	662	0
Prill	337	182	307	5	Tetor	537	0
Maj	330	70	97	17	Nëntor	527	0
Qershor	251	137	272	8	Dhjetor	293	118
Totalet	1860	735	1885	217		2881	408

2.19 Tabela 6 ofron të dhëna krahasuese në lidhje me numrin e personave të cilëve iu është dhënë statusi i refugjatit në pikën e hyrjes, dhe atyre të cilët janë deportuar në bazë të kushteve të ligjit të aplikueshëm. Krahasimi i gjashtë muajve të parë të vitit 2006 dhe periudha e njëjtë e vitit 2007, tregon se numri i personave të cilët janë

deportuar mbetet gati rreth 1,900. Në gjysmën e dytë të vitit 2006 është shënuar rritje prej 35% nga gjashtë muajt e parë të vitit dhe do të jetë me rëndësi të në kuptim të strategjisë aftmesme të Departamentit që të shihet nëse kjo përbën një pjesë të këtij trendi. Në lidhje me refugjatët, mostra ka ndryshuar dhe ekziston dëshmi e rënies së tepërt: nga 735 në gjashtëmujorin e parë të vitit 2006 në 217 në periudhën e njëjtë të vitit 2007. Numri i personave të cilët kërkojnë azil në Kosovë është shumë i vogël. Në vitin 2006, në Kosovë kërkuan azil dy persona (nga Shqipëria dhe Pakistani) ndërsa në vitin 2007 azil kërkuan gjashtë persona (nga Shri Lanka, Kameruni dhe Pakistani).

2.20 Në mënyrë që të arrihet një sistem i menaxhimit të integruar kufitar, i cili kërkohet në Rregulloren 2005/53, ekziston nevoja për një bashkëpunim në mes të agjencioneve dhe bashkëpunim ndër-qeveritar në mënyrë që të sigurohet se kontrollimi i kufijve të Kosovës është efektiv dhe në pajtueshmëri me standardet e BE-së. Departamenti i Policisë Kufitare mund të raportojë për një shkallë të lartë të suksesit në të dy fushat. Departamenti ka nënshkruar një numër të Memorandumeve të Mirëkuptimit (MM) me Shërbimin Doganor, Shërbimet e Fitosanitarisë dhe të Veterinarisë (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural) dhe Divizioni i Trashëgimive Kulturore (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit), që ka të bëjë me mbrojtjen e sendeve të trashëgimive kulturore të Kosovës të cilat transportohen në mënyrë të paligjshme jashtë kufijve të saj. Në nivelin ndër-qeveritar, janë bërë një numër marrëveshesh në mes të UNMIK-ut/IPVQ-ve dhe shteteve fqinje. Në mënyrë të veçantë, policia kufitare e SHPK-së e implementon marrëveshjen e Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) të arritur nga UNMIK-u dhe Republika e Shqipërisë, në shtator të vitit 2002. Kjo marrëveshje kërkon bashkëpunim në luftimin e krimit të organizuar, terrorizëm, trafikim me drogë, trafikim të qenjeve njerëzore dhe shpërlarje të të hollave. MM e njëjtë ekziston në mes të UNMIK-ut dhe Qeverisë së Malit të Zi.

Pajisjet dhe trajnimet

2.21 Në përgjithësi, niveli i pajisjeve personale dhe i automjeteve që iu janë ofruar policisë kufitare duket të jetë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për ta bërë punën e tyre. Zyrtarët e punësuar në departament janë të pajisur me revole standarde të tipit GLOCK19, municion 30 copë, radiolidhje, sprej OC, shufër metalike, rripin e pajisjeve, bateri dhe uniformë. Gjithashtu policia kufitare posedon rreth 21 armë të gjata (AK47) të cilat janë të caktuara kryesisht në zonat kufitare me terren malor. Përderisa disa zyrtarë policor ankohen se nuk kanë automjete të mjaftueshme - në kuptim të sasisë dhe nivelit të specifikimit - është e pamundur për Inspektoratin Policor që në mënyrë të duhur ta vlerësojë aktualisht këtë çështje, për shkak të mungesës së strategjisë së shkruar me synime të definuara qartë. Për shembull, nëse verifikohet që synimet strategjike (kur ato ekzistojnë) nuk mund të arrihen për shkak të mungesës së automjeteve, mund të ketë mundësi të përmirësimit në këtë burim të shtrenjtë.

2.22 Një supozim i rëndësishëm në definimin e një strategjie afat-mesme, synimet përkatëse dhe nevojat për pajisje për policinë kufitare, është edhe prezenca e vazhdueshme dhe e konsiderueshme e KFOR-it. Siç u pa më lartë, Kosova ka një vijë të gjatë kufitare me vendet fqinje dhe një pjesë e madhe e asaj vije kufitare është malore dhe e vështirë që të monitorohet dhe të patrullohet. Me sa duket ekzistojnë mundësi të pakufizuara për hyrje dhe dalje të paligjshme të personave dhe pronës dhe kjo kërkon mbështetje të një force ushtarake, me transport dhe pajisje të specializuara, që ta kontrollojë 'kufirin e gjelbër' me çfarëdo shkalle të efektivitetit. Në këtë mënyrë strategjia afatmesme e SHPK-së duhet të merr parasysh këtë supozim të rëndësishëm dhe t'i shmanget dyfishimit të panevojshëm të funksioneve dhe investimeve në pajisje.

2.23 Sa i përket pajisjeve, Inspektorati Policor vërejtë se sistemi i komunikimit të policisë kufitare dhe sistemi i menaxhimit të të dhënave është më pak se adekvat. Siç u përmend edhe më herët, policia kufitare e SHPK-së duhet të punojë më shumë në mënyrë që t'i përmbushë përgjegjësitë ligjore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe strategjia e saj duhet të pasqyrojë atë synim. Në bazë të Rregullores 2005/53, Ministria është përgjegjëse për "zbatimin e menaxhimit të integruar kufitar, në bashkëpunim me UNMIK-un dhe në lidhje me rregullimin e vendkalimeve të vendosura kufitare, në pajtim me standardet e vendosura nga Bashkimi Evropian, dhe në veçanti për një bashkërenditje efektive në mes të policisë dhe autoriteteve tjera publike të përfshira në kontrollin e kalimit të kufirit". Sistemi i menaxhimit të integruar kufitar vepron në nivele të shumta, intra-organizativ, inter-organizativ dhe ndër-qeveritar. Niveli i parë ka të bëjë me mundësinë e organizatës - policia kufitare e SHPK-së - që në mënyrë efektive, efikase dhe të saktë t'ia komunikojë informatat dhe të dhënat pjesës tjetër të organizatës së vet. Në masë të madhe kjo është çështje e të pasurit një sistem telekomunikimi, pajisje të duhura të TI-së si dhe shkathtësi të menaxhimit. Aktualisht ky është një aspekt brengosës.

2.24 Përmes të donacionit të mirë të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, policia kufitare e SHPK-së është e pajisur me sistemin e integruar për menaxhimin e të dhënave 'PISCES'. Ky sistem, kur funksionon si duhet, ofron mundësinë për të mbledhur, sistemuar dhe për të transferuar të dhënat nga dhe në secilin vendkalim zyrtar të kufirit dhe në qendrën komanduese në Shtabin e SHPK-së. Kjo i ndihmon SHPK-së jashtëzakonisht shumë në funksionet e saj për kontrollimin e lëvizjeve të personave dhe të automjeteve, dhe gjithashtu në luftimin e formave të ndryshme të krimeve përtej kufirit. Për fat të keq, i tërë potenciali që ka sistemi PISCES nuk është realizuar plotësisht. Sipas menaxherëve të policisë kufitare, sistemi në masë të madhe është i paoperueshëm për shkak të një numri të defekteve në sistemin e TI-së si dhe për shkak të lidhjeve të papërshtatshme. Inspektorati Policor është informuar se problemet kanë të bëjnë me kontratën për fazën pas instalimit (apo mirëmbajtjes), e cila është bërë me kompaninë e cila është përgjegjëse për konstruksionin e sistemit 'PISCES'. Shkurt, Qeveria e SHBA-ve e ka financuar instalimin fillestar dhe mjetet e konsiderueshme financiare të cilat tani kërkohen nga

kompania për mirëmbajtje, nuk janë në dispozicion apo janë vlerësuar të jenë të tepërta.

2.25 Edhe pse mungesa e rrjetit gjithpërfshirës dhe të integruar nuk e parandalon policinë kufitare të SHPK-së që ta bëjë punën e vet, prezenca e një mjeti të tillë do ta bënte këtë funksion të rëndësishëm të SHPK-së shumë më efektiv. Do ta mundësonte përhapjen e menjëhershme të të dhënave në lidhje me personat, automjetet dhe çështjet tjera në mes të gjithë policëve kufitarë në Kosovë. Për shkak të shpenzimeve, standardeve të BE-së dhe kërkesave të ligjit të aplikueshëm, detyra për gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme të këtij problemi l mbetet Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kërkohet një ekspertizë teknike që ta vlerësojë ekonomizimin relativ qoftë për ta aktivizuar plotësisht PISCES-in apo për ta zëvendësuar atë me një sistem i cili do të ketë shpenzime më të vogla për mirëmbajtje. Inspektorati Policor rekomandon që kësaj çështje t'i jepet një përparësi më e madhe në planifikimin strategjik të Departamentit të Policisë Kufitare si dhe të Ministrisë.

Rekomandimi kryesor

Nr. 4

Inspektorati Policor rekomandon që t'i jepet përparësi futjes në përdorim të një rrjeti të integruar komunikimi i cili është gjithpërfshirës, i qëndrueshëm dhe stabil gjatë planifikimit strategjik të Departamentit të Policisë Kufitare dhe Ministrisë.

2.26 Gjatë vitit 2006 dhe 2007, është bërë një investim mjaft i madh dhe i vazhdueshëm për trajnime. Është mundësuar një numër i madh i kurseve në Shkollën e SHPK-së si dhe në qendrën trajnuese të policisë kufitare, duke përfshirë edhe trajnimin themelor dhe të avancuar për polici kufitare, trajnime për menaxhim, mbi trafikimin e qenieve njerëzore, kursi për teknikat e kontrollimit, dokumentet e falsifikuara, për kidnapim të aeroplanëve dhe në fusha tjera. Deri më tani janë ndarë gjithsejt 3517 vende për trajnim për policinë kufitare gjatë viteve 2006 dhe 2007. Departamenti i Policisë Kufitare planifikon edhe 790 vende për trajnim të mëtutjeshëm në kurse të klasifikuara, gjatë vitit 2008. Sasia e investimit mund të matet vetëm me anë të numrit të vendeve për trajnim, pasi që nuk ekzistojnë të dhëna në lidhje me numrin e ditëve kur personalia ka vijuar këto trajnime. Përveç kësaj, as Departamenti për Trajnim i SHPK-së e as Shkolla e SHPK-së (QKSPEZH) nuk ka ndonjë sistem për vlerësimin e efektshmërisë së trajnimeve të tilla në vend të punës. Është e domosdoshme që menaxherët e policisë kufitare të kenë në dispozicion informata të hollësishme në lidhje me shpenzimet e sakta për trajnim, në bazë të numrit të ditëve të humbura në vendin e punës. Gjithashtu është me rëndësi që QKSPEZH dhe/apo Departamenti për Trajnim i SHPK-së të ofrojnë disa formularë për vlerësimin e efikasitetit të kurseve të ndryshme, për shkak se shpenzimet në kuptim të mosvijimit në punë janë mjaft të larta.

Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti për Trajnim i SHPK-së (në bashkëpunim me QKSPEZH) duhet që rregullisht t'i ofrojnë menaxherëve të SHPK-së informata të hollësishme në lidhje me mungesën nga vendi i punës për shkak të (d.m.th. të ofrojë më shumë të dhëna në lidhje me numrin e përgjithshëm 'të ditëve të punës' të përfshirë në çdo kurs, sesa vetëm numrin e vendeve të trajnimit).

2.27 Inspektorati Policor e mirëpret vendimin e Departamentit të Policisë Kufitare që ta angazhojë njësitin e specializuar për ta kryer një inspektim ad hoc dhe formal të performancës së policisë. Gjithashtu e mirëpret edhe interesimin e madh që asistent zëvendës komisar (Policia kufitare) e kupton këtë metodë të dobishme të menaxhimit dhe shpesh e shoqëron njësitin e inspektimit gjatë vizitave në zyret e pikave kufitare. Është e qartë që njësitin e inspektimit përqëndrohet në standardet e pajisjeve, në pajtueshmërinë me standardet e procedurave të operimit dhe kualitetin e shërbimeve të ofruara. Përderisa thuhet se kjo qasje e ka përmirësuar performancën policore, Inspektorati Policor nuk është në gjendje ta verifikojë këtë pohim për shkak të mungesës së të dhënave objektive. Sidoqoftë, ky shembull i praktikës më të mirë në mesin e menaxherëve të SHPK-së mund të jetë edhe më efektiv sikur të ndërlihej me treguesit e performancës, në bazë të synimeve strategjike të departamentit. Treguesi i performancës është një masë shumë e thjeshtë dhe e lehtë e verifikimit (apo e kundërt) të personelit të policisë kufitare, në arritjen e synimit të caktuar. Për shembull, një synim i mundshëm mund të jetë që të sigurohet se ngasësit e mjeteve motorike janë në gjendje të kalojnë nëpër procedurat e kontrollit në kufij, sa më shpejtë që është e mundur. Një tregues njëjtë i performancës policore, në shembullin e njëjtë, mund të jetë që koha e pritjes për ngasësit e mjeteve motorike në vendkalimet kufitare të mos jetë më e gjatë se 10 minuta. Treguesit e tillë të performancës janë të lehtë për verifikim dhe mund të tregojnë se në çfarë mase departamenti i realizon synimet e veta.

Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti i Policisë Kufitare të SHPK-së ta merr parasysh përdorimin e treguesve të performancës policore në mënyrë që ta plotësojë dhe zgjerojë efikasitetin e njësitit të inspektimit.



Raport i përkohshëm i inspektimit 6
**Mënyra e kryerjes së detyrave të
menaxhmentit të SHPK-së në trafikun rrugorë**

MËNYRA E KRYERJES SË DETYRAVE TË MENAXHMENTIT TË SHPK-së NË TRAFIKUT RRUGOR

1. HYRJE

1.1 Inspektimi i gjashtë i zakonshëm i SHPK-së është kryer prej datës 27 - 29 gusht 2007, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqendrua vetëm në menaxhimin e kryerjes së detyrave policore në trafikun rrugor dhe është ndërmarrë nga z. Enver Rustemi, Kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit të përbërë nga 16 inspektorë. Inspektimi në menaxhimin e trafikut rrugor shënon një hap të rëndësishëm në historinë e Inspektoratit Policor: është hera e parë që kjo fushë kyçe tematike, në bazë të Urdhëresës Administrative 2006/9, është vizituar sërish dhe paraqet mundësinë e parë për ta kontrolluar nivelin në të cilin zyrtarët e lartë policor veprojnë në bazë të rekomandimeve të IPK-së.

1.2 Kryerja e detyrave në trafikun rrugor është synim kryesor i SHPK-së në detyrën e saj për ta ruajtur një ambient të qetë dhe të sigurtë, për të gjithë qytetarët e Kosovës. Është e qartë se niveli i tanishëm i aksidenteve në trafikun rrugor, vdekjet dhe lëndimet e shkaktuara nga aksidentet në Kosovë mbesin fushë e shqetësimit publik. Menaxhimi i kryerjes së detyrave në trafikun rrugor bëhet edhe më i rëndësishëm pasi që numri i automjeteve në Kosovë vazhdon të rritet dhe numri i aksidenteve vazhdon të shtohet në një nivel të papranueshëm. Në gusht të vitit 2007, Ministria ka publikuar planin e saj strategjik për periudhën kohore 2007 - 2010. Një numër i karakteristikave të planit strategjik drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me Drejtorinë e Trafikut të SHPK-së. Veçanërisht, në bazë të synimit strategjik 1, ministria do të përpiqet që të zhvillojë shërbime policore që janë 'efektive, efikase, të hapura dhe transparente'. Fusha kryesore e rezultateve (FKR) 1.2 I referohet synimeve të ministrisë për forcimin e SHPK-së në të gjitha pjesët e Kosovës, përfshirë rishikimin dhe pajtimin në lidhje me planet strategjike dhe operataive të SHPK-së. Prandaj, detyra e zhvillimit dhe implementimit të një strategjie gjithpërfshirëse, për të zvogëluar numrin e vdekjeve dhe lëndimeve që rezultojnë nga aksidentet rrugore, është çështje e rëndësishme për Ministrinë, dhe ky raport inspektues do të jetë burimi primar i dëshmive në procesin e rishikimit nga ana e Ministrisë.

1.3 Qëllimi i këtij inspektimi të zakonshëm është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore lidhur me zhvillimin e karrierës në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me standardet relevante të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP);

- Pajtueshmëria me synimin strategjik 1 të Ministrisë së Punëve të Brendshme' *Plani strategjik 2007 - 2010*;
- Të inkurajojë strategjitë më të mira policore proaktive dhe reaktive për të zvogëluar vdekjet dhe lëndimet në trafikun rrugor në Kosovë;
- Të ndihmojë në përdorimin e masave më efektive që në mënyrë të sukseshme të zbulojë dhe parandalojë shpejtësinë dhe kundërvajtjet tjera në trafikun rrugor; dhe
- Të identifikojë dhe përhapë praktikatat më të mira.

1.4 Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorati Policor intervistoi këta punonjës të SHPK-së:

- Asistentin e zv. komisarit për Operativë, Shtab SHPK;
- Drejtorin e Policisë së Trafikut Rrugor;
- Shefin për Zhvillim dhe Planifikim Strategjik;
- Përgjegjës për infrastrukturë rrugore, inxhinier (staf civil);
- Shefin e Administratës Mbështetëse;
- Zv.komandantët Regjionalë, përgjegjës për operativë;
- Komandatë të Njesisë Regjionale të Trafikut;
- Komandantë të stacioneve policore; dhe
- Inspektim të patrullave policore të rastit.

1.5 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike, i cili parim është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

2. STRUKTURA DHE BURIMET

Struktura dhe organizimi

2.1 Sikurse në vitin 2006, detyrat e trafikut rrugor në Kosovë vazhdojnë të organizohen përmes njësive regjionale të trafikut që ndahen me autoritete menaxhuese të ndara nga Drejtoria e Trafikut, Shtabi qendror I SHPK-së dhe komandantët regjional. Secili njësit regjional I trafikut është nën komandën operative të komandantit regjional përkatës, pra menaxhimi I automjeteve të trafikut, pajisjeve dhe mirëmbajtjes është I centralizuar. Gjithashtu, selektimi, trajnimi dhe emërimi I zyrtarëve policor të trafikut dhe personelit civil është I centralizuar Drejtoria e trafikut rrugor gjithsejt ka 30 të punësuar, 23 zyrtarë policor dhe 7 personel civilë- dhe ka për detyrë përpilimin e planeve dhe strategjive në lidhje me sigurinë në trafikun rrugor në tërë Kosovën. Inpektorati Policor nuk ishte në gjendje që të sigurojë ndonjë dokument – përveç përshkrimit të vendit të punës – që ka treguar saktësisht funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorisë. Megjithëse kjo çështje, pasi që veçanërisht ka të bëjë me strukturën e brendshme të Departamentit për Rend Publik,

do të diskutohet përsëri më vonë, Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që funksionet e kësaj Drejtorie dhe marrëdhëniet me komandantët regjional duhet të përcaktohen qartë dhe t’ju komunikohen grupit të zyrtarëve të lartë.

Rekomandimi kryesor

Nr. 1

Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që funksionet e kësaj Drejtorie dhe marrëdhëniet me komandantët regjional duhet të përcaktohen qartë dhe t’ju komunikohen grupit të zyrtarëve të lartë.


2.2 Tabela 1, tregon strukturën aktuale dhe burimet njerëzore të Drejtorisë së Trafikut⁵⁶. Drejtoria është e ndarë në dy pjesë funksionale, në bazë të komandës së Drejtorit: Zhvillimi i planeve dhe strategjive dhe mbështetja administrative. Në bazë të përshkrimit të punës, drejtori është përgjegjës për ofrimin e ‘zhvillimit strategjik’ për të përmirësuar sigurinë në rrugë për pjesëtarët e publikut dhe për krahejen e planit afatgjatë për zhvillimin e performancës në trafikun rrugor’. Gjithashtu, drejtori duhet “të bashkëpunojë për së afërmi me komandantët regjional, në mënyrë direkte apo indirekte përmes Kryesuesit të Njësive Regjionale të Trafikut Rrugor”, dhe duhet “për së afërmi të bashkëpunojë me të gjitha ministritë në Kosovë, dhe të punojë në zhvillimin e (rrugëve) infrastrukturës, dhe të përmirësojë kontrollin në trafikun rrugor”. Zhvillimi i planeve dhe strategjive iu ofron mbështetje teknike ligjore dhe inxhinieri njësive operative të trafikut në regjione si dhe funksionin e monitorimit të performancës. Është e rëndësishme që Shefi për Planifikim dhe Zhvillim Strategjik është përgjegjës për zhvillimin “e planeve strategjike për përmirësimin e performancës në trafikun rrugor”, si dhe detyrën e sigurimit për “implementimin e planeve operative për zhvillimin dhe përparimin e performancës së trafikut rrugor të SHPK-së”⁵⁷.

2.3 Është e qartë, që përshkrimi i vendit të punës për drejtorin dhe shefin për planifikim dhe zhvillim strategjik tregon që planifikimi dhe zhvillimi strategjik i kuadrove të SHPK-së për ta përmbushur synimin e vet të sigurisë në trafikun rrugor, janë funksionet kryesore të Drejtorisë. Në mënyrë që t’i përmbushë këto funksione, Drejtoria duhet ta tregojë mundësinë që të sajojë plane të duhura strategjike dhe në mënyrë efektive t’i implementojë ato nëpër njësitë regjionale të trafikut rrugor. Inspektorati Policor u përqendrua në këto dy çështje gjatë kontrollimit të performancës së Drejtorisë.

⁵⁶ Inspektorati Policor vërejtë se disa pozita në strukturën organizative të Drejtorisë nuk janë plotësuar (p.sh. këshilltarë ligjorë) dhe kjo vazhdon ta dobësojë performancën e organizatës.

⁵⁷ Burimi: Përshkrimi i punës për Shefin për Zhvillim dhe Planifikim strategjik, Drejtoria e Trafikut

Tabela 1 – Struktura e Drejtorisë së Trafikut, Departamenti për Rend Publik i SHPK-së,
Shtabi i SHPK-së (2007)



2.4 Plani strategjik në lidhje me sigurinë në trafikun rrugor duhet të bazohet në një përshkrim të qartë të gjendjes aktuale të çështjeve në Kosovë. Me fjalë të tjera, problemi që plani strategjik kërkon ta rregullojë apo zgjidh duhet të jetë i definuar në mënyrë të duhur. Në përgjithësi, nuk është vetëm çështje e dijes se ekzistojnë shumë aksidente të cilët janë shkaktarë të vdekjes dhe lëndimeve: duhet të ketë informata në lidhje me numrin e aksidenteve të tilla, vendet e tyre dhe, çka është më me rëndësi, cili është shkaku i aksidenteve. Për këtë arsye, procesi i sajimit të strategjisë për trafikun rrugor duhet të fillojë me statistika të sakta në lidhje me numrin, llojin, vendin dhe shkakun e aksidenteve. Mundësia e SHPK-së për të paraqitur statistika të sakta dhe të besueshme – e veçanërisht faktorët shkaktues ⁵⁸ –

⁵⁸ Termi 'faktor shkaktues' i referohet faktorit i cili është përcaktuar si shkaku dominues i një aksidenti (p.sh. tejkalimi i shpejtësisë, gabimi i ngasësit, kushtet e pafavorshme në rrugë, automjetet me defekte), pa marrë parasysh nëse vepron ndaras apo në kombinim me shkaqet tjera dominuese.

në vitin 2006⁵⁹ nga Inspektorati Policor është identifikuar si dobësi. Pas më shumë se 12 muajve, Inspektorati Policor nuk ka parë përmirësime në këtë fushë dhe shtrohet pyetja nëse sistemi aktual i paraqitjes së statistikave paraqet variantin më të mirë. Drejtorja e Trafikut Rrugor ka burime të kufizuara dhe të pamjaftueshme për t'i shkëputur të dhënat nga të gjitha raportet a aksidenteve në trafikun rrugor dhe të paraqesë statistika në lidhje me numrin, llojin, vendin, faktorët shkaktues si dhe pikat tjera kryesore të informatave. Në të njëjtën kohë, të dhënat e paraqitura nga regjionet e SHPK-së nuk duken të jenë të besueshme dhe për arsye se nuk janë të qarta, nuk përputhen me shifrat e paraqitura nga Shtabi. Inspektorati Policor edhe njëherë nxit SHPK-në që ta rishikojë dhe përmirësojë sistemin e menaxhimit të informatave në lidhje me aksidentet në trafikun rrugor, dhe t'i marrë parasysh përparësitë e mundshme të sistemi të centralizuar dhe të menaxhuar nga Drejtorja e Trafikut. Kjo qasje natyrisht se do të kërkojë më shumë burime për Drejtorinë. Sidoqoftë, nëse njësitë regjionale të cilat përpilojnë statistika shpërndahen, personeli mund të transferohet në Drejtori dhe aty ekziston mundësia që të zvogëlohen kërkesat e përgjithshme të SHPK-së për këtë funksion.

Rekomandimi kryesor

Nr. 2

Inspektorati Policor edhe njëherë nxit SHPK-në që ta rishikojë dhe përmirësojë sistemin e menaxhimit të informatave në lidhje me aksidentet në trafikun rrugor, dhe t'i marrë parasysh përparësitë e mundshme të sistemi të centralizuar dhe të menaxhuar nga Drejtorja e Trafikut.

Burimet njerëzore

2.5 Përgjegjësia për detyrat policore në trafikun rrugor është e ndarë për të gjithë zyrtarët operativ regjional, të angazhuar nga stacionet policore dhe njësia regjionale e trafikut rrugor (NJRTR). Megjithatë NJRTR ofron një rol të veçantë në ndjekjen e këtyre synimeve policore, në bazë të nenit 3, të Rregullorës 2005/54, pasi që ato kanë të bëjnë me sigurinë nëpër rrugët e Kosovës. Veçanërisht NJRTR është përgjegjëse për:

- a) Hetimin e të gjitha aksidenteve rrugore të rënda dhe fatale;
- b) Hetimin e të gjitha aksidenteve ku përfshihen automjetet e SHPK-së;
- c) Hetimin e aksidenteve të cilat përfshijnë dëmet që kalojnë vlerën e caktuar monetare;
- d) Zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor dhe ofrimin e një ambienti të sigurtë rrugor; dhe
- e) Përcjelljen e VIP-ve dhe funksione tjera të veçanta të trafikut.

Të gjitha aksidentet tjera trajtohen nga policët patrullues të stacioneve.

⁵⁹ Shih Raportin e Përkohshëm nr.1/2006 (Mënyra e kryerjes së detyrave të menaxhimit të SHPK-së në trafikun rrugor, gusht 2006.

Tabela 2 – Njësitë Regjionale të Trafikut Rrugor (NJRTR-te) – Caktimi i personelit në detyrë, shtator 2007

	Policë	Staf Civil	Totali
Prishtinë	117	13	130
Pejë	96	16	112
Prizren	78	13	91
Mitrovicë	79	10	89
Gjilan	65	8	73
Ferizaj/	60	7	67

2.6 Tabela 2, tregon numrin e punonjësve të SHPK-së – civilë dhe policë të caktuar në NJRTR-te, në shtator të vitit 2007. Është me rëndësi se nuk ekziston ndonjë ndryshim i konsiderueshëm që nga viti 2006 dhe rreth 90% e NJRTR-ve kanë numrin e duhur të personelit, në bazë të kompetencave të autorizuara. Gjatë intervistave me personelin e NJRTR-së, Inspektorati Policor ka vërejtur një numër çështjesh të përbashkëta, përfshirë këtu edhe kushtet e papërshtatshme të punës (mungesën e hapësirës për zyre, pajisjet), vizitat e pamjaftueshme në terren njësiteve të trafikut nga ana e menaxherëve të SHPK-së, sigurimin e pamjaftueshëm të uniformës (p.sh. ata janë pjesërisht të pajisur me uniformë), mospajtimin me menaxhmentin e SHPK-së dhe pagat e ulëta. Këto çështje në mënyrë të hidhur i përkujtojnë menaxherët e SHPK-së që lidhshipi proaktiv përfshinë vizitat e personelit, dëgjimin e shqetësimeve të tyre dhe motivimin e vazhdueshëm. Mungesa e dukshme e interesimit për personelin operativ është e paarsyeshme dhe Inspektorati Policor rekomandon që personeli i SHPK-së në nivelet më të larta të jetë shembull në parimin e parë të lidhshipit –motivimin– duke vizituar policët operativ në terren dhe duke dëgjuar shqetësimet e tyre.

Key Recommendation

No. 3

Inspektorati Policor rekomandon që personeli i SHPK-së në nivelet më të larta të jetë shembull në parimin e parë të lidhshipit –motivimin– duke vizituar policët operativ në terren dhe duke dëgjuar shqetësimet e tyre.

2.7 Një kontrollë e pajisjeve dhe burimeve materiale që ka në dispozicion NJRTR-ja konfirmon shqetësimet e personelit, siç u cek më lartë. Kur automjetet e NJRTR-së u inspektuan nga Inspektorati Policor, u vërejt se në përgjithësi janë të pastra, të pajisura dhe të servisuara. Sidoqoftë, një kontrollim i dokumenteve të automjeteve ka vënë në pah se shumica prej tyre për herë të fundit janë regjistruar në vitin 2004, kur ato kanë hyrë në shërbimin e SHPK-së. Ekziston një nevojë e qartë për ta

qartësuar pozitën ligjore në lidhje me regjistrimin vjetor të automjeteve të SHPK-së, dhe kjo do të përmendet në raportin tjetër të rëndomtë. Problemet në lidhje me kalibrimin rutinor dhe mirëmbajtjen e zbuluesve të shpejtësisë dhe pajisjeve për testimin e alkoolit mbesin të pazgjidhura. Këto mjete të rëndësishme të NJRTR-së në masë të madhe nuk janë në dispozicion për policët dhe arsyeja nuk është plotësisht e qartë.

Tabela 3 – Pajisjet në dispozicion për Njësitë Regjionale të Trafikut Rrugor dhe Drejtorinë e Trafikut (2007)

	Pajisja për zbulimin e shpejtësisë		Pajisjet për alko-test		Automjetet	
	Në përdorim	Jashtë përdorimit	Në përdorim	Jashtë përdorimit	Në përdorim	Jashtë përdorimit
Drejtoria	/	2	/	4	3	/
Prishtinë	4	7	/	8	10	10
Pejë	3	6	/	6	6	2
Prizren	6	5	/	5	6	3
Mitrovicë	4	8	/	6	8	/
Gjilan	1	11	/	6	6	2
Ferizaj	5	7	/	9	11	1
Nën-totalet/ %	23	46 (66.6%)	/	44 (100%)	50	18 (26.4%)
Totali	69		44		68	

2.8 Gjendja aktuale sa i përket mundësisë së sigurimit të pajisjeve në Drejtori dhe NJRTR-të mund të përshkruhet vetëm si e rëndë. Tabela 3 ofron një përmbledhje të mundësisë së sigurimit të pajisjeve për zbulimin e shpejtësisë, pajisjeve për zbulimin e alkoolit dhe automjeteve. Është e qartë se mundësia e sigurimit të pajisjeve të mirënjatura dhe të cilat funksionojnë në mënyrë të duhur është zvogëluar që nga viti i kaluar, edhe përkundër asaj se Inspektorati Policor ua ka tërhequr vëmendjen në lidhje me këtë çështje të rëndësishme menaxheriale. Prej gjithsejt 26% të automjeteve ishin jashtë përdorimit, 66% e pajisjeve për zbulimin e shpejtësisë nuk janë funksionale dhe asnjë pajisje për testimin e alkoolit nuk është në përdorim. Edhe pse 12 muaj kanë kaluar që nga koha kur kjo çështje është identifikuar për herë të parë si një fushë me menaxhim të dobët dhe nuk është ndërmarre asnjë

veprim, tani është e nevojshme që të ndërmerren veprime të prera. Prandaj, Inspektorati Policor rekomandon që Komisarri I Policisë së UNMIK–ut dhe Minisri I Punëve të Brendshme të lëshojnë një vërejtje me shkrim për Drejtorinë e Rendit Publik dhe t’ia imponojë një standard të performancës njësive regjionale të trafikut rrugor, sa l përket pajisjeve për zbulimin e shpejtësisë dhe pajisjeve për zbulimin e alkoolit.

Rekomandimi kryesor

Nr. 4

Inspektorati Policor rekomandon që Komisarri I Policisë së UNMIK–ut dhe Minisri I Punëve të Brendshme të lëshojnë një vërejtje me shkrim për Drejtorinë e Rendit Publik dhe t’ia imponojë një standard të performancës njësive regjionale të trafikut rrugor, sa l përket pajisjeve për zbulimin e shpejtësisë dhe pajisjeve për zbulimin e alkoolit.

3. PERFORMANCA E MENAXHIMIT TË TRAFIKUT RRUGOR

Sfidat në sigurinë e rrugëve të Kosovës

3.1 Para se të merret parasysh performanca e Drejtorisë së Trafikut dhe e njësive të trafikut rrugor, është me rëndësi që të vendoset puna e tyre në një kontekst global për çështjen e sigurisë në rrugët e Kosovës. Në këtë mënyrë mund të shihet se policia është vetëm një pjesë e zgjidhjes së problemit të zvogëlimit të vdekjeve dhe lëndimeve në rrugë. Kosova ka 647km rrugë ‘magjistrale’ dhe 1278km rrugë ‘rajonale’. Është vështirë të caktohet numri i saktë i automjeteve që e përdorin këtë hapësirë të kufizuar të rrugës. Që nga pranimi i skemës së regjistrimit në KS, 323,000 automjeteve iu janë lëshuar këto tabela të regjistrimit: çka nuk dihet është se sa nga këto automjete janë çmontuar dhe janë larguar tërësisht nga rruga. Tabela 4 tregon të dhënat e ofruara nga Drejtoria e Trafikut për numrin dhe llojin e automjeteve të regjistruar për çdo vjet në Kosovë, në mes viteve 1999 dhe 2006. Shembulli në mes të viteve 1999 dhe 2004 duket i parregullt dhe i pasaktë, dhe vetëm në vitin 2005 dhe 2006 ekziston një numër më i saktë me rreth 55,000 automjete. Këtij numri duhet t’i shtohet edhe numri i panjohur i automjeteve të përdorura nga KFOR–i, organizatat ndërkombëtare, vizitorët e përkohshëm dhe një numër i konsiderueshëm i trafikut ‘që ka të bëjë me tregëti’.

Tabela 4 – Numri i automjeteve të reja të regjistruara në Kosovë – (1999 – 2006)

	Automobila	Autobusët/ Minibusët	Kamionët	Motorçikletata	Të tjera	Totali
1999	848	115	3	1	1480	2447
2000	36413	5288	1292	10	43220	86223
2001	19893	4154	3125	141	30310	57623
2002	8505	1628	1860	330	9712	22035
2003	7390	1595	984	212	15167	25348
2004	18505	2862	1739	185	19903	43194
2005	29159	2614	2264	291	22073	56401
2006	28369	3720	1836	669	20057	54651

3.2 Problemi i sigurisë në rrugë përqendrohet në dy faktorë kryesorë: në infrastrukturë të kufizuar dhe të vjetër, në kombinim me automjetet e vjetra dhe të mirëmbajtura në mënyrë jo të duhur. Edhe pse është bërë një investim financiar në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore në gjashtë vitet e fundit, përfshirë udhëkryqet dhe urat, nuk është bërë një investim i mjaftueshëm në ndërtimin e rrugëve të reja. Problemet në dendësinë e trafikut dhe infrastrukturën e dobët kanë të bëjnë me shenjat joadekuate në trafikun rrugor, vijat në sipërfaqe të rrugës dhe shenjat vertikale. Sipas Drejtorisë së Trafikut këto probleme janë keqësuar nga dëmet joligjore të shenjave të trafikut dhe tendenca e rritur e vjedhjes së shenjave për shitje të metaleve. Edhe pse nuk ekzistojnë të dhëna të besueshme, Drejtoria e Trafikut vlerëson se vjetërsia mesatare e automjeteve në rrugët e Kosovës është 10 vjet dhe shumë prej tyre janë në gjendje të keqe. Sipas personelit të Drejtorisë, sistemi aktual i kontrollave teknike për verifikimin e gjendjes së automjetit është joefektiv dhe ka mungesë kredibiliteti, për shkak të mungesës së kualitetit të kontrollit dhe vlerësimit nga ana e Ministrisë së Transportit.

3.3 Siguria në rrugët e Kosovës paraqet një sfidë të madhe për Ministrinë e Transportit, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe SHPK-në. Një strategji e mirë policore është vetëm një aspekt i zgjidhjes.

Aksidentet në trafikun rrugor

3.4 Sikurse në të kaluarën, secili regjion i ka ofruar Drejtorisë statistika në lidhje me kategoritë kryesore të aksidenteve në trafikun rrugor. Tabela 5 paraqet një krahasim të aksidenteve në trafikun rrugor (në bazë të kategorisë) për gjashtëmujorin e parë

të vitit 2006 dhe 2007 në secilin regjion⁶⁰. Edhe pse nuk është një analizë e plotë e 12 mujorëshit, të dhënat tregojnë një gjendje të përzier. Numri i aksidenteve fatale dhe I personave të vdekur është në zvogëlim e sipër, përdërisa numri i aksidenteve me lëndime dhe me persona të lënduar ka shënuar një rritje në shumicën e fushave. Shumica e regjioneve tregojnë një zvogëlim të konsiderueshëm vetëm në numrin e aksidenteve me dëme.

Figure 5 – Road Traffic Accidents in Kosovo – Comparison by Region

January to June 2006/7

Accident Type	Prishtinë/ Priština		Pejë/ Peć		Prizren		Mitrovicë/ Mitrovica		Gjilan/ Gnjilane		Ferizaj/ Uroševac	
	'06	'07	'06	'07	'06	'07	'06	'07	'06	'07	'06	'07
Fatal accidents	26 [67]	18	9	6	18	10	7	5	3	5	6	5
Persons Killed	30 [75]	20	13	6	18	10	7	5	4	5	6	5
Injury accidents	307 [1197]	526	176	251	265	374	168 [147]	184	161 [52]	91	133 [96]	123
Injured Persons	493 [1862]	853	283	384	415	596	248 [207]	321	242	160	190 [160]	202
Damage accidents	1608 [4518]	358	809	653	717 [334]	410	371 [176]	194	564 [162]	139	418 [189]	209

⁶⁰ Të dhënat e paraqitura janë nxjerrë nga statistikat e ofruara nga secili regjion në qershor të vitit 2007, duke shfrytëzuar kategoritë përkatëse

Tabela 6 – Aksidentet në trafikun rrugor në Kosovë sipas regjioneve (2006)

Krahasimi I gjashtëmujorit të parë (1) dhe të dytë (2) të vitit

Lloji I aksidentit	Prishtinë		Pejë		Prizren		Mitrovicë		Gjilan		Ferizaj	
	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2
Aksidentet fatale	26	?	9	15	18	16	7	14	3	2	6	5
Persona të vdekur	30	?	13	15	18	20	7	19	4	2	6	5
Aksidentet me lëndime	307	?	176	279	265	423	168	227	161	209	133	161
Personat lënduar	493	?	283	457	415	661	248	388	242	339	190	260
Aksidentet me dëme	1608	?	809	1069	717	1125	371	518	564	670	418	525

3.5 Tabela 6 ofron një analizë të të dhënave të aksidenteve rrugore, të ofruara nga regjionet në vitin 2006, dhe bënë krahasimin e numrit të përgjithshëm të gjashtëmujorit të parë (1) me numrin e përgjithshëm të gjashtëmujorit të dytë (2). Vëreni se regjioni i Prishtinës nuk ka qenë në gjendje të ofrojë të dhëna për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2006. Regjionet tjera shënojnë një rritje në numrin e aksidenteve të të gjitha llojeve dhe nuk është dhënë asnjë arsye e qartë nga Drejtoria e Trafikut.

Tabela 7 – Aksidentet në trafikun rrugor në Kosovë (Të gjitha regjionet)

Janar – qershor 2006/7

Lloji I aksidentit	2006	2007	+/- %
Aksidente fatale	69	49	- 28,98%
Aksidentet me lëndime	1210	1023	-15,45%
Vetëm dëmtim	4487	1605	-64,23%

3.6 Në përgjithësi, të dhënat e SHPK-së tregojnë një rënie të dukshme në numrin e aksidenteve të të gjitha kategorive në trafikun rrugor. Siç tregohet në tabelën 7⁶¹, të dhënat e kombinuara të cilat iu janë dorëzuar Inspektoratit nga regjionet tregojnë një rënie të përgjithshme gati 30% të aksidenteve fatale (krahasuar me një rritje prej

⁶¹ Tabela 7 kombinon vetëm të dhënat e paraqitura në tabelën 5.

12% në mes të viteve 2005–2006) dhe një rënie prej 15% në numrin e aksidenteve me lëndime (krahasuar me një rritje prej 21% në mes të vitit 2005–2006). Çka është më me rëndësi, të dhënat nga regjionet tregojnë një rënie prej 64% në numrin e aksidenteve 'vetëm me dëme'. Sidoqoftë, Inspektorati Policor ka arsye që të pyes në lidhje me saktësinë e statistikave. Së pari, ekzistojnë mospërputhje në mes të statistikave që iu janë ofruar Inspektoratit Policor në vitin 2006 dhe atyre që iu janë ofruar në vitin 2007. Tabela 5, në kllapa tregon, statistikën për gjashtëmujorin e parë të vitin 2006 të cilat janë ofruar në qershor të po atij viti, si dhe numrin për periudhën e njëjtë kohore të cilat janë ofruar në këtë vit. P.sh. regjioni I Prishtinës në korrik të vitit 2006 ka raportuar 67 aksidente fatale dhe 75 fatalitete në gjashtëmujorin e parë të vitit 2006; sidoqoftë, në shtator të vitit 2007 regjionet kanë raportuar 26 aksidente fatale dhe 30 të vdekur për periudhën e njëjtë kohore në vitin 2006. Statistikat e rishikuara nga regjioni i Prishtinës sa i përket aksidenteve me lëndime, persona të lënduar dhe aksidente 'vetëm me dëme', ende janë shumë të tepërta. Së dyti, një rënje aq e madhe në numrin e aksidenteve – veçanërisht aksidentet 'vetëm me dëme' – në mes të vitit 2006 dhe 2007 (shifh tabelën 7) – është vështirë të besohet, duke pasur parasysh se nuk është dhënë asnjë faktor tjetër i rëndësishëm për ta sqaruar një ndryshim të tillë.

3.7 Ekziston qartë arsyeja për ta vënë në pyetje integritetin dhe besueshmërinë e sistemit të tanishëm të raportimit të aksidenteve në trafikun rrugor dhe krahasimin e statistikave në SHPK. Përkundër rekomandimit të qartë të Inspektoratit Policor në vitin 2006, në lidhje me përmirësimin e kualitetit dhe besueshmërisë së statistikave të trafikut rrugor, zyrtarët e lartë të SHPK-së siç duket kanë dështuar që t'i korrigjojnë këtë çështje themelore të menaxhimit të performancës. Prandaj, Inspektorati Policor rekomandon që Komisari I Policisë së UNMIK–ut dhe Ministri I Punëve të Brendshme t'ia bëjnë një vërejtje me shkrim Drejtorisë për Rend Publik dhe t'ia imponojë një standard të performancës në lidhje me mbledhjen dhe krahasimin e statistikave në trafikun rrugor.

Rekomandimi kryesor

Nr. 5

Inspektorati Policor rekomandon që Komisari I Policisë së UNMIK–ut dhe Ministri I Punëve të Brendshme t'ia bëjnë një vërejtje me shkrim Drejtorisë për Rend Publik dhe t'ia imponojë një standard të performancës në lidhje me mbledhjen dhe krahasimin e statistikave në trafikun rrugor.

3.8 Edhe pse shqipëtimi i 'tiketave të dënimit' ka mbetur masë preventive primare e zbatueshme nga njësitet e trafikut të SHPK-së në përpjekjet e tyre për t'i zvogëluar aksidentet, ekziston një rënie e konsiderueshme në numrin e kundërvajtjeve të zbuluara në vitin 2007. Tabela 8 ofron një analizë të të dhënave të paraqitura nga regjionet, ku bëhet krahasimi I janarit deri në qershor për vitet 2006–2007. Tiketa e dënimit mund të shqipëtohet për një numër kundërvajtjesh, përfshirë ngasjen pa patent shofer, automjetet e paregjistruara, ngasjen pa rripin e sigurisë dhe tejkalimin e shpejtësisë. Sidoqoftë, kundërvajtja për tejkalimin e shpejtësisë kërkon përdorimin

e pajisjes së kalibruar për zbulimin e shpejtësisë dhe kjo duket të jetë faktori kryesor në rënien e numrit të përgjithshëm të tiketave të lëshuara nëpër regjione.

3.9 Pasi që ekziston pasiguri në saktësinë e aksidenteve në trafikun rrugor (shih lartë), është vështirë që të vlerësohet nëse ekziston ndonjë lidhje në mes të numrit të aksidenteve dhe numrit të tiketave të shqiptuara për kundërvajtje në trafik. Në vështrimin e parë, krahasimi I tabelës 5 dhe asaj 8 tregon një përfundim të njëjtë me atë që ka qenë në raportin nr.1/2006 të Inspektoratit Policor: domethënë, që nuk ka lidhje direkte në mes të përdorimit të ‘tiketave për dënim’ dhe numrit të aksidenteve të rënda. Në vitin 2007 numri I aksidenteve të raportuara dhe I tiketave për dënim ka treguar një rënie të madhe. As noted in the past, the apparent lack of effectiveness of the use of ‘penalty tickets’. Siç është vërejtur në të kaluarën, mungesa e qartë e efikasitetit në përdorimin e ‘tiketave për dënim’ – që ka të bëjë me zvogëlimin e numrit të aksidenteve me lëndime– kërkon më shumë kontrollë. Përveç kësaj, Inspektorati Policor përsëritë nevojën për një rishikim të përgjithshëm të dobësive të njohura dhe përmirësimet e mundshme në kornizën ligjore nga ana e SHPK-së, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Ministria e Drejtësisë. Ky rishikim duhet të fillojë me statistikat më të besueshme në lidhje me aksidentet dhe, në veçanti, me më shumë të dhëna që kanë të bëjnë me faktorët kryesorë të cilët janë shkaktarë të aksidenteve.

Tabela 8 –Kundërvajtjet në trafikun rrugor – Tiketat të lëshuara (Të gjitha regjionet)

Janar – Qershor 2006/7

	2006	2007	+/- %
Prishtinë	N/P	25584	N/A
Pejë	22717	21179	- 6,7%
Prizren	17557	11770	-32,96%
Mitrovicë	8091	13852	+41,59%
Gjilan	9206	11121	+17,22%
Ferizaj	14013	18602	+ 24,67%

4. POLITIKA DHE STRATEGJIA

Iniciativat e reja

4.1 Inspektorati Policor ka qenë i impresionuar nga një numër i iniciativave të ndërmarra nga Drejtoria e Trafikut dhe regjionet gjatë vitit të fundit, në formë të planeve operative. Këto iniciativa në lidhje me sigurinë në rrugë përfshijnë aktivitetet

për të treguar defektet në automjetet e rënda transportuese (20.11.2006) në të gjitha regjionet përveç njërit (Pejë); regjistrimin e shenjave rrugore që mungojnë apo që janë vjedhur është rreth 155 shenja të trafikut të hequra, me vlerë mbi 80.000 Euro; disa raste të kontrollave teknike që tregojnë se një numër i konsiderueshëm janë në gjendje jo të mirë; dhe kontrollimin e qendrave për kontrollim teknik të automjeteve në bashkëpunim me inspektorët e Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit (26.10..2006). Drejtoria gjithashtu ka inicuar një aktivitet për siguri në rrugë në të gjitha shkollat e Kosovës, duke rritur vetëdijësimin e nxënësve për siguri në rrugë me anë të fletushkave informative dhe ligjeratave. Një iniciativë tjetër që Drejtoria është duke punuar në bashkëpunim me personelin e KFOR-it të SHBA-ve është për ta rritur vetëdijësimin e publikut në lidhje me tejkalimin e shpejtësisë dhe aksidentet fatale në Kosovë. Për këtë aktivitet do të shfrytëzohen reklama për të treguar numrin e personave të vdekur për secilin muaj. Inspektorati Policor lavdëron këtë punë si një shembull i iniciativës në mesin e menaxherëve të SHPK-së.

4.2 Sidoqoftë, ka qenë e papranueshme të vërehet se ekzistojnë shumë pak informata dhe dëshmi dokumentuese në lidhje me atë se sa janë implementuar këto plane, si dhe rezultatet dhe të arriturat e tyre të qarta. Është gjithashtu e papranueshme që në tërë SHPK-në ende ka mungesë të ndonjë dokumenti strategjik për siguri në rrugë. Kjo ishte temë e Inspektoratit Policor në raportin 1/2007 (Menaxhimi I Trafikut Rrugor në SHPK) dhe është plotësisht e qartë që dështimi ka të bëjë me mungesën e një sistemi të besueshëm të mbledhjes, krahasimit dhe analizimit të statistikave, dhe një mungesë e njohurive dhe shkathtësive në mesin e menaxherëve përkatës të SHPK-së. Prandaj, Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti i Trajnimit të SHPK-së duhet të koordinojë përgatitjen e trajnimeve të duhura në fushat e analizimit të statistikave, zhvillimit dhe implementimit të strategjive dhe në shkathtësitë e shkruarjes së raporteve përkatëve. Ky trajnim duhet të përqendrohet në zyrtarët e lartë të trafikut, në regjione dhe në Shtabin Qendror të SHPK-së.

Rekomandimi kryesor

Nr. 6

Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti i Trajnimit të SHPK-së duhet të koordinojë përgatitjen e trajnimeve të duhura në fushat e analizimit të statistikave, zhvillimit dhe implementimit të strategjive dhe në shkathtësitë e shkruarjes së raporteve përkatëve. Ky trajnim duhet të përqendrohet në zyrtarët e lartë të trafikut në regjione dhe në Shtabin Qendror të SHPK-së.

Nevoja për zhvillimin e legjislacionit mbi trafikun në lidhje me policinë

4.3 Një numër i synimeve në strategjinë e trafikut rrugor duhet të përfshijë zhvillime të mëtutjeshme të ligjit mbi trafikun rrugor, pasi që ato kanë të bëjnë me autorizimet policore. Formulimi I synimeve të tilla duhet të pasqyrojë zbratësitë e njohura dhe të metat e autorizimeve të tanishme të zyrtarëve policorë, për të ndaluar dhe inspektuar automjetet, të kërkojë dokumentet, dhe kur është e nevojshme të

largojë automjetet e dëmtuara nga rruga dhe të konfiskojë dokumentet e falsifikuara. Synimet gjithashtu duhet të kenë për qëllim mënjanimin e shkaqeve të dy formave të keqpërdorimit të kompetencave ligjore të përdorura më së shpeshti nga SHPK-ja.p.sh heqja e tabelave të regjistrimit nga automjetet të cilat janë të parkuara në mënyrë joligjore dhe konfiskimi i pasapotave, letërnjoftimëve, patent shoferit, dokumentave të regjistrimit në mënyrë që të sigurohet pagesa e gjobave të shqiptuara për kundërvajtje. Përderisa Inspektorati Policor i vërteton këto probleme praktike që i shtyejn policët të konfiskojnë këto gjësende, është më mirë që të zgjidhet problemi përmes korrigjimit të legjislacionit sesa t'ë vazhdohet me politikën në bazë të së cilës shkilet ligji ekzistues.

4.4 Zhvillimin e një strategjie që përmban synimet që kanë për qëllim të zhvillojnë ligjin e aplikueshëm dhe në përgjithësi të përmirësojnë sigurinë në trafikun rrugor, përfshinë nevojën për bashkëpunim të afërt në mes të SHPK-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme me Ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit (MTT) dhe autoriteteve komunale. Intervistat me zyrtarët policor të SHPK-së në drejtori dhe komandat regjionale të trafikut tregojnë se nuk ekziston asnjë qasje e strukturuar për bashkëpunim. Duhet të dihet që bashkëpunim do të thotë takime më të shpeshta se zakonisht dhe ato të ashtuquajtura 'add hoc': kërkon respekt dhe njohje të dyanshme si dhe përkushtim të plotë në parimin se vetëm duke punuar së bashku mund të përmirësohet siguria në rrugët e Kosovës. Prandaj, Inspektorati Policor rekomandon që Ministria e Punëve të Brendshme, si pjesë e planit të vet strategjik, duhet të marrë iniciativë për krijimin e një marrëveshjeje me MTT-në dhe me SHPK-në për një qasje të strukturuar për bashkëpunim. Kjo marrëveshje duhet të përfshijë takime të rregullta për ta përcaktuar një strategji të përbashkët me fusha të qarta të përgjegjësisë, ndarje të informatave, synime të pranuar nga të dy anët dhe afate të kufizuara kohore.

Rekomandimi kryesor

Nr. 7

Inspektorati Policor rekomandon që Ministria e Punëve të Brendshme, si pjesë e planit të vet strategjik, duhet të marrë iniciativë për krijimin e një marrëveshjeje me MTT-në dhe me SHPK-në për një qasje të strukturuar për bashkëpunim. Kjo marrëveshje duhet të përfshijë takime të rregullta për ta përcaktuar një strategji të përbashkët me fusha të qarta të përgjegjësisë, ndarje të informatave, synime të pranuar nga të dy anët dhe afate të kufizuara kohore.

Procedura e hetimit të aksidenteve

4.5 Inspektorati Policor vërejt se politika e tanishme në lidhje me kategorizimin e aksidenteve dhe shpërndarjen e burimeve duhet të rishikohen. Siç u pa më lartë, me aksidentet ku përfshihen vdekjet apo lëndimet e rënda, apo automjetet e SHPK-së apo dëmet e konsiderueshme, merret NJRTR-së. Me të gjitha aksidentet tjera – pjesn më të madhe – merren policia në stacione policore. Pyetja se 'vetëm deri në çfarë mase të dëmit në aksidente merret NJRTR-ja duket të jetë shkak i konfliktit në mes

të NJRTR-së dhe kolegëve të tyre të cilët patrollojnë nga stacionet e tyre lokale. Në bazë të Ligjit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, aksidentet ku përfshihet dëmi mbi 15,000 Euro duhet t'i referohet prokurorit publik, dhe kjo formon bazën për kriter të angazhimit të NJRTR-ve. Natyrisht se një rregull e tillë është pothuajse e pamundur të aplikohet në praktikë. Policët nuk janë të kualifikuar që ta vlerësojnë vlerën e dëmit në automjete të cilat l gjejnë në rrugë, dhe në çfarëdo rasti, politika mbi angazhimin e burimeve duhet të udhëzohet nga synimet organizative, siç është shërbimi sa më l mirë për publikun. Thjeshtë nuk është e pranueshme që policët e NJRTR-ve të trajnuar shumë mirë të qëndrojnë në një anë, në vend se të ndihmojnë në aksidente rrugore me dëme nën 15,000 Euro dhe të cilat aksidente bllokojnë rrugët kryesore duke shkaktuar vonesa në trafik. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së ta rishikojnë politikën ekzistuese që ka të bëjë me kategorizimin e aksidenteve dhe me angazhimin e burimeve. Ky rishikim duhet të udhëzohet nga synimi për ofrimin e kualitetit më të lartë për shërbim të publikut dhe përdorimin maksimal të burimeve të specializuara.

Rekomandimi kryesor

Nr. 8


Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së ta rishikojnë politikën ekzistuese që ka të bëjë me kategorizimin e aksidenteve dhe me angazhimin e burimeve. Ky rishikim duhet të udhëzohet nga synimi për ofrimin e kualitetit më të lartë për shërbim të publikut dhe përdorimin maksimal të burimeve të specializuara.

Zinxhiri komandues

4.6 Intervistat e bëra me zyrtarët policore të të gjitha niveleve në NJRTR dhe në drejtori tregojnë se ekziston një shkallë e paqartësive në lidhje me fushat e përgjegjësive dhe zinxhirin komandues. Veçanërisht, Inspektorati Policor përmend se ka paqartësi në lidhje me rolin e drejtorisë dhe marrëdhëniet e tij me komandat regjionale. Ekziston një përshtypje se Drejtoria e Trafikut në disa nivele është nën Departamentin e Operativës (Shtabi Qëndror) e më me0 rëndësi është nën vartësi të komandantëve regjional. Për këtë arsye, kërkesat për informata dhe të dhëna, për plane operative dhe iniciativa në lidhje me trafikun rrugor të inicuar nga Drejtoria nganjëherë injorohen nga komandat regjionale.⁶² Ky perceptim është l mbështetur nga personeli l NJRTR-së dhe nga bindja e tyre se më shumë iu jep udhëzime komandanti l tyre regjional përkatës sesa Drejtoria. Kjo kërkon që Drejtoria ta përdorë një zingjir komandues të gjatë dhe që l bie për qark, e paraqitur në tabelën 9 – d.m.th. çdo kërkesë apo udhëzim duhet të shkojnë nëpërmes të Asistentit të Zëvendës Komisarit, tek komandanti përkatës regjional dhe poshtë në NJRTR. Ky zinxhir i gjatë komandues vepron në dy drejtime dhe e ngadalëson sistemin e menaxhimit.

⁶² Kjo është parë qartë në shembullin e fushatës së gjetjes së defektet në automjetet e rënda për transportin e mallrave në vitin 2006- regjioni l Pejës/Pec nuk l ka përfillur udhëzimet dhe regjionet tjera dështuar të veprojnë në pjtueshmëri me kushtet sakta të planit operativ .

Tabela 9 – Sistemi I ‘zingjirit komandues ’ në menaxhimin e trafikut rrugor



4.7 Në qendër të këtij problemi ‘të zinxhirit komandues’ qëndron mungesa e një përpikërie në definimin e funksioneve të Drejtorisë, lidhjen e saj me NJRTR-të dhe nivelin e autorizimit që ka të bëjë me funksionet e definuara të saj. Për dallim nga funksionet tjera mbështetëse brenda Shtabit Qendror (siç janë financat dhe prokurimi), veprimet e Drejtorisë mund të injorohen shumë lehtë. Përveç sistemit të zinxhirit komandues të tejzgjatur, Inspektorati Policor është i vetëdijshëm për një faktor tjetër të rëndësishëm në rrjedhën e dobët të informatave në mes të Drejtorisë dhe personelit të NJRTR-së. Komandantët regjional të trafikut kanë një përgjegjësi të rëndësishme për monitorimin e performancës së NJRTR-së, si dhe krijimin dhe implementimin e performancës, sigurimin e sjelljes etike dhe komunikim e qëllimeve dhe synimeve në strategjitë e miratuara mbi trafikun rrugor. Është e qartë se mënyrat më efektive për komunikimin e synimeve dhe monitorimin e performancës janë nëpërmes briefingjeve dhe mbledhjeve të shpeshta me personelin. Sidoqoftë, Inspektorati Policor tani është i vetëdijshëm se ky mjet themelor i komunikimit të menaxhmentit nuk përdoret në shumë fusha dhe në disa fusha (p.sh. Prizren) nuk është përdorur asnjëherë.

4.8 Inspektorati Policor nxitë asistentin e zëvendës komisarit (Operativë) dhe komandantët regjional që të adresojnë dështimin e qartë të sistemit të zingjirit

komandues dhe dështimin e komandantëve regjional të trafikut për të adaptuar metodat themelore të komunikimit me personelin e tyre. Kërkohet një rishikim i hollësishëm i strukturës aktuale të menaxhimit të trafikut rrugor, duke e përfshirë edhe rivlerësimin e rolit dhe funksionit të Drejtorisë së Trafikut, sistemit të krahasimit dhe analizimit të aksidenteve rrugore dhe të dhënave lidhur me to, dhe sitemin më të efektshëm të sajimit të një strategjie për siguri në trafikun rrugor. Pasi që të bëhet rishikimi i strukturës dhe sistemi i menaxhimit, ato duhet të monitorohen dhe të vlerësohen në mënyrë që të sigurohet që janë duke funksionuar si duhet.

Rekomandimi kryesor

Nr. 9

Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të kryejnë një rishikim të strukturës së menaxhimit të trafikut rrugor, përfshirë një rivlerësim të rolit dhe funksionit të Drejtorisë së Trafikut, sistemit e krahasimit dhe të analizimit të aksidenteve rrugore dhe të dhënave lidhur me to, dhe sitemin më të efektshëm të sajimit të një strategjie për siguri në trafikun rrugor. Theksi duhet të vëhet mbi krijimin e një zingjiri komandues të efektshëm dhe efikas.

4.9 Ka qenë mjaft zhgënjyese për Inspektoratin Policor të mësojë se shumica e menaxherëve të intervistuar gjatë këtij inspektimi nuk kanë qenë në dijeni për ekzistimin e raportit të rëndomëta të IPK-së nr. 1/2006 (Menaxhimi i Trafikut rrugor në SHPK) apo nëse ata kanë qenë në dijeni për të, asnjëherë nuk e kanë lexuar. Kjo tregon faktin se pse shumica e rekomandimeve të përfshira në raport nuk janë marrë parasysh. Sidoqoftë, ky dështim reflektohet keq në kompetencat e SHPK-së dhe aftësitë e menaxherëve të saj për t'u informuar dhe komunikuar informatat tek ata që i mbikëqyrin dhe i menaxhojnë. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja të zhvillojë një sistem efikas të komunikimit të informatave tek ata menaxherë të cilët e kërkojnë atë, dhe ashtu siç është e duhur, të sigurohen se menaxherët veprojnë në bazë të informatave. Veçanërisht rekoamndohet që raportet e Inspektoratit Policor të shpërndahen tek të gjithë menaxherët e SHPK-së.

Rekomandimi kryesor

Nr. 10

Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja të zhvillojë një sistem efikas të komunikimit të informatave tek ata menaxherë të cilët e kërkojnë atë, dhe ashtu siç është e nevojshme, të sigurohen se menaxherët veprojnë në bazë të informatave. Veçanërisht rekoamndohet që raportet e Inspektoratit Policor të shpërndahen tek të gjithë menaxherët e SHPK-së.



Raport i përkohshëm i inspektimit 7
Kryerja e detyrave në menaxhmentin e
parkut të automjeteve të SHPK-së

KRYERJA E DETYRAVE NË MENAXHMENTIN E PARKUT TË AUTOMJETEVE TË SHPK-së

1. HYRJE

1.1 Inspektimi *i shtatë / zakonshëm* I SHPK-së është bërë më datën 17, 18 dhe 19 shtator, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqendrua vetëm në kryerjen e detyrave nga menaxhmenti I parkut të automjeteve të SHPK-së dhe është ndërmarrë nga Z. Enver Rustemi, kryeshef ekzekutiv I Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 17 inspektorëve. Vizitat u bënë në Departamentin e Shërbimeve Administrative, Shtabin Kryesor të SHPK-së në Prishtinë dhe në të gjitha shtabet regjionale. Zyrtarët e Inspektoratit Policor edhe kësaj radhe u ndanë të kënaqur me bashkëpunimin e plotë të personelit të SHPK-së dhe gatishmërinë e tyre për të ndihmuar.

1.2 Parku i automjeteve të SHPK-së është i një madhësie të konsiderueshme dhe paraqet njëri nga investimet më të madhe kapitale të organizatës. Menaxhmenti i këtij investimi të madh kapital paraqet një sfidë të madhe për një grup zyrtarësh të lartë të SHPK-së dhe shërbyesve civil, në përpjekjen e tyre për të siguruar që zyrtarët e SHPK-së janë të pajisur me automjete të sigurt me kosto minimale të taksapaguesve. Automjetet e SHPK-së janë njëra ndër karakteristikat më të dukshme të kësaj organizate të re: gjendja fizike e automjeteve është një tregues i profesionalizmit të SHPK-së para syve të qytetarëve. Prandaj qytetarët janë mjaft të interesuar lidhur me atë se si zyrtarët e lartë të SHPK-së menaxhojnë parkun e automjeteve. Përdorimi i automjeteve është një konsumues i madh i resurseve të SHPK-së – i dyti pas shpenzimeve të pagave të personelit të SHPK-së. Për këtë arsye është mjaft e rëndësishme që nevoja për një transport policor të sigurt të qëndrueshëm dhe të besueshëm harmonizohet me anë të menaxhimit efektiv të këtyre resurseve mjaft të shtrenjta. Të gjithë pjesëtarët e SHPK-së – menaxherët e lartë, personeli mbështetës dhe zyrtarët të cilët përdorin automjetet – janë të detyruar të zvogëlojnë shpenzimet e taksapaguesve.

1.3 Në gusht të vitit 2007, Ministria botoi Planin Strategjik për periudhën kohore 2007–2010. Një numër karakteristikash të këtij plani strategjik janë të ndërlidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me menaxhimin e parkut të automjeteve të SHPK-së. Veçanërisht, me synimin strategjik 1 Ministria përpiqet të zhvillojë shërbime policore “efektive, efikase, të hapura dhe transparente”. Fusha kryesore e rezultateve (FKR) 1.2 i referohet synimit të Ministrisë për përforsimin e SHPK-së në të gjitha pjesët e Kosovës, përfshirë rishikimin dhe miratimin e një planifikimi strategjik të SHPK-së në aspektin e shpenzimeve të kapitalit dhe pajisjeve. Prandaj detyra e zhvillimit dhe implementimit të një strategjie gjithëpërfshirëse për zhvillimin dhe mbajtjen e një parku të automjeteve efektiv është çështje për të cilën Ministria është e interesuar,

dhe ky raport inspektimi do të jetë burim primar i provës në procesin e rishikimit të Ministrisë.

1.4 Qëllimi i këtij inspektimi të zakonshëm është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me standardet relevante të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP);
- Pajtueshmëria me synimin e parë strategjik të Ministrisë së Punëve të Brendshme' *Plani strategjik 2007 - 2010*;
- Të inkurajohet menaxhimi profesional
- Të ndihmojë në përgatitjen e mundësive transportuese të cilat janë më shumë efektive sipas koston dhe sa më të sigurta dhe
- Të identifikojë dhe përhapë praktikat më të mira

1.5 Gjatë rrjedhës së inspektimit, personeli I Inspektoratit Policor vizitoi dhe intervistoi punonjësit policor në vijim:

- Zëvendës komisar in për Administratë
- Udhëheqësin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të SHPK-së
- Menaxherin e parkut të automjeteve të SHPK-së
- Drejtorin e Prokurimit/Financave të SHPK-së
- Komandantët regjional (shembuj rasti)
- Komandantët e stacionit (shembuj rasti)
- Policët e trafikut të SHPK-së (shembuj rasti)

1.6 Nëpërmes të një bashkëpunimi të mirë të zyrtarëve të lartë të SHPK-së Inspektorati Policor ka mbledhur një numër të konsiderueshëm të të dhënave duke përdorur protokollin mbi menaxhimin e parkut të automjeteve⁶³. Ky raport nuk paraqet të gjitha informatat dhe të dhënat e mbledhura gjatë inspektimit, por përqendrohet në çështje të caktuara të menaxhimentit për të cilat Inspektorati Policor beson se janë sfera të rëndësishme për zhvillim organizativ në fushën e menaxhimit të parkut të automjeteve.

1.7 Ky raport është përgatitur në bazë të parimeve të përgjegjësisë dhe transparencës publike e cila është e përfshirë në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

⁶³ Neni 1(e) i Urdhëresës Administrative 2006/9 e definon termin "protokoll" si udhëzim i shkruar që definon procedurat operative. Përbehet nga një seri e pyetjeve lidhur me temën e menaxhimit (p.sh. Politikat e Menaxhimit të Rrugëve) dhe vepron si udhëzues procedural për një 'inspektim të zakonshëm'.

KRYERJA E DETYRAVE NGA MENAXHMENTI I PARKUT TË AUTOMJETEVE TË SHPK-SË

2 Organizimi

2.1 Siç është vërejtur në inspektimin e vitit 2006, Inspektorati policor e pranoi se shume aspekte të menaxhmentit të parkut të automjeteve të SHPK-së nuk shtriheshin në fushën e vendimeve të ndërmarra nga menaxherët e SHPK-së. Ajo ishte periudha e tranzicionit, nga UNMIK-u tek zyrtarët e lartët e SHPK-së dhe shërbyesit civil, në të cilën SHPK-ja trashëgoi një autopark dhe sistem menaxhmenti që rezultonte nga vendimet e marra nga kolegët e UNMIK-ut për gjashtë vitet e mëparshme. Megjithatë gjatë periudhës kohore 2006/7, SHPK-ja ka vë autoritetin e vet në këtë fushë, duke marrë vendime të cilat do të drejtojnë furnizimin e ardhshëm të automjeteve dhe shërbimeve mbështetëse përkatëse.

2.2 Prokurimi dhe mirëmbajtja e parkut të automjeteve të SHPK-së mbesin plotësisht të centralizuara dhe nën kontrollin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse (DSHM), në kuadër të Shtabit të SHPK-së. Përgjegjësinë për prokurim dhe financim të parkut të automjeteve e mban Udhëheqësi I Drejtoratit për Financa dhe udhëheqësi I zyrës së prokurimit. Servisimi dhe mirëmbajtja e parkut të automjeteve është përgjegjësi e menaxherit të parkut të automjeteve, i cili është nën Drejtoratin e Logjistikës të DSHM-së. Ky i fundit është përgjegjës për planifikim, organizim, dhe mbikëqyrje të resurseve të alokuara në këtë njësit, si dhe udhëheqjen dhe menaxhimin e personelit në kuadër të komandës së tij. Riparimet, sigurimet, kontrollimet teknike, regjistrimet, inspektimet dhe përgatitjet e statistikave për të gjitha aksidentet që përfshijnë automjetet e SHPK-së kryhen nga njësit i menaxhimit të parkut të automjeteve. Ky njësit gjithashtu mbanë një bazë të të dhënave për të gjitha faturat e derivateve dhe shënimet për servisim të automjeteve.

2.3 Inspektorati policor tregon se menaxheri aktual i parkut të automjeteve është zyrtar policor. Kjo nuk është në pajtim me praktikën e zakonshme në shumë organizata policore të Evropës Veriore, ku për menaxhimin e parkut të automjeteve nevojiten shkathtësi specialiste të cilat mund të ofrohen nga pjesëtarë civil. Punësimi i një menaxheri civil në vend të zyrtarit policor mundëson vazhdimësi më të madhe dhe më pak shpenzime për trajnim të specializuar. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja të rishikojë përbërjen e personelit të menaxhmentit të njësitit të autoparkut dhe të shqyrtojë mundësinë e angazhimit të një specialisti civil për menaxhimin e njërit nga aspektet më të shtrenjta të organizatës së SHPK-së. Grada e shërbyesit civil përgjegjës për parkun e automjeteve duhet të reflektojë nivelin e lartë të përgjegjësisë.

Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja të rishikojë përbërjen e personelit të menaxhmentit të njësitit të autoparkut dhe të shqyrtojë mundësinë e angazhimit të një specialisti civil për menaxhimin e njërit nga aspektet më të shtrenjta të organizatës së SHPK-së. Grada e shërbyesit civil përgjegjës për parkun e automjeteve duhet të reflektojë nivelin e lartë të përgjegjësisë.

2.4 Në prill të vitit 2006, SHPK-ja shkëputi kontratën me një kompani private e cila kishte ofruar servisim dhe mirëmbajtje rutinore⁶⁴. Siç do të diskutohet më vonë, SHPK-ja tanimë përdor një sistem të përzier të servisimit dhe mirëmbajtjes së parkut të vet të automjeteve: shërbime të caktuara ofrohen brenda organizatës nga ana e personelit të SHPK-së për mirëmbajtje të automjeteve ndërsa shërbimet tjera ofrohen nga kompanitë e kontraktuara. Kryerja e servisimeve dhe riparimeve brenda organizatës bëhet në garazhin qendror në Prishtinë, e cila përfshinë bartjen e automjeteve nga rajonet e tyre operative në garazhin qendror për të gjitha format e riparimit dhe servisimit të cilat nuk konsiderohen si dëme të vogla. Për dëmet e vogla, ekzistojnë ekipet lëvizëse të mekanikëve të SHPK-së të cilët vizitojnë regjionet në bazë të orarit të caktuar nga parku i automjeteve të SHPK-së ose, tani ekipe të mekanikëve dhe pajisjeve janë duke u vendosur nëpër qendra regjionale. Deri më tani dy regjione (Mitrovicë dhe Ferizaj) janë pajisur me pajisje për një sistem të decentralizuar të kryerjes së riparimeve dhe servisimeve të vogla por puna ende nuk ka filluar.

2.5 Politika e decentralizimit të riparimeve dhe servisimeve të vogla ishte prezantuar nga menaxherët e SHPK-së gjatë 12 muajve të fundit, si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj ankesave të komandantëve regjional dhe atyre të stacioneve se shumë automjete nuk ishin në dispozicion si pasojë e pritjes për riparim, nën një sistem plotësisht të centralizuar. Këto ankesa dhe mundësia e decentralizimit të mirëmbajtjes dhe servisimit janë përfshirë në Raportin e Përkohshëm të IPK-së për Inspektim Nr. 2/2006 (Mënyra e kryerjes së detyrave në menaxhmentin e parkut të automjeteve të SHPK-së). Inspektorati Policor mirëpret këtë iniciativë të zyrtarëve të lartë përkatës të SHPK-së si një shembull i një politike të suksesshme për rritjen e efektshmërisë operative.

2.6 Furnizimi me derivate për automjetet të SHPK-së bëhet në bazë të një rrjeti të kompanive lokale të derivateve të cilat i nënshtrohen kontratave të autorizuara dhe proceseve normale të tenderimit

⁶⁴ Më shumë hollësi lidhur me këtë kompani dhe përfundimin e kontratës mund të gjenden në Raportin e Përkohshëm për Inspektim të IPK-së Nr. 2/2006 (Mënyra e kryerjes së detyrave në menaxhmentin e parkut të automjeteve të SHPK-së).

Gjendja aktuale

3.1 Parku i automjeteve në SHPK posedon gjithsejtë 1138⁶⁵ automjete, 38 më pak se në vitin 2006, që do të thotë një automjet për çdo 6.3 zyrtarë të SHPK-së, në vitin 2007. Për fat të keq nuk ekzistojnë të dhëna nga organizatat policore fqinje lidhur me raportin polic/automjet. Megjithatë, krahasimi me organizatat policore me përzjerje të ngjashme urbane/rurale në Mbretërinë e Bashkuar⁶⁶ tregon se numri i automjeteve të SHPK-së është më i ulët se sa që do të mund të ishte, por shumë i shtrenjtë për shkak të llojit të automjeteve të përdorura. Buxheti total i caktuar i SHPK-së për vitin 2007 është vetëm 56.6 milion€: kjo paraqet 0.4% rënie në buxhet nga viti 2006.. Figura 1 paraqet një analizë të fondeve të alokuara për parkun e automjeteve të SHPK-së për vitin 2007– prandaj shpenzimet totale prej 10.8 milion € paraqesin 19% të buxhetit total të SHPK-së. Shpenzimet e parkut të automjeteve të SHPK-së (10.8 milion€) janë të konsiderueshme, veçanërisht nëse merret parasysh se ato paraqesin 38.7% të shpenzimeve totale të pagave dhe në vitin 2007 (27.9 milion€). Megjithatë Inspektorati Policor vëren se shpenzimet e përgjithshme për mirëmbajtjen e parkut të automjeteve të SHPK-së janë zvogëluar për 2.3 milion€ nga viti 2006.

3.2 Me përjashtim të shpenzimeve për zëvendësimin e automjeteve dhe autobusëve, fondet e alokuara për derivate dhe mirëmbajtje të parkut të automjeteve të SHPK-së (7.0 milion€) për 1138 automjete janë bars me 6,000 € në vit. Ndonëse në vlerë më të vogël se në vitin 2006, shpenzimet për funksionimin e çdo automjeti vazhdojnë të jenë shumë të larta për shkak të shpenzimeve të derivateve dhe mirëmbajtjes. Ngjashëm me organizatat tjera policore, SHPK-ja ballafaqohet me sfidën e krijimit të një strategjie afatgjate për parkun e automjeteve e cila bazohet në nevojën e zvogëlimit të shpenzimeve të derivateve dhe mirëmbajtjes, duke ofruar në të njëjtën kohë automjetet më të përshtatshme në numër të mjaftueshëm. Ajo detyrë duhet të fillojë duke shikuar më për së afërmi përvojën e organizatave tjera policore në regjionin e Ballkanit dhe më larg, duke hulumtuar për strategjitë e tyre të parkut të automjeteve dhe duke mbledhur të dhëna të dobishme. Pa dyshim, do të shihet se shumica e organizatave policore nuk posedojnë një numër të madh të automjeteve 'që tërheqin me katër rrota' 4x4 për shkak të shpenzimeve të larta për derivate dhe pjesëve rezervë.

⁶⁵ Vëreni se duket të ekzistojnë parregullësi lidhur me madhësinë e saktë të parkut të automjeteve të SHPK-së në vitin 2007: në bazë të një burimi ekzistojnë 1138 automjete dhe në bazë të një burimi tjetër 1113 (shih figurën 3).

⁶⁶ Në shtator të vitit 2007 Policia e Avon-it dhe Somerset-it, në Mbretërinë e Bashkuar kanë patë një automjet për çdo 5.1 policë (3,398 policë dhe 660 automjete), por shumica e automjeteve janë vetura të zakonshme.

Tabela 1: Përmbledhje e fondeve të caktuara për parkun e automjeteve të SHPK-së –Buxheti për 2007

Fushat e financimit	EURO
Mirëmbajtja	1,613,254
Sigurimi	250,000
Kontrollimi teknik	70,000
Regjistrimi	70,000
Derivatet	4,958,500
Automjetet e reja	3,000,000
Autobusët	825,000
Garazhet regjionale	100,000
Totali	10,886,754

3.3 Sidoqoftë, Inspektorati Policor e mirëpret përpjekjen aktuale në mesin e menaxherëve përkatës të SHPK-së për ta zvogëluar çmimin e derivateve dhe të mirëmbajtjes. Tabela 2 ofron të dhëna krahasuese në lidhje me tri vitet e fundit, dhe tregon zvogëlim të konsiderueshëm të fondeve të caktuara për derivate dhe mirëmbajtje. Çmimet globale të derivateve kanë qenë jashtëzakonisht të larta në dy vitet e fundit dhe kjo e rrit vështirësinë e menaxhimit të shpenzimeve në SHPK. Në vitin 2007 derivatet paraqesin 45.3% (€4.9 milion) të buxhetit total të fondeve të përgjithshme të caktuara për parkun e automjeteve, apo 8.6% të buxhetit të përgjithshëm të SHPK-së. Edhe pse shpenzimet e derivateve përfshijnë derivatet për gjeneratorët elektrik, pjesa kryesore e këtyre shpenzimeve është për derivate të automjeteve. Në të njëjtën kohë, Inspektorati Policor këshillon se zvogëlimi i mëtutjeshëm në konsumimin e derivateve duhet të krijojë një synim të rëndësishëm në strategjinë e parkut të automjeteve të SHPK-së.

**Tabela 2: Përmbledhje e fondit të caktuar për parkun e automjeteve të SHPK-së –
2005, 2006 dhe 2007 të krahasuara**

Kategoria	2005 Milion EURO	2006 Milion EURO	2007 Milion EURO	2006/7 Krahasimi +/- %
Derivate	4.81	5.47	4.9	- 9.3%
Mirëmbajtja e automjetit	4.87	3.36	1.6	- 51.6%
Riparimi i automjetit	0.474	0.476	N/D	N/D

3.4 Tabela 3 ofron të dhëna në lidhje me shpërndarjen e automjeteve të SHPK-së në vitin 2007 dhe tregon vetëm ndryshime të vogla nga shpërndarja e tyre gjatë vitit 2006. Parku përfshinë automjetet e rëndomta të rrugëve (73), 'që tërheqin me katër rrota' 4X4 (945), kombit (43), motoçikletat (24), minibusët (9), autobusët (9), kamionët (11) dhe kamionat tërheqës (6). Prandaj mbi 80% e parkut përbëhet prej automjeteve 'që tërheqin me katër rrota' 4X4 dhe kjo ndoshta i shpjegon shpenzimet e mëdha të derivateve dhe të mirëmbajtjes, si dhe investimet e konsiderueshme kapitale të kërkuara për t'i siguruar këto automjete të shtrenjta. Numri më i madh i automjeteve (22%) gjenden në Shtabin e SHPK-së, prej të cilëve shumica janë 'që tërheqin me katër rrota'. Ndoshta informata më dëshpëruese e treguar në tabelën 3 është përqindja e automjeteve të SHPK-së që nuk janë të gatshme për përdorim. Edhe pse të dhëna të tilla nuk ishin në dispozicion për Shtabin e SHPK-së, përqindja e kombinuar e automjeteve të cilët iu nënshtrohen mirëmbajtjes dhe riparimit në regjione është gati 33% – një e treta e parkut në përgjithësi. Kjo paraqet një keqësim të konsiderueshëm të performancës që nga viti 2006, kur 15.2% të automjeteve të SHPK-së ishin jashtë përdorimit⁶⁷.



⁶⁷ Shih raportin e përkohshëm të IPK-së nr.2/2006 (Performanca e menaxhmentit të parkut të automjeteve të SHPK-së).

Tabela 3: Shpërndarja e automjeteve të SHPK-së (gusht 2007)⁶⁸

Regjioni	Numri i automjeteve të SHPK-së	Përqindja në total	Përqindja e automjeteve të iu nënshtrohet servisimit/riparimit
Shtabi Qendror (SHQ)	245	22%	N/D
Prishtinë	206	18.5%	37.8%
Pejë	128	11.5%	46.8%
Mitrovicë	132	11.8%	30.3%
Prizren	129	11.5%	29.4%
Gjilan	105	9.4%	25.7%
Ferizaj	72	6.4%	30.5%
Policia kufitare	96	8.6%	21.8%
Totali	1113	-	[32.9%]

3.5 Mbi 32% e parkut nuk është në dispozicion për përdorim operativ dhe është çështje e një shqetësimi të madh, dhe Inspektorati Policor edhe njëherë nxit zyrtarët e lartë të SHPK-së që ta shqyrtojnë këtë çështje nëpërmes të një strategjie gjithpërfshirëse të parkut të automjeteve. Sikurse në vitin 2006, periudha e tejzgatur gjatë së cilës automjetet iu nënshtrohen servisimit dhe riparimit ishte shkaku kryesor i ankesave në lidhje me automjetet në regjionet e SHPK-së. Në bazë të të dhënave të ofruara, Inspektorati Policor nuk e ka të qartë se pse ky problem është keqësuar. Duket të jetë si rezultat i numrit të lartë të vazhdueshëm të aksidenteve të SHPK-së, të një sistemi të pamjaftueshëm të mirëmbajtjes dhe riparimit, pamundësisë që pa vështirësi të sigurojë pjesë për një park i cili përfshin një llojllojshmëri të gjërë të modeleve dhe vjetërsi të parkut. Tabela 4 ofron një analizë të shkurtë të vjetërsisë së parkut të SHPK-së dhe tregon se gati 50% e automjeteve në park janë prodhuar para vitit 2003. Automjetet e policisë, ndryshe nga automjetet e rëndomta përdoren tërë ditën gjatë tërë vitit, akumulojnë numër të madh të kilometrave dhe janë të qëndrueshme ndaj kërkesave të larta për përdorimin e tyre. Është e qartë se niveli mesatar i automjeteve të policisë e arrin pikën kur bëhet jo ekonomike më herët sesa automjetet që shfrytëzohen për nevoja private apo në fusha të tjera në sektorin publik: numri i madh i kilometrave dhe

⁶⁸ Vëreni se duket të ekzistojnë parregullësi lidhur me madhësinë e saktë të parkut të automjeteve të SHPK-së në vitin 2007: në bazë të një burimi ekzistojnë 1138 automjete (shih paragrafin 3.1) dhe në bazë të një burimi tjetër 1113.

përdorimi i përgjithshëm nënkuptojnë atë që për tri vite bëhet shumë shtrenjtë për t'u riparuar, furnizuar me derivate dhe për t'u mirëmbajtur. Startegjia e parkut të automjeteve duhet të merr përgjegjësi për këta faktorë dhe duhet ta gjejë mënyrën më të mirë për shfrytëzimin e parave të taksapaguesve. Disa organizata policore e kanë kuptuar se bilanci më i mirë në mes të nevojës për ekonomizim (d.m.th. ofrimin e një parku të automjeteve me shpenzime minimale) dhe nevojës për automjete sa më efektive dhe të sigurta policore është politika e mbajtjes së automjeteve për vetëm tri vite dhe pastaj ngritjen e 'vlerës së mbetur' me anë të shitjes në ankand.

Tabela 4: Vjetërsia e parkut të automjeteve të SHPK-së

Viti i prodhimit	Numri i automjeteve	Përqindja në total
Para-1999	20	1.7%
1999	33	2.9%
2000	145	12.7%
2001	132	11.6%
2002	217	19.1%
2003	327	28.8%
2004	7	0.6%
2005	203	17.9%
2006	49	4.3%
2007	1	
Totali	1134	

3.6 Deri më tani, Inspektorati Policor nuk ka hasur në ndonjë strategji të shkruar në lidhje me parkun e automjeteve, e cila qartë definon planin afatgjatë, të bazuar në një marrëveshje të sigurtë dhe në fakte financiare. Ndoshta ekziston nevoja për SHPK-në që plotësisht ta rishikojë përvojën e vet në sigurim dhe në mirëmbajtjen e automjeteve gjatë viteve të fundit, si dhe krahasimin me përvojën e Maqedonisë, Malit të Zi dhe të Shqipërisë. Është koha e duhur për një rishikim të hollësishëm dhe gjithpërfshirës, për shkak të investimeve të konsiderueshme në automjete të SHPK-së, performancës së dobët të menaxhimit aktual të mirëmbajtjes, gjendjes së dobët të shumë automjeteve të SHPK-së dhe numrit të madh të automjeteve të shtrenjta të cilat tërheqin me katër rrota. Të dhënat e mbledhura në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen nga Ministria dhe zyrtarët e lartë të SHPK-së për miratimin e një

strategjie në të ardhmen, e cila paraqet shrytëzimin më të mirë të fondeve publike dhe ka gjasa që të sigurojë që zyrtarët e SHPK-së të kenë qasje në automjete të sigurta dhe të qëndrueshme.

Rekomandimi kryesor Nr. 2

Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja ta rishikoj tërësisht përvojën e vet të sigurimit dhe të mirëmbajtjes së automjeteve gjatë disa viteve të fundit, si dhe ta krahasojë atë me përvojën në Maqedoni, Mal të Zi dhe Shqipëri. Të dhënat e mbledhura në këtë mënyrë pastaj mund të përdoren nga Ministria dhe nga zyrtarët e lartë të SHPK-së në mënyrë që të bien dakord për një strategji e cila përfaqëson përdorimin më të mirë të fondeve publike dhe ka gjasa që të sigurojë që zyrtarët e SHPK-së të kenë qasje në automjete të sigurta dhe të qëndrueshme.

3.7 Numri i madh i aksidenteve në trafik ku përfshihen automjetet e SHPK-së vazhdon të mbetet një arsye e madhe për brengosje. Tabela 5 tregon se, edhe përkundër keqësimit në vitin 2006, numri mesatar i aksidenteve të tilla është në rritje për gati një në ditë, sikurse në periudhën para vitit 2006. Duhet të vërehet se numri i aksidenteve të cilat ceken në tabelën 5 përfshijnë sferën e plotë, nga ato me dëme të vogla deri te ato me dëme të konsiderueshme si dhe lëndimet e zyrtarëve policore dhe të pjesëmarrësve tjerë në rrugë. Edhe pse të gjitha aksidentet nuk janë shkaktuar për shkak të gabimit të ngasësve të SHPK-së, vazhdimi i këtij niveli të lartë tregon se problemi nuk është menaxhuar nga mbikëqyrësit e SHPK-së.

Tabela 5: Numri i aksidenteve ku janë përfshirë automjetet e SHPK-së

Krahasimi në vite

Viti	2003	2004	2005	2006	2007 (janar – gusht)
Numri i aksidenteve	444	451	636	223	227
Numri mesatar i aksidenteve në ditë	1.2	1.2	1.7	0.6	0.9

3.8 Tabela 6 tregon numrin e automjeteve të SHPK-së të përfshira në aksident në secilin regjion gjatë tetë muajve të parë të vitit 2007, dhe gjithashtu përqindjen e rasteve ku ngasësi i automjeteve SHPK-së është identifikuar si fajtor (d.m.th. gabimi i ngasësit të SHPK-së ka qenë shkak i aksidentit). Mesatarja e përgjithshme tregon se shumica e aksidenteve të SHPK-së kanë qenë si shkak i fajtit të ngasësve që kanë qenë zyrtarë policor, dhe në disa regjione mesatarja arrin deri në 70 %. Është e qartë se nuk është arritur asnjë përparim në këtë fushë të performancës së menaxherëve të SHPK-së, edhe përkundër vërejtjes dhe rekomandimeve të bëra nga Inspektorati

Policor në vitin 2006⁶⁹. Edhe pse komandantët regjional dhe personeli i Shtabit Qendror vazhdon ta shprehë pakënaqësinë lidhur me efektshmërinë e procedurave të zgjatura për ballafaqimin me zyrtarët policor të cilët shkaktojnë aksident, me paramendim apo për shkak të pakujdesisë, ekziston vetëm një strategji e kufizuar lidhur me trajtimin e këtij problemi të madh. Është krijuar një komision (I përbërë prej përfaqësuesve nga Drejtoria e Personelit, Drejtoria e Trafikut, zyra ligjore dhe zyra e financave) për ta rishikuar secilin rast dhe për të japur mendimin lidhur me nivelin e përgjegjësisë (ose obligimit) dhe shqiptimin e dënimeve për punonjësit përkatës të SHPK-së. Deri më tani ky komision ka trajtuar vetëm tetë raste dhe Inspektoratit Policor nuk iu janë ofruar të dhëna tjera. Inspektorati Policor do ta rishikojë efektshmërinë e kësaj qasjeje pas një periudhe kohore prej 12 muajsh.

3.9 Strategjia e cila ekziston në lidhje me hetimin e një aksidenti në komunikacion (nga ana e Njësitit Regjional i Aksidenteve të Trafikut Rrugor), e përcjellur nga hetimi i Njësitit për Standarde Profesionale nuk funksionon. Sikurse në vitin 2006, ka më pak veprime të ndërmarra disiplinore dhe shpesh zyrtarët policor përkatës vazhdojnë t'i ngasin automjetet e policisë⁷⁰. Përndryshe, policët përkatës shumë rallë iu nënshtohen ndonjë dënimi me të holla për ndonjë dëm të konsiderueshëm që ia shkaktojnë automjeteve të shtrenjëta. Për këtë arsye, Inspektorati Policor nxit SHPK-në që ta rishikojë procedurën e vet në lidhje me zyrtarët policor të cilët iu shkaktojnë dëme automjeteve të SHPK-së, pa marrë parasysh nëse i bëjnë ato me paramendim apo nga pakujdesia. Ky proces duhet të merr parasysh dispozitën e re të Urdhresës Administrative 2006/9 (shkeljet disiplinore që kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës policore), dhe të marre parasysh përdorimin e diskualifikimit të menjëhershëm nga ngasja dhe dënimin e duhur me të holla.

Rekomandimi kryesor

Nr. 3

Inspektorati Policor nxit SHPK-në që ta rishikojë procedurën e vet në lidhje me zyrtarët policor të cilët iu shkaktojnë dëme automjeteve të SHPK-së, pa marrë parasysh nëse i bëjnë ato me paramendim apo nga pakujdesia. Ky proces duhet të merr parasysh dispozitën e re të Urdhresës Administrative 2006/9 (shkeljet disiplinore që kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës policore), dhe të marre parasysh përdorimin e diskualifikimit të menjëhershëm nga ngasja dhe dënimin e duhur me të holla.

⁶⁹ Shih raportin e përkohshëm të IPK-së nr.1 /2006 (Performanca e menaxhimit të SHPK-së në trafikun rrugor).

⁷⁰ Duhet të dihet se kjo nuk është konfirmuar duke iu referuar të dhënave nga Njësi për Standarde Profesionale gjatë rrjedhës së këtij inspektimi të rëndomtë.

Tabela 6: Analizimi i aksidenteve ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së (Janar – Gusht 2007)

Regjioni	Numri i aksidenteve të SHPK-së	Ngasësit e SHPK-së fajtorë?		% e aksidenteve të shkatuara për shkak të fajit të SHPK-së
		Po	Jo	
SHQ i SHPK-së	54	22	32	40.74
Kufiri	17	11	6	64.71%
Prishtinë	37	19	18	51.35
Pejë	21	10	11	47.62
Prizren	42	23	19	54.76
Mitrovicë	22	15	7	68.18
Gjilan	25	13	12	52.00
Ferizaj	9	6	3	66.67
Totali	227	119	108	52.4

3.10 Sikurse me aksidentet tjera në përgjithësi (shih raportin e përkohshëm nr. 6/2007 – Performanca e SHPK-së mbi menaxhimin e trafikut rrugor), Inspektorati Policor vërejtë se SHPK-së i mungojnë të dhënat analitike në lidhje me faktorët kryesorë ⁷¹ të shkaqeve të aksidenteve në SHPK – një mjet esencial menaxhues në zhvillimin strategjisë për zvogëlimin e aksidenteve të tilla. Sidoqoftë, detyrat për identifikimin e faktorëve të tillë shkakor duhet të jenë të arritshme pa vështirësi, duke iu referuar raporteve të aksidentit që përgatiten për secilin incident. Ekziston një konsensus në mesin e personelit të lartë të SHPK-së se shumica dërrmuese e aksidenteve të SHPK-së janë si rezultat i shkathtësive të papranueshme të ngasjes në mesin e zyrtarëve policor përkatës.

Rekomandimi kryesor

Nr. 4

SHPK-ja nxitet që të krijojë dhe implementojë një sistem krahasues të faktorëve shkakor të aksidenteve nga raportet e hetimeve të aksidentit, për të gjitha aksidentet ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së. Të dhënat përfundimtare duhet të përdoren nga zyrtarët e lartë për identifikimin e hapave të duhura në mënyrë që të zvogëlohen aksidentet e tilla, si pjesë e politikave të përgjithshme dhe e strategjisë përkatëse.

⁷¹ Shprehja 'faktor shkakor' i referohet faktorit i cili është përkufizuar si shkak kryesor i aksidentit (p.sh. shpejtësia e madhe, gabimi i ngasësit, kushtet e këqija në rrugë, automjetet me defekte), pa marrë parasysh nëse veprojnë të vetme apo në kombinim me shkaqet tjera kryesore.

4 Politika dhe strategjia

4.1 Sipas personelit të SHPK-së të cilët janë intervistuar, aktualisht, nuk ekziston asnjë strategji dhe politikë e shkruar e SHPK-së⁷² në lidhje me parkun e automjeteve të SHPK-së. Kjo është e papranueshme, duke pasur parasysh faktin se mirëmbajtja e parkut paraqet 19% të buxhetit vjetor të SHPK-së (duke mos përmendur investimet e konsiderueshme kapitale në vet parkun e automjeteve). Siç theksohet nga Inspektorati Policor në vitin 2006⁷³, SHPK-ja duhet ta definojë shpejt një strategji të planifikuar me kujdes. Një numër i çështjeve të ndara por në të njëjtën kohë të lidhura me të duhet të cekën në politikën e parkut të automjeteve dhe në strategjinë përkatëse:

- Numri e nevojshëm, tipin dhe shpërndarja e automjeteve në mbështetje të veprimeve të SHPK-së, në bazë të formulës së definuar në mënyrë të qartë;
- Programi i menaxhuar në lidhje me secilin automjet, që nga prokurimi e deri te shitja përfundimtare, që siguron vlerën maksimale për të hollat e taksapaguesve në planet afat-gjate;
- Mirëmbajtja ekonomike dhe efikase dhe sistemi i riparimit që i përmbush nevojat operative të SHPK-së në nivel lokal;
- Masa për ta shtuar ndjenjën e 'pronësisë' dhe përgjegjësisë për automjetet e SHPK-së në nivele lokal; dhe
- Një sistem rigoroz të menaxhimit të ngasësve policor dhe zvogëlimin e aksidenteve dhe dëmeve të automjeteve të SHPK-së.

Këto tani do të diskutohen në më shumë hollësi.

Rekomandimi kryesor

Nr. 5

SHPK-ja këshillohet që ta fillojë një proces të krijimit të një politike gjithpërfshirëse të parkut të automjeteve dhe strategjinë implementuese në lidhje me prokurimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e parkut të automjeteve. Ky proces i krijuar duhet të frymëzohet nga parimi i ekonomizimit dhe i udhëzuar nga një plan gjithpërfshirës policor që i njeh anët pozitive dhe kufizimet e patrullave mobile (automjetet) në përmbushjen e synimeve të SHPK-së.

⁷² Është me rëndësi që është e qartë se çfarë Inspektorati Policor mendon me këto shprehje. *Politika* është përmblendhje idesh që janë të formuluar si deklaratë në lidhje me veprimet e menduara të SHPK-së lidhur me përdorimin e njohur të automjeteve për plotësimin e synimeve të SHPK-së. Politika e parkut të automjeteve tregon qëllimet specifike të cilat zyrtarët e lartë përkatës kanë për qëllim që t'i arrijnë përgjatë periudhës së definuar kohore. Kurse, strategjia është plan në hollësi për arritjen e këtyre qëllimeve të paraqitura në këtë dokument të politikës. Strategjia e parkut të automjeteve duhet t'i ofrojë udhëzime në hollësi menaxherëve përkatës për administratë dhe komandantëve regjional dhe të shtabit në lidhje me atë se çfarë duhet të bëhet, taktikat dhe metodat e preferuara, si dhe burimet të cilat do të jenë në dispozicion.

⁷³ Shih raportin e përkohshëm të IPK-së nr.1/2006 (Performanca e menaxhimit të SHPK-së në trafikun rrugor).

4.2 Politika e parkut të automjeteve duhet t'i shqyrtojë pyetjet themelore të llojit optimal të automjeteve për shfrytëzim nga ana e policisë, si dhe madhësinë e duhur dhe shpërndarjen e automjeteve. Përgjigjet në pyetje të tilla duhet ta marrin parasysh nevojën për shpenzime minimale operative, si dhe të merret parasysh përvoja dhe politika e organizatave policore në shtetet fqinje në regjionin e Ballkanit më shumë sesa në organizatat e vendeve ku ekonomia është e zhvilluar. Për këtë është me rëndësi se asnjë vend në regjion nuk ka investuar aq shumë automjetete 'që tërheqin me katër rrota' (4X4)⁷⁴: politikat efektive preferojnë parqe të vogla me vetura standarde të cilat ofrojnë shpenzime më të vogla të derivateve dhe qasje më të lehtë dhe më të lirë për pjesë/servisim.

4.3 Siç shihet në tabelën 7, gjithsejt mbi 14 milion € janë investuar në automjetet e SHPK-së dhe në pjesë që nga viti 2003: gjithsejt 9.79 milion € janë investuar në blerjen e automjeteve të reja. Politika e parkut të automjeteve duhet të drejtohet nga nevoja për t'i zvogëluar shpenzimet dhe për ta identifikuar numrin optimal dhe llojin e automjeteve në bazë të kërkesave të njohura të policisë operative, siç praktikohet në Evropën Perëndimore dhe Amerikën Veriore. Kërkesat operative kanë të bëjnë me kërkesat reaktive (numri mesatar dhe lloji i incidenteve që kërkojnë reagim të menjëhershëm) dhe kërkesa proaktive (numri mesatar dhe lloji i masave proaktive policore që kërkojnë përdorim të automjetit). Në këtë mënyrë, planet policore lokale që kërkojnë sipas Rregullores 2005/54 do t'i ofrojnë të dhëna esenciale atyre që e përgatitin politikën e parkut të automjeteve.

Tabela 7: Investimi kapital në automjetet e SHPK-së (2003 – 2007)

Viti	Shpenzimet në pjesët e e automjeteve Miliona EURO	Shpenzimet e prokurimit të automjeteve Miliona EURO	Investimi total Miliona EURO
2003	0.29	4.96	5.25
2004	1.96	0.53	2.49
2005	1.69	1.3	2.99
2006	0.46	0	0.46
2007	N/K	3.0	3.0
Totali	4.4	9.79	14.1

⁷⁴ Mbi 80% e automjeteve të SHPK-së janë automjetete që tërheqin me katër rrota, përfshirë këtu Toyota Land Cruiser, Land Rover Defender, dhe kryesisht KIA Sportage dhe modelet e Sorentos.

Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së këshillohen që t'i rishikojnë madhësinë e parkut të automjeteve, llojin e automjeteve në përdorim dhe shpërndarjen e tyre në mbështetje të masave proaktive dhe reaktive policore. Duhet të krijohen lidhje me planet lokale policore të përgatitura në bazë të Rregullores 2005/54.

4.4 Edhe pse Inspektorati Policor nuk ka parë asnjë politikë të shkruar, është bërë e ditur se SHPK-ja tani do të heqë dorë nga bindja e tyre në automjete të shtrenjëta 'që tërheqin me katër rrota' dhe do të ndjekë politikën e blerjes së automjeteve të rëndomta. Organizata ka bërë të ditur blerjen e më shumë se 100 Volkswagen Golf të ri dhe Toyota-ve në vitin 2007. Planifikohet që të blehen edhe 250 automjete të reja për vitin 2008. Inspektorati Policor e mirëpret këtë veprim si pjesë e përpjekjeve të SHPK-së për të siguruar një park më ekonomik, duke zvogëluar konsumimin e derivateve dhe shpenzimet e mirëmbajtjes.

4.5 Deri më tani, politika e SHPK-së duket të ketë përfshirë shfrytëzimin e çdo automjeti deri sa është bërë ekonomikisht i papërdorshëm (d.m.th. më i vjetër se 7 vjet apo me mbi 250,000 km të kaluara). Është marrë një vendim formal se nuk ka levërdi nga riparimi i automjeteve, dhe pastaj kur automjeti prishet: pjesët e dobishme përdoren në parkun e automjeteve për qëllime të ndryshme dhe çdo mbeturinë e mbetur nga metali shitet. Në bazë të Udhëzimit Administrativ 2005/11 (Menaxhimi dhe rezhistrimi i pasurive qeveritare), SHPK-ja ka krijuar një Bord Ekzekutiv për ta rishikuar pronën dhe është kanë ardhë në përfundim se të gjitha automjetet e SHPK-së të cilat shfrytëzohen më shumë se 7 vite duhet të "shlyhen" dhe të hidhen. Deri më tani 132 automjete janë shlyer: disa prej tyre janë shitur përmes ankandit, një numër i tyre janë çmontuar dhe janë përdorë për pjesë, dhe të tjerat janë shitur si hekur. Inspektorati Policor e mirëpret iniciativën aktuale nga menaxheri i parkut të automjeteve i cili është duke shqyrtuar përmirësim në nenin 8.1 të Udhëzimit Administrativ 2005/11, i cili definon rregullat e përgjithshme të amortizimit të automjeteve dhe vendimin për ta çmontuar apo shitur automjetin. Ndyshimi i propozuar do të merret parasysh në kushte të veçanta të automjeteve, përfshirë numrin e madh të kilometrave dhe shkallën e lartë të përdorimit. Në vend të rregullës aktuale në lidhje me 7 vjet, është propozuar që automjetet e policisë duhet të merren parasysh për shitje në ankand apo nxjerrjen jashtë përdorimit pas 4 viteve apo kur ato të kenë kaluar 150,000 kilometra. Një ndryshim i tillë do të ndihmojë në zhvillimin e një strategjie të përmirësuar të parkut të automjeteve, duke e kompensuar vlerën e mbetur të automjeteve me anë të shitjes në ankand dhe duke iu shmangur shpenzimeve të mëdha në mirëmbajtjen e automjeteve më të vjetra se 4 vjet apo me mbi 150,000 kilometra të kaluara.

4.6 Inspektorati Policor edhe njëherë nxit zyrtarët e lartë të SHPK-së, si pjesë e Politikës së Parkut të Automjeteve, që sa më shpejtë që është e mundur të zhvillojë një grumbull masash efektive për ta ndaluar shkallën e lartë të papranueshme të aksidenteve ku përfshihen automjetet e SHPK-së, duke qenë të vetëdijshëm për


rrezikun për jetë, shpenzimet e konsiderueshme të taksapaguesve⁷⁵, dhe efektet e kundërta në imazhin profesional të SHPK-së. Një strategji e tillë duhet të informohet nga të dhënat e forta analitike në lidhje me shkaqet e aksidenteve, veprimet riparuese të cilat lidhen me shkaqet kryesore dhe përfshijnë një procedurë të fortë për ballafaqimin me zyrtarët policorë të cilët me vetëdije apo nga pakujdesia shkaktojnë aksidente. Gjithashtu zyrtarët e lartë të SHPK-së këshillohen që me kujdes të marrin parasysh përvojën dhe strategjitë e adoptuara nga organizatat atjera policore në regjionin e Ballkanit gjatë zhvillimit të strategjisë për zvogëlimin e aksidenteve të shkaktuara nga zyrtarët policor.

Rekomandimi kryesor

Nr. 7

Si pjesë e Politikës së Parkut të Automjeteve të SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së nxiten që të krijojnë dhe implementojnë një sistem më të fuqishëm për zvogëlimin e numrit të aksidenteve ku përfshihen automjetet e SHPK-së.

⁷⁵ Inspektorati Policor ka dëshmi të dokumentuara lidhur me 40 automjete të SHPK-së (3.41% e parkut të automjeteve) të cilat janë shkatërruar plotësisht gjatë aksidenteve që nga viti 2001.



Raport i përkohshëm i inspektimit 8
**Kryerja e detyrave nga ana SHPK-së
në menaxhimin e objekteve**

KRYERJA E DETYRAVE NGA ANA E SHPK-së NË MENAXHIMIN E OBJEKTEVE

1. HYRJE

1.1 Inspektimi i tetë i rëndomtë është bërë më datën 3, 4 dhe 5 tetor të vitit 2007, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim është udhëhequr nga z. Enver Rustemi, Kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 18 inspektorëve. Vizitat janë bërë në Shtabin Qendror në Prishtinë, në të gjitha regjionet dhe në disa stacione policore nëpër Kosovë. Pa përjashtim, Inspektorët hasën në bashkëpunim të kënaqshëm nga ana e pjesëtarëve të SHPK-së.

1.2 Në gusht të vitit 2007 Ministria publikoi planin e vet strategjik për periudhën 2007-2010. Një numër karakteristikash të planit strategjik kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me menaxhimin e pronës së patundshme dhe të infrastrukturës së SHPK-së. Veçanërisht në bazë të synimit strategjik 1, Ministria do të përpiqet të zhvillojë shërbime policore që janë "efektive, efikase, të drejta dhe transparente". Fusha kryesore e rezultateve (FKR) 1.2, i referohet synimit të Ministrisë mbi zgjerimin e SHPK-së në tërë Kosovën, duke e përfshirë edhe rishqyrtimin dhe dakordimin e Planit Strategjik të SHPK-së në fushën e shpenzimeve dhe pajisjeve kapitale. Prandaj detyra e zhvillimit dhe e implementimit të një strategjie gjithëpërfshirëse për të zhvilluar dhe ruajtur pronën dhe objektet e SHPK-së është një çështje me rëndësi për Ministrinë, dhe ky raport mbi inspektimin do të jetë një burim i rëndësishëm i dëshmive në procesin e rishikimit nga ana e Ministrisë.

1.3 Prona e SHPK-së përbëhet nga numër i madh i ndërtesave, të cilat më parë ishin përdorur nga policia në nivel komunal, krahinor dhe në nivel të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, para ardhjes së Administratës së Kombeve të Bashkuara, sipas RKS KB-së 1244. Prona e patundshme e policisë në Kosovë është dëmtuar për vite me radhë si rezultat i pakujdesisë dhe mungesës së investimeve dhe megjithëse procesi i renovimit dhe modernizimit të stacioneve policore dhe ndërtesave të tjera të SHPK-së ka filluar, kjo kërkon shpenzime të konsiderueshme dhe në planin afatmesëm do të paraqesë një sfidë të madhe financiare.

1.4 Qëllimi i inspektimeve në këtë inspektim të rëndomtë është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtuueshmëria me standardet relevante brenda *Kodit Evropian të Etikës Policore* (KEEP-së);
- Pajtuueshmëria me synimin strategjik 1 të Ministrisë së Punëve të Brendshme' *Plani Strategjik 2007 - 2010*;
- Të nxitet menaxhimi profesional i ndërtesave dhe objekteve policore;

- Të ndihmohet përmirësimi i gjendjes së ndërtesave dhe objekteve që përdoren nga zyrtarët SHPK-së, personat e paraburgosur dhe qytetarët tjerë; dhe
- Të identifikohet dhe të shpërndalet praktika më e mirë.

1.5 Gjatë periudhës së inspektimit personeli i IPK-së vizitoi stacionet policore dhe objektet tjera të SHPK-së si dhe intervistoi punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Asistentin e Zv. Komisarit për Administratë;
- Kryesuesin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të SHPK-së;
- Drejtoreshën në Drejtorinë për Menaxhimin e Objekteve të SHPK-së;
- Udhëheqësin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Shefin e Prokurimit;
- Komandantët Regjional;
- Komandantët e stacioneve ; dhe
- Zv. komandantët e stacioneve.

1.6 Nëpërmes të një bashkëpunimi të mirë të personelit përkatës të zyrtarëve të lartë të SHPK-së, Inspektorati Policor siguroi një numër të mjaftueshëm të të dhënave, duke përdorur protokollin mbi menaxhimin e objekteve⁷⁶. Ky raport nuk i paraqet të gjitha informatat dhe të dhënat e siguruar gjatë inspektimit, mirëpo përqendrohet në çështjet kryesore të menaxhmentit, e që Inspektorati Policor mendon se janë fusha të rëndësishme për zhvillim organizativ në fushën e menaxhimit të objekteve dhe të ndërtesave.

1.7 Ky raport është i përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike, që përkrahët nga neni 19 i Kodit Evropian të Etikës Policore.

2. KRYERJA E DETYRAVE NË MENAXHIMIN E OBJEKTEVE

Organizimi

2.1 Menaxhimi i mirëmbajtjes së objekteve është i centralizuar nën administratën e SHPK-së, në Komandën Kryesore. Administrata e SHPK-së e cila gjendet në Prishtinë dhe në regjione është e ndarë në tri departamente kryesore; në Departamentin e Shërbimeve Administrative, Departamentin e Trajnimeve dhe në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse. Nën këtë të fundit bën pjesë Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve me gjithsejtë 103 punonjës. Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve është një fushë e re dhe në zhvillim, nën kompetencat e menaxhmentit të SHPK-së dhe përbëhet nga një ekip i madh arkitektësh, inxhinierësh dhe specialistë tjerë. Në bazë

⁷⁶ Paragrafi 1(e) i Urdhëresës Administrative 2006/9 definojnë termin "protokoll" si një udhëzim me shkrim që definojnë procedurat operative. Përmban një numër të pyetjeve në lidhje me temat mbi menaxhmentin (p.sh. Kryerja e detyrave policore në trafikun rrugor) dhe vepron si një udhëzues procedural për një 'inspektim të rëndomtë'.

të planit aktual të ristrukturuar, në vitin 2008 Drejtoria do ta zvogëlojë numrin e personelit në 97 persona.

2.2 Historiku i Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve tregon se që nga viti 2000 deri më 2003 është formuar si 'Sektor', prej vitit 2003 – 2005 si 'Njësi', kurse nga viti 2005 është shndërruar në Drejtori për Menaxhimin e Objekteve. Është vërejtur se kompetencat e Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve ende nuk janë bartur plotësisht tek SHPK-ja. Drejtori i Drejtorisë raporton nëpërmes të dy zinxhirëve komandues: brenda SHPK-së ai raporton tek mbikëqyrësi i Departamentit për Shërbime Mbështetëse dhe brenda sistemit të UNMIK-ut, drejtori i raporton Zëvendës Komisarit për Administratë (Policia Civile e UNMIK-ut)⁷⁷. Drejtoria mundohet që të zhvillojë dhe mirëmbajë pronën e policisë me anë të përdorimit të personelit të vet sa më shumë që është e mundur. Aktualisht funksionet e Drejtorisë ndahen në dy fusha kryesore: që do të thotë, ndërtimin e objekteve të reja dhe mirëmbajtjen e objekteve që ekzistojnë.

2.3 Zhvillimi i objekteve të reja të policisë, siç janë ndërtesat e reja në Komandën Regjionale fillon me përgatitjen e dizajnit dhe hollësive të projektit nga ekspertët në Drejtori. Kjo punë formon bazat për kontratën me organizatat e jashtme duke përdorur procesin e zakonshëm i njohur si 'ofertë për tender; pastaj ndërtimi rishikohet dhe inspektohet nga inxhinierët e Drejtorisë. Mirëmbajtja dhe renovimi ndahen në dy nivele. Mirëmbajtja rutinore (ose 'niveli i ulët') kryhet nga ana e personelit të Drejtorisë në nivel lokal (d.m.th. shtëpiakët) duke përdorur pajisje nga depot qendrore dhe lokale. Ky sistem do të thotë që me riparimet e 'niveleit të ultë' mund të fillohet me punë në afat prej pesë ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës. Sidoqoftë, Inspektorati Policor vërejtë disa ankesa se riparimet e vogla shpesh janë kryer sipas një standardi mjaft të dobët dhe kanë ndikuar në dështimin e inspektimit të punës dhe identifikimin e standardeve jo përkatëse. Riparimet shumë të vogla (d.m.th. më pak se 100€) kryhen zakonisht në regjione, duke i përdorur rezervat vjetore nga paratë për shpenzime të imta (peti kesh) (d.m.th. 5.000 –7.500€), në mënyrë që t'iu shmangen vonesave të tepërta. Riparimet dhe renovimet më të mëdha bëhen në të njëjtën mënyrë sikurse puna zhvilluese: dizajni dhe hollësitë nga Drejtoria, ndërlidhja me organizatat e jashtme nëpërmes të kontratave dhe mbikëqyrja nga Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve. Inspektorati Policor e mirëpriti politikën e re përmes së cilës Drejtoria në mënyrë aktive kërkon rekomandime dhe komente nga zyrtarët e lartë në regjione.

Performanca aktuale

2.4 Ndonëse Inspektorati Policor hasi në aspekte me një progres të konsiderueshëm, një pjesë e madhe e pronës së SHPK-së (ndërtesat dhe infrastruktura përkatëse) në përgjithësi vazhdon të jetë në gjendje të dobët dhe paraqet një aspekt të konsiderueshëm dobësie për organizatën policore. Ngjashëm me inspektimin e mëparshëm, Inspektorati policor ishte i vetëdijshëm për faktin se gjendja e dobët e

⁷⁷ Kjo informata është marrë nga drejtori i Drejtorisë për Menaxhim të Objekteve.

ndërtesave të policisë është rezultat i moskujdesit dhe mungesës së investimeve kapitale në vitet e 90-ta si dhe dëmeve të shkaktuara gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s. Që nga themelimi i SHPK-së në vitin 1999, nevoja për investime të mëdha kapitale në ndërtesat dhe infrastrukturën policore është dashur të hyjë në konkurrencë me shumë kërkesa tjera urgjente në resurset e kufizuara të buxhetit të konsoliduar të Kosovës (pagat e policëve, automjetet dhe pajisjet themelore).

2.5 Gjatë dy viteve të fundit, SHPK-ja ka filluar me procesin e shtuar të ndërtimit dhe rinovimit. Planet buxhetore afatmesme (2007 - 2009) tregojnë një politikë të ndarjes së më shumë fondeve për detyrën mjaft të shtrenjtë të krijimit të pronës policore e cila do të plotësonte nevojat e organizatës dhe do të përmbushte kushtet themelore të punës për zyrtarët policorë dhe personelin tjetër. Kjo detyrë vazhdon të paraqet një sfidë të madhe të menaxhmentit financiar për udhëheqësinë e re të SHPK-së, e cila kërkon një nivel të avancuar të kompetencës në planifikimin strategjik.

Tabela 1: Investimet kapitale të SHPK-së - 2006 & 2007

Viti	Buxheti i SHPK-së - gjithsej investimet kapitale (EURO)	Buxheti i Drejtorisë për menaxhimin e objekteve (EURO)	% totale e investimeve kapitale
2006	14,471,000	3,360,000	23.2%
2007	14,169,105	2,267,960	16.0%

2.6 Është vërejtur se vetëm vitet e fundit SHPK-ja ka filluar të investojë në ndërtimin e objekteve të reja dhe rinovimin e atyre ekzistuese. Tabela 1 tregon nivelin e investimeve për 24 muajt e fundit dhe përputhet me planin buxhetor afatmesëm (2007-2009). Gjatë vitit 2007 gjithsejt 2.2 milion € do të ndahen për ndërtim dhe mirëmbajtje, që paraqet 30% të rënies nga viti i kaluar dhe është pjesë e një procesi afatgjatë të investimeve. Inspektorati Policor nuk pati mundësi të sigurojë një vlerësim të shpenzimeve të përgjithshme (të çmimeve aktuale) të shndërrimit të të gjitha stacioneve policore dhe ndërtesave të SHPK-së në objekte të një standardi të pranueshëm (kënaqshëm). Sidoqoftë, siç do të shihet në pjesën në vijim të këtij raporti, shkalla e punës së nevojshme është e konsiderueshme në tërë Kosovën.

Tabela 2A – Ndërtesat policore të inspektuara nga IPK–ja PIK (Tetor, 2007)⁷⁸

No.	Building	Legal Owner	Floor Area (Square Metres)	Number of staff	Visited by PIK (October 2007)	Assessed Condition (by the PIK)
Nr.	Ndërtesa	Pronari ligjor	Sipërfaqja (metër katror)	Numri i personelit	Vizituar nga IPK–ja (Tetor 2007)	Gjendja e vlerësuar
1	Objekti i Shtabit Kryesor	SHPK	3748 m ²	796	PO	Mirë
2	Ndërtesa e administratës	KK Prishtinë	4122 m ²	452	PO	Mirë
3	Komanda regjionale dhe stacioni qendër	KK Prishtinë	2604 m ²	229	PO	Në rinovim
4	Stacioni Policor Veri Prishtinë	Ujësjiellësi	220 m ²	180	PO	Dobët
5	Stacioni jugor Prishtinë	KEK	400 m ²	179	PO	Dobët
6	Stacioni policor Fushë Kosovë	KK Fushë Kosovë	288 m ²	81	PO	Dobët
7	Stacioni Policor Obiliq	SHPK	1500 m ²	80	PO	Dobët
8	Stacioni Policor Podujevë	KK. Podujevë	1368 m ²	133	PO	Mirë
9	Stacioni Policor Glllogovc	SHPK	501.29 m ²	131	PO	Kënaqshëm
10	Stacioni Policor Lipjan	KK Lipjan	1578 m ²	132	PO	Mirë
11	Komanda regjionale Pejë & stacioni policor në Pejë	KK Pejë	2124 m ²	303	PO	Mirë
12	Njësi I trafikut – Pejë	SHPK	530 m ²	95	PO	Shumë mirë

Notimi : Shumë dobët – Dobët – Kënaqshëm – Mirë – Shumë mirë

⁷⁸ Të dhënat e paraqitura në tabelën 2 (A – C) janë siguruar nga Drejtoria për Menaxhimin e Ndërtesave dhe nga Zyra Ligjore e SHPK-së. (Tetor 2007).

Tabela 2B – Ndërtesat policore të inspektuara nga IPK-ja (tetor, 2007)

Nr.	Ndërtesa	Pronari ligjor	Sipërfaqja (metër katror)	Numri lipersonelit	Vizituar nga IPK-ja (Tetor 2007)	Gjendja e vlerësuar
14	Stacioni policor Klinë	Klinë	600 m ²	94	PO	Mirë
15	Stacioni policor Deçan	SHPK	580 m ²	101	PO	Shumë mirë
16	Nën stacioni Junik	KB Moranicë	260 m ²	23	PO	Mirë
17	Stacioni Policor Istog	SHPK	828 m ²	101	PO	Shumë mirë
18	Stacioni policor Gjakovë	Pronë e auto shkollës	/	151	PO	Kënaqshëm
19	Komanda regjionale Prizren	SHPK	1021.4 m ²	186	PO	Mirë
20	Stacioni policor Alfa – Prizren	KK Prizren	2000m ²	200	PO	Kënaqshëm
21	Stacioni policor Suharekë	Policisë	700 m ²	132	PO	Dobët
22	Stacioni policor Malishevë	SHPK	950 m ²	103	PO	Kënaqshëm
23	Stacioni policor Rahovec	SHPK	0.17,26 ha S=810 m ²	99	PO	Mirë
24	Stacioni policor Dragash	Policisë	1283m ²	93	PO	Mirë
25	Komanda regjionale Mitrovicë	KK Mitrovicë	1650m ²	144	PO	Mirë
26	Stacioni policor Veri- Mitrovicë	SHPK	0.30,17 ha S=1800m ²	101	PO	Kënaqshëm
27	Stacioni policor Jug- Mitrovicë	KK Mitrovicë	861 m ²	170	PO	Kënaqshëm
28	Stacioni policor Vushtrri	KK Vushtrri	1400m ²	174	PO	Mirë
29	Stacioni policor Skenderaj	KK Skenderaj	2958 m ²	139	PO	Shumë mirë

Notimi : Shumë dobët – Dobët – Kënaqshëm – Mirë – Shumë mirë

Tabela 2C – Ndërtesat policore të inspektuara nga IPK-ja (tetor, 2007)

Nr.	Ndërtesa	Pronari ligjor	Sipërfaqja (metër katror)	Numri i personelit	Vizituar nga IPK-ja (Tetor 2007)	Gjendja e vlerësuar
30	Stacioni policor Leposaviq	Policisë	680 m ²	75	PO	Shumë mirë
31	Komanda regjionale Gjilan	KK Gjilan	200m ²	210	PO	Dobët
32	Stacioni policor Gjilan	KK Gjilan	Bashkë me regjionin	197	PO	Kënaqshëm
33	Stacioni policor Kamenicë	SHPK	737,03 m ²	128	PO	Mirë
34	Stacioni policor Viti	Policisë	501.65m ²	91	PO	Dobët
35	Stacioni policor Novobërdë	KK Novo Bërdë	530 m ²	28	PO	Kënaqshëm
36	Komanda regjionale dhe Stacioni policor Ferizaj	KK Ferizaj	26855.50m ²	395	PO	Mirë
37	Stacioni policor Shtërpce	Policisë	225,66m ²	68	PO	Dobët
38	Stacioni policor Shtime	Policisë	300m ²	60	PO	Dobët
39	Stacioni policor Kaçanik	KK Kaçanik	2108m ²	103	PO	Mirë

Notimi : Shumë dobët – Dobët – Kënaqshëm – Mirë – Shumë mirë

2.7 Siç është paraqitur në tabelën 2 (A – C), Inspektorati Policor vizitoi gjithsejt 39 ndërtesa policore, rreth 36.7% të të gjitha ndërtesave në pronësi, të kontrolluara apo në shfrytëzim të SHPK-së. Kjo mostër ofron një vështrim të dobishëm në problemet e vazhdueshme të pronësisë së ndërtesave të SHPK-së, mungesën e hapësirës dhe gjendjen e shpërfillur të shumë ndërtesave të SHPK-së. Në të njëjtën kohë, Inspektorati Policor mirëpret përmirësimin e konsiderueshëm të gjendjes së shumë ndërtesave të SHPK-së që nga inspektimi i fundit në vitin 2006. Inspektorët të cilët vizituan ndërtesat e SHPK-së nuk hasën në asnjë ndërtesë në gjendje shumë të dobët, 9 (23%) në gjendje të dobët, 8 në gjendje të kënaqshme (20.5%), 16 (41%) në gjendje të mirë dhe 5 (12.8%) në gjendje shumë të mirë. Në këtë mënyrë, shumica (74.3) prej tyre janë në gjendje të kënaqshme ose në gjendje më të mirë dhe kjo

tregon një përmirësim prej 25% në krahasim me vitin e kaluar. Inspektorati Policor lavdëron punën e Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve. Megjithatë, shumë punë mbetet për t'u bërë dhe zyrtarët e Inspektoratit Policor gjatë intervistave me zyrtarë operativ policor mësuan se gjendja e keqe e 25 % të ndërtesave të inspektuara vazhdon të ketë ndikim negativ në motivimin e policëve për punë. Lista e plotë e ndërtesave të cilat janë në pronësi apo në shfrytëzim të SHPK-së mund të gjendet në Shtojcën A (në fund të raportit vjetor) dhe është me rëndësi të përmendet se në disa raste, vlerësimi i Inspektoratit Policor për gjendjen e ndërtesave nuk përputhet me atë të Drejtorisë.

2.8 Përveç progresit në investimet e mëdha kapitale për renovim dhe ndërtim, shihet qartë se Drejtoria është duke realizuar një performancë të nivelit të lartë në plotësimin e kërkesave për mirëmbajtje rutinore dhe riparime të vogla. Tabela 3 tregon se Drejtoria ka pranuar gjithsejt 876 kërkesa për punë të mirëmbajtjes dhe riparime të vogla vetëm në gjysmën e parë të vitit 2007. Mbi 85% e kërkesave janë kryer dhe gati 14% e tyre janë refuzuar. Në përgjithësi, këto të dhëna tregojnë se Drejtoria përgjigjet mirë ndaj kërkesave të personelit të SHPK-së; megjithatë këto të dhëna nuk tregojnë periudhën kohore mesatare të nevojshme për t'u përgjigjur ndaj kërkesave dhe gjatë inspektimit shumë punonjës të SHPK-së janë ankuar për vonesat në përgjigjen ndaj kërkesave për mirëmbajtje rutinore. Inspektorati Policor do të inkurajonte drejtorin e DMO-së që të vazhdojë më tutje me këtë punë dhe të fillojë me një standard pune më preciz lidhur me kërkesat për mirëmbajtje rutinore dhe riparime. Për shembull, Drejtoria duhet t'i vë vetes synimin për t'iu përgjigjur 80% të kërkesave brenda një periudhe të caktuar kohore e pastaj të përpilojë të dhëna të cilat tregojnë deri në çfarë mase është realizuar ai synim.

Tabela 3 – Kërkesat për punët e mirëmbajtjes ose pajisjeve, pranuar nga Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve (Janar – Qershor 2007)

Nr.	Regjionet	Gjithsej kërkesa të pranuar	Kërkesa të kryera	Kërkesa të refuzuara	Kërkesa në pritje
1.	Prishtinë	357	297	54	6
2.	Prizren	48	41	6	1
3.	Pejë	101	81	20	0
4.	Mitrovicë	53	42	11	0
5.	Gjilan	35	35	0	0
6.	Ferizaj	58	55	3	0
7.	Policia kufitare	158	138	19	1
8.	Nën stacionet	66	57	9	0
Totali		876	746 85.1%	122 13.9%	8 0.9%

Rekomandimi kryesor

Nr. 1

Inspektorati Policor inkurajon drejtorin e DMO-së që në bazë të suksesit aktual të Drejtorisë të paraqes një standard pune më preciz lidhur me kërkesat për mirëmbajtje rutinore dhe riparime. Për shembull, Drejtoria duhet t'i vë vetes synimin për t'iu përgjigjur 80% të kërkesave brenda një periudhe të caktuar kohore.

2.9 Përveç progresit në mirëmbajtjen rutinore, Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve vazhdon të përparojë në zbatimin e planit afatmesëm për renovimin e ndërtesave të SHPK-së dhe, aty ku është e nevojshme t'i rinovojë ato ekzistuese. Tabela 4 ofron hollësi për 20 projekte të zbatuara për rinovim dhe ndërtim brenda buxhetit 2007, duke përdorur 2.2 milion € nga buxheti i ndarë për investime kapitale. Kjo përfshinë ndërtimin e një stacioni të ri policor në Klinë, si dhe rinovimin e 16 stacioneve tjera policore. Për fat të keq, ndërtimi i planifikuar i dy stacioneve të reja policore – Jugu Prishtinë dhe Stacioni Jugu Mitrovicë nuk është realizuar, e poashtu edhe plani për fillimin e 95% të projekteve brenda gjashtë muajve të parë të vitit 2007, për shkak të vonesave në Zyrën e Prokurimit.

Tabela 4 – Ndërtimi dhe rinovimi i ndërtesave të SHPK-së (2007)⁷⁹

Ndërtesat policore	Lloji i punëve	Shpenzimet EURO	Data e nënshkrimit të kontratës	Statusi
Stacioni policor Pejë	Rinovim	59,943,30	11.05.2007	E përfunduar
Stacioni qendër Prishtinë	Rinovim	160,090,65	25.06.2007	Në proces
Stacioni policor Alfa-Prizren	Rinovim	196,802,91	17.07.2007	Në proces
Stacioni policor Glogovc	Rinovim	8,276,40	02.10.2007	Në proces
Stacioni policor Podujevë	Rinovim	19,040,00	02.10.2007	Në proces
Stacioni policor Deçan	Rinovim	32,104,08	02.10.2007	Në proces
Stacioni policor Junik	Rinovim	13,858,24	02.10.2007	Në proces
Stacioni policor Viti	Rinovim	13,928,69	02.10.2007	Në proces
Stacioni policor Malishevë	Rinovim	35,317,48	02.10.2007	Në proces
Stacioni policor Zvecan	Rinovim	15,491,52	02.10.2007	Në proces
Stacioni policor Obiliq	Rinovim	23,263,70	04.10.2007	Në proces
Stacioni policor Klina	Ndërtim	345,477,46	14.09.2007	Në proces
Salla sportive ⁸⁰	Rinovim	55,494,00	03.10.2007	Në proces
Salla ⁸¹	Rinovim	9,256,50	03.10.2007	Në proces
Qendra e ndalimit – Stacioni policor Pejë	Rinovim	18,850,67	09.07.2007	Në proces
Stacioni policor Leposavic	Rinovim	44,631,35	Në proces	N/A
Nën stacioni Ponoshec	Rinovim	38,281,58	Në proces	N/A
Stacioni policor F. Kosovë	Rinovim	Në proces të tenderimit	N/A	N/A
Stacioni policor Vushtrri	Rinovim	Në proces të tenderimit	N/A	N/A
Stacioni policor Lipjan	Rinovim	Në proces të tenderimit	N/A	N/A
Totali		1,090,111		

⁷⁹ Të dhënat në figurën 4, janë marrë nga Zyra e Prokurimit të SHPK-së dhe Plani i afarizmit vjetor , 2007.

⁸⁰ Lokacioni I "sallës sportive" nuk i është bërë e qartë Inspektoratit Policor.

⁸¹ Lokacioni I "sallës" nuk i është bërë e qartë Inspektoratit Policor.

2.10 Siç shihet në tabelën 4, ekzistojnë gjasa që në vitin 2007 të shpenzohet shumë më pak, përafërsisht 1 milion €. Kjo paraqet një çështje mjaft brengosëse për Inspektoratin Policor, veçanërisht për shkak të nevojës urgjente për përmirësimin e cilësisë së mjedisit të punës për punonjësit e SHPK-së dhe kushtet e personave të mbajtur në qendrat e ndalimit. Inspektorati Policor nxit zyrtarët e lartë të SHPK-së që të rishikojnë performancën e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse dhe më në veçanti, mundësitë aktuale për përgatitjen e kontratave për ndërtim dhe rinovim. Për shkak të shpenzimit më të ultë të buxhetit për investime kapitale për vitin 2007, ky rishikim duhet të trajtohet si një çështje prioritare.

Rekomandimi kryesor

Nr. 2

Inspektorati Policor nxit zyrtarët e lartë të SHPK-së që të rishikojnë performancën e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse dhe më në veçanti, mundësitë aktuale për përgatitjen e kontratave për ndërtim dhe rinovim. Për shkak të shpenzimit më të ultë të buxhetit për investime kapitale për vitin 2007, ky rishikim duhet të trajtohet si një çështje prioritare.

2.11 Përkundër problemeve të prokurimit, Inspektorati Policor lavdëron punën e Drejtorisë përgjatë viteve të fundit dhe mirëpret përpjekjet për përmirësimin e mjedisit dhe të kushteve të punës, për zyrtarët e SHPK-së si dhe kushtet e personave të cilët mbahen në qendrën e paraburgimit. Kërkohe më shumë përpjekje për ta rritur efikasitetin e zyrës për prokurim dhe sigurimin që të gjitha fondet buxhetore të shpenzohen para fundit të çdo viti fiskal, në bazë të planit të buxhetit vjetor.

2.12 Përveç punës së Drejtorisë, Inspektorati Policor e mirëpriti përparimin e bërë në projektin e Agjencionit Evropian për Rindërtim (AER), për ndërtimin dhe rinovimin e pikave kontrolluese kufitare të SHPK-së, i cili është në proces. Gjendja e punës mund të përmbledhet si në vijim: ndërtimi i pikës kufitare Qafa e Morinës dhe Qafa e Prushit ka përfunduar, dhe puna ndërtimore në Kullë, Gllaboçicë dhe Han të Elezit është në proces. Gjithashtu, renovimi i objekteve në pikën kufitare të Vërmicës ka përfunduar, ndërsa Objekti 5 në Gjakovë është në proces. Është me rëndësi të vërehet se financimi dhe mbikëqyrja e punës në këto vende është siguruar nga AER-i.

2.13 Zyra Ligjore e Administratës së SHPK-së përsëri ka informuar Inspektoratin Policor për probleme të konsiderueshme lidhur me statusin ligjor të objekteve që janë në pronësi apo aktualisht të shfrytëzuara nga SHPK-ja. Katalogu që ka të bëjë me tokat dhe ndërtesat 'që i takojnë policisë' tregon se ka shume hamendje në lidhje me pronësinë dhe të drejtat. Gjithsejt janë 106 objekte 'policore' në Kosovë, prej të cilave vetëm 49 (46.22%) mund të thuhet se janë pronë e SHPK-së (Ministrisë së Punëve të Brendshme) dhe shumë prej tyre nuk shfrytëzohen nga SHPK-ja. Në disa vende (p.sh. në Mitrovicë dhe në Veri të Kosovës) SHPK-ja është duke shfrytëzuar 'pronat shoqërore', të cilat tani janë nën Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit, dhe në disa qendra (p.sh. Gjilan) toka dhe/ose ndërtesat i takojnë komunës. Në më së paku

një rast, toka e cila i takon policisë (apo Ministrisë së Punëve të Brendshme) shfrytëzohet për ndonjë ndërtim ilegal⁸².

2.14 Problem tjetër është se shumica e pronave të SHPK-së nuk shfrytëzohen nga SHPK-ja, përderisa në vende tjera SHPK-ja vazhdon që të përdorë ‘pronat e huazuara shoqërore’ apo tokat ose objektet që i takojnë komunës. Ka raste kur toka që në mënyrë ligjore i takon SHPK-së është shfrytëzuar për ndonjë ndërtim ilegal. Inspektorati Policor i mirëpret përpjekjet e Zyrës Ligjore për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me pronën dhe tokat e huazuara apo të shfrytëzuara nga SHPK-ja. Në rast se toka apo objekti nuk janë pronë e SHPK-së, zyra zbaton procedurat përkatëse administrative dhe kërkon që autoritetet kompetente t’i ndihmojnë SHPK-së për marrjen në posedim të pronës, me qëllim të krijimit të bazës juridike për secilën pronë. Në vitin 2006 Zyra Ligjore ka bërë bartjen e gjashtë pronave në pronësi të SHPK-së, ndërsa në vitin 2007 deri më tani katër prona janë bartur në posedim të SHPK-së.

Tabela nr. 5 – Kontrata mbi qiranë e objekteve që shfrytëzohen nga SHPK-ja ⁸³					
Nr.	Objekti	Data e nëshkrimit	Data e skadimit të kontratës	Çmimi për muaj	Totali vjetor
1.	Zubin Potok	11.12.2005	09.08.2008	1,000	12,000
2.	Kishnicë	04.11.2002	14.10.2007	2,100	25,200
3.	Graçanicë	21.10.2002	01.02.2007	1,000	E pushuar
4.	Pejton (Poligrafi)	06.02.2004	15.12.2005	700	E pushuar
Totali vjetor për kontratë në fuqi					37,200

2.15 Për shkak të mungesës së hapësirës së përshtatshme për zyre, SHPK-ja është e detyruar të shfrytëzojë objekte me qira. Tabela 5 ofron një përmbledhje të ndërtesave ekzistuese të cilat janë marrë me qira gjatë vitit 2007. Shpenzimet totale prej mbi 37,000 € në vitin 2007 janë të konsiderueshme dhe Inspektorati Policor vërejtë se disa nga ndërtesat e marra me qira nuk iu përshtaten kushteve për punë policore dhe mund të paraqesin rrezik fizik për punonjësit policor. Inspektorati Policor rekomandon që politika për marrjen me qira të ndërtesave t’i nënshtrohet një rishikimi nga ana e menaxherëve të lartë të SHPK-së, në mënyrë që të identifikojë mundësi sa më të duhura dhe më ekonomike.

⁸² Inspektorati Policor u informua nga Zyra Ligjore e Administratës së SHPK-së se Hotel Victory, në Prishtinë është i ndërtuar në tokën që është ‘në pronësi të shtetit’ që duhet të interpretohet si nën kontroll të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

⁸³ Të dhënat në tabelën 5 janë siguruar nga Zyra e Prokurimit dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa, SHPK, (tetor 2007).

Inspektorati policor rekomandon që politika për marrjen me qira të ndërtesave t'i nënshtrohet një rishikimi nga ana e menaxherëve të lartë të SHPK-së, në mënyrë që të identifikojë mundësi sa më të duhura dhe më ekonomike.

2.16 Ngjashëm me inspektimin e fundit në vitin 2006, Inspektorati Policor vërejt se nuk ekzistojnë objekte të duhura për pushim (çlodhje) për zyrtarët e SHPK-së. Megjithatë, Inspektorati Policor vëren se gjatë 12 muajve të fundit janë ndërmarrë hapa për të shtuar numrin e byfeve nëpër stacione policore, si përgjigje ndaj rekomandimeve të IPK-së nga inspektimi i bërë në vitin 2006 lidhur me zhvillimin (hapjen) e byfeve policore nëpër stacione. Sipas disa zyrtarëve të lartë të SHPK-së, kjo çështje mendohet të jetë zgjidhur në regjionin e Prishtinës dhe ndonëse ekzistojnë disa vonesa teknike në regjionet tjera, janë bërë përparime nëpër tërë organizatën. Megjithatë, inspektorët vërejtën se gjendja në terren është shumë e kundërt: bile edhe në regjionin e Prishtinës objektet e planifikuara për pushim nuk janë funksionalizuar plotësisht. Inspektorati Policor mirëpret planet aktuale për shtimin e numrit dhe cilësisë së objekteve për pushim/byfeve për zyrtarët e SHPK-së dhe rekomandon që këto plane të zbatohen në tërësi. Një masë e tillë do të përmirësojë motivimin e policëve për punë, do të ndihmojë SHPK-në që të përshtatet me legjislacionin e ri, i cili ndalon pirjen e duhanit në vende publike (shih Nenin 13.7(e) Urdhëresa Administrative 2006/9) dhe do t'i jep fund imazhit negativ të qytetarëve ndaj policëve të uniformuar të mbledhur nëpër kafeteri.

Inspektorati policor mirëpret planet aktuale për shtimin e numrit dhe cilësisë së objekteve për pushim/byfeve për zyrtarët e SHPK-së dhe rekomandon që këto plane të zbatohen në tërësi. Një masë e tillë do të përmirësojë motivimin e policëve për punë, do të ndihmojë SHPK-në që të përshtatet me legjislacionin e ri, i cili ndalon pirjen e duhanit në vende publike (shih Nenin 13.7(e) Urdhëresa Administrative 2006/9) dhe do t'i jep fund imazhit negativ të qytetarëve ndaj policëve të uniformuar të mbledhur nëpër kafeteri.

2.17 Inspektorati Policor vërejt se pavarësisht nga ajo që kjo çështje është përmendur në vitin 2006, SHPK-së ende i mungon një politikë e cila do të siguronte objektet e SHPK-së ndaj rrezikut nga zjarri dhe se nuk ekzistojnë standarde minimale për mbrojtje nga zjarri. Pajisjet për mbrojtje nga zjarri janë të pamjaftueshme, aparatet e zjarrit – nëse ekzistojnë – shpesh nuk i nënshtohen inspektimeve/kalibrimeve rutinore, dhe nuk bëhet asnjë stërvitje për mbrojtje nga zjarri (për të siguruar se personeli di të dalë nga ndërtesa shpejt dhe sigurt në raste zjarri). Për shkak se shumë policë janë duke i shfrytëzuar ndërtesat të cilat nuk kanë qenë të parapara për përdorim nga ana e policisë dhe /ose janë në gjendje të keqe, kjo mungesë e menaxhimit për mbrojtje kundër zjarrit krijon rrezik të

konsiderueshëm për punonjësit policor. Prandaj Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së urgjentisht t'i rishikojnë standardet për mbrojtje nga zjarri në të gjitha stacionet policore përfshirë furnizimin me pajisje të sigurisë (mbrotje nga zjarri) me qëllim të futjes në përdorim dhe mirëmbajtjes së pajisjeve për mbrojtje nga zjarri si dhe stërvitjet e rregullta të personelit.

Rekomandimi kryesor	Nr. 5
<p><i>Inspektorati policor përsëri rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së urgjentisht t'i rishikojnë standardet për mbrojtje nga zjarri në të gjitha stacionet policore përfshirë furnizimin me pajisje të sigurisë (mbrotje nga zjarri) me qëllim të futjes në përdorim dhe mirëmbajtjes së pajisjeve për mbrojtje nga zjarri si dhe stërvitjet e rregullta të personelit .</i></p>	

2.18 Tabela 6 ofron një analizë të shpenzimeve për shërbime komunale të bëra në ndërtesat policore nëpër tërë Kosovën dhe bënë një krahasim të performancës gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2007 me vitin 2006. Inspektorati Policor mirëpret uljen e shpenzimeve, që gjithsejt shënojnë 10%. Megjithatë në mungesë të çfarëdo dokumenti shoqërues, për Inspektoratin Policor është e paqartë nëse këto ulje të shpenzimeve janë si rezultat i politikave brenda SHPK-së ose i ndonjë apo më shumë faktorëve të jashtëm. Është e qartë se dimri i butë në vitin 2006/07 ka bërë që të zvogëlohen shpenzimet për nxemje në tërë Kosovën, dhe kjo do të shpjegonte uljen e shënuar të shpenzimeve të elektricitetit në shumë ndërtesa të SHPK-së. Sikurse të gjitha shërbimet tjera publike, SHPK-ja duhet të krijojë politika të menduara mirë për të siguruar se shpenzimet e shërbimeve komunale bëhen në minimum. Nëse politikat e tilla janë zhvilluar më parë, Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të zhvillojnë dhe zbatojnë politikat e shkruara që kanë të bëjnë me nevojën e mbajtjes në minimum të shpenzimeve të shërbimeve komunale –veçanërisht shpenzimet e elektricitetit dhe telefonit– dhe të inkurajojnë personelin që t'i shmangen keqpërdorimit të panevojshëm.

**Tabela nr. 6 – Analizimi i shpenzimeve komunale të SHPK-së nëpër regjione
(gjashtë muajt e parë të vitit 2006 dhe 2007)⁸⁴**

Regjioni	Janar – Qershor 2006				
	Ujë EURO	Mbeturina EURO	Telefon EURO	Nxemje EURO	Rrymë EURO
Prishtinë	59,539,07	11,543.26	77,745.52	45.988.14	122,000,34
Prizren	4,919,31	3,533,31	15,981,66	–	46,563,26
Pejë	3,839,38	4,456,20	14,991,00	–	47,727,01
Mitrovicë	4,834,48	8,166,22	11,204,97	–	28,284,17
Gjilan	1,653,10	1,512,72	18,829,50	–	17,850,22
Ferizaj	1,658,17	4,428,48	14,166,13	–	27,536,70
Kufi	318,96	3,384,72	5,009,44	–	16,846,37
PTT serbe	–	–	4,447,63	–	–
Totali	76,762,47	37,024,91	162,375,85	45,988,14	306,808,07
Regjioni	Janar – Qershor 2007				
Prishtinë	42,144,02	13,366,32	73,891,54	45,959,67	94,332,39
Prizren	3,695,53	3,061,13	13,953,17	–	17,212,35
Pejë	5,806,44	3,412,25	16,439,01	–	36,758,94
Mitrovicë	3,595,09	4,520,89	8,374,34	–	22,160,16
Gjilan	1,564,48	1,186,80	11,146,79	–	18,815,62
Ferizaj	1,272,02	4,428,48	11,980,73	–	24,336,98
Kufi	7,895,75	4,661,15	4,311,01	–	11,243,34
PTT serbe	–	–	3,802,01	–	–
Totali	65,973,33	34,637,02	143,898,60	45,959,67	224,859,78
-/+ % 2006 & 2007	- 14,05 %	- 6,44 %	- 11,37 %	- 0,06 %	- 26,70 %

⁸⁴ Të dhënat e paraqitura në tabelë janë siguruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, SHPK (Tetor, 2007)

Nëse politikat e tilla janë zhvilluar më parë, Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të zhvillojnë dhe zbatojnë politikat e shkruara që kanë të bëjnë me nevojën e mbajtjes në minimum të shpenzimeve të shërbimeve komunale –veçanërisht shpenzimet e elektricitetit dhe telefonit– dhe të inkurajojnë personelin që t'i shmangen keqpërdorimit të panevojshëm.

Politika dhe strategjia

2.19 Inspektorati Policor është njoftuar për punën e zhvillimit të Planit të parë Strategjik të SHPK-së, I cili tregon synimet strategjike në periudhën kohore 2007–2009. Kjo është një iniciative e mirëpritur dhe sipas zyrtarëve të lartë të SHPK-së I përfshin synimet strategjike lidhur me zhvillimin e infrastrukturës së SHPK-së. Në të vërtetë përfshinë ndërtimin e objekteve të reja dhe renovimin e atyre ekzistuese në regjione të ndryshme. Një organizatë policore përbëhet nga bashkëveprimi I personelit të vet në realizim të synimeve të definuara mirë. Një formë e strategjisë së përbashkët (ose planifikimit) është e nevojshme për të gjitha organizatat policore e veçanërisht organizatat e mëdha policore siç është SHPK-ja. Përcaktimi I synimeve strategjike në organizatat policore në shoqërite demokratike duhet të rezultojnë nga angazhimi I tri burimeve të ndryshme: politikanët e zgjedhur (Ministri I Punëve të Brendshme dhe Kuvendi I Kosovës), zyrtarët e përhershëm (zyrtarët e lartë policor) dhe ata që përfitojnë nga shërbimi policor (qytetarët). Ky është shembull aktual në Kosovë, siç përshkruhet në Rregulloren e UNMIK–ut 2005/54. Inspektorati Policor për së afërmi do të monitorojë zhvillimin e planifikimit strategjik të SHPK-së si dhe raportin e vet me Planin Strategjik të Ministrisë 2007 – 2010.

2.20 Inspektorati Policor inkurajon zhvillimin e mëtutjeshëm të planifikimit strategjik në SHPK në nivel të përgjithshëm – dhe në kohën e duhur edhe në nivel regjional. I Inspiruar nga plani I ri strategjik për organizatën si tërësi, Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që Drejtoria për menaxhimin e objekteve duhet të zhvillojë një dokument të vet të hollësishëm lidhur me planifikimin strategjik. Kjo e fundit duhet të veprojë në pajtim me synimet e përgjithshme të planit kryesor strategjik 2007 – 2009, dhe të përmbajë hollësi të mjaftueshme lidhur me synimet në fushat e ndërtimit, renovimit, mbrojtjes nga zjarri, objektet për pushim, shfrytëzimi i shpenzimeve komunale dhe kursimi i rrymës. Së fundi, strategjia e Drejtorisë – si plan kryesor strategjik i SHPK-së – duhet të jetë dokument publik, në këtë mënyrë të promovojë parimet demokratike të transparencës dhe të përgjegjshmërisë ndaj popullatës.

Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që Drejtoria për menaxhimin e objekteve duhet të zhvillojë një dokument të vet të hollësishëm lidhur me planifikimin strategjik. Kjo e fundit duhet të veprojë në pajtim me synimet e përgjithshme të planit kryesor strategjik 2007 - 2009, dhe të përmbajë hollësi të mjaftueshme lidhur me synimet në fushat e ndërtimit, renovimit, mbrojtjes nga zjarri, objektet për pushim, shfrytëzimi i shpenzimeve komunale dhe kursimi i rrymës. Së fundi, strategjia e Drejtorisë - si plan kryesor strategjik i SHPK-së - duhet të jetë dokument publik, në këtë mënyrë të promovojë parimet demokratike të transparencës dhe të përgjegjshmërisë ndaj popullatës.



Raport i përkohshëm i inspektimit 9

**Kryerja e detyrave në menaxhimin e
arrestimit dhe ndalimit nga ana e SHPK-së**

KRYERJA E DETYRAVE NË MENAXHIMIN E ARRESTIMIT DHE NDALIMIT NGA ANA E SHPK-së

1.HYRJE

1.1 Inspektimi i nëntë i rëndomtë i SHPK-së u krye më 04, 05 dhe 08 tetor të vitit 2007, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqendrua vetëm në kryerjen e detyrave nga ana e menxhmentit për arrestim dhe ndalim dhe është ndërmarrë nga Z. Enver Rustemi, Kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 17 inspektorëve. Janë vizituar të gjitha komandat regjionale dhe një numër i stacioneve policore nëpër tërë Kosovën. Poashtu u vizituan edhe një numër i dhomave për ndalim policor. Pa përjashtim, inspektorët hasën në bashkëpunim dhe gatishmëri të plotë të SHPK-së për të ndihmuar.

1.2 Në përgjithësi Inspektorati Policor vërejti se menaxhimi i personave të ndaluar – në bazë të ligjit të aplikueshëm – është një fushë për të cilën pjesëtarët e SHPK-së duhet të bëjnë më shumë përpjekje. Duke përdorur kornizën ligjore të definuar në *Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës* (2004), SHPK-ja aktualisht demonstroi një pajtueshmëri të plotë me ligjin dhe standardet ndërkombëtare, në lidhje me të drejtat e personave të ndaluar. Sidoqoftë, duhet të punohet më shumë në menaxhimin, organizimin dhe përmirësimin e objekteve për ndalim.

1.3 Një numër i karakteristekave të Planit Strategjik 2007–2010, të Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë të bëjnë me menaxhimin e arrestimeve dhe ndalimeve nga ana e SHPK-së. Veçanërisht, sipas synimit strategjik 1, Ministria do të përpiqet të zhvillojë shërbime policore që janë 'efektive, efikase, të hapura dhe transparente'. Fusha Kryesore e Rezultateve (FKR) 1.2 i referohet synimit të Ministrisë për zgjerimin e SHPK-së në tërë Kosovën, përfshirë rishikimin dhe marrëveshjen e planit strategjik të SHPK-së në fushën e qendrave policore të ndalimit. Prandaj, detyra e zhvillimit dhe e implementimit të një strategjie gjithpërfshirëse për të zhvilluar dhe mirëmbajtur qendrat e ndalimit të SHPK-së është çështje me rëndësi për Ministrinë dhe ky raport inspektues do të jetë një burim i rëndësishëm i dëshmive në procesin e rishikimit të Ministrisë.

1.4 Si pjesë e këtij inspektimi, Inspektorati Policor ka përgatitur një listë me rekomandime kryesore për të ndihmuar zyrtarët e lartë policor në përmirësimin e performancës së tyre.

1.5 Qëllimi I këtyre inspektimeve të rëndomta është të bëhen rekomandimet për atë se si menaxherët e SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve të mëposhtme:

- Pajtueshmërinë me standardet relevante brenda Procedurës së Përkohshme Penale të Kosovës dhe dispozitave tjera të ligjit të aplikueshëm.;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të *Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)*;
- Pajtueshmërinë me synimet e Planit Strategjik 2007–2010, të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Për përkrahjen e menaxhimit profesional të personave të cilët iu kanë nënshtruar arrestimit dhe ndalimit policor;
- Për të ndihmuar në përmirësimin e kualitetit të ndërtesave dhe objekteve për personat e ndaluar, për personelin e SHPK-së dhe pjesëtarët tjerë të popullatës; dhe
- Për të identifikuar dhe shpërndarë praktikën më të mirë.

1.6 Gjatë inspektimit, personeli i Inspektoratit Policor vizitoi dhe intervistoi punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Komandantët regional dhe/ose zëvendës komandantët
- Komandantët e stacioneve dhe/ose zëvendës komandantët (disa raste)
- Intervistat me personelin e SHPK-së për ndalim policor (disa raste)
- Vizitat në ‘dhomat e ndalimit’ të SHPK-së (disa raste); dhe
- Intervistat me personat e ndaluar nga ana e SHPK-së (disa raste)

1.7 Nëpërmes një bashkëpunimi të mirë të personelit të lartë përkatës të SHPK-së, Inspektorati Policor grumbulloi një numër të konsiderueshëm të të dhënave, duke përdorur protokollin mbi menaxhimin e arrestimit dhe ndalimit. Ky është raporti i dytë në lidhje me këtë fushë, që nga themelimi i IPK-së dhe përpiqet të monitorojë përmirësimet në performancën policore që nga inspektimi i parë në vitin 2006.

1.8 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjësisë dhe transparencës publike, i cili parim është i mbështetur nga neni 19-të i Kodit Evropian të Etikës Policore.

2. KRYERJA E DETYRAVE NGA ANA E MENAXHMENTIT TË NDALIMIT

Organizimi

2.1 Ky inspektim është i përqendruar vetëm në 'ndalimin policor', siç është e definuar në nenin 211 dhe 281 të *Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (tani e tutje 'Kodi')*. Mirëpo, ky inspektim nuk ka të bëjë me autorizimet e gjykatës për caktimin e paraburgimit apo burgimit. *Kodi* përmban dispozitat e detajizuara për bazat dhe kushtet e ndalimit policor si dhe të drejtat e personave të ndaluar gjatë ndalimit. Ndalimi policor nuk mund të kalojë periudhën kohore prej më shumë se 72 orë, nga koha e arrestimit (çdo 24 orë në raste me të miturit), pas së cilës periudhë kohore policia duhet ta lirojë të ndaluarin, vetëm nëqoftëse gjykatësi i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin.

2.2 Praktikisht, çdo stacion kryesor i SHPK-së ka një numër të caktuar dhomash ndalimi ose 'qeli' për qëllim të ndalimit të personave deri në 72 orë. Menaxhimi ditor i këtyre dhomave të ndalimit është bërë në pajtim me Procedurat Standarde Operative, të ashtuquajtura 'qendrat e ndalimit' (numri referues DRP/DPZH/0143/07), i cili ka hyrë në forcë më 15 qershor të vitit 2007 dhe i aprovuar nga Shtabi Qendror i SHPK-së, Prishtinë. Ky dokument është i bazuar në Parimet dhe Procedurat e SHPK-së, Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, si dhe në deklaratat dhe Konventat tjera ndërkombëtare të ndërlidhura me të drejtat e njeriut. Ndonëse përdorimi i këtyre Procedurave Standarde Operative 'Qendrat e ndalimit' përfshinë një angazhim dhe përpjekje të gjithanshme drejtë aplikimit të tyre në praktikë, Inspektorati Policor vërejt se - në praktikë - mungon njëtrajtshmëria në aplikimin e tyre. Edhe pse vërehen përmirësime që nga viti i kaluar - veçanërisht në lidhje me përdorimin e përgjithshëm të formularëve të njëjtë - gjendja fizike e objekteve, mungesa e sigurisë adekuate për ata të cilët i shfrytëzojnë këto objekte, dhe mungesa e trajnimit për zyrtarët të cilët punojnë në qendrat e ndalimit, mbesin fusha të shqetësimit.


2.3 Në të vërtetë caktimi i punonjësve të SHPK-së në detyrë në dhomat e ndalimit bëhet në baza *ad hoc*, pa ndonjë pushim nga viti i kaluar. Mbikëqyrësit e ndërrimit (ose 'udhëheqësit e ekipit') zgjedhin policët patrullues të uniformuar nga një grup i policëve në dispozicion për detyra patrulluese rutinore dhe i caktojnë ata në detyrë në dhomat e ndalimit në baza ditore. Zakonisht ata përzgjedhin zyrtarë policor me performancë të dobët dhe puna në dhomat e ndalimit konsiderohet si detyrë me më pak prioritet. Puna në qendrat e ndalimit nuk konsiderohet si funksion i veçantë (profesion) dhe secili zyrtar policor mund të përzgjedhet që ta kryejë këtë detyrë. Gjendja e keqe dhe kushtet joadekuate në dhomat e ndalimit janë dobësi që janë vërejtur nga inspektorët e IPK-së si dhe raporti inspektues i OSBE-së, Këshillit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe KLMDNJ-së (Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut), të cilët kanë vizituar dhe kanë vlerësuar gjendjen e këtyre objekteve dhe kanë rekomanduar që urgjentisht të ndërmerren masa në këtë drejtim.

2.4 Përgjegjësia lidhur me dhomat e ndalimit është e ndarë në dy shtylla kryesore të SHPK-së: shtyllës së operativës dhe shtyllës së administratës. Zëvendës Komisari për

Operativë dhe Drejtori për Siguri dhe Rend Publik, Shtylla Operative janë përgjegjëse për të siguruar që personeli dhe procedurat e duhura t'i ofrohen qendrave të ndalimit. Përderisa Zëvendës Komisari për Administratë, Drejtori për Shërbime Mbështetëse dhe Drejtori për Menaxhimin e Objekteve janë përgjegjëse për kushtet fizike të objekteve, pajisjet dhe përputhjen me standardet e caktuara në ligjin e aplikueshëm dhe në konventat ndërkombëtare.

Gjendja aktuale

2.5 Inspektorati Policor ka vërejtur ndryshime shumë të vogla në performancë që nga inspektimi i fundit i tij në këtë fushë. Menaxhimi aktual i performancës në lidhje me objektet e ndalimit të SHPK-së është i ngjashëm me atë të vitit të kaluar, sa i përket gjendjes fizike të objekteve të ndalimit dhe performancës së atyre zyrtarëve të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e qendrës dhe të personave të ndaluar. Tabela 1 ofron një analizë të



numrit të personave të arrestuar dhe të ndaluar në hapësirat për ndalim (në secilin regjion) që nga viti 2002. Tabela gjithashtu ofron një krahasim të gjashtëmujorit të parë të vitit 2006 dhe 2007. Siç mund të shihet, ka pasur vetëm një rritje të vogël (4%) në numrin e personave të ndaluar në gjashtë muajt e parë të vitit 2007, krahasuar me vitin e kaluar. Kjo paraqet një mesatare prej 16.7 të personave të ndaluar brenda ditës, krahasuar me mesataren prej 16.1 personave të ndaluar brenda ditës në vitin 2006 – një numër shumë i vogël krahasuar me shumë vende tjera evropiane.

2.6 Pas regjionit të Pejës me një mesatare prej 5.4 të arrestuar në ditë, stacioni qendror në Prishtinë është qendra tjetër më aktive me një mesatare prej 5 të arrestuar në ditë. Sidoqoftë, shumica e stacioneve kanë, mesatarisht, më pak se një person të ndaluar brenda ditës. Numri i përgjithshëm i personave të arrestuar dhe të ndaluar rezulton me vetëm një person i cili i nënshtrohet ndalimit policor në 452 zyrtarë policor në një ditë mesatare, në Kosovë. Krahasimi i numrit të personave të ndaluar në vitin 2006/2007 tregon një nivel vazhdimisht të ulët, duke parashtruar pyetjen nëse numri aktual i qendrave të paraburgimit është i mjaftueshëm. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë të kryejë një rishikim tërësor të qendrave të veta të ndalimit dhe ta zhvillojë një strategji afatgjate duke u bazuar në nevojat aktuale. Ky rishikim duhet të merr parasysh qasjet alternative dhe më ekonomike të qendrave policore të ndalimit, përfshirë mundësinë e mbylljes së qendrave të ndalimit me më pak se një person (në mesatare) brenda ditës dhe zhvillimin e qendrave regjionale më të mëdha dhe të pajisura më mirë. Kjo duhet të rezultojë në kushte më të mira të objekteve, personel të trajnuar dhe kursime të konsiderueshme.

Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë të kryejë një rishikim tërësor të qendrave të veta të ndalimit dhe ta zhvillojë një strategji afat-gjate duke u bazuar në nevojat aktuale. Ky rishikim duhet të merr parasysh qasjet alternative dhe më ekonomike të qendrave policore të ndalimit, përfshirë mundësinë e mbylljes së qendrave të ndalimit me më pak se një person (në mesatare) brenda ditës dhe zhvillimin e qendrave regjionale më të mëdha dhe të pajisura më mirë.

2.7 Sikurse në inspektimin e vitit 2006, kushtet e dhomave të ndalimit policor dhe objekteve përkatëse janë në përgjithësi të dobëta dhe kjo qartë është si rrjedhojë e kushteve të këqija në shumë stacione policore (shih Raportin e Përkohshëm nr. 8 – Kryerja e detyrave nga ana e e SHPK-së në menaxhimin e ndërtesave). Tabela 2 ofron një prëmbledhje të shkurtë të lokacionit dhe gjendjes së dhomave të ndalimit në tërë Kosovën. Sikurse në vitin 2006, pothuajse në të gjitha rastet dhomat e ndalimit – nëse shfrytëzohen – nuk do të plotësonin standardin minimal prej 7 m² për person. Në kuptim të gjendjes së përgjithshme, Inspektorati vërejti një laramani në këto qendra të ndalimit, sidomos duke marrë parasysh ligjin e aplikueshëm dhe standardet e të drejtave të njeriut si dhe Raportin e 12-të të Komisionit për Parandalimin e Torturës (KPT) të Këshillit të Evropës.

Tabela 1

Numri i personave të cilët iu nënshtrohen 'ndalimit policor nga regjioni/stacioni - 2002 - 2005 dhe gjashtëmuajt e parë të viteve 2006-2007

Regjioni	Stacioni	2002	2003	2004	2005	Mesatarja e personave në ditë (2005)	Gjashtë muajt e parë			
							2006	2007		
Prishtina	Qendra	1553	2138	1790	1595	4.3	851	4.7	917	5.0
Peja	Peja	414	459	231	220	0.6	136	0.7	214	1.1
	Gjakova	407	926	561	562	1.5	192	1.0	520	2.8
	Deçan	-	-	-	149	0.4	49	0.2	98	0.5
	Istog	-	-	-	123	0.3	38	0.2	78	0.4
	Klina	64	101	122	116	0.3	65	0.3	72	0.4
Totali		-	-		1170	3.2	480	2.6	982	5.4
Mitrovica	Jug	-	-	156	263	0.7	135	0.7	25	0.1
	Veri	-	99	146	201	0.5	114	0.6	80	0.4
	Vushtrri	18	132	139	198	0.5	41	0.2	60	0.3
	Skenderaj	149	116	66	27	0.07	16	0.08	11	0.06
	Leposaviq	20	35	33	31	0.08	9	0.04	2	0.01
	Zubin Potok	-	-	-	-	-				
Totali					720	1.9	315	1.7	178	0.9

2.8 Siç shihet në tabelën 2, ekzistojnë gjithsej 29 qendra të ndalimit dhe Inspektorati Policor i ka vizituar dhe vlerësuar 19 prej tyre (65%). Megjithëse duhet të përmendet se vetëm 13 (44.8%) qendra janë funksionale. Inspektimi i IPK-së ka vërejtur që 5 (26.3%) qendra të ndalimit kanë qenë në gjendje 'shumë të mirë', 6 (31.5%) kanë qenë në gjendje 'të mirë', 2 (10.5%) kanë qenë në gjendje 'të kënaqshme', 5 (26.3%) janë klasifikuar si të 'dobëta', dhe 1% medohet të jetë në gjendje 'shumë të dobët'. Prandaj, nga ato qendra të ndalimit të cilat janë inspektuar, 68.4% janë vetëm të kënaqshme apo më të mira dhe kjo tregon një përmirësim të konsiderueshëm (26%) që nga inspektimi i vitit të kaluar. Inspektorati Policor lavdëron përpjekjen e personelit përkatës të SHPK-së dhe inkurajon punë të mëtutjeshme në ngritjen e standardeve.

2.9 Në të njëjtën kohë Inspektorati Policor ka vërejtur se gati në të gjitha fushat ekziston nevoja për investime të mëtutjeshme dhe të konsiderueshme në gjendjen e objekteve për ndalim policor me qëllim të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare. Niveli i kushteve për pastrim rutinor duket se nuk ka ndryshuar dhe hapësirat e caktuara për ndalim në shumicën e rasteve nuk janë të ventiluara mirë dhe/ose nuk kanë ngrohje përkatëse. Niveli i kushteve për pastrim rutinor është i ulët dhe hapësirat e ndalimit në shumicën e rasteve nuk janë të ventiluara mirë dhe/ose nuk kanë ngrohje përkatëse. Në shumë vende, të ndaluarit shfrytëzojnë shtretërit me korniza të hekurta apo nga druri, dyshekë dhe mbulesa të cilat paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e të ndaluarve dhe të vetë personelit të SHPK-së. Në stacionin policor në veri të Mitrovicës, inspektorët vërejtën se gjendja ishte e njëjtë sikurse në vitin e kaluar. Ende vazhdojnë të përdoren ‘dyer me grila’ në dhomat e ndalimit të kombinuara brenda me tualet, që do të thotë se personat e ndaluar nuk kanë privatitet përderisa e përdorin tualetin. Në disa stacione, personat e ndaluar dhe personeli i SHPK-së i përdorin tualetet e njejta pa hapësirë të posaçme për higjienë personale. Shumicës prej qendrave të paraburgimit i mungojnë dhomat adekvate dhe të duhura për intervistimin (marrje në pyetje) e personave të naluara, dhe shpesh të ndaluarit duhet të shkojnë në qendra tjera të SHPK-së në mënyrë që të intervistohen, duke shkaktuar shpenzime shtesë dhe bezdisje të personat e ndaluar dhe personeli i SHPK-së. Në pritje të një zgjidhje afat-gjate, Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja urgjentisht të caktojë fonde për t’i përmirësuar kushtet në shumicën e dhomave të ndalimit dhe në objektet përkatëse të organizatës. Për shkak të lidhjes direkte me standardet ndërkombëtare, kjo fushë e menaxhmentit policor tani duhet të merret parasysh si çështje prioritare.

Tabela 1 – vazhdim
Numri i personave të cilët iu nënshtrohen 'ndalimit policor nga regjioni/stacioni –
2002 – 2005 dhe gjashtë muajt e parë të viteve 2006–2007

Regjioni	Stacioni	2002	2003	2004	2005	Mesatarja e personave në ditë (2005)	Gjashtë muajt e parë			
							2006	2007		
Prizren	Suharekë	-	-	-	-	-	55	0.3	37	0.2
	Malishevë	-	-	-	-	-	21	0.1	21	0.1
	Rahovec	173	282	284	135	0.3	58	0.3	48	0.2
	Dragash			67	40	0.1	19	0.1	29	0.1
	Prizren			657	729	1.9	390	2.1	284	1.5
Totali					904	2.4	538	2.9	419	2.3
Gjilan	Gjilan	802	781	721	718	1.9	312	1.7	172	0.9
	Kamenicë	-	-	-	-	-	21	0.1	9	0.04
	Vitia	-	-	-	-	-	38	0.2	15	0.08
Totali					718	1.9	371	2.0	196	1.0
Ferizaj	Kaçanik	71	153	197	149	0.4	92	0.5	82	0.4
	Shtime	-	-	-	-	-	46	0.2	22	0.1
	Shtërpcë	-	-	-	-	-	13	0.07	5	0.02
	Ferizaj						197	1.0	226	1.2
Totali		-	-	-	149	0.4	348	2.1	331	1.8
Totali							2903	16.12	3023	16.79

Rekomandimi kryesor Nr. 2

Në pritje të një zgjidhje afat-gjate, Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja urgjentisht të caktojë fonde për t'i përmirësuar kushtet në shumicën e dhomave të ndalimit dhe në objektet përkatëse të organizatës. Për shkak të lidhjes direkte me standardet ndërkombëtare, kjo fushë e menaxhmentit policor tani duhet të merret parasysh si çështje prioritare.

Tabela 2

Gjendja e qendrave të ndalimit të SHPK-së- 2007

Regjioni	Stacioni	Dhomat e ndalimit	Madhësia mesatare (m ²)	Kapaciteti i përgjithshëm	Në përdorim (Po/Jo)	Vlerësimi nga ana e zyrtarëve të SHPK-së (tetor 2007)
Prishtinë	Qendra	8	13.3	22	Po	Shumë mirë
	Glllogovc	4	10.1	6	Jo	-
	Graçanicë	3	5.3	6	Jo	-
	Lipjan	4	-	-	Jo	-
	Obiliq	2	8.4	-	Jo	-
	Podujevë	2	7.5	-	Jo	-
Pejë	Pejë	4	/	8	Jo	Mirë
	Gjakovë	3	5.5	3	Jo	Dobët
	Deçan	2	3	4	Jo	-
	Istog	4	-	6	Po	Shumë mirë
	Klinë	1	9.3	2	Po	Dobët
Mitrovicë	Jug	4	12.5	4	Po	Dobët
	Veri	4	11.3	4	Po	Dobët
	Vushtrri	2	-	2	Jo	-
	Skenderaj	4	12.8	-	Jo	-
	Leposaviq	4	11.3	6	Po	Shumë mirë
	Zubin Potok	-	-	-	Jo	-

Vlerësimi : Shumë dobët -Dobët - Kënaqshëm - Mirë -Shumë mirë

2.10 Sigurimi i ushqimit dhe i pijeve për personat e ndaluar është kontradiktor, në kuptim të mjeteve financiare dhe standardeve. Sikurse në të kaluarën, Inspektorati Policor vërejti se në disa stacione policore ushqimi sigurohet nga restorantet lokale duke përdorur mjetet nga 'peti kesh', në disa vende ushqimi sigurohet nga komuna, dhe në disa vende sigurohet nga burgjet që gjenden afër qendrave të ndalimit. Inspektorati Policor shprehë brengën e vet se angazhimi aktual 'ad hoc' i ushqimit për të ndaluarit nuk i plotëson nevojat standarde minimale. Për shembull inspektorati ka vërejtur rastin në Skenderaj, ku sipas regjistrimit të ndalimit (i inspektuar në prezencë të komandantit të stacionit policor) personit të ndaluar i është dhënë vetëm një herë ushqim brenda 24 orëve, sa ai ka qenë i ndaluar. Ky

incident tregon një shkelje të ligjit të aplikueshëm dhe të standardeve ndërkombëtare në lidhje me personat e ndaluar. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që sa më shpejtë që është e mundur të sajohet dhe të implementohet një politikë e njëtrajtëshme në lidhje me dhënien e ushqimit dhe pijeve freskuese personave të ndaluar. Duhet të vërehet se ky aspekt i menaxhimit të qendrës së ndalimit, sikurse edhe të tjerat, do të zgjidhej më mirë nëse SHPK-ja do të siguronte qendra të ndalimit më të mëdha dhe të pajisura më mirë në regjione dhe t'i mbyllë qendrat e vogla të ndalimit.

Rekomandimi kryesor

Nr. 3

Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që sa më shpejtë që është e mundur të sajohet dhe të implementohet një politikë e njëtrajtëshme në lidhje me dhënien e ushqimit dhe pijeve freskuese personave të ndaluar. Duhet të vërehet se ky aspekt i menaxhimit të qendrës së ndalimit, sikurse edhe të tjerat, do të zgjidhej më mirë nëse SHPK-ja do të siguronte qendra të ndalimit më të mëdha dhe të pajisura më mirë në regjione dhe t'i mbyllë qendrat e vogla të ndalimit.

Tabela 2 – Vazhdim

Kushtet e qendrave të paraburgimit të SHPK-së – 2007

Region	Stacion	Dhomat e ndalimit	Madhësia mesatare (m ²)	Kapaciteti i përgjithshëm	Në përdorim (Po/Jo)	Vlerësimi nga ana e zyrtarëve të SHPK-së (tetor 2007)
Prizren	Suharekë	4	-	6	Po	Shumë mirë
	Malishevë	8	-	12	Po	Shumë mirë
	Rahovec	4	-	8	Po	Mirë
	Dragash	2	-	4	Po	Mirë
	Prizren	6	-	12	Jo	Renovim
Gjilan	Gjilan	4	4.35	8	Po	Kënaqshëm
	Kamenica	4	13.3	8	Po	Mirë
	Vitia	1	11.7	2	Po	Kënaqshëm
Ferizaj	Centre	2	5	2	Jo	Dobët
	Kaçanik	7	11	12	Po	Mirë
	Shtime	2	9.7	3	Jo	Mirë
	Shtërpcë	2	9.7	3	Jo	Shumë dobët

Vlerësimi : Shumë dobët –Dobët – Kënaqshëm – Mirë –Shumë mirë

2.11 Sa u përket standardeve për shëndet dhe siguri – si për të ndaluarit poashtu edhe për personelin e SHPK-së – performanca është e dobët. Në të gjitha vendet e vizituara nga Inspektorati Policor është vërejtur se nuk ekzistojnë pasijet e ndihmës së parë dhe personelit të SHPK-së nuk i janë ofruar dorëza kirurgjike për përdorim gjatë bastisjes së personave të ndaluar. Gjithashtu, menaxhimi i dosjeve në qendrën e ndalimit dhe sendeve të personale të ndaluar mbetet i parregullt në tërë Kosovën. Sikurse në inspektimin e mëparshëm, dosjet e ndalimit në shumicën e rasteve janë vetëm të vendosura në dosje kartoni dhe të vendosura në raft, në vend që të vendosen në ndonjë vend të sigurtë. Për shembull, në Gjakovë Inspektorati Policor ka vërejtur që dosjet e ndalimit kanë qenë të vendosura në një vend me lagështi dhe dhe se ishin shkatërruar nga uji. Në shumicën e vendeve nuk bëhen kopjet e dosjeve të ndalimit dhe nuk ekziston asnjë masë paraprake në rast të humbjes apo shkatërrimit të formularëve orgjinal të ndalimit. Në disa vende sendet personale të personave të ndaluar nuk sigurohen në sirtarë të mbyllur, ndërsa në disa vende vendosen në dollap të mbyllur. Inspektorati Policor është i brengosur se mungesa e menaxhimit adekvat dhe e objekteve të përshtatshme mund ta rrisë rrezikun e humbjes apo shkatërrimit të sendeve personale të personave të ndaluar, në veçanti të parave dhe të sendeve me vlerë. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të sajojnë një Procedurë Standarde Operative në lidhje me menaxhimin e qendrës së ndalimit. Kjo duhet të specifikojë standardet minimale, pajisjet dhe orenditë, në mënyrë që t’ mundësojë personelit të SHPK-së të arrijë standarde më të larta në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Rekomandimi kryesor

Nr. 4

Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të sajojnë një Procedurë Standarde Operative në lidhje me menaxhimin e e qendrës së ndalimit. Kjo duhet të specifikojë standardet minimale, pajisjet dhe orenditë, në mënyrë që til mundësojë personelit të SHPK-së të arrijë standarde më të larta në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

2.12 Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorati Policor ka vërejtur disa hapa pozitive që janë ndërmarrë nga zyrtarët e lartë të SHPK-së, në përgjigje të rekomandimeve të IPK-së në lidhje me qendrat e ndalimit, dhe Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT). Në vazhdim të këtyre rekomandimeve, SHPK-ja ka sajuar dhe implementuar një numër formularësh për ndalim të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me ligjin e aplikueshëm, sa u përket të drejtave themelore të personave të ndaluar. Këta formularë janë në të gjitha gjuhët zyrtare dhe tani përdoren në tërë Kosovën dhe mund të përdoren në tërë organizatën përmes intranetit të SHPK-së. Përveç kësaj, Inspektorati Policor mirëpret ofrimin e trajnimit dy ditorë për të drejtat e njeriut për të gjithë zyrtarët policor.

2.13 Megjithëse, asnjë ankesë formale nuk është bërë nga personat e ndaluar, Inspektorati është i brengosur që ofrimi joadekvat i ndihmës sa u përket objekteve mund të rezultojë në praktikë të dobët. Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorati Policor ka vërejtur se ka pasur raste të vdekjeve në përkujdesje policore, gjithashtu

një tentim vetëvrasje në regjionin e Mitrovicës. Ekziston brenga se ata të cilët përfaqësojnë personat e ndaluar – në veçanti personat e ndaluar të cilët janë të dobët – dhe ata të cilët përkujdesen për mirëqenjen e tyre nuk janë plotësisht në dijeni sa i përket legjislacionit të ri në lidhje me ankesat kundër policisë. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja duhet të përpiqet ta rrisë vetëdijësimin në lidhje me të drejtat e personave të ndaluar dhe procedurave për paraqitjen e ankesës. Kjo mund të përfshijë një kampanjë me afishe në të gjitha stacionet policore, të cilat tregojnë të drejtat e personave dhe mënyrën se si ata mund të paraqesin një ankesë formale.

Rekomandimi kryesor

Nr. 5

Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja duhet të përpiqet ta rrisë vetëdijësimin në lidhje me të drejtat e personave të ndaluar dhe procedurave për paraqitjen e ankesës. Kjo mund të përfshijë një kampanjë me afishe në të gjitha stacionet policore, të cilat tregojnë të drejtat e personave dhe mënyrën se si ata mund të paraqesin një ankesë formale.

3. Politika dhe strategjia

3.1 Në kohën e kryerjes së inspektimit të rëndomtë, Inspektorati Policor nuk ka qenë në dijeni për asnjë strategji të përgjithshme të shkruar në lidhje me menaxhimin e personave të mbajtur në qendrat e ndalimit të SHPK-së, e cila mund të demonstrojë përkushtimin e organizatës në respektimin e të drejtave të personave të ndaluar, sipas ligjit të aplikuar në Kosovë. Inspektoratit Policor iu është ofruar Procedura Standarde Operative e ashtuquajtur “Qendrat e Ndalimit”: në bazë të këtij dokumenti kërkohet që kushtet për personat e mbajtur në qendrat e ndalimit të jenë në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit të aplikueshëm dhe të jetë si reference për rekomandimet e IPK.



“Qendrat e Ndalimit ‘ gjithashtu ofrojnë program trajnues për tërë personelin e qendrës. Është me rëndësi të përmendet që në kohën e inspektimit të rëndomtë Inspektorati Policor ka vërejtur se shumica e dokumenteve nuk janë shfrytëzuar. Sidoqoftë dokumenti nuk parasheh që qendra e ndalimit të ketë zyrtarë policor të cilët kryejnë funksione të specializuara, duke e rritë në këtë mënyrë vetëdijësimin në lidhje me gjendjen dhe duke nxitur praktikat më të mira përmes të punësuarve të trajnuar. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja duhet të merr parasysh krijimin e përshkrimit të punëve të specializuara për personelin e qendrës së ndalimit, duke përshkruar njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme, dhe përmirësimin e gjendjes dhe profesionalizmit në mesin e punonjësve të specializuar.

Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja duhet të merr parasysh krijimin e përkrahimit të punëve të specializuara për personelin e qendrës së ndalimit, duke përkrahur njohuritë dhe shkathësitë e nevojshme, dhe përmirësimin e gjendjes dhe profesionalizmit në mesin e punonjësve të specializuar.

3.2 Disa zyrtarë të lartë të SHPK-së kanë sqaruar që vendimi për ta sajuar një strategji afatëgjatë për zhvillim lidhur me qendrat e ndalimit është shtyer. Kjo ka ndodhur për shkak të një marrëveshje në pritje me donatorin, për të zhvilluar infrastrukturën në qendrat e ndalimit në tërë Kosovën. Ministria e punëve të jashtme të Italisë ka propozuar grante për të financuar projektin për përmirësimin e qendrave ekzistuese të ndalimit dhe ndërtimin e qendrave të reja në pajtueshmëri me standardet e kërkuara nga Këshilli i Evropës. Projekti duhet të realizohet në bashkëpunim të afërt me Kombet e Bashkuara: Zyra e Kombeve të Bashkuara për projekte (UNOPS) e cila do të bashkëpunojë për së afërmi me SHPK-në përmes një komiteti drejtues të përbërë nga zyrtarë policor të SHPK-së, Zyra e Kombeve të Bashkuara për projekte dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut.

3.3 Sidoqoftë, gjatë rrjedhës së intervistave me zyrtarët e lartë të SHPK-së, Inspektorati Policor ka vërejtur se shumë nga zyrtarët e lartë kanë qenë në dijeni për projektin e financuar por kanë qenë në gjendje të japin vetëm hollësi shumë të pakta në lidhje me implementimin e projektit. Nuk ekziston asnjë strategji alternative nëse plani dështon. Veçanërisht, Drejtori për Menaxhimin e Objekteve të SHPK-së i ka bërë me dije Inspektoratit Policor një numër barrierash që e pengojnë planin e propozuar për të rinovuar disa qendra ekzistuese për ndalim: kjo përfshinë paqatësinë vazhdueshme në lidhje me statusin ligjor të disa pronave të SHPK-së dhe mungesën e personelit të trajnuar për të kryer këtë punë në pajtueshmëri me standardet e Bashkësisë Evropiane. Drejtorja aktualisht nuk ka numër të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar dhe të trajnuar për ta kryer punën e nevojshme. Drejtori gjithashtu ka sqaruar që strategjia e investimeve është zhvilluar në dy faza; në mes të vitit 2004 dhe 2005 faza e parë përfshinë donacionet për punën në Glllogovc, Suharekë, Shtime, Malishevë, Rahovec, Kaçanik and Leposaviq; dhe faza e dytë ka të bëjë me një varg nërtimesh dhe projekte rinovimi të financuara nga grantet e Qeverisë Italiane dhe të përgatitura nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Projekte (UNOPS) .

Përderisa Inspektorati Policor mirëpret këto iniciativa dhuruese, gjithashtu rekomandon që SHPK-ja ta zhvillojë strategjinë e vet afatëgjatë për rinovim dhe mirëmbajtje të qendrave të ndalimit. Kjo detyrë duhet të kryhet pa marrë parasysh burimin e të ardhurave.

Përderisa Inspektorati Policor mirëpret këto iniciativa dhuruese, gjithashtu rekomandon që SHPK-ja ta zhvillojë strategjinë e vet afatëgjatë për rinovim dhe mirëmbajtje të qendrave të ndalimit. Kjo detyrë duhet të kryhet pa marrë parasysh burimin e të ardhurave

3.4 Sa i përket programit të SHPK-së për të trajnuar punonjësit e vetë lidhur me menaxhimin e qendrave të ndalimit dhe të personave të ndaluar, Inspektoratit Policor iu është ofruar një plan i specializuar trajnimi. Ky plan është sajuar në përgjigje të rekomandimeve të mëparshme të IPK-së. Plani trajnues i propozuar përqendrohet në tri fusha: vetëdijësimi mbi të drejtat e njeriut (4 ditë), trajtimi i personave me sëmundje mendore (1 ditë), dhe shkathtësitë e përgjithëshme policore për ndalim. Kjo e fundit përfshinë rregullat për ndalim dhe procedurat për kryerjen e detyrës, kufizimin e lëvizjes, ballafaqimin me çrregullime emocionale, dhe fotografimi. Inspektorati Policor e mirëpret planin e propozuar si një hap i sigurtë për rrugë të drejtë. Sidoqoftë, rekomandohet që trajnimi i propozuar të bazohet në përshkrimin e hollësishëm të punës që përfshinë listën e njohurive të kërkuara, shkathtësive dhe qëndrimit të personelit në qendrën e ndalimit. Kjo do ta definojë në mënyrë të duhur këtë fushë të ndjeshme të punës policore si një funksion të specializuar e jo thjeshtë si një detyrë 'ad hoc' që mund t'i ndahet secilit pjesëtarë të ekipit të patrullës rutinore.

Inspektorati Policor rekomandon që që trajnimi i propozuar të bazohet në përshkrimin e hollësishëm të punës që përfshinë listën e njohurive të kërkuara, shkathtësive dhe qëndrimit të personelit në qendrën e ndalimit. Kjo do ta definojë në mënyrë të duhur këtë fushë të ndjeshme të punës policore si një funksion të specializuar e jo thjeshtë si një detyrë 'ad hoc' që mund t'i ndahet secilit pjesëtarë të ekipit të patrullës rutinore.

Lista e rekomandimeve të Inspektoratit Policor – *Inspektimet e zakonshme*

Inspektorati Policor i Kosovës ia paraqet rekomandimet në vijim komesarit të Policisë së UNMIK–ut dhe personelit të lartë të SHPK–së, në pajtim me dispozitat e Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/99.

1. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK–ja të zhvillojë një metodologji të vetme në lidhje me inspektimin e armëve të zjarrit në të gjitha regjionet. Ky sistem duhet të bazohet në parimin që çdo armë e zjarrit duhet t'i nënshtrohet një kontrollimi të obliguar mujor, duke përdorur një formular zyrtar të SHPK–së dhe të evidentohen në bazën e të dhënave regjionale/qëndrore. Këto të dhëna mund të analizohen për të identifikuar trendet për sjelljen e SHPK–së (në lidhje me armët e zjarrit) dhe rezultatet e tyre mund të përdoren për të marrë vendime në lidhje me trajnim, testim dhe ndëshkime disiplinore.
2. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që SHPK–ja ta përdorë një politikë për largim të menjëhershëm nga puna kur ekzistojnë dëshmi të qarta se polici ka shtënë me armën e tij të zjarrit në mënyrë të pakujdeshme dhe të papërgjegjshme.
3. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që NJSP–ja rregullisht t'ia dërgojë informatat departamentit të trajnimit të SHPK–së në lidhje me procedurat disiplinore që përfshijnë keqpërdorimin e armëve të zjarrit, si pjesë e përpjekjes së vazhdueshme për zvogëlimin e incidenteve të tilla nëpërmes trajnimeve riçertifikuese dhe testeve.
4. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që SHPK–ja në strategjinë e armëve të zjarrit të përfshijë sigurinë minimale dhe standardet e sigurisë, dhe që këto standarde të implementohen në mënyrë të njëjtë në tërë organizatën sa më shpejt që të jetë e mundur.
5. Inspektorati Policor rekomandon që procesi I prezentimit të legjislacionit I cili rregullon përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve të SHPK–së, të përfundojë sa më parë që të jetë e mundur.
6. Inspektorati policor rekomandon që definicioni i forcës së arsyhme të shtjellohet më tutje në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave, dhe të gjithë zyrtarëve të SHPK–së duhet t'iu sigurohet nga një kopje e Kodit të Etikës mbi përdorimin e forcës, bazuar në KEEP.
7. Inspektorati policor rekomandon që departamenti I trajnimeve në SHPK të shqyrtojë mundësinë e zgjatjes së periudhës trajnuese mbi përdorimin e forcës në teori dhe praktikë, për kadetët e trajnimit themelor.
8. Inspektorati policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK–së të zhvillojnë një plan afatgjatë për prezentimin e trajnimit riçertifikues për të gjithë zyrtarët e SHPK–së së paku një herë në vit. Ky plan duhet të bazohet në

standardet e njohura të BE-së dhe praktikën më të mirë; këto rregulla duhet të përfshihen në dispozitat ligjore në draftin e ligjit policor.

9. Inspektorati policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të marrin parasysh ndërtimin e poligoneve të mbyllura për gjuajtje nëpër regjione si objekte të rëndësishme primare që do të mundësonin zbatimin e planit të SHPK-së për trajnime riçertifikuese. Plani për ndërtimin e këtyre poligoneve mund të integrohet në planet aktuale për renovimin dhe ndërtimin e stacioneve të reja policore dhe në këtë mënyrë të zvogëlojë barrën financiare afatgjate.
10. Inspektorati policor rekomandon që zëvendës komisarri për administratë, sa më parë të paraqesë një sistem të evidentimit të të gjitha ankesave ndaj pjesëtarëve të SHPK-së. Ky sistem duhet të përfshijë ankesat që zgjidhen në mënyrë joformale me hollësitë e zyrtarit policor të akuzuar dhe mbikëqyrësit.
11. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon Komisarri I policisë duhet të bëjë një shqyrtim gjithpërfshirës në përdorimin dhe keqpërdorimin e mundshëm të sistemit disiplinor nga mbikëqyrësit e SHPK-së. Kjo duhet të përfshijë një studim të numrit të rasteve disiplinore të inicuar nga mbikëqyrësit ose policët tjerë dhe numrin e rasteve të tilla që rezultojnë në shpalljen e fajësisë.
12. Inspektorati Policor nxit Komisarri e Policisë së UNMIK-ut të iniciojë një hetim urgjent në lidhje me zhvillimet e tanishme në vendimet e marra nga bordi i ankesave, me qëllim të implementimit të masave të menjëhershme të caktuara për të rikthyer besueshmërinë e popullatës në sistemin e tanishëm disiplinor.
13. Inspektorati Policor rekomandon që sa më shpejtë SHPK-ja të rishikojë sistemin e menaxhimit të informatave për rastet disiplinore. Duhet të krijohet një formë e re e bazuar në shkeljet sipas Urdhërësës Administrative 2006/9 dhe të ofrojë të dhëna të qarta dhe të sakta në lidhje me numrin e rasteve për secilin lloj të shkeljes dhe numrin e zyrtarëve të shpallur fajtorë.
14. Inspektorati Policor rekomandon që Drejtoria e Standardeve Profesionale të zhvillojë një politikë të ankesave policore dhe strategji përkatëse. Ajo duhet të përqëndrohet në nevojën e ngritjes së besueshmërisë së popullatës në sistemin e krijuar, për të siguruar se rastet e sjelljes së keqe të policëve të zgjidhen me shpejtësi dhe në pajtueshmëri të plotë me Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, dhe pastaj në bazë të Urdhërësës Administrative 2006/9. Gjithashtu, duhet të përpiqet të shtoj rrjedhën e saktë dhe të qartë të të dhënave lidhur me ankesat policore për menaxherët e lartë të SHPK-së, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe publikun. Duhet të ndihmojë në përdorimin e 'qarkut të informatave' që mundëson personelit të SHPK-së të ndër marrë masa proaktive në mënyrë që të zvogëlojë llojet e caktuara të sjelljeve të këqia.
15. Inspektorati Policor rekomandon që Drejtoria e Standardeve Profesionale të rishikoj politikën e përzgjedhjes dhe trajnimit për personelin e NJSP-së, si pjesë e përgaditjes për implementim të plotë të Urdhërësës Administrative

2006/9. Kjo politikë duhet të përfshijë vlerësimin nga ana e SHPK-së që zyrtarët e NJSP-së kanë rol vendimtar në masat e përgjegjësisë së organizatës dhe duhet të sigurojë që zyrtarët e përzgjedhur dhe të trajnuar të NJSP-së në kuptim të kompetencave dhe profesionalizmit, janë baras me rolin e përmbushjes së të priturve gjithnjë e më të mëdha të popullatës..

16. Inspektorati policor nxitë SHPK-në që të implementojë plotësisht dispozitat e ligjit të aplikueshëm që kanë të bëjnë me rolin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe atë të komandantëve të stacionit. Në mënyrë specifike dhe në bashkëpunim me Ministrinë, Procedurat Standarde të Operimit duhet të përpilohen në atë mënyrë që të definojnë në mënyrë të duhur procesin e planifikimit të buxhetit dhe çështjeve përkatëse dhe të përfshijnë konsultimet e duhura me komandantët regjional dhe komandantët e stacioneve.
17. Inspektorati Policor rekomandon që, si pjesë e një raporti vjetor gjithëpërfshirës të aktiviteteve të SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së duhet të ofrojnë informata të hollësishme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve financiare. Veçanërisht, duhet të saktësoj pagesën e personelit në secilin regjion dhe në departamentet e Shtabit Qendror, si dhe atë se çfarë është arritur përmes investimeve kapitale.
18. Inspektorati Policor rekomandon që ekipi udhëheqës i zyrtarëve të lartë të SHPK-së – në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme – duhet të krijojë një sistem të planifikimit strategjik afatmesëm. Ky sistem duhet të përpiket të identifikojë një vizion të përbashkët të miratuar, synime specifike organizative dhe ato të punës të nevojshme për realizimin e atij vizioni, si dhe alokimin e planifikuar të resurseve financiare për realizimin e objektivave
19. Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti I Personelit duhet në mënyrë aktive të inkurajojë zyrtarët policor, veçanërisht ata në pozita udhëheqëse që të angazhohen në kurse universitare. Kjo iniciativë duhet të përfshijë përpjekjet për të inkurajuar Universitetin e Prishtinës si dhe universitetet tjera private (të liçensuara) të ofrojnë kurse të avancuara studimi në lëndët lidhur me policinë.
20. Inspektorati Policor rekomandon që draft ligji I kuvendit për SHPK-në duhet të përmbajë dispozita të hollësishme lidhur me kriterin e përzgjedhjes për të gjitha gradat e SHPK-së, si dhe udhëzime lidhur me metodat e vlerësimit që shfrytëzohen për identifikimin e kandidatëve më të mirë.
21. Inspektorati Policor rekomandon që sistemi I gradimit duhet t'i nënshtrohet një rishikimi urgjent sa I përket aftësive të tij për identifikimin e kandidatëve më të mirë të mundshëm për secilën gradë. Ky rishikim duhet të marrë parasysh shfrytëzimin e mekanizmave shtesë, si rishikimin e kryerjes së punës nga ana e presonelit, qendrat e vlerësimit dhe programet trajnuese për zyrtarë të lartë, programe të cilat përqendrohen në verifikimin e shkathtësive të lidershipit para gradimit.

22. Inspektorati Policor nxit Departamentin e Personelit që të angazhojë më shumë resurse për përkrahjen e përpjekjes së vet për paraqitjen e pershkrimeve të standardizuara të punës për të gjithë pjesëtarët e SHPK-së të cilët janë në pozitë menaxhuese apo kryejnë role specialiste. Inspektorati Policor nxit Departamentin e personelit, që si çështje prioriteti, të sigurojë që të gjithë pjesëtarët e SHPK-së të cilët janë në pozitë menaxheri apo kryejnë ndonjë rol specialist, në gradën e rreshterit e më lartë, janë të pajisur me përshkrim pune të hollësishëm i cili do të defononte roline tyre dhe standardet e punës.
23. Inspektorati policor rekomandon që Departamenti I Personelit të dizajnojë dhe implementojë një skemë të përmirësuar të vlerësimit të personelit si pjesë e strategjisë afatgjate të zhvillimit të karrierës në SHPK. Kjo skemë e korigjuar duhet të sigurojë vlerësimin objektiv të punës së personelit dhe të ofrojë lidhje të qarta me përzgjedhjen dhe gradimin për të gjitha gradat. Përveç kësaj, kjo skemë duhet të përfshijë një program trajnues gjithpërfshirës dhe të detyrueshëm për të gjithë mbikëqyrësit dhe vlerësimi I performancës personale duhet të jetë shkathtësi kryesore në përshkrimet e punës së të gjithë mbikëqyrësve.
24. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që Departamenti I Personelit të shqyrtojë mundësinë e përcaktimit të një bordi të pavarur vlerësues për procesin e gradimit të policëve, si pjesë e një strategjie afatgjate për zhvillimin e karrierës. Vetëm një bord I tillë I pavarur mund të sigurojë transparencë dhe një sistem të drejtë përzgjedhës për të gjithë kandidatët. Gjithashtu rekomandohet që si pjesë e strategjisë afatgjate, Departamenti I Personelit të shqyrtojë mundësinë e futjes në funksion të qendrave të vlerësimit të cilat do të kontrollohen nga një organ plotësisht I pavarur .
25. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të marrin përsipër zhvillimin e një sistemi afatgjatë për zhvillimin e karrierës. Ky sistem duhet të bazohet në definimin e miratuar të stilit të lidhshëm të SHPK-së që do të jetë I nevojshëm në të ardhmen. Gjithashtu duhet të përfshijë një skemë gjithpërfshirëse bazuar në hulumtime të gjëra në prëvojën e organizatave tjera policore dhe të jetë në gjendje të bëjë identifikimin e liderëve të mundshëm si dhe t'i pajisë ata me mjetet e nevojshme për zhvillim.
26. Inspektorati Policor rekomandon që strategjia afatgjate e SHPK-së për zhvillimin e karrierës duhet në veçanti të kërkojë mënyrat për rritjen e numrit të përfaqësuesve të grupeve etnike dhe përfaqësimit të gjinisë femërore nga gradat e mesme deri te gradat e larta të SHPK-së.
27. Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti i Policisë Kufitare të SHPK-së duhet të rishikojë strukturën e vet organizative dhe të përpiqet të arrijë një spektër më të njëtrajtshëm kontrolli në tri nivelet e para të menaxhmentit.

28. Inspektorati policor fuqimisht rekomandon që të rishikohet sistemi aktual I policisë kufitare për numrimin e personave dhe automjeteve dhe të futet në përdorim një sistem më i qëndrueshëm.
29. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që Departamenti i Policisë Kufitare (Ministria e Punëve të Brendshme) ta kryej një studim më të hollësishëm të niveleve të personelit dhe të produktivitetit në porta të ndryshme kufitare, me qëllim të përdorimit të të dhënave rezultuese në hartimin e strategjisë aftmesme të Departamentit.
30. Inspektorati Policor rekomandon që t'i jepet përparësi futjes në përdorim të një rrjeti të integruar komunikimi I cili është gjithpërfshirës, I qëndrueshëm dhe stabil gjatë planifikimit strategjik të Departamentit të Policisë Kufitare dhe Ministrisë.
31. Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti për Trajnim i SHPK-së (në bashkëpunim me QKSPEZH) duhet që rregullisht t'i ofrojnë menaxherëve të SHPK-së informata të hollësishme në lidhje me mungesën nga vendi i punës për shkak të (d.m.th. të ofrojë më shumë të dhëna në lidhje me numrin e përgjithshëm 'të ditëve të punës ' të përfshirë në çdo kurs, sesa vetëm numrin e vendeve të trajnimit).
32. Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti i Policisë kufitare të SHPK-së ta merr parasysh përdorimin e treguesve të performancës policore në mënyrë që ta plotësojë dhe zgjerojë efikasitetin e njësitit të inspektimit.
33. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që funksionet e kësaj Drejtorie dhe marrëdhëniet me komandantët regjional duhet të përcaktohen qartë dhe t'ju komunikohen grupit të zyrtarëve të lartë.
34. Inspektorati Policor edhe njëherë nxit SHPK-në që ta rishikojë dhe përmirësojë sistemin e menaxhimit të informatave në lidhje me aksidentet në trafikun rrugor, dhe t'i marrë parasysh përparësitë e mundshme të sistemi të centralizuar dhe të menaxhuar nga Drejtoria e Trafikut.
35. Inspektorati Policor rekomandon që personeli I SHPK-së në nivelet më të larta të jetë shembull në parimin e parë të lidhshimit -motivimit- duke vizituar policët operativ në terren dhe duke dëgjuar shqetësimet e tyre.
36. Inspektorati Policor rekomandon që Komisari I Policisë së UNMIK-ut dhe Ministri I Punëve të Brendshme të lëshojnë një vërejtje me shkrim për Drejtorinë e Rendit Publik dhe t'ia imponoj një standard të performancës njësive regjionale të trafikut rrugor, sa I përket pajisjeve për zbulimin e shpejtësisë dhe pajisjeve për zbulimin e alkoolit.
37. Inspektorati Policor rekomandon që Komisari I Policisë së UNMIK-ut dhe Ministri I Punëve të Brendshme t'ia bëjnë një vërejtje me shkrim Drejtorisë për Rend Publik dhe t'ia imponojë një standard të performancës në lidhje me mbledhjen dhe krahasimin e statistikave në trafikun rrugor.

38. Inspektorati Policor rekomandon që Departamenti i Trajnimit të SHPK-së duhet të koordinojë përgatitjen e trajnimeve të duhura në fushat e analizimit të statistikave, zhvillimit dhe implementimit të strategjive dhe në shkathtësitë e shkruarjes së raporteve përkatëve. Ky trajnim duhet të përqendrohet në zyrtarët e lartë të trafikut në regjione dhe në Shtabin Qendror të SHPK-së.
39. Inspektorati Policor rekomandon që Ministria e Punëve të Brendshme, si pjesë e planit të vet strategjik, duhet të marrë iniciativë për krijimin e një marrëveshjeje me MTT-në dhe me SHPK-në për një qajse të strukturuar për bashkëpunim. Kjo marrëveshje duhet të përfshijë takime të rregullta për ta përcaktuar një strategji të përbashkët me fusha të qarta të përgjegjësive, ndarje të informatave, synime të pranuar nga të dy anët dhe afate të kufizuara kohore.
40. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së ta rishikojnë politikën ekzistuese që ka të bëjë me kategorizimin e aksidenteve dhe me angazhimin e burimeve. Ky rishikim duhet të udhëzohet nga synimi për ofrimin e kualitetit më të lartë për shërbim të publikut dhe përdorimin maksimal të burimeve të specializuara.
41. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të kryejnë një rishikim të strukturës së menaxhimit të trafikut rrugor, përfshirë një rivlerësim të rolit dhe funksionit të Drejtorisë së Trafikut, sistemit e krahasimit dhe të analizimit të aksidenteve rrugore dhe të dhënave lidhur me to, dhe sitemin më të efektshëm të sajimit të një strategjie për siguri në trafikun rrugor. Theksi duhet të vëhet mbi krijimin e një zingjiri komandues të efektshëm dhe efikas.
42. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja të zhvillojë një sistem efikas të komunikimit të informatave tek ata menaxherë të cilët e kërkojnë atë, dhe ashtu siç është e nevojshme, të sigurohen se menaxherët veprojnë në bazë të informatave. Veçanërisht rekoamndohet që raportet e Inspektoratit Policor të shpërndahen tek të gjithë menaxherët e SHPK-së.
43. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja të rishikojë përbërjen e personelit të menaxhmentit të njësitit të autoparkut dhe të shqyrtojë mundësinë e angazhimit të një specialisti civil për menaxhimin e njërit nga aspektet më të shtrenjta të organizatës së SHPK-së. Grada e shërbyesit civil përgjegjës për parkun e automjeteve duhet të reflektojë nivelin e lartë të përgjegjësisë.
44. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja ta rishikoj tërësisht përvojën e vet të sigurimit dhe të mirëmbajtjes së automjeteve gjatë disa viteve të fundit, si dhe ta krahasojë atë me përvojën në Maqedoni, Mal të Zi dhe Shqipëri. Të dhënat e mbledhura në këtë mënyrë pastaj mund të përdoren nga Ministria dhe nga zyrtarët e lartë të SHPK-së në mënyrë që të bien dakord për një strategji e cila përfaqëson përdorimin më të mirë të fondeve publike dhe ka

gjasa që të sigurojë që zyrtarët e SHPK-së të kenë qasje në automjete të sigurta dhe të qëndrueshme.

45. Inspektorati Policor nxit SHPK-në që ta rishikojë procedurën e vet në lidhje me zyrtarët policor të cilët iu shkaktojnë dëme automjeteve të SHPK-së, pa marrë parasysh nëse i bëjnë ato me paramendim apo nga pakujdesia. Ky proces duhet të merr parasysh dispozitën e re të Urdhëresës Administrative 2006/9(shkeljet disiplinore që kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës policore), dhe të marre parasysh përdorimin e diskualifikimit të menjëhershëm nga ngasja dhe dënimin e duhur me të holla.
46. SHPK-ja nxitet që të krijojë dhe implementojë një sistem krahasues të faktorëve shkakor të aksidenteve nga raportet e hetimeve të aksidentit, për të gjitha aksidentet ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së. Të dhënat përfundimtare duhet të përdoren nga zyrtarët e lartë për identifikimin e hapave të duhura në mënyrë që të zvogëlohen aksidentet e tilla, si pjesë e politikave të përgjithshme dhe e strategjisë përkatëse.
47. SHPK-ja këshillohet që ta fillojë një proces të krijimit të një politike gjithpërfshirëse të parkut të automjeteve dhe strategjinë implementuese në lidhje me prokurimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e parkut të automjeteve. Ky proces i krijuar duhet të frymëzohet nga parimi i ekonomizimit dhe i udhëzuar nga një plan gjithpërfshirës policor që i njeh anët pozitive dhe kufizimet e patrullave mobile (automjetet) në përmbushjen e synimeve të SHPK-së.
48. Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së këshillohen që t'i rishikojnë madhësinë e parkut të automjeteve, llojin e automjeteve në përdorim dhe shpërndarjen e tyre në mbështetje të masave proaktive dhe reaktive poliocore. Duhet të krijohen lidhje me planet lokale policore të përgatitura në bazë të Rregullores 2005/54.
49. Si pjesë e Politikës së Parkut të Automjeteve të SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së nxiten që të krijojnë dhe implementojnë një sistem më të fuqishëm për zvogëlimin e numrit të aksidenteve ku përfshihen automjetet e SHPK-së
50. Inspektorati Policor inkurajon drejtorin eDMO-së që në bazë të suksesit aktual të Drejtorisë të paraqes një standard pune më preciz lidhur me kërkesat për mirëmbajtje rutinore dhe riparime. Për shembull, Drejtoria duhet t'i vë vetes synimin për t'iu përgjigjur 80% të kërkesave brenda një periudhe të caktuar kohore
51. Inspektorati Policor nxit zyrtarët e lartë të SHPK-së që të rishikojnë performancën e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse dhe më në veçanti, mundësitë aktuale për përgatitjen e kontratave për ndërtim dhe renovim. Për shkak të shpenzimit më të ultë të buxhetit për investime kapitale për vitin 2007, ky rishikim duhet të trajtohet si një çështje prioritare.
52. Inspektorati policor rekomandon që politika për marrjen me qira të ndërtesave t'i nënshtrohet një rishikimi nga ana e menaxherëve të lartë të

SHPK-së, në mënyrë që të identifikojë mundësi sa më të duhura dhe më ekonomike.

53. Inspektorati policor mirëpret planet aktuale për shtimin e nurmit dhe cilësisë së objekteve për pushim/byfeve për zyrtarët e SHPK-së dhe rekomandon që këto plane të zbatohen në tërësi. Një masë e tillë do të përmirësojë motivimin e policëve për punë, do të ndihmojë SHPK-në që të përshtatet me legjislacionin e ri, i cili ndalon pirjen e duhanit në vende publike (shih Nenin 13.7(e) Urdhëresa Administrative 2006/9) dhe do t'i jep fund imazhit negativ të qytetarëve ndaj policëve të uniformuar të mbledhur nëpër kafeteri.
54. Inspektorati policor përsëri rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së urgjentisht t'i rishikojnë standaret për mbrojtje nga zjarri në të gjitha stacionet policore përfshirë furnizimin me pajisje të sigurisë (mbrojtje nga zjarri) me qëllim të futjes në përdorim dhe mirëmbajtjes së pajisjeve për mbrojtje nga zjarri si dhe stërvitjet e rregullta të personelit.
55. Nëse politikat e tilla janë zhvilluar më parë, Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të zhvillojnë dhe zbatojnë politikat e shkruara që kanë të bëjnë me nevojën e mbajtjes në minimum të shpenzimeve të shërbimeve komunale –veçanërisht shpenzimet e elektricitetit dhe telefonit– dhe të inkurajojnë personelin që t'i shmangen keqpërdorimit të panevojshëm..
56. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që Drejtoria për menaxhimin e objekteve duhet të zhvillojë një dokument të vet të hollësishëm lidhur me planifikimin strategjik. Kjo e fundit duhet të veprojë në pajtim me synimet e përgjithshme të planit kryesor strategjik 2007 – 2009, dhe të përmbajë hollësi të mjaftueshme lidhur me synimet në fushat e ndërtimit, renovimit, mbrojtjes nga zjarri, objektet për pushim, shfrytëzimi i shpenzimeve komunale dhe kursimi i rrymës. Së fundi, strategjia e Drejtorisë – si plan kryesor strategjik i SHPK-së – duhet të jetë dokument publik, në këtë mënyrë të promovojë parimet demokratike të transparencës dhe të përgjegjshmërisë ndaj popullatës.
57. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë të kryejë një rishikim tërësor të qendrave të veta të ndalimit dhe ta zhvillojë një strategji afat-gjate duke u bazuar në nevojat aktuale. Ky rishikim duhet të merr parasysh qasjet alternative dhe më ekonomike të qendrave policore të ndalimit, përfshirë mundësinë e mbylljes së qendrave të ndalimit me më pak se një person (në mesatare) brenda ditës dhe zhvillimin e qendrave regjionale më të mëdha dhe të pajisura më mirë.
58. Në pritje të një zgjidhje afat-gjate, Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja urgjentisht të caktojë fonde për t'i përmirësuar kushtet në shumicën e dhomave të ndalimit dhe në objektet përkatëse të organizatës. Për shkak të lidhjes direkte me standardet ndërkombëtare, kjo fushë e menaxhmentit policor tani duhet të merret parasysh si çështje prioritare.

59. Inspektorati Policor fuqimisht rekomandon që sa më shpejtë që është e mundur të sajohet dhe të implementohet një politikë e njëtrajtëshme në lidhje me dhënien e ushqimit dhe pijeve freskuese personave të ndaluar. Duhet të vërehet se ky aspekt i menaxhimit të qendrës së ndalimit, sikurse edhe të tjerat, do të zgjidhej më mirë nëse SHPK-ja do të siguronte qendra të ndalimit më të mëdha dhe të pajisura më mirë në regjione dhe t'i mbyllë qendrat e vogla të ndalimit.
60. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të sajojnë një Procedurë Standarde Operative në lidhje me menaxhimin e qendrës së ndalimit. Kjo duhet të specifikojë standardet minimale, pajisjet dhe orenditë, në mënyrë që t'i mundësojë personelit të SHPK-së të arrijë standarde më të larta në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.
61. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja duhet të përpiqet ta rrisë vetëdijësimin në lidhje me të drejtat e personave të ndaluar dhe procedurave për paraqitjen e ankesës. Kjo mund të përfshijë një kampanjë me afishe në të gjitha stacionet policore, të cilat tregojnë të drejtat e personave dhe mënyrën se si ata mund të paraqesin një ankesë formale.
62. Inspektorati Policor rekomandon që SHPK-ja duhet të merr parasysh krijimin e përshkrimit të punëve të specializuara për personelin e qendrës së ndalimit, duke përfshirë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme, dhe përmirësimin e gjendjes dhe profesionalizmit në mesin e punonjësve të specializuar.
63. Përderisa Inspektorati Policor mirëpret këto iniciativa dhuruese, gjithashtu rekomandon që SHPK-ja ta zhvillojë strategjinë e vet afatëgjate për rinovim dhe mirëmbajtje të qendrave të ndalimit. Kjo detyrë duhet të kryhet pa marrë parasysh burimin e të ardhurave.
64. Inspektorati Policor rekomandon që që trajnimi i propozuar të bazohet në përshkrimin e hollësishëm të punës që përfshinë listën e njohurive të kërkuara, shkathtësive dhe qëndrimit të personelit në qendrën e ndalimit. Kjo do ta definojë në mënyrë të duhur këtë fushë të ndjeshme të punës policore si një funksion të specializuar e jo thjeshtë si një detyrë 'ad hoc' që mund t'i ndahet secilit pjesëtarë të ekipit të patrullës rutinore.



Pjesa III

Hetimet e sjelljeve të këqija

POLICE



Lansimi i hetimeve të IPK-së

Një pikë e rëndësishme e zhvillimit të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) u shënuar me lansimin e departamentit të hetimeve më datën 1 tetor 2007 dhe nga ajo datë, Agjencioni mori përgjegjësinë për hetimin e akuzave për shkelje të këqija të rënda nga ana e punonjësve të SHPK-së të të gjitha gradave. Që nga 1 tetori deri më 16 nëntor, nga IPK-ja janë pranuar mbi 50 ankesa qoftë nga qytetarët apo të përcjellura nga Njësi I Standardeve Profesionale në SHPK (NJSP).



The screenshot shows a web interface for managing complaints. It includes fields for 'Ref Number', 'Subject', and 'Category'. There are date pickers for 'Received Date', 'Complaint Date', 'Initial Response date', 'Finalised Date', and 'Final letter Date'. Below these are sections for 'PIK Officers' and 'PIK Investigator', each with fields for Name, Surname, Id Number, Desk Phone, Mobile Phone, Fax, E-mail, and Note. There are 'Add Officer' and 'Add Investigator' buttons.

IPK-ja si një organizatë e pavarur mund të ndihmojë në rritjen e besimit të qytetarëve se zyrtarët policor të cilët nuk veprojnë në pajtim me ligjin do të jenë përgjegjës për veprimet e tyre. Gjithashtu mund të ofrojë përkrahje më të madhe për zyrtarët policor të cilët janë subjekt i akuzave qëllimkëqija dhe të rrejshme për sjellje të keqe.

Departamenti i formuar rishtasi përbëhet prej drejtorit dhe 19 hetuesve të zgjedhur nga më shumë se 700 kandidatë gjatë fushatës së rekrutimit të shërbimit civil të IPK-së në fillim të këtij viti. Të gjithë hetuesit janë të diplomuar në fakultet, shumica e të cilëve janë të diplomuar në juridik apo kanë të kryer shkallën e dytë të studimeve në juridik (magjistraturë).

Trajnimi i hetuesve të IPK-së

Ekipi implementues i Misionit të OSBE-së në Kosovë udhëhoqi një program trajnimi për hetues prej 24 javësh i cili filloi në prill dhe përfundoi më 28 shtator. Kursi intenziv përbëhej prej katër moduleve për zhvillimin e njohurive, të kuptuarit dhe aplikimit të shkathtësive hetuese në fushën e ligjit të apikueshëm, përpilimit të raportit dhe koncepteve në menaxhment. Një theks i veçantë u vu në parimet e 'të mësuarit duke vepruar' dhe zhvillimit të aftësive personale. Dispozitat e Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresa Administrative 2006/9 janë inkorporuar në të gjitha modulet.



Gjatë kursit 24 javësh, performanca e çdo pjesëmarrësi të IPK-së në trajnim u vlerësua në intervale të rregullta me anë të testeve formale me shkrim dhe dorëzimit të detyrave për secilin modul. Nga secili pjesëmarrës trajnimi është kërkuar që të intervistojë një numër aktorësh të roleve për dëshmitarë dhe të dyshimtë me qëllim të përgatitjes së pesë dosjeve individuale të rastit.

SHPK-ja dhe informimi i qytetarëve

Programi trajnues gjithashtu përfshiu seminarët e përbashkëta të organizuara nga ekipi i OSBE-së për implementim të IPK-së, SHPK-ja dhe NJSP-ja. Këto tubime nënvizuan dispozitat e reja ligjore dhe ndarjen e përgjegjësive në mes IPK-së dhe NJSP-së e të cilat janë treguar shumë të sukseshme.

Menaxheri i projektit të ekipit të OSBE-së për implementim gjithashtu përgatiti një “Udhëzues për ankesat ndaj policisë” ku tani 9000 kopje të këtij manuali prej 98 faqesh janë duke iu shpërndarë çdo zyrtari policor dhe punonjësi civil si një udhëzues për ‘vetmësim’. 300,000 broshura për informimin e qytetarëve lidhur me rolin dhe funksionin e IPK-së janë në proces për t’u shtypur nga ana e OSBE-së e të cilat do t’i shpërndahen secilës familje në Kosovë, në një të ardhme të afërt. Poashtu kjo broshurë lexuesit i ofron udhëzime dhe këshilla se si të paraqes çfarëdo lloj ankese ndaj pjesëtarëve të SHPK-së për sjellje të keqe të mundshme.

Specialistët e OSBE-së⁸⁵ ofruan përkrahje të rëndësishme në dizajnimin dhe implementimin e bazës së të dhënave të IPK-së për të rexhistruar, menaxhuar dhe siguruar të dhënat statistikore për të gjitha ankesat. Gjithashtu specialistët tjerë të OSBE-së ⁸⁶ organizuan dhe mbajtën trajnimin për njoftim me mediat, për hetuesit e IPK-së dhe rezultatet tanimë mund të shihen me anë të bashkëpunimit të mirë të IPK-së me shtypin dhe televizionin.

Zhvillimet e ardhshme

Pas përfundimit të hetimit të IPK-së, Kryeshefi ekzekutiv do të përcaktojë nëse ekzistojnë baza të mjaftueshme për dëgjim disiplinor. Siç është definuar në Urdhëresën Administrative 2006/9, përgjegjësinë për përcaktimin e fajit ose ndryshe për të gjitha supozimet për shkelje të rënda e mbanë Këshilli për Emërime të Larta Policore dhe Disiplinë (KELPD).

Ky këshill është i pavarur nga SHPK-ja dhe përbëhet nga punonjës të lartë

civil të ministrive dhe komunave. Formimi i KELPD-së është vonuar pak për shkak të zgjedhjeve të nëntorit dhe Ekipi implementues i OSBE-së shpreson të fillojë me seminarin trajnues për anëtarët e KELPD-së para se të fillohet me dëgjimet e KELPD-së në fillim të vitit 2008.



Vizita e Sekretarit të përgjithshëm të OSBE-së, Marc Perrin de Brichambaut në zyrën qendrore të IPK-së.

⁸⁵ Shërbimet e TI-së në OSBE, Z. Elchin Azizos, zyrtar për dizajn të bazës së të dhënave, Z. Faton Tytynxhiu, asistent për dizajn të bazës së të dhënave dhe Z. Kastriot Gashi, asistent për dizajn të bazës së të dhënave.

⁸⁶ Departamenti për Siguri dhe Rend Publik I OSBE-së, Sektori për Siguri dhe Informim, Znjsh. Angela Tenbruck, Zonja Shpresa Mulliqi dhe Znjsh. Valmira Bimbashi

Inspektorët e Inspektoratit Policor të Kosovës



Enver Rrustemi
Kryeshef ekzekutiv

Bekim Pira, UD/Drejtor i
Departamentit të Inspektiveve

Valdet Hoxha, Drejtor i
Departamentit të Hetimeve

Admir Shala, Inspektor i IPK-së
Arben Vrajolli, Inspektor i IPK-së
Arsim Telaku, Inspektor i IPK-së
Asmir Muminovic, Inspe. i IPK-së
Aziz Nika, Inspektor i IPK-së
Bekim Lajci, Inspektor i IPK-së
Bujar Mustafa, Inspektor i IPK-së
Daluk Haliti, Inspektor i IPK-së
Hasan Mehmeti, Inspekt. i IPK-së
Hysni Gashi, Inspekt. i IPK-së
Ilir Idrizaj, Inspektor i IPK-së
Kadri Keqmezi, Inspekt. i IPK-së
Miradije Kelmendi, Insp. i IPK-së
Mirsad Pocurica, Inspek. i IPK-së
Nazmi Gashi, Inspektor i IPK-së
Servet Tasholli, Inspek. i IPK-së
Xhevdet Halili, Inspektor i IPK-së

Agron Zekolli, Hetues i IPK-së
Ahmet Kapitaj, Hetues i IPK-së
Arben Osmani, Hetues i IPK-së
Avdi Sylaj, Hetues i IPK-së
Bajram Fetahu, Hetues i IPK-së
Bardhyl Haxhimustafa, Hetues
Donika Smajlaj, Hetues i IPK-së
Edona Haqifi, Hetues i IPK-së
Exhevit Zuka, Hetues i IPK-së
Faruk Dakaj, Hetues i IPK-së
Gani Zulfaj, Hetues i IPK-së
Kushtrim Hodaj, Hetues i IPK-së
Kushtrim Jonuzi, Hetues i IPK-së
Magribe Aliu, Hetues i IPK-së
Mentor Ademaj, Hetues i IPK-së
Qazim Veseli, Hetues i IPK-së
Qerim Bytyçi, Hetues i IPK-së
Ramiz Ramadani, Hetues i IPK-së
Xhavit Fetahaj, Hetues i IPK-së



Ekipi implementues I OSBE-së për Inspektoratin Policor të Kosovës (2007)

Pjesëtarët e personelit të Departamentit për Siguri dhe Rend Publik, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Frank Harris, Menaxher i projektit

Steve Smith, Menaxher i trajnimit

Selim Selimi, Trajner (Ligji i aplikueshëm)

Apollon Hoxha, Trajner (Përpilimi i raportit)

Burim Brahimi, Trajner (Shkathtësitë në menaxhment)

Teuta Begolli, Trajner

Arlinda Krasniqi, Asistente e programit

Bojana Ivkovic, Asistente e programit

Venera Mehmeti, Asistente e programit

Srdjan Peric, Asistent i programit

Elvane Bunjaku, Asistente e programit

Sinan Pasha, Asistent gjuhe/Monitorues

Kristijan Adzic, Asistent gjuhe/Monitorues



Francis Harris
Chief of Police Inspectorate
of Kosovo Section



Stephen Smith
Governmental Trainer



Burim Brahimi
Trainer



Teuta Begolli
Trainer



Selim Selimi
Trainer



Apollon Hoxha
Trainer



Bojana Ivkovic
Programme Assistant



Elvane Bunjaku
Programme Assistant



Arlinda Krasniqi
Programme Assistant



Sinan Pasha
Language Assistant



Venera Mehmeti
Programme Assistant



Srdjan Peric
Programme Assistant



Kristijan Adzic
Language Assistant




Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo unutrašnjih poslova
Ministry of Internal Affairs

osce
MISSION IN KOSOVO

OSCE IMPLEMENTATION TEAM
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



SHTOJCAT

A. Prona e patundshme në pronësi/e kontrolluar/në shfrytëzim të SHPK-së

B. Analizë e përbërjes etnike në SHPK

Shtojca A (1) – Prona e pajuaftshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronari ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metra katror për person	Vlerësuar nga SHPK-ja	Vlerësuar nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Objekti i Shtabit Qendror	Policia	/ S=3748 m ²	796	4.70 m ²	Mirë	Mirë	/
Objekti i administratës	Kuvendi Komunal Prishtinë	/ S=4122 m ²	452	9.11 m ²	Mirë	Mirë	/
Komanda regjionale dhe stacioni qendër	Kuvendi Komunal-Prishtinës	/ S=2604 m ²	229	11.3 m ²	Mirë	Renovim	/
Stacioni policor –Veri	Ujësjiellësi	0.62,68 ha S=220 m ²	180	1.2 m ²	Mirë	Dobët	/
Stacioni policor–Jug	KEK	0.03,76 ha S=400 m ²	179	2.2 m ²	Mirë	Dobët	/
Policia kufitare dhe Komanda Regjionale	Kuvendi Komunal-Prishtinës	0.18,10 ha /	56	/	Mirë	/	/
Baza e logjistikës Prishtinë	Kuvendi Komunal-Prishtinë	3.50,00 ha S=8748 m ²	/	/	/	/	/
Qendra e trajnimit	Kuvendi Komunal-Prishtinë	/ /	/	/	Mirë	/	/
Garazhat e policisë në kompleksin “Qafa”	Policisë	/ /	/	/	Ka nevojë për renovim	/	/
Poligoni i gjuajtjes në Grabovc	KEK	1.96,11 ha /	/	/	Relativisht mirë	/	/

Shtojca A (2) - Prona e pajuajtshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronar ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metra katror për personel	Vlerësuar nga SHPK-ja	Vlerësuar nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Besi- Prugovc	SHPK-së	2.55,90 ha /	/	/	Mirë	/	/
Stacioni policor Graçanicë	SHPK-së	0.39,25 ha	/	/	/	/	/
Ish nën stacioni policor Keqekollë	Kuvendi Komunal-Prishtinë	/	/	/	/	/	/
Stacioni Policor F.Kosovë	Kuvendi Komunal i F.Kosovë	0.17,79 ha S=288 m ²	81	3.5 m ²	Mirë	Dobët	/
Shtabi i trafikut regjional /Prishtinë	Pronë e hekurudhës	0.08,50 ha S=748 m ²	/	/	Mirë	/	/
Stacioni policor- Obiliç	Policisë	0.83,33 ha S=1500 m ²	80	18.7 m ²	Mirë	Dobët	/
Stacioni policor Podujevë	Kuvendi Komunal Podujevë	0.24,82 ha S=1368 m ²	133	10.2 m ²	Mirë	Mirë	/
Ish nën stacioni policor Luzhan	Policisë	0.96,52 ha S=210 m ²	/	/	Relativisht mirë	/	/
Ish nën stacioni Kërpimëh	Policisë	/	/	/	/	/	/
Ish nën stacioni policor Orllan	Kuvendi Komunal- Podujevë	0.07,40 ha	/	/	Relativisht mirë	/	/

Shtojca A (3) – Prona e pajuaftshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronar ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metër katror për personel	Vlerësuar nga SHPK-ja	Vlerësuar nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Airoporti sportiv	Ish Ministria e Punëve të Brendshme	47.43,82 ha /	/	/	Objektet janë demoluar gjatë luftës	/	/
Stacioni policor Glllogovc	SHPK-së	0.38,33 ha S=501.29 m ²	131	3.8 m ²	Relativisht mirë	Kënaqshëm	/
Ish nën stacioni policor Arllat	Policisë	2.61,18 ha NN	/	/	E braktisur	/	/
Ish nënstationi policor Komaran	Policisë	1.33,44 ha /	/	/	E braktisur	/	/
Stacioni policor Lipjan	Kuvendi Komuna-Lipjan	0.81,46 ha S=1578 m ²	132	11.9 m ²	Mirë	Mirë	/
Ish nënstationi policor Janjevë	/	/ S= 136 m ²	/	/	/	/	/
Ish NSP Magure	Policisë	0.25,95 ha	/	/	/	/	/
Blinajë	Policisë	0.03,13 ha /	/	/	Është vendosur TMK-ja	/	/
Shtabi Regjional Pejë dhe stacioni policor- Pejë	Kuvendi Komunal-Pejë	0.64,45 ha S=2124 m ²	303	7.0 m ²	Mirë	Mirë	S. policor 0.25.93ha 732 m ² & KRP 0.25.93ha 1030 m ²
NJT -Pejë	SHPK-së	0.25,93 ha 530 m ²	95	5.5 m ²	Mirë	Shumë mirë	0.11.38ha 300m ²

Shtojca A (4) – Prona e pajuaftshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronar ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metër katror për personel	Kushtet e vlerësuara nga SHPK-ja	Kushtet e vlerësuara nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
NSP Vitomiricë	Kuvendi Komunal-Pejë	/ S=508 m ²	26	19.5 m ²	Mirë	Mirë	/ 120m ²
NSP Gorazhdec	/	/ S=177 m ²	/	/	/	/	Kontejner
Stacioni policor Klinë	Klinë	0.81,46 ha S=600 m ²	94	6.3 m ²	Mirë	Mirë	/ 330m ²
NSP Ujmirë	Kuvendi Komunal-Klinë	0.33,90 ha /	/	/	I braktisur	/	/
Stacioni policor Deçan	SHPK-së	0.29,23 ha S=580 m ²	101	5.7 m ²	Mirë	Sh.mirë	0.29.23ha 580m ²
NSP Junik	KB Moranica	0.14,64 ha S=260 m ²	23	11.3 m ²	Mirë	Mirë	0.14.64ha 272m ²
Izniq	Policisë	0.19,65 ha /	/	/	I djegur gjatë luftës	/	/
Stacioni policor Istog	SHPK-së	0.25,22 ha S=828 m ²	101	8.1 m ²	/	Sh. mirë	0.18.52ha 823.4m ²
Ish NSP Gorakoc	Policisë	0.31,75 ha /	/	/	I braktisur	/	/
Banjë-(Pejë)	Drejtoria së kompleksit të banjës	0.10,00 ha /	/	/	Ka nevojë për renovim	/	/

Shtojca A (5) – Prona e pajuajtshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronar ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metër katror për personel	Kushtet e vlerësuara nga SHPK-ja	Kushtet e vlerësuara nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Rakosh	Kuvendi Komuna i Istogut	0.40,22 ha /	/	/	Pronën e shfrytëzon një familje	/	/
Stacioni policor Gjakovë	Pronë e autoshkollës	/	151	8.23 m ²	Mirë	Kënaqshëm	/
Ish NSP Gjakovë	SHPK-së	0.08,88 ha /	/	/	Është i dëmtuar nga lufta	/	/
Ish NSP Zhub	Policisë	1.57,81 ha /	/	/	Është i dëmtuar nga lufta	/	/
Ish NSP Ponoshec	Policisë	1.44,84 ha	/	/	/	/	/
Ish NSP Hereq	Policisë	3.01,94 ha /	/	/	Nuk ka objekte	/	/
Ish NSP Rugovë	Policisë	0.35,18 ha /	/	/	Objekti i dëmtuar	/	/
Ish NSP Cërmjan	Policisë	0.88,62 ha /	/	/	Objekti i dëmtuar	/	/
Shtabi regjional Prizren	SHPK-së	/	186	5.49 m ²	/	Mirë	/
		1021.4 m ²					1248m ²
Stacioni policor Alfa	Kuvendi Komunal-Prizren	0.04,05 ha S=2000m ²	200	10 m ²	Good	Kënaqshme	/
							960m ²

Shtojca A (6) – Prona e pajuajtshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronar ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i prsonelit	Metër katror për personel	Kushtet e vlerësuara nga SHPK-ja	Kushtet e vlerësuara nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Njësi për mbështetje	SHPK-së	0.12,97 ha /	/	/	Mirë	/	/
NSP Zhur	Policisë	0.40,87 ha S=110 m ²	19	5.7 m ²	Relativisht mirë	/	/
Ish NSP Komogllavë	/	/	/	/	/	/	/
Ish NSP Zym	Policisë	0.14,65 ha /	/	/	Relativisht mirë	/	/
Ish NSP Lubizhd	Policisë	29.01 ha /	NN	/	Objekti i rrënuar	/	/
Ish NSP Reqan	Kuvendi Komunal i Prizrenit	0.04,58 ha /	NN	/	Objekti i rrënuar	/	/
Ish NSP te URA e SHEJT	Policisë	/	NN	/	Është shndërruar në hotel privat	/	/
NSP Sreckë	Policisë	0.02,60 ha S=110 m ²	29	3.7 m ²	Relativisht mirë	/	/
Vërmicë	Dogana	2.23,94 ha /	64	Shfrytëzohet së bashku me doganën	Mirë	/	/

Shtojca A (7) – Prona e pajuajtshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronari ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metër katror për personel	Kushtet e vlerësuara nga SHPK-ja	Kushtet e vlerësuara nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Stacioni policor Suharekë	Policisë	0.44,66 ha s=700 m ²	132	5.3 m ²	Mirë	Dobët	/ 700m ²
Ish NSP Mushtisht	Kuvendi Komunal Suharekë	0.55,96 ha /	21	/	Mirë	/	/
Ish NSP Duhël	Kuvendi Komunal – Suharekë	0.44,58 ha /	/	/	I braktisur	/	/
Stacioni policor Malishevë	SHPK-së	0.35,94 ha S=950 m ²	103	9.2 m ²	Mirë	kënaqshëm	/ 950m ²
Ish NSP Kjevë	Pronë e shkollës	0.33,74 ha	/	/	E uzurpuar	/	/
Stacioni Policor Rahovec	SHPK-së	0.17,26 ha S=810 m ²	99	8.1 m ²	Mirë	Mirë	/ 810m ²
Ish NSP Xërxe	/	/	/	/	/	/	/
Sub-station Krushë e Madhe	Police	0.14,60 ha /	/	/	Relativisht mirë	/	/
Ratkoc	Kuvendi Komunal Rahoves	0.29,42 ha /	/	/	/	/	/
Stacioni policor Dragash	Policisë	0.20,41 ha S=1283m ²	93	13.7 m ²	Mirë	Mirë	/ 1283m ²

Shtojca A (8) – Prona e pajuajtshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronari ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metër katror për personel	Kushtet e vlerësuara nga SHPK-ja	Kushtet e vlerësuara nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Ish NSP Bresanë	Policisë	0.01,05 ha /	/	/	I shkatërruar	/	/
Shtabi regjional Mitrovicë	Kuvendi Komunal-Mitrovicë	0.08,75 ha S=1650m ²	144	11.4 m ²	Mirë	Mirë	0.8.75ha 2223m ²
Stacioni policor- Veri	SHPK-së	0.30,17 ha S=1800m ²	101	17.8 m ²	/	Kënaqshëm	0.17.50ha 2960m ²
Stacioni Policor -Jug	Kuvendi Komunal Mitrovicë	0.19,04 ha S=861 m ²	170	5.0 m ²	Mirë	Kënaqshëm	0.19.40ha 1722m ²
Ish NSP Stantrg	OP. Trepça	0.37,28 ha /	/	/	/	/	/
Stacioni policor Vushtrri	Kuvendi Komunal-Vushtrri	0.41,90 ha S=1400m ²	174	8.0 m ²	Mirë	Mirë	0.23.61 ha 760m ²
Ish NSP Vushtrri	SHPK-së	0.05,73 ha /	/	/	Shfrytëzohet nga Qendra për Punë Sociale	/	/
Akademia Policore	Kuvendi Komunal-Vushtrri	6.16,15 ha /	/	/	Mirë	/	/
Ish NSP Dubovc	Kuvendi Komunal Vushtrri	1.07,37 ha /	/	/	I braktisur dhe i demoluar	/	/
Ish NSP Prilluzhë	Kuvendi Komunal Vushtrri	0.12,49 ha /	/	/	Ka nevojë për renovim	/	/

Shtojca A (9) – Prona e pajuajtshme në pronësi/ e kontrolluar/ në shfrytëzim të SHPK-së në vitin 2007

Objekti	Pronari ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metër katror për personel	Kushtet e vlerësuara nga SHPK-ja	Kushtet e vlerësuara nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Stacioni policor Kamenicë	SHPK-së	02.25,65 ha S=737,03 m ²	128	5.7 m ²	Mirë	Mirë	3.00.00ha 956m ²
Ish NSP Hogoshtë	Policisë	0.22,39 ha	/	/	Mirë	/	/
Ish NSP Muqivercë	Kuvendi Komunal Kamenicë	0.35,63 ha /	/	/	Relativisht mirë	/	/
Ish NSP Ranilluk	Policisë	o.28,69 ha /	/	/	/	/	/
Ish NSP Kopërnice	Policisë	2.38,89 ha /	/	/	/	/	/
Stacioni policor Viti	Policisë	0.25,11 ha S=501.65m ²	91	5.5 m ²	Mirë	Dobët	0.25.11ha 855m ²
Ish NSP Klllokot	Policisë	0.30,00 ha /	/	/	Ka nevojë për renovim	/	/
Ish NSP Pozhoran	Policisë	0.29,90 ha /	17	/	Shfrytëzohet nga Shtëpia e Shëndetit	/	/
Stacioni policor Novobërdë	Kuvendi Komunal- Novo Bërdë	0.09,76 ha 530 m ²	28	18.9 m ²	Ka nevojë për renovim	Kënaqshëm	0.9.76ha 530m ²
Shtabi regjional dhe stacioni policor Ferizaj	Kuvendi Komunal- Ferizaj	11.52,01 ha 26855.50m ²	395	67.9 m ²	Mirë/ SHPK-ja e shfrytëzon një pjesë të tokës	Mirë	KRF&stac.pol.Ferizaj 2.45.20ha 26855.50 m ²

Shtojca A (10) – Pronë e paluajtshme e huazuar/kontrolluar/ e shfrytëzuar nga SHPK-ja në vitin 2007

Objekti	Pronari ligjor	Sipërfaqja e tokës dhe e objektit (m ²)	Numri i personelit	Metër katror për personelin	Kushtet e vlerësuara nga SHPK-ja	Kushtet e vlerësuara nga IPK-ja	Të dhënat të cilat i posedojnë komandantët e stacioneve
Ish NSP Babushi i Serbëve	Policisë	0.10,69 ha /	/	/	Relativisht mirë	/	/
Ish NSP Gatnje	Bashkësia fetare serbe	0.14,54 ha /	/	/	/	/	/
Stacioni policor Shtërpce	Policisë	0.12,98 ha S=225,66m ²	68	3.3 m ²	Relativisht mirë	Dobët	0.12.29ha 225.60m ²
Stacioni policor Shtime	Policisë	0.77,45 ha S=300m ²	60	5.0 m ²	Mirë	Dobët	0.77.45ha 300m ²
Ish NSP Nerodime e Epërme	Pronë shoqërore e shkollësl	0.10,69 ha /	/	/	Mirë	/	/
Stacioni policor H.Elezit	/	/	/	/	Mirë	/	/
Stacioni policor Kaçanik	Kuvendi Komunal Kaçanik	0.14,58 ha S=2108m ²	103	20.4 m ²	Mirë	Mirë	0.49.53ha 2108m ²

Shtojca B

Analizë e përbërjes etnike në SHPK në bazë të gradave (2006)

	Shqiptar		Serb		Boshnjak		Ashkali		Turk		Goran		Kroat		Roma		Egjiptian		Malaz.		Totali	%	
	Nr.	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr.	%			Nr	%	Nr	%	Nr.	%	Nr	%			
Gjen. Nën-Kolonel	1	100																				1	0.07
Gjen. Major	4	100																				4	0.29
Kolonel	14	87.5	1	6.25	1	6.25																16	1.19
Nën-Kolonel	23	85.1	1	3.7	3	11.1																27	2.01
Major	27	84.3	4	12.5	1	3.1																32	2.38
Kapiten	81	88	9	9.7	1	1.0			1	1.0												92	6.85
Toger	283	93.0	12	3.9	3	0.9			2	0.65	2	0.6			2	0.65						304	22.6
Rreshter	721	83.0	69	7.9	47	5.4	4	0.4	13	1.4	6	0.6	2	0.2	1	0.1	3	0.3	1	0.1		868	64.6
Totali	1154		96		56		4		16		8		2		3		3		1		1343	100	
%	86.0		7.14		4.16		0.29		1.19		0.59		0.14		0.22		0.22		0.07		100		



ankesatipk@gmail.com

038 213 670

Rr. "Armend Daci", Nr#1
Bregu i Diellit
Prishtinë